

**KOMISIONI EVROPIAN**

Bruksel, 9 nëntor 2010  
SEC (2010) 1335

**DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT**

***RAPORT ANALITIK***

*që shoqëron*

**KOMUNIKATËN E KOMISIONIT PËR PARLAMENTIN EVROPIAN  
DHE KËSHILLIN**

**Opinion i Komisionit për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian**

{COM(2010)680}

## PASQYRA E LËNDËS

<b>A.</b>	<b>Hyrje.....</b>	<b>4</b>
a)	Aplikimi për anëtarësim .....	4
b)	Marrëdhëniet BE-Shqipëri.....	5
c)	Përmbajtja e Raportit Analitik.....	8
<b>B.</b>	<b>Kriteret e anëtarësimit.....</b>	<b>9</b>
<b>1.</b>	<b>Kriteri politik.....</b>	<b>9</b>
1.1.	Demokracia dhe shteti i së drejtës.....	10
1.1.1.	Parlamenti.....	11
1.1.2.	Ekzekutivi.....	13
1.1.3.	Administrata publike.....	16
1.1.4.	Sistemi gjyqësor.....	18
1.1.5.	Politika anti-korrupsion.....	23
1.1.6.	Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë.....	25
1.2.	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.....	26
1.3.	Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.....	37
1.4.	Vlerësim i përgjithshëm.....	39
<b>2.</b>	<b>Kriteri ekonomik.....</b>	<b>42</b>
2.1.	Zhvillimet ekonomike.....	42
2.2.	Vlerësimi në raport me Kriteret e Kopenhagënit.....	44
2.2.1.	Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale.....	44
2.2.2.	Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së .....	51
2.3.	Vlerësim i përgjithshëm.....	56
<b>3.</b>	<b>Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit.....</b>	<b>57</b>
3.1.	Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave.....	58
3.2.	Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve.....	61
3.3.	Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime.....	63
3.4.	Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit.....	65
3.5.	Kapitulli 5: Prokurimi publik.....	67

3.6.	Kapitulli 6: Legjislacioni për shoqëritë tregtare.....	68
3.7.	Kapitulli 7: Legjislacioni për pronësinë intelektuale.....	70
3.8.	Kapitulli 8: Konkurrenca.....	72
3.9.	Kapitulli 9: Shërbimet financiare.....	74
3.10.	Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media.....	75
3.11.	Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural.....	78
3.12.	Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare.....	82
3.13.	Kapitulli 13: Peshkimi.....	85
3.14.	Kapitulli 14: Politikat e transportit.....	87
3.15.	Kapitulli 15: Energjia.....	89
3.16.	Kapitulli 16: Tatimet.....	92
3.17.	Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare.....	94
3.18.	Kapitulli 18: Statistikat.....	95
3.19.	Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi.....	96
3.20.	Kapitulli 20: Politika për ndërmarrjet dhe industrinë.....	100
3.21.	Kapitulli 21: Rrjetet trans-Evropiane.....	102
3.22.	Kapitulli 22: Politika rajonale dhe bashkërendimi i instrumenteve strukturore.....	104
3.23.	Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.....	107
3.24.	Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria.....	113
3.25.	Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi shkencor.....	118
3.26.	Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura.....	120
3.27.	Kapitulli 27: Mjedisi.....	122
3.28.	Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit.....	126
3.29.	Kapitulli 29: Bashkimi doganor.....	129
3.30.	Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë.....	132
3.31.	Kapitulli 31: Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes.....	134
3.32.	Kapitulli 32: Kontrolli financiar.....	136
3.33.	Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore.....	137
3.34.	Vlerësim i përgjithshëm.....	138
	Shtojca statistikore.....	141

## A. HYRJE

### a) Aplikimi për anëtarësim

Shqipëria e paraqiti aplikimin e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian në 28 prill 2009. Në 16 nëntor 2009, Këshilli i Bashkimit Evropian i kërkoi Komisionit të paraqiste opinionin e tij për këtë aplikim, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 49 të Traktatit të Bashkimit Evropian, i cili shprehet se: *‘Çdo shtet evropian i cili respekton vlerat e përmendura në nenin 2 dhe angazhohet në përkrahje të këtyre vlerave, mund të aplikojë për t’u bërë anëtar i Bashkimit. Parlamenti Evropian dhe parlamentet kombëtare njoftohen për këtë aplikim. Shteti aplikant ia paraqet aplikimin Këshillit i cili shprehet me unanimitet pasi të jetë këshilluar me Komisionin dhe pasi të ketë marrë pëlqimin e Parlamentit Evropian i cili shprehet me shumicën absolute të anëtarëve që e përbëjnë. Do të merren parasysh kushtet e pranueshmërisë për të cilat ka rënë dakord Këshilli Evropian’.*

Neni 2 shprehet se *‘Bashkimi është themeluar mbi vlerat e respektit për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, shtetin e së drejtës dhe respektin për të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve. Këto janë vlera të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri në të cilën sundojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia ndërmjet grave dhe burrave’.*

Ky është kuadri ligjor brenda të cilit Komisioni dorëzon Opinionin<sup>1</sup> dhe këtë raport analitik.

Këshilli Evropian i Feiras në qershor 2000, njohu vendet e Ballkanit Perëndimor pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit si vende ‘kandidate potenciale’ për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Perspektiva evropiane e këtyre vendeve u konfirmua edhe më tej nga Këshilli Evropian në Selanik në qershor 2003, i cili miratoi “Agjendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor”. Kjo agjendë mbetet themeli i politikës së BE-së për rajonin.

Këshilli Evropian në dhjetor 2006 ripërtëriu angazhimin e BE-së *“se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në Bashkimin Evropian”* dhe ritheksoi se *“përparimi i çdo vendi drejt Bashkimit Evropian varet nga përpjekjet e secilit për të përmbushur kriteret e Kopenhagënit dhe plotësimin e kushteve të Procesit të Stabilizim-Asociimit. Rezultatet e pëlqyeshme të një vendi në përmbushjen e detyrimeve të tij në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), duke përfshirë dispozitat në lidhje me tregtinë, janë një element thelbësor që Bashkimi Evropian të shqyrtojë aplikimin për anëtarësim”.* Në takimin ndërministror BE-Ballkani Perëndimor të Sarajevës në 2 qershor 2010, BE ritheksoi zotimin paekuivok për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe se e ardhmja e këtyre vendeve është në Bashkimin Evropian.

Në përputhje me kërkesat e Traktatit, ky vlerësim është përgatitur bazuar në kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara nga Këshilli Evropian. Në Kopenhagën, në qershor 1993, Këshilli Evropian arriti në përfundimin se:

*“Anëtarësimi realizohet sapo vendi të jetë i aftë të përballojë detyrimet e anëtarësimin nëpërmjet plotësimin të kushteve ekonomike dhe politike të kërkuara.*

---

<sup>1</sup> COM(2010) 680 datë 9.11.2010

*Anëtarësimi kërkon:*

*që shteti kandidat të ketë arritur stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve; ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, si dhe aftësinë për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut nga brenda Bashkimit; aftësinë për të përballuar detyrimet e anëtarësimin duke përfshirë mbështetjen për qëllimet e bashkimit politik, ekonomik dhe monetar”.*

Kapaciteti i Bashkimit për të përthithur anëtarë të rinj, duke ruajtur në të njëjtën kohë ritmin e integritetit evropian, është një faktor po aq i rëndësishëm, për t’u marrë parasysh në interesin e përgjithshëm si të Bashkimit ashtu edhe të vendeve candidate.

Në dhjetor 1995 në Madrid, Këshilli Evropian tërhoqi vëmendjen mbi nevojën për të “krijuar kushtet për integritetin gradual dhe të harmonizuar të vendeve [aplikante], veçanërisht përmes zhvillimit të ekonomisë së tregut, përshtatjes së strukturave të tyre administrative dhe krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm ekonomik dhe monetar”.

Kushtëzimet e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) u përcaktuan nga Këshilli në 31 maj 1999 dhe përfshijnë bashkëpunimin me Gjykatën Ndërkombëtare Penale për Ish-Jugosllavinë (GjNPIJ) dhe bashkëpunimin rajonal. Këto kushte janë elemente themelore për PSA-në dhe janë integruar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Shqipërinë, që hyri në fuqi në prill 2009.

Në dhjetor 2006, Këshilli Evropian ra dakord se ‘strategjia e zgjerimit e bazuar mbi konsolidimin, kushtëzimin dhe komunikimin, e kombinuar me kapacitetin e BE-së për të integruar anëtarë të rinj, formon bazën për një konsensus të ripërtërirë për zgjerimin’.

Në këtë Opinion, Komisioni analizon aplikimin e Shqipërisë mbi bazën e aftësisë së vendit për të plotësuar kriteret e përcaktuara nga Këshilli Evropian në Kopenhagën në 1993, ashtu edhe kushtëzimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit. Janë shqyrtuar edhe rezultatet e Shqipërisë në plotësimin e detyrimeve të saj në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duke përfshirë dispozitat në lidhje me tregtinë.

Në përputhje me konsensusin e ripërtërirë për zgjerimin, raporti analitik paraqet edhe vlerësimet e impaktit fillestar në fushat dhe sektorët kyç (liria e lëvizjes së punëtorëve, bujqësia dhe zhvillimi rural, politika rajonale dhe dispozitat financiare dhe buxhetore). Për këto fusha kyçe, Komisioni paraqet vlerësime më të hollësishme të impaktit në fazat e mëvonshme të procesit të para-anëtarësimin. Përveç kësaj, një traktat anëtarësimi për Shqipërinë do të kërkonte përshtatjen teknike të institucioneve të BE-së duke marrë parasysh Traktatin e Bashkimit Evropian.

## **b) Marrëdhëniet BE-Shqipëri**

Komuniteti Evropian vendosi marrëdhënie me Shqipërinë në qershor 1991, pas zgjedhjeve të para pluraliste në vend. Në vitin 1992, hyri në fuqi Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet

BE-së dhe Shqipërisë. Vendi fitoi të drejtën për financim nga programet e asistencës financiare të BE-së në dhjetor 1991. Bashkëpunimi ekonomik u forcua më tej në vitin 1999, kur Shqipëria filloi të përfitojë nga Preferencat Autonome Tregtare të BE-së. Që nga viti 2000, produktet e eksportit shqiptar fituan të drejtën e futjes pa detyrime doganore në tregun e BE-së.

**Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)** ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë<sup>2</sup> u nënshkrua në qershor 2006 dhe hyri në fuqi në prill 2006, duke zëvendësuar Marrëveshjen e Përkohshme për tregtinë dhe çështjet e lidhura me të, e cila kishte hyrë në fuqi në dhjetor 2006. Që nga viti 2001, BE dhe Shqipëria kanë organizuar mbledhje të dialogut politik në nivel ministror.

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit shënoi një etapë të re cilësore në marrëdhëniet dypalëshe, dhe ngarkoi Shqipërinë me detyrime dhe angazhime të reja në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, lëvizjes së lirë të punëtorëve, të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të kapitalit dhe shërbimeve, si edhe në transport, fushën audiovizuale dhe telekomunikacionin. Gjithashtu, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon dispozita për bashkëpunim të ngushtë mes BE-së dhe Shqipërisë në një numër fushash të politikave të BE-së. Në mjaft fusha, bashkëpunimi përqendrohet në prioritetet që lidhen me *acquis* e BE-së, ku Shqipëria angazhohet të përafrojë legjislacionin e saj me *acquis* dhe të bashkëpunojë me BE-në në realizimin e objektivave të përbashkëta.

Në përgjithësi, Shqipëria ka përmbushur mirë detyrimet në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Përkohshme. Shqipëria ka kontribuar në funksionimin e duhur të institucioneve të ndryshme të përbashkëta. Komiteti i Përbashkët i krijuar në bazë të Marrëveshjes së Përkohshme u mblodh në 2006, 2007 dhe 2008, dhe Grupet e Punës të lidhura me të, u mblodhën në 2007, 2008 dhe 2009. Mbledhjet e Këshillit të Stabilizim-Asociimit u zhvilluan në maj 2009 dhe maj 2010. Mbledhja e parë e Komitetit të Stabilizim-Asociimit u mbajt në mars 2010. Mbledhjet e nënkomiteteve u zhvilluan në 2009 dhe 2010.

Që nga viti 1993, janë zhvilluar takime vjetore ndërparlamentare mes përfaqësuesve të Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë. Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë për Shqipërinë në korrik 2010<sup>3</sup>.

Shqipëria merr pjesë në dialogun shumëpalësh ekonomik ndërmjet Komisionit, Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendeve kandidate potenciale në kuadrin e mekanizmit të mbikëqyrjes fiskale të para-anëtarësimit. Që nga viti 2006, Shqipëria përgatit Programin vjetor Ekonomik dhe Fiskal (PEF), i cili synon përgatitjen e vendeve kandidate potenciale për pjesëmarrje në procedurat e mbikëqyrjes shumëpalëshe dhe të koordinimit të politikave ekonomike, që aktualisht janë në fuqi në BE, si pjesë e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

**Partneriteti i parë Evropian** me Shqipërinë u miratua nga Këshilli në 2004. Në shkurt 2008, Këshilli miratoi Partneritetin e ri Evropian me Shqipërinë<sup>4</sup>.

---

<sup>2</sup> GZ L 107, 28.4.2009, f. 166

<sup>3</sup> Z. Nikolaos Chountis është raportuesi për Shqipërinë.

<sup>4</sup> GZ L 080, 19.3.2008, f. 1

Në kuadër të dialogut për liberalizimin e vizave, Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme në fusha të ndryshme të udhërrëfyesit. Për rrjedhojë, më 27 maj 2010, Komisioni paraqiti një propozim për heqjen e detyrimit për vizë për qytetarët shqiptarë, propozim i cili kushtëzohej me plotësimin e kriterëve të mbetura paplotësuar. Propozimi u miratua nga Parlamenti Evropian në 7 tetor dhe nga Këshilli në 8 nëntor. Marrëveshja e Ripranimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë është në fuqi që nga viti 2006.

Shqipëria u bë anëtare me të drejta të plota në Komunitetin e Energjisë të Europës Juglindore, në 1 korrik 2006. Traktati synon krijimin e një tregu rajonal të integruar të energjisë për energjinë elektrike dhe gazin natyror, si pjesë e tregut më të gjerë të BE-së. Shqipëria nënshkroi marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA) në qershor 2006.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007-2013) është dokumenti themelor i politikave strategjike të qeverisë shqiptare, e cila paraqet objektivat afatgjata të zhvillimit kombëtar dhe integritimit në BE. Strategjia përmban një përmbledhje të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale afatmesme dhe afatgjata. Shumica e strategjive sektoriale përmbajnë edhe plane veprimi, që përcaktojnë afate specifike për realizimin e aktiviteteve konkrete në secilin sektor brenda periudhës 2007-2013.

Bashkimi Evropian është **partneri më i rëndësishëm** tregtar i Shqipërisë. Në vitin 2009, tregtia me BE-në zinte 80% të volumit të përgjithshëm të tregtisë së jashtme të Shqipërisë.

Në vitin 2009, eksportet e Shqipërisë në BE-në arritën në rreth 86% të eksporteve totale të vendit, me një vlerë prej 595 milion Euro. Shqipëria eksporton kryesisht metale dhe minerale, tekstile dhe këpucë, produkte të përpunuara bujqësore dhe pije, si dhe materiale ndërtimi.

Në vitin 2009, 73.1% e totalit të importeve të Shqipërisë vinte nga BE-ja, me një vlerë prej 2,166 milion Euro. Eksportet e BE-së në Shqipëri përfshijnë mallra me përpunim të brendshëm aktiv, si tekstile dhe këpucë, produkte metali, mobilie dhe mallra elektronike, të cilat ri-eksportohen pothuajse tërësisht drejt Shteteve Anëtare të BE-së. Ndër importet e rëndësishme nga BE-ja janë edhe makineritë dhe pajisjet, energjia elektrike, produktet farmaceutike, si dhe duhani e cigaret.

Në vitin 2009, deficiti tregtar i Shqipërisë me BE-në arriti në 1,571 milion Euro.

Shqipëria u bë anëtare e OBT-së në vitin 2000 dhe është anëtare e CEFTA-s që nga viti 2007.

Shqipëria ka përfituar nga **asistenca financiare e BE-së** që nga viti 1991. Në total, në periudhën 1999-2010, BE-ja akordoi mbi 565.7 milion Euro për Shqipërinë. Në periudhën 1999-2006, Shqipëria përfitoi 259.6 milion Euro nga asistenca CARDS e BE-së. Që nga viti 2007, CARDS është zëvendësuar me programin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA), në kuadër të të cilit, Shqipëria ka përfituar asistencë në vlerën 306.1 milion Euro, në periudhën 2007-2010.

Programi CARDS në Shqipëri ka mbështetur stabilizimin demokratik, qeverisjen e mirë dhe forcimin e institucioneve, forcimin e kapaciteteve administrative, drejtësinë dhe çështjet e brendshme, zhvillimin ekonomik dhe social, mjedisin, dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programet Komunitare.

Në periudhën 2007-2010, programet IPA përqendrohen në fusha kyçe të kriterit politik, si reforma e gjyqësorit, policia dhe infrastruktura e vuajtjes së dënimit, shërbimi civil dhe reforma në administratën publike, parlamenti, të drejtat themelore dhe shoqëria civile. Për kriterin ekonomik dhe kriteret e anëtarësimit në BE, asistenca e IPA-s përqendrohet në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sistemin arsimor, tatimet, statistikat, të drejtat e pronësisë intelektuale, infrastrukturën mjedisore, transportin (rrugët dytësore/rurale), punësimin e përfshirjen sociale, dhe sigurinë ushqimore.

Shqipëria merr pjesë në tre programe bashkëpunimi ndërkufitar në “kufijtë e brendshëm” të Ballkanit Perëndimor (Mali i Zi, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova<sup>5</sup>; një program bashkëpunimi dypalësh ndërkufitar me një Shtet Anëtar të BE-së (Greqinë), dhe në disa programe shumëpalëshe (ku përfshihen Shtete Anëtare të BE-së), si p.sh. në Programet Transnacionale Evropiane ERDF: Hapësira e Europës Juglindore dhe Hapësira Mesdhetare, si dhe në programin rajonal të Adriatikut.

Asistenca e IPA-s administrohet në mënyrë të centralizuar nga Delegacioni i BE-së. Shqipëria po përgatit akreditimin për menaxhimin e fondeve të IPA-s. Asistenca IPA bazohet në një numër dokumentesh strategjike, të tilla si Partneriteti Evropian dhe prioritetet e MSA-së; këto janë pasqyruar në Dokumentet e Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar dhe Kuadret Financiare Indikativë Shumëvjeçare.

Marrëveshja Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë për pjesëmarrjen në Programet e BE-së u ratifikua në maj 2005. Shqipëria merr pjesë aktive në tre Programe të BE-së: Programi i 7-të Kuadër (FP7) për kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik (2007-2013), në Programin e veçantë për Sipërmarrjen dhe Novacionin (EIP) të Programit Kuadër për Konkurrueshmërinë dhe Novacionin (2007-2013), dhe në Programin Europa për Qytetarët. Fondet e IPA-s përdoren për të përballuar pjesërisht koston e pjesëmarrjes në të tre këto programe.

### **c) Përmbajtja e raportit analitik**

Raporti analitik merr parasysh konkluzionet e Këshillit Evropian të Kopenhagënit të vitit 1993 dhe konkluzionet pasuese të Këshillit Evropian. Raporti:

Përshkruan marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe BE-së;

Analizon situatën në lidhje me kushtet politike të vendosura nga Këshilli Evropian (demokracia, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut, mbrojtja e minoriteteve),

Vlerëson gjendjen e vendit dhe perspektivat në lidhje me kushtet ekonomike të vendosura nga Këshilli Evropian (ekonomi tregu funksionale, kapaciteti për të përballuar presionin e konkurrencës); i jep përgjigje pyetjes mbi kapacitetet e vendit për të marrë mbi vete detyrimet e anëtarësimit, d.m.th tërësinë e legjislacionit të BE-së siç përcaktohet në Traktat, legjislacionin dytësor, si dhe politikat e Bashkimit Evropian (*acquis* e Bashkimit Evropian);

---

<sup>5</sup> sipas Rezolutës 1244/1999 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së



Në përputhje me konkluzionet e Këshillit Evropian në dhjetor 2006, jep vlerësimin e impaktit fillestar në fushat e lirisë së lëvizjes së punëtorëve (kapitulli 2), bujqësisë dhe zhvillimit rural (kapitulli 11), politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore (kapitulli 22), dhe dispozitave financiare dhe buxhetore (kapitulli 33). Këto janë identifikuar si fushat kryesore të politikave që do të kërkojnë vëmendje të veçantë në rastin e anëtarësimit të Shqipërisë.

Gjatë vlerësimit të situatës së Shqipërisë në lidhje me kriteret ekonomike dhe kapacitetet e saj për të marrë përsipër detyrimet e *acquis*, Komisioni ka parashikuar edhe progresin që në mënyrë të arsyeshme, mund të pritët në vitet e ardhshme, përpara anëtarësimit të mundshëm, duke marrë parasysh faktin që vetë *acquis* do të vazhdojë të zhvillohet.

Komisioni ka përdorur një numër burimesh informacioni: përgjigjet e dhëna nga autoritetet shqiptare për një pyetësor të detajuar dhe për pyetje shtesë pasuese, misionet e ekspertëve, konsultimet me Delegacionin e BE-së në Shqipëri, raportimet nga ambasadat e Shteteve Anëtare në Tiranë, vlerësimet nga organizatat ndërkombëtare (duke përfshirë edhe Këshillin e Europës, OECD, OSBE, FMN, Bankën Botërore), si dhe organizatat jo-qeveritare lokale dhe ndërkombëtare.

Ky Opinion është përgatitur sipas një metodologjie të ngjashme me atë të përdorur në Opinionet e mëparshme me disa përshtatje që reflektojnë elementet e përfshirë në 'konsensusin e rinovuar mbi zgjerimin' të vitit 2006. Komisioni ka organizuar një numër misionesh ekspertësh në Shqipëri, të përqendruara kryesisht në fushën e mbuluar nga kriteret politike. Kjo metodologji lejoi një vlerësim të plotë të kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare, të mënyrës si zbatohet legjislacioni dhe ndihmoi për të identifikuar më mirë sfidat e mbetura dhe prioritetet për veprimet e ardhshme. Komisioni ka analizuar si gjendjen e tanishme, ashtu edhe perspektivën afatmesme. Në qëllimet e këtij Opinioni dhe pa paragjykuar ndonjë datë të ardhshme të anëtarësimit, perspektiva afatmesme është përcaktuar si një periudhë pesëvjeçare.

## **B. KRITERET E ANËTARËSIMIT**

### **1. KRITERI POLITIK**

Këshilli Evropian, në Kopenhagën në vitin 1993, vendosi një numër kriteresh politike për anëtarësim që duhet të plotësohen nga vendet aplikante. Një shtet duhet të ketë arritur '*stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve*'. Në rastin e Ballkanit Perëndimor, kushtet e përcaktuara nga Procesi i Stabilizim-Asociimit janë gjithashtu, një element themelor i politikës së BE-së, të cilat do të vlerësohen në këtë raport. Këtu përfshihet bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe realizimi i detyrimeve ndërkombëtare.

Kriteret politike të përcaktuara në Kopenhagën rrjedhin nga vlerat themelore mbi të cilat është themeluar BE-ja, siç shprehet neni 2 i Traktatit të Bashkimit Evropian. Këto parime janë theksuar në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Neni 6, pika 1 e Traktatit sanksionon se: '*Bashkimi i njehtë të drejtat, liritë dhe parimet e përcaktuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit*

*Evropian të datës 7 dhjetor 2000, ashtu siç është përshtatur në Strasburg më 12 dhjetor 2007, e cila do të ketë të njëjtën vlerë ligjore si Traktatet’.*

Vlerësimi i dhënë më poshtë shqyrton mënyrat kryesore të organizimit dhe funksionimit të autoriteteve publike, si edhe situatën në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore. Vlerësimi nuk kufizohet në një përshkrim formal, por synon të konstatojë se si funksionon në praktikë demokracia dhe shteti i së drejtës.

## **1.1 Demokracia dhe shteti i së drejtës**

Demokracia parlamentare u vendos në Shqipëri pas zgjedhjeve të marsit 1991. Këto zgjedhje u paraprinë nga ndryshimet e ligjit zgjedhor në dhjetor 1990 dhe janar-shkurt 1991, të cilat lejuan pluralizmin politik.

Në prill 1991, legjislatura e re shumëpartiake miratoi Ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese. Kjo ishte në fakt një kushtetutë e përkohshme që hodhi themelet e shtetit demokratik modern.

**Kushtetuta** aktuale u miratua me referendum në nëntor 1998. Kushtetuta sanksionon bazën për një republikë parlamentare, shtet unitar dhe të pandashëm bazuar në zgjedhje të lira. Ajo njeh liritë themelore dhe të drejtat e njeriut, si edhe pluralizmin politik, lirinë e shprehjes dhe besimit fetar, respektimin e pakicave, si dhe ndalimin e dënimit me vdekje. Sipas Kushtetutës, sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe ekuilibrin e pushteteve midis legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Institucionet kushtetuese janë të formuara.

Kushtetuta është ndryshuar dy herë, në vitin 2007 dhe 2008. Në vitin 2007, janë bërë ndryshime të vogla duke përfshirë edhe zgjatjen e mandatit të organeve të qeverisjes vendore dhe rritjen e numrit të anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndryshime më thelbësore u bënë në prill 2008. Këto përfshinin: ndryshimin e sistemit zgjedhor nga mazhoritar proporcional të përzier në një sistem proporcional rajonal, ndryshimin e procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, heqjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga Kushtetuta si organ kushtetues, kufizimin e mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm në mandat 5-vjeçar ndërkohë që më përpara ishte i pakufizuar, dhe ndryshimin e disa rregullave parlamentare.

Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese ka ardhur në rritje që nga viti 2005. Në disa raste, ajo ka shfuqizuar ose pezulluar ligjet e miratuara. Në vitet 2007-2010, u janë nënshtruar rishqyrtimit kushtetues 33 ligje: 18 janë gjetur pjesërisht antikushtetues, 2 tërësisht antikushtetuese, dhe në 13 raste Gjykata refuzoi shqyrtimin e kërkesave si jokushtetuese. Një nga vendimet e fundit të rëndësishme të Gjykatës, ishte vendimi për të ashtuquajturin ‘ligjin e lustracionit’ i cili u gjykua si antikushtetues pasi shkelte ndarjen e pushteteve.

Kushtetuta përcakton një kuadër të përshtatshëm për një qeverisje demokratike në përputhje me shtetin së drejtës. Megjithatë, në disa raste vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë kundërshtuar hapur ose janë shpërfillur nga institucionet qeveritare.

Në tërësi, Kushtetuta e Shqipërisë ofron një kuadër të arsyeshëm për një qeverisje demokratike në përputhje me shtetin e së drejtës. Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese ka ardhur në rritje që nga viti 2005. Megjithatë, respektimi i Kushtetutës në disa raste është sfiduar nga institucionet qeveritare duke vënë në dyshim dhe madje duke shpërfillur vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

### 1.1.1 Parlamenti

Shqipëria ka një sistem parlamentar me një dhomë. **Parlamenti** (apo Kuvendi) është organi më i lartë i pushtetit shtetëror dhe aktualisht përbëhet nga 140 deputetë të zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë dhe të përgjithshëm. Parlamenti zgjidhet çdo katër vjet. Në 2008, sistemi zgjedhor shqiptar ndryshoi nga një sistem i përzier (100 vende të plotësuara me shumicë të thjeshtë nga deputetë që fitonin në zonat zgjedhore, dhe 40 vende me përfaqësim proporcional kombëtar), në një sistem proporcional rajonal (140 vende me përfaqësim proporcional të plotësuara nga listat partiake në qarqe që korrespondojnë me ndarjen administrative ekzistuese. Objektivi i këtyre reformave ishte që ta bënte sistemin politik më të qëndrueshëm, të thjeshtonte makinerinë zgjedhore dhe të ulte personalizimin e garës elektorale.

**Zgjedhjet parlamentare** të qershorit 2009, u vlerësuan nga OSBE/ODIHR si një përmirësim krahasuar me praktikën e mëparshme dhe se e plotësuan shumicën e standardeve ndërkombëtare. Megjithatë, u identifikuan mangësi dhe u bënë një numër rekomandimesh për zgjedhjet e ardhshme. Raporti theksoi se zgjedhjet treguan përparim të prekshëm, veçanërisht në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe procesin e identifikimit, kuadrin ligjor, votimin, numërimin dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Megjithatë, raporti shtoi se zgjedhjet nuk arritën standardet më të larta dhe se politizimi i numërimit dhe përgatitjes së tabelave përmbledhëse minoi besimin e qytetarëve të procesit zgjedhor. Gjithashtu, mangësitë përfshinin edhe financimin jotransparent të partive politike dhe mbulimin mediatic me të meta.

Organizimi dhe funksionimi i parlamentit sanksionohet nga Rregullorja e Brendshme e miratuar me shumicë të thjeshtë. Sesionet parlamentare janë zakonisht të hapura për publikun. Organet drejtuese të parlamentit janë Kryetari, Byroja Parlamentare dhe Konferenca e Kryetarëve të grupeve parlamentare. Organe të tjera janë komisionet e përhershme, nënkomisionet, komisionet speciale, komisionet hetimore, Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Imuniteteve, dhe Komisioni i Ligjeve. Gjithashtu, parlamenti ka edhe një Komision të Përhershëm të Integritimit Evropian, i cili për momentin kryesohet nga opozita.

Parlamenti ushtron rolin legjislativ. Të drejtën e iniciativës legjislative e kanë Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si edhe 20,000 zgjedhës të regjistruar që paraqesin një peticion të nënshkruar. Projektligji shkon së pari për shqyrtim të komisionit parlamentar dhe pastaj në seancë plenare për votim. Parlamenti, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të 1/5 së anëtarëve të tij, mund të diskutojë dhe miratojë një ligj nëpërmjet procedurave të përshpejtuara. Gjithashtu, rregullorja e brendshme parashikon edhe sistemin e verifikimit të përputhjes së legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së.

Siç përcaktohet në Kushtetutë, parlamenti ushtron mbikëqyrje mbi ekzekutivin dhe institucionet e krijuara dhe të votuara nga ai vetë. Rregullorja e brendshme parashikon një numër instrumentesh që

garantojnë rolin mbikëqyrës të parlamentit, duke përfshirë këtu edhe komisionet hetimore, interpelancat, seancat e pyetjeve dhe përgjigjeve, mocionet për debat, mocionet e votëbesimit, mocionet e mosbesimit, raportimet dhe peticionet.

Parlamenti ka miratuar një numër të konsiderueshëm ligjesh që nevojiten për reformat e domosdoshme sociale dhe ekonomike, si dhe për të përafëruar legjislacionin shqiptar me *acquis* e BE-së. Megjithatë, cilësia e legjislacionit të miratuar nuk i ka plotësuar gjithmonë standardet e duhura. Komisionet parlamentare shpesh punojnë nën një presion të madh kohe. Ka disproporcion të madh në volumin e punës ndërmjet komisioneve, dhe komisioni i ligjeve është veçanërisht i mbingarkuar. Pjesëmarrja e grupeve të interesit në seancat dëgjimore dhe konsultime është e kufizuar. Agjenda legjislative e Kuvendit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve, e cila përbëhet nga kryetarët e grupeve parlamentare, por jo nga kryetarët e komisioneve parlamentare. Për pasojë, ka pasur konflikte ndërmjet planit të punës të komisioneve dhe agjendës legjislative të Kuvendit. Pozicioni i kryetarit të parlamentit është keqpërdorur, veçanërisht nëpërmjet ushtrimit të ndikimit disproporcional mbi procesin e përcaktimit të agjendës legjislative, duke imponuar shpesh vendime afatshkurtra në vend që të zbatohen vendimet e përbashkëta të Konferencës së Kryetarëve.

Pavarësisht dispozitave kushtetuese, mungon mbikëqyrja parlamentare efektive mbi ekzekutivin dhe parlamenti nuk funksionon si institucion i pavarur. Interpelancat dhe seancat e pyetjeve përdoren rrallë dhe pyetje me shkrim nuk dorëzohen pothuajse asnjëherë. Kultura e fortë e politikës partizane polarizon qëndrimet në parlament, gjë e cila vështirëson funksionimin e duhur të Kuvendit dhe të komisioneve të tij. Komisionet hetimore janë përdorur më shpesh si arena për grindje politike të partive, sesa si instrumente të mbikëqyrjes parlamentare. Ato rrallë kanë prodhuar rezultate dhe për këtë arsye kanë pasur ndikim të kufizuar mbi politikën qeveritare. Ka konsensus të pakët mes partive në parlament në lidhje me funksionimin dhe standardet e parlamentit.

Aktiviteti parlamentar si për sa i përket miratimit të ligjeve, ashtu edhe ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse, prej shumë vitesh është karakterizuar thellësisht nga dialogu i vështirë dhe shpesh jokonstruktiv. Që nga zgjedhjet e qershorit 2009, aktiviteti i parlamentit është eklipsuar dhe penguar nga ngërçi politik. Partia Socialiste në opozitë ka bojkotuar punën e parlamentit për periudha të gjata kohe që pas zgjedhjeve, duke kërkuar transparencë dhe hetim të parregullsive të pretenduara në zgjedhje. Qeveria nga ana e saj, nuk ka treguar gatishmëri për kompromis për propozimet për kapërcimin e bllokimit politik, të bëra nga Partia Socialiste. Për pasojë, dialogu politik është përkeqësuar edhe më tej, duke qenë mjaft konfrontues dhe joproduktiv ose shpesh krejtësisht joekzistent. Ngërçi politik dhe pengimi i parlamentit e thellon edhe më shumë mbikëqyrjen e dobët parlamentare. Dy kampet kundërshtarë të përbëra nga partitë qeveritare dhe Partia Socialiste nuk i kanë kapërcyer mosmarrëveshjet mes tyre edhe tani një vit pas zhvillimit të zgjedhjeve. Kjo nuk është arritur, edhe pse u përfshinë shumë palë, si partitë kryesore në Parlamentin Evropian dhe komuniteti ndërkombëtar, të cilat synonin përgatitjen e terrenit për arritjen e një zgjidhjeje.

Ngërçi politik është duke dëmtuar funksionimin e demokracisë në Shqipëri dhe po pengon reforma të rëndësishme të cilat janë të domosdoshme për përparimin e vendit në rrugën drejt integritimit në BE dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Akte të rëndësishme të legjislacionit të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar (tre të pestat e të gjitha votave) nuk mund të miratohen. Po vonohet shumë reforma

zgjedhore e domosdoshme për zgjedhjet e ardhshme vendore. Kjo situatë politike rrezikon të shkaktojë polarizim të thellë dhe të zgjatur të klasës politike me pasoja serioze për gatishmërinë për kompromis dhe gjetjen e konsensusit për reformat kyçe. Dialogu konstruktiv ndërpartiak është i domosdoshëm për të siguruar funksionimin e mirë të parlamentit të bazuar në rregulloren e tij.

Strukturat e parlamentit janë relativisht të dobëta dhe shumë aktivitete kryhen më tepër mbi bazë *ad hoc* sesa sipas procedurave të përcaktuara. Politizimi i personelit administrativ e profesional të parlamentit është i dëmshëm për organizimin e përgjithshëm të veprimtarisë. Përveç kësaj, kapacitetet e punonjësve janë të kufizuara dhe ka ndërrime të shpeshta të tyre.

*Në tërësi*, Shqipëria është demokraci parlamentare e bazuar mbi një kuadër kushtetues dhe legjislativ që është në përputhje me parimet dhe standardet evropiane. Megjithatë, parlamenti nuk funksionon plotësisht si institucion i pavarur dhe për këtë arsye nuk ushtron në mënyrë efektive dhe eficiente funksionin e tij të mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi qeverinë. Kultura politike është e pafavorshme për dialogun politik konstruktiv. Që nga zgjedhjet e qershorit 2009, veprimtaria parlamentare është penguar nga ngërçi politik mes partive të shumicës dhe Partisë Socialiste në opozitë. Duhet t'u jepet një zgjidhje e plotë rekomandimeve të OSBE-ODIHR për zgjedhjet e 2009 dhe të zbatohen ato deri në fund duke pasur parasysh zgjedhjet e ardhshme.

#### 1.1.2. Ekzekutivi

Presidenti i Republikës zgjidhet nga Parlamenti me shumicë të cilësuar, me tre të pestat e 140 votave në tre rundet e para të votimit dhe shumicë të thjeshtë në dy rundet e fundit. Presidenti ka rol ekzekutiv të kufizuar. Presidenti dekreton ligjet e miratuara nga parlamenti dhe ka të drejtë që t'i kthejë ato në seancë plenare për rishqyrtim. Ai është Komandanti i Përgjithshëm i forcave të armatosura. Presidenti emëron Kryeministrin me propozimin e partisë ose koalicionit të partive që kanë fituar shumicën e vendeve në Kuvend, emëron dhe shkarkon ministrat me propozimin e Kryeministrit dhe emëron e shkarkon ambasadorët dhe përfaqësuesit e tjerë diplomatikë. Presidenti kryeson Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Ai emëron anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë me pëlqimin e parlamentit.

Presidenti aktual, Z. Bamir Topi u zgjodh në korrik 2007, për një periudhë 5-vjeçare. Ai ka rolin kushtetues të garantuesit të konsensusit, duke nxitur dialogun dhe kompromisin mes partive. Megjithatë, në disa nga çështjet kryesore debatit publik, duke përfshirë ngërçin politik që nga viti 2009, roli efektiv i Presidentit të Republikës ka mbetur i kufizuar. Në vitin 2010, disa nga emërimet e propozuara nga Presidenti për Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, nuk arritën të marrin pëlqimin e parlamentit.

Këshilli i Ministrave (KM) është organi ekzekutiv kryesor. Brenda 10 ditësh pas emërimit nga Presidenti, Kryeministri paraqet përpara parlamentit për miratim programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e qeverisë.

**Qeveria aktuale** udhëhiqet nga Kryeministri Sali Berisha. Ai u riemërua nga parlamenti në shtator 2009, pas zgjedhjeve të qershorit dhe formimit të qeverisë së koalicionit ndërmjet Partisë Demokratike

të Kryeministrit Berisha që kishte lënë detyrën dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim të Ilir Metës. Qeveria ka një zëvendëskryeministër (Ilir Meta, i cili është edhe Ministri i Ekonomisë) dhe 14 ministra, një nga të cilët është femër.

Në lidhje me detyrën kryesore të qeverisë për bërjen e ligjeve, mjeti kryesor i planifikimit është Programi Analitik të Projekt-akteve (PAP). Përpara miratimit, Programi ballafaqohet me prioritetet kryesore të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, megjithëse kjo lidhje nuk është sistematike, dhe një numër i madh ligjesh të paraqitura nga ministrinë e linjës në vitet e fundit nuk kanë qenë përfshirë në PAP. Kjo reflekton ambiciet e tepruara dhe afatshkurtra të qeverisë për agjendën legislative. Ka një mekanizëm për planifikimin e punës në institucione të ndryshme, por që nuk funksionon në mënyrë të mjaftueshme në praktikë.

Ligji kërkon konsultimin ndërministror për projekt-aktet juridike. Është detyrë e ministrinë të linjës që të organizojë grupe ndërministrorë dhe të ftojë ekspertë për të diskutuar projektligjet. Megjithatë, pjesëmarrësit në grupet ndërministrorë nuk kanë gjithmonë mandatat që të negociojnë marrëveshje në emër të ministrive të tyre, dhe kjo e ul efektivitetin e këtyre procedurave. Formalisht kërkohet që të kryhen konsultime të jashtme; megjithatë, konsultimet me një bazë të gjerë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të grupeve të interesit janë të rralla.

Në përgjithësi, kapacitetet e hartimit të legjislacionit në ministrinë e linjës dhe organet administrative janë të dobëta. Konkretisht, vëmendja e pamjaftueshme në zbatimin e ligjit, konsultimi i kufizuar me grupet e interesit dhe specialistët, agjenda legislative tejet ambicioze e qeverisë, si dhe shqyrtimi i kufizuar nga parlamenti, sjellin për pasojë akte ligjore me cilësi të dobët.

Zbatimi i duhur dhe respektimi i legjislacionit cenohet nga cilësia e dobët e akteve legislative. Për më tepër, zbatimi i ligjit pengohet hera-herës nga mungesa e kuptimit të plotë të rolit shoqëror dhe politik të ligjeve nga ana e institucioneve përkatëse të sektorit publik; këto për pasojë, nënvlerësojnë disa rregulla ligjore. Ka pasur raste kur respekti për ligjin dhe shteti i së drejtës janë vënë në pikëpyetje nga qeveria, ku vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë kundërshtuar ose madje edhe nuk janë marrë parasysh.

Qeveria ka investuar në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), i cili mishëron parimet se qeveria duhet të ketë një grup të qartë dhe koherent prioritetesh të politikave që janë të lidhura me procesin e buxhetit. Komiteti i Planifikimit Strategjik është forumi më me influencë për diskutimin ndërmjet ministrave të prioritetëve dhe strategjive sektoriale kryesore; ky komitet ndërministror i kryesuar nga Kryeministri, po përqendrohet gjithnjë e më tepër në lidhjen mes politikave/ prioritetëve dhe çështjeve të buxhetit. Pavarësisht zhvillimeve pozitive në këtë drejtim, koherenca ndërmjet SPI, PAP dhe buxhetimit mbetet e dobët.

Ministria e Integritimit (MIE) u krijua në vitin 2004, duke pasur si detyrë kryesore koordinimin e punës për integrimin evropian të qeverisë. U krijuan po ashtu, edhe drejtoritë e integritimit evropian në ministrinë relevante të linjës.

Me qëllim që të racionalizonte dhe përmirësonte koordinimin e procesit të integritimit evropian, qeveria shqiptare krijoi Komitetin e Koordinimit Ndërinstitucional, të kryesuar nga Ministri i Integritimit dhe të përbërë nga zëvendësministrat ose sekretarët e përgjithshëm të çdo ministrie të linjës, ashtu edhe nëpunës të institucioneve qendrore relevante. Komiteti mblidhet të paktën një herë në muaj.

Përpara pyetësorit të Opinionit, u krijuan grupet ndërinstitucionale të përhershme të punës që mbulonin kapitujt e veçantë të *acquis*. Sekretariati i ri Evropian u krijua brenda MIE-s për të koordinuar punën e këtyre grupeve. MIE së bashku me grupet e punës kanë menaxhuar në mënyrë të kënaqshme procesin e përgjigjeve të pyetësorit.

Kushtetuta shqiptare parashikon se **pushteti vendor** bazohet në parimin e decentralizimit dhe i ushtron kompetencat e saj në përputhje me parimin e autonomisë vendore. Kushtetuta përmban parimet bazë të Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore të ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1999.

Komunat dhe bashkitë janë njësitë bazë të qeverisjes vendore. Këshillat e komunave, bashkive dhe prefekturave rregullojnë dhe menaxhojnë çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre. Ato ushtrojnë të drejtat e pronësisë, administrojnë të ardhurat e tyre në mënyrë të pavarur dhe kanë të drejtë të angazhohen në aktivitet ekonomik, të mbledhin të ardhura dhe të shpenzojnë fondet e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre. Po ashtu, ato kanë të drejtë që në përputhje me ligjin të vjelin taksat vendore dhe të përcaktojnë nivelin e këtyre taksave.

Kryetarët e komunave dhe bashkive mund të shkarkohen nga qeveria në rastet e shkeljeve të rënda në detyrë. Qeveria emëron prefektë për të verifikuar ligjshmërinë e akteve ligjore të miratuara nga qeverisja vendore. Prefektët mund të ushtrojnë edhe kontroll financiar mbi këto organe, megjithëse nuk kanë marrëdhënie varësie ndërmjet tyre. Bashkëpunimi ndërmjet organeve vendore dhe prefektëve të emëruar nga qeveria funksionon përgjithësisht mirë.

Pavarësisht debatit të madh mbi procesin e decentralizimit, u zbatuan vetëm pak nga masat e planifikuara në strategjinë e qeverisjes vendore dhe decentralizimit 2007-2010. Transferimi i disa prej kompetencave u bë vetëm pak kohë pas njoftimit për këtë veprim dhe shpesh pa përgatitje adekuate. Ligji për planifikimin e territorit dhe ndryshimet e tij, shkaktoi shqetësime në lidhje me konflikte të mundshme me strukturat ekzistuese rajonale dhe vendore.

Përkeqësimi i klimës politike në nivel kombëtar ka ndikuar në marrëdhëniet mes pushtetit qendror dhe vendor. Ndikim ka pasur edhe në veprimtaritë e shoqatës së përfaqësuesve të qeverisjes vendore. Një shoqatë e dytë u krijua nga zyrtarët vendorë të zgjedhur të opozitës.

*Në tërësi*, institucionet qeverisëse në përgjithësi funksionojnë, megjithëse me disa mangësi. Këto kanë të bëjnë veçanërisht me cilësinë e ulët të hartimit të akteve ligjore dhe konsultimet e kufizuara me palët e treta për politikat publike. Kjo nga ana e saj, çon në mangësi serioze në zbatimin dhe respektimin e legjislacionit. Përbëjnë shqetësim rastet e mosrespektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga qeveria në vitet e fundit dhe politizimi i votimit për emërimet e Presidentit në

Gjykatën Kushtetuese. Presidenti nuk ka qenë në gjendje që të përmbushë rolin e tij kushtetues si garantues i konsensusit, duke nxitur dialogun dhe kompromisin mes partive. Sistemi i qeverisjes vendore në Shqipëri është në përputhje me parimet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Bashkëpunimi ndërmjet pushtetit vendor dhe prefektëve të emëruar nga qeveria, funksionon në tërësi mirë. Në vitet e fundit, nuk janë zbatuar masat e planifikuara për decentralizimit. Mungesa e dialogut politik konstruktiv në nivel qendror ka ndikuar në marrëdhëniet ndërmjet nivelit qendror dhe vendor.

### 1.1.3. *Administrata publike*

Kushtetuta shqiptare, Ligji për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, dhe ligje të tjera të veçanta për organizimin dhe funksionimin e institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, ose ministrive të linjës, përcaktojnë rregullat për krijimin dhe funksionimin e institucioneve qendrore të administratës publike. Ky legjislacion përcakton misionin, fushën e veprimit, kompetencat, aktivitetin dhe mënyrën e financimit të tyre. Institucionet e krijuara në këtë mënyrë përfshijnë: institucionet politike (parlamentin), institucionet gjyqësore (gjykatat), institucionet e pavarura (Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Anti-Korrupsionit, inspektoratet sektoriale, Avokati i Prokurimeve, prefektët).

Meqë nuk ka një ligj të unifikuar për organizimin dhe funksionimin e përgjithshëm të administratës publike, ekziston rreziku i fragmentimit ndërmjet akteve të ndryshme ligjore. Me këto akte ligjore ngrihen struktura administrative dhe sanksionohen dispozita të posaçme për çdo institucion administrativ publik për sa i përket përgjegjësisë, llogaridhënies dhe kompetencave të tyre, pa qenë të detyruar të ndjekin rregulla të përgjithshme në nivel administrate shtetërore.

Statusi i nëpunësit civil rregullohet nga Ligji për shërbimin civil i vitit 1999, si edhe nga shumë akte nënligjore. Kodi i Punës është i zbatueshëm për nëpunësit civilë si legjislacion shtesë: ai mbulon shumë aspekte që lidhen me kushtet e punës në shërbimin civil. Kodi i Punës përbën kuadrin ligjor bazë për nëpunësit publike pa status nëpunësi civil. Siç përcaktohet edhe nga ligji për shërbimin civil, shërbimi civil në Shqipëri është një sistem i bazuar në pozicionin e punës me disa elemente të mekanizmit të karrierës. Ky sistem është më i ndjeshëm ndaj zëvendësimeve të stafit me motive politike, sesa një sistem që bazohet tërësisht mbi karrierën. Numri total i punonjësve publikë është rreth 90,000, përfshi 15,000 në administratën vendore dhe të prefekturave. Nga këta, vetëm 5,000 gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Rekrutimet në shërbimin civil bëhen në bazë të ligjit për shërbimin civil. Këto organizohen për çdo vend bosh, edhe pse çdo institucion duhet të raportojë një vit përpara parashikimin e tij për punësimet e reja. Ligji parashikon konkurset e hapura si e vetmja formë e rekrutimit të nëpunësve civilë. Shumica e fazave të konkurseve janë transparente. Por faza e fundit dhe vendimi për rekrutimin është plotësisht në dorën e eprorit përkatës. Një përjashtim nga konkurset e hapura është punësimi i përkohshëm me kontratë. Vitet e fundit përqindja e punësimeve me kontratë ka qenë relativisht e lartë (mesatarisht mbi 20%). Shumica e punonjësve të punësuar me kontratë, konfirmohen në detyrë në konkurset e hapura më pas. Qeveria nxori një vendim më 1 qershor që



synon kufizimin e praktikës së punësimit me kontratë; ky vendim dhe zbatimi i tij duhet të vërtetohen në praktikë. Vitet e fundit, në përgjithësi, ka pasur një përqindje të lartë të zëvendësimit të punonjësve për shkak të politizimit të praktikave të rekrutimit. Sistemi aktual i bazuar në pozicione pune, lë të hapur mundësinë e shkurtimeve të vendeve të punës për shkak të ristrukturimit të ministrive. Këto praktika minojnë procedurat dhe parimet e ligjit për shërbimin civil në lidhje me emërimet në bazë merite, dhe zvogëlojnë kapacitetin e përgjithshëm të administratës publike.

Ligji i shërbimit civil përcakton procedurat për transferimin paralel dhe ngritjen në detyrë të nëpunësve civilë përmes konkursit. Por, këto procedura janë zbatuar rrallë vitet e fundit.

Që në vitin 2006, qeveria ka zbatuar politikën e rritjes së pagave në shërbimin publik, duke aplikuar shkallë të ndryshme sipas sektorëve (rritjet më të mëdha ishin në arsim dhe shëndetësi). Rritja e pagave vazhdoi edhe në 2009 dhe 2010, pavarësisht presioneve globale për shtrëngime buxhetore, gjë e cila ndihmon në ngushtimin e hendekut të të ardhurave mes sektorit publik dhe privat, dhe rrjedhimisht ul ndërrimet e punonjësve.

Kodi i Etikës i vitit 2003 është detyrues për nëpunësit civilë. Megjithatë, një pjesë e Kodit të Etikës anashkalohet si i pazbatueshëm, pasi disa koncepte janë kontraktore. Kodi rregullon gjithashtu, edhe disa procedura për zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dorëzimi i deklaratave për konfliktin e interesit, është një kërkesë që zbatohet me rreptësi nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), por saktësia e këtyre deklaratave nuk verifikohet.

Strategjia për reformën në administratën publike dhe plani i veprimit i shtatorit 2009, synojnë të adresojnë mangësitë në funksionimin e administratës publike; ato parashikojnë rishikimin e ligjit për shërbimin civil dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të institucioneve zbatuese të legjislacionit të shërbimit civil. Duhet që këto ndryshime në ligj të bëhen në një klimë bashkëpunimi dhe me përfshirjen e të gjitha grupeve të interesit. Kjo kërkon vullnet politik dhe konsensus politik mbi nevojën dhe shtrirjen e reformës së administratës publike, pasi miratimi i këtyre ndryshimeve kërkon shumicë të cilësuar në parlament.

Dy institucione janë përgjegjëse për administrimin dhe monitorimin e menaxhimit të shërbimit civil në nivel shtetëror. Departamenti i Administratës Publike ka për detyrë menaxhimin e shërbimit civil në institucionet qendrore, ndërsa në institucionet e pavarura këtë funksion e kryejnë sektorët e tyre të burimeve njerëzore. DAP gjithashtu, ka rol qendror në reformën e administratës publike. Komisioni i Shërbimit Civil (KSHC) mbikëqyr ligjshmërinë e vendimeve të nivelit drejtues në lidhje me shërbimin civil, dhe vendos për ankimet e nëpunësve civilë në të gjitha fushat e ligjit për administratën publike. Përveç kësaj, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) ka për detyrë trajnimin e nëpunësve civilë.

Burimet administrative dhe kapacitetet organizative të DAP-it janë të pamjaftueshme dhe duhen forcuar, në mënyrë që të përballojnë dy funksionet kryesore: monitorimin e zbatimit të reformës së administratës publike dhe monitorimin e zbatimit të ligjit për shërbimin civil. Forcimi dhe ruajtja e kapaciteteve institucionale të Komisionit të Shërbimit Civil, si dhe ekzekutimi më i mirë i vendimeve

të KSHC-së nga ana e organeve administrative, kanë një rëndësi të veçantë për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësve civilë shqiptarë.

Në Shqipëri nuk ka gjykata administrative të veçanta. Shqyrtimi gjyqësor i akteve administrative kryhet nga seksionet administrative të gjykatave të shkallës së parë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Vendimet e gjykatave të shkallës së parë, mund të ankimohen – në përputhje me rregullat e përgjithshme procedurale – në gjykatat e apelit dhe në Gjykatën e Lartë. Megjithatë, mekanizmat ekzistues për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative janë shumë shpesh të pamjaftueshme. Projektligji që do të krijojë kuadrin bazë ligjor për gjykatat administrative në Shqipëri, kërkon shumicë të cilësuar dhe është pezull në parlament.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) është institucioni më i lartë auditues në Shqipëri (Shiko edhe Kapitullin 32 për kontrollin financiar). Kushtetuta i jep KLSH-së fushë të gjerë veprimi dhe mandatin që të kryejë lloje të ndryshme auditesh. KLSH është anëtar i EUROSAT-t që në 1993. Për shkak se KLSH nuk është i detyruar me ligj të kontrollojë të gjitha institucionet shtetërore çdo vit, burimet aktuale që ka janë të mjaftueshme. Në planin afatgjatë, KLSH duhet të forcojë më tej kapacitetet institucionale. Duhet të përmirësohet raportimi në Parlament dhe adresimi i rekomandimeve audituese nga ana e institucioneve shtetërore.

Ligji për **Avokatin e Popullit** i ngarkon këtij institucioni misionin që të garantojë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve nga veprimet e paligjshme ose mosveprimet e institucioneve të administratës publike apo të organeve private që veprojnë për llogari të shtetit. Gjithashtu, Avokati i Popullit monitoron zbatimin e ligjeve për transparencën dhe kontrollin e brendshëm, përfshi Ligjin për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare. Avokati i Popullit ka dhënë rekomandime solide dhe në kohë në fushat që ka në ngarkim. Por, këto rekomandime nuk zbatohen në mënyrë të mjaftueshme nga institucionet qeveritare. Puna e tij pengohet nga mungesa e burimeve dhe së fundmi nga shkurtimi i buxhetit, si edhe nga zvarritja e emërimit të Avokatit të ri të Popullit (*shiko edhe Seksionin 1.2 për të drejtat e njeriut dhe minoritetet*).

*Në tërësi*, kuadri i përgjithshëm ligjor administrativ dhe sistemi i shërbimit civil janë përgjithësisht në pajtim me standardet dhe parimet evropiane, por disa boshllëqe ekzistojnë. Zbatimi i duhur i kuadrit ligjor mbetet shqetësues, ashtu si edhe mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies në emërimet, si dhe politizimi i administratës publike. Nevojitet vullnet politik dhe përpjekje të fuqishme për zbatimin e plotë të ligjit për shërbimin civil dhe për të shënuar përparim me strategjinë për reformën në administratën publike, që janë të nevojshme për krijimin e një shërbimi civil të pavarur, profesional dhe mbi baza merite. Zgjedhja e pritur e Avokatit të Popullit si dhe respekti i mangët për rekomandimet e këtij institucioni, përbëjnë shqetësim.

#### 1.1.4. Sistemi gjyqësor (*Shiko edhe Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore*)

Sistemi gjyqësor bazohet në Kushtetutën e vitit 1998 dhe është i organizuar në tre shkallë, **Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë**. Shqipëria ka 22 gjykata të shkallës së parë, gjashtë gjykata apeli, një gjykatë të shkallës së parë për krime të rënda, një gjykatë apeli për krime të rënda dhe një Gjykatë të Lartë.

Gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Presidenti emëron anëtarët e Gjykatës së Lartë me pëlqimin e parlamentit (me shumicë të thjeshtë). Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë kanë mandat 9-vjeçar pa të drejtë riemërimi. Gjykata e Lartë është instanca e fundit kombëtare për çështjet civile dhe penale. Përveç kësaj, ka juridiksion fillestar kur gjykon akuza penale ndaj Presidentit të Republikës, Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Duke qenë instanca më e lartë e gjyqësorit në Shqipëri, Gjykata e Lartë luan një rol të veçantë në garantimin e zbatimit të njehsuar të praktikës gjyqësore

**Gjykata Kushtetuese** përbëhet nga nëntë gjyqtarë të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e parlamentit (me shumicë të thjeshtë) për një mandat 9-vjeçar pa të drejtë riemërimi. Gjykata vendos për përputhshmërinë me Kushtetutën të ligjeve si dhe të akteve normative, si për shembull të marrëveshjeve ndërkombëtare. Kur gjyqtarët e quajnë një ligj jokushtetues, ata pezullojnë shqyrtimin e çështjes dhe e dërgojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë detyruese për të gjitha gjykatat.

Gjykata Kushtetuese ka ushtruar pavarësi në rritje që nga viti 2005, duke nxjerrë vendime që në disa raste kanë anuluar akte ligjore të miratuara nga shumica. Megjithatë, ka shqetësime, që bëhen edhe më të mëdha nga ngërçi i tanishëm politik, lidhur me politizimin e votimit të pëlqimit në parlament për emërimin nga ana e Presidentit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo rrezikon paanshmërinë dhe pavarësinë e këtij institucioni.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, tre anëtarë të zgjedhur nga parlamenti (me shumicë të thjeshtë) dhe nëntë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për pesë vjet. Këshilli është përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, largimin dhe vlerësimin profesional të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe apelit.

Zëvendësimet e gjyqtarëve në Këshillin e Lartë për momentin, janë të bllokuara nga pezullimi i Ligjit për Konferencën Gjyqësore Kombëtare. Ndryshimet në këtë ligj duhet të miratohen nga parlamenti me shumicë të cilësuar (tre të pestat).

Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka kompetencë mbi Gjykatën e Lartë, e cila emërohet politikisht dhe ka një pozicion të jashtëzakonshëm brenda sistemit gjyqësor. Përfundimi i gjykatës së shkallës më të lartë nga rregullat e zbatueshme për gjykatat e shkallëve më të ulëta, e dobëson pavarësinë e gjyqësorit në tërësi.

Prokuroria kryen hetime penale, ngre akuzë para gjykatës në emër të shtetit dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë si një organ i centralizuar i cili i është bashkëngjitur sistemit gjyqësor. Në ushtrimin e kompetencave të tyre, prokurorët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.

Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e shumicës së thjeshtë të parlamentit, për një mandat 5-vjeçar dhe me të drejtë riemërimi. Prokurorët e tjerë emërohen nga

Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm. Prokuroria funksionon në bazë të udhëzimeve që jep Prokurori i Përgjithshëm, si një strukturë e centralizuar që përfshin Prokurorinë e Përgjithshme, Këshillin e Prokurorisë si dhe prokuroritë e tjera brenda sistemit gjyqësor.

Këshilli i Prokurorisë përbëhet nga gjashtë prokurorë dhe një përfaqësues i Ministrit të Drejtësisë dhe kryen funksione këshilluese, në ndihmë të Prokurorit të Përgjithshëm. **Sistemi i prokurorisë** është tejet i centralizuar dhe hierarkik. Ai konsiderohet se nuk është pjesë e sistemit gjyqësor ose e ekzekutivit. Autonomia e prokurorëve garantohet në fazën e gjykimit, por është e kufizuar në fazën e hetimeve, gjë e cila zbeh eficientësinë e hetimeve. Mungon qasja pro-aktive ndaj hetimeve si dhe përdorimi më i gjerë i metodave moderne të hetimit. Prokuroria e Përgjithshme ka ndërmarrë hapa për përmirësimin e funksionimit të saj, duke miratuar urdhra të brendshëm që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm të saj. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatimin e rregullave të reja. Pavarësia dhe përgjegjshmëria e sistemit të prokurorisë është dobësuar në veçanti, nga fakti se emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm bëhet me shumicë të thjeshtë të parlamentit; gjithashtu, mungon një sistem i shëndoshë vlerësimi dhe inspektimi për prokurorët.

Shkolla e Magjistraturës është e ngarkuar me formimin fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pranimi në Shkollë bëhet nëpërmjet një konkursi publik me provim me shkrim dhe anonim. Kandidatët me rezultatet më të mira nga provimi me shkrim, fitojnë të drejtën për të filluar trajnimin fillestar prej tre vjetësh për të marrë titullin e magjistratit dhe që kërkon një vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës. Ky sistem në tërësi po ndihmon në përmirësimin e kualifikimeve të magjistratëve si dhe në rritjen e transparencës së procedurave të rekrutimit.

Parimi i pavarësisë së gjyqësorit parashikohet në Kushtetutë dhe në legjislacionin përkatës. Kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarëve (përveç gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese) nuk mund të jetë i kufizuar; pagat e tyre dhe përfitimet e tjera nuk mund të ulen. Megjithatë, pavarësia efektive has në pengesa të mëdha. Politizimi i emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese cenon paanshmërinë dhe pavarësinë e këtyre institucioneve.

Pavarësia dhe forca goditëse e gjyqësorit është dobësuar edhe nga mungesa e sistemeve të shëndosha të vlerësimit për gjyqtarët, ashtu edhe nga mungesa e emërimeve dhe transferimeve në bazë merite. Emërimet fillestare dhe pasuese të gjyqtarëve në gjykatat e rretheve dhe ato të apelit bëhen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kushtet dhe procedurat e konkurrimit për përzgjedhje janë të përcaktuara me ligj. Një prej kriterëve për emërimin fillestar është që kandidatët duhet që të jenë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës. Megjithatë, 10% e të gjithë gjyqtarëve mund të emërohen pa mbaruar Shkollën e Magjistraturës, me të vetmin kusht që të kenë punuar më parë si gjyqtarë. Ngritjet në detyrë dhe transferimet në gjykatat më të larta bëhen në bazë të sistemeve të vlerësimit, të cilave u mungon transparenca si dhe zbatimi sistematik dhe konsistent. Përveç kësaj, kur propozon kandidatë për emërim, transferim ose poste drejtuese, Këshilli nuk e arsyeton vendimin e tij. Për kandidatët nuk janë parashikuar procedura apo dispozita ankimi ndaj vendimeve ose për shqyrtim gjyqësor. Kjo e fundit ndodh edhe për shkak të mungesës së gjykatave administrative, ngritja e të cilave është parashikuar në projektligjin që pret të miratohet me shumicë të cilësuar në parlament. Një mungesë e tillë përgjegjshmërie, transparence dhe mundësie ankimi, krijon rrezikun për ndërhyrje politike dhe korrupsion.

Gjykatat kanë një buxhet të posaçëm të cilin e propozojnë në përputhje me ligjin dhe e administrojnë vetë. Megjithatë, buxheti për gjyqësorin në përgjithësi, mbetet i pamjaftueshëm.

Përgjegjshmëria e gjyqësorit sigurohet me anë të inspektimeve që kryhen nga dy institucione. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë kryen inspektime si me nismën e tij, ashtu edhe në bazë të ankesave të qytetarëve. Po ashtu, ai kryen vlerësime profesionale të gjyqtarëve çdo tre vjet. Ministria e Drejtësisë kryen inspektime të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit duke u përqendruar në organizimin dhe punën e shërbimeve dhe administratës gjyqësore, sipas programeve të veçanta tematike apo territoriale.

Megjithatë, ka mbivendosje dhe mangësi koordinimi ndërmjet dy inspektorateve. Si Ministria e Drejtësisë ashtu dhe KLD-ja kanë kompetenca dhe zbatojnë procedura që nuk përputhen krejtësisht me standardet evropiane për inspektimin e gjyqtarëve dhe gjykatave. Mungon transparenca në vlerësimin e gjyqtarëve. Nisma për procedim disiplinor është vetëm në duart e Ministrit të Drejtësisë, pa asnjë baraspeshë apo kontroll. Për shkak se mungesa e procedimit disiplinor është element kyç për karrierën në gjyqësor, ekziston rrezik konkret i ndërhyrjes nga qeveria në këtë fushë kyçe. Për rrjedhojë, nuk janë vendosur sisteme të përgjegjshme dhe eficiente për inspektimet dhe për procedimet disiplinore të gjyqtarëve. Përveç kësaj, masat parandaluese kundër korrupsionit në gjyqësor nuk janë të mjaftueshme.

Parimi i barazisë përpara ligjit dhe e drejta për t'u gjykuar nga gjykata të paanshme është i parashikuar me Kushtetutë. Kodi i Etikës Gjyqësore është miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në vitin 2000 dhe që atëherë është mbikëqyrur prej saj. Në pjesën më të madhe të zyrave të gjyqësorit, ekziston një sistemi i kompjuterizuar për administrimin dhe ndarjen me short të çështjeve, si në procedimet civile ashtu edhe atë penale. Megjithatë, problemet me ndarjen e rastësishme të çështjeve në praktikë vazhdojnë të shfaqen kryesisht për shkak të mungesës së një përqsasjeje konsistente në të gjitha gjykatat si dhe mungesës së udhëzimeve të nevojshme dhe trajnimeve. Për të pasur një sistem të integruar, tejet uniform dhe të harmonizuar të menaxhimit të çështjeve dhe që të funksionojë dhe përdoret në të gjitha gjykatat, nevojiten përpjekje të mëtejshme.

Gjyqësori vuan nga problemet e transparencës dhe të efencës. Ka pengesa serioze në hetimin e rasteve të korrupsionit në gjyqësor, kryesisht për shkak të faktit se ligji u jep gjyqtarëve imunitet të plotë. Imuniteti i gjyqtarëve mund të hiqet vetëm me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjë që redukton ndjeshëm efektshmërinë e hetimeve të mundshme (*Shiko edhe seksionin 1.1.5 për korrupsionin*). Administrimi i gjykatave është i dobët, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare, sidomos në gjykatat e rrethit të shkallës së parë. Nuk ka asnjë organizim dhe trajnim të shëndoshë dhe adekuat për administratorët e gjykatave. Përbëjnë shqetësim vonesat e paarsyeshme në procedimet gjyqësore, si edhe numri i lartë i çështjeve të prapambetura. Procedimet gjyqësore janë të ngadalta dhe numri i seancave gjyqësore për një çështje është i lartë. Përveç kësaj, procedimet shpesh shtyhen ose madje bllokohen nga të paditurit. Kushtet e punës në gjykata mbeten të dobëta dhe seancat dëgjimore shpeshherë zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, duke u bërë pengesë për transparencën dhe efektshmërinë. Shqetësimet lidhur me sigurinë e gjyqtarëve vazhdojnë të jenë të

pranishme. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë është duke përgatitur ndryshime në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin Civil me synim ndreqjen e këtyre mangësive.

Në gjyqësor ekziston korrupsioni, rreziku për pavarësinë e gjyqtarëve, mungon transparenca dhe përgjegjshmëria për shumë prej procedurave, dhe ka mungesë efektshmërie në përgjithësi, në sistemin gjyqësor. Për pasojë, treguesit e perceptimit publik shënojnë një nivel shumë të ulët të besimit të tij tek gjyqësori. Çështjet kundër personave me pushtet janë të rralla dhe kur ato ndiqen penalisht, në shumicën e rasteve nuk rezultojnë me ndëshkime. Ka pasur raste kur Prokuroria e Përgjithshme ka kryer hetimin, por gjykimi është shtyrë për motive procedurale dhe për pasojë është pezulluar për shkak të imunitetit të të paditurit. Kjo inerci ushqen perceptimin e përgjithshëm se personat me pushtet nuk ndiqen penalisht për shkak të pushtetit politik dhe ekonomik.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë reforma në gjyqësor, duke përfshirë si përmirësimin e infrastrukturës së gjyqësorit, ashtu dhe hartimin e legjislacionit të harmonizuar me standardet evropiane. Megjithatë, Shqipërisë i mungon një strategji reformuese gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë për gjyqësorin. Për këtë qëllim, janë të rëndësishëm konsensusi dhe bashkëpunimi ndërinstucional për nevojën për reforma gjyqësore. Mungesa e kapaciteteve relevante në nivel teknik dhe të politikave brenda Ministrisë së Drejtësisë, pengon zbatimin efektiv të reformave në këtë sektor. Koordinimi me Këshillin e Lartë të Drejtësisë për reformat gjyqësore ka qenë i pamjaftueshëm. Për më tepër, nuk zbatohen gjithmonë mekanizmat e konsultimit adekuat dhe vlerësimit të ndikimit financiar dhe instucional të legjislacionit. Ka konfuzion lidhur me nismëtarin dhe hartuesin e ligjeve në sektorin e gjyqësorit. Në dhjetor 2009, Ministria e Drejtësisë krijoi një grup pune për përgatitjen e strategjisë së sektorit gjyqësor. Nuk janë miratuar akte të rëndësishme ligjore që nevojiten për plotësimin e kuadrit ligjor, duke përfshirë ligjet për Konferencën Gjyqësore Kombëtare, për gjykatën administrative dhe për administratën gjyqësore. Në veçanti, ligji për gjykatën administrative duhet të përfundohet dhe të miratohet brenda një afati kohor të arsyeshëm, në mënyrë që të mbushen boshllëqet ekzistuese në këtë fushë.

E drejta për avokat mbrojtës nuk është e detyrueshme në një numër shumë të madh rastesh. Kjo përbën shqetësim. Shpesh gjyqtarët e konsiderojnë të pamjaftueshme cilësinë e shërbimeve të ofruara nga avokatët. Ka raste të shumta në të cilat avokatët përdorin taktika të zvarritjes së çështjeve, siç është mosparaqitja në seanca, pa u përballur me procedime disiplinore nga ana e Dhomës së Avokatëve.

Ekzekutimi i vendimeve është i dobët, sidomos në rastet kur pala e paditur është institucion shtetëror. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në shumë raste, ka dhënë vendime kundër Shqipërisë për moszbatim të vendimeve të saj. Ligji për shërbimin e ri përmbartimor, i miratuar në vitin 2008, ende nuk ka hyrë plotësisht në fuqi. Sistemi i përmbartimit privat ende nuk ka nisur të funksionojë dhe nuk është ngritur për përmbartuesit ndonjë sistem i shëndoshë për menaxhimin e çështjeve. Ekzekutimi i vendimeve kundër institucioneve shtetërore, mund të përmirësohet nëse vihen në dispozicion burimet e duhura financiare dhe relevante nga buxheti i shtetit. Emërimi së fundmi i Komisionit Shtetëror për Ndhimën Ligjore është zhvillim pozitiv në promovimin e aksesit në drejtësi dhe do të çojë në vënien në zbatim të Ligjit për ndihmën ligjore, i miratuar në vitin 2008.

*Në tërësi, Shqipërisë i mungon tradita e pavarësisë së gjyqësorit. Ajo duhet të vazhdojë procesin e reformimit të gjyqësorit, përfshi miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të reformës në gjyqësor dhe të ligjeve kyçe që kanë ngelur pezull, si edhe krijimin e një historiku rezultatesh solide në zbatimin e ligjit, që do të demonstronte pavarësinë dhe eficientësinë e gjyqësorit. Duhet të adresohet mungesa e pavarësisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë në emërimin, transferimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve, si dhe të bëhen përmirësimet e nevojshme në sistemin e inspektimit të gjyqësorit. Fakti që parlamenti voton për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, mbart rrezikun e lartë të politizimit dhe rrjedhimisht të dobësimit të pavarësisë së institucioneve. Për të siguruar funksionimin eficient të gjykatave, nevojiten burime adekuate njerëzore dhe financiare si dhe kushte infrastrukturore. Shqipëria duhet të adresojë edhe korrupsionin në gjyqësor, duke marrë parasysh tëra aspektet relevante si pagat, imuniteti, siguria dhe politizimi i emërimeve kyçe.*

#### *1.1.5. Politikat anti-korrupsion (Shiko edhe Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore)*

Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë përpjekje të koordinuara për krijimin një kuadri ligjor dhe institucional për luftën kundër korrupsionit në fusha të caktuara. Megjithatë, korrupsioni mbizotëron në shumë fusha dhe është një problem veçanërisht serioz.

Shqipëria ka miratuar disa masa dhe ligje anti-korrupsion. Kodi Penal parashikon si vepra penale format kryesore të korrupsionit dhe Kodi i Procedurës Civile parashikon mjetet kyçe për luftimin e korrupsionit, duke përfshirë metodat speciale të hetimit. Ndryshimet në Kodin Penal parashikuan dispozita për mitmarrjen në sektorin publik, si edhe dispozita të reja për mitmarrjen në sektorin privat dhe ushtrimin e ndikimit të paligjshëm.

Në vitin 2008, u miratua një strategji ndërsektoriale për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Çdo vit hartohet një plan i përgjithshëm veprimi për zbatimin e strategjisë, i cili përgatitet nga një grup pune ndërministror. Plani i veprimit i vitit 2010 është më i detajuar dhe përfshin tregues të matshëm, gjë e cila duhet të lehtësojë zbatimin dhe monitorimin e tij. Ministrinë e linjës miratojnë edhe plane individuale, zbatimi i të cilëve është pjesë e një sistemi të përgjithshëm raportimi vjetor.

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Anti-korrupsion (DKBAA) kryen kontrole të brendshme mbi administratën dhe është organi administrativ i ngarkuar me koordinimin e veprimtarive të përcaktuara nga grupi ndërministror i punës.

Shqipëria ka një ligj për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të nëpunësve civilë dhe një ligj për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të punës në sektorin publik. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive (ILDKP) është i ngarkuar me pranimin dhe verifikimin e deklaratave të pasurive të zyrtarëve publikë, si dhe verifikon që pozicionet e tyre të jenë në përputhje me ligjin e konfliktit të interesit.

ILDKP mund të marrë masa administrative ndaj nëpunësve civilë në rast mosdorëzimi të deklaratave të tyre dhe mund të njoftojë prokurorinë kur ka shkelje të ligjit. ILDKP ka nisur të japë rezultate të

kënaqshme; megjithatë, duhet të përmirësohet më tej bashkëpunimi me organet e zbatimit të ligjit dhe me prokuroritë, për të shfrytëzuar plotësisht analizën dhe hetimet në lidhje me deklaratat e pasurisë.

Në Ministrinë e Brendshme, është ngritur Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB) për hetimin e rasteve të korrupsionit në polici. Ka dhënë disa rezultate. Disa oficerë të policisë rrugore janë hetuar dhe janë larguar nga puna për mitmarrje.

Janë ngritur Njësi të Përbashkëta Hetimore (NjPH) për krimet ekonomike dhe korrupsionin. Ato janë të vendosura në Tiranë dhe 6 qytete të tjera dhe kanë për qëllim të përmirësojnë koordinimin e agjencive të zbatimit të ligjit. NjPH-të përbëhen nga stafi policor nga prokuroria, policia e shtetit, policia doganore dhe tatimore dhe institucione të tjera relevante.

Sistemet e prokurimit elektronik janë futur në administratën publike për të reduktuar kontaktet personale ndërmjet autoriteteve kontraktuese dhe ofertuesve, gjë e cila zvogëlon mundësitë e mitmarrjes. Janë ndërmarrë reforma në sektorin e arsimit (p.sh baza elektronike e të dhënave për regjistrimin në shkollë dhe provimet anonime të pranimit) dhe në sektorin shëndetësor (p.sh rregullore e re për sistemin referues), në përpjekje për të forcuar luftën kundër korrupsionit në këto fusha. Megjithatë, mbetet që masat dhe politikat e spondërmarrja ta vërtetojnë efektshmërinë e tyre në praktikë.

Pavarësisht se kuadri ligjor dhe institucional është përmirësuar, korrupsioni mbetet i lartë në shumë sektorë dhe institucione, sidomos në sistemin gjyqësor, sektorin e shëndetësisë dhe të drejtat e pronësisë, por edhe në prokurimin publik dhe financimin e partive.

Kuadri ligjor ka boshllëqe për sa i takon luftës kundër korrupsionit. Kodi Penal nuk parashikon rastet e mitmarrjes nga zyrtarët publikë të huaj. Për më tepër, edhe nëse imuniteti i dhënë një grupi të madh zyrtarësh publikë (deputetë, ministra dhe gjyqtarë) ka për qëllim të rrisë pavarësinë e tyre, ai ka treguar se është pengesë serioze në hetimin e korrupsionit, gjë që rrit rrezikun e këtij fenomeni. Imuniteti mund të hiqet vetëm me vendim të Parlamentit ose të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kjo mënyrë është e komplikuar, kërkon kohë, pengon hetimin eficient dhe shumë rrallë ka sukses.

Struktura institucionale ka boshllëqe për sa i takon luftës kundër korrupsionit. Kapacitetet e DKBAA për të luajtur rol koordinues në kuadrin e strategjisë dhe të planit të veprimit, janë të kufizuara për shkak të mungesës së kapaciteteve. Monitorimi i zbatimit të plan veprimit nga ana e DKBAA është i pamjaftueshëm, sidomos raportimi dhe statistikat për korrupsionin. Në përgjithësi, i gjithë sektori i inspektiveve administrative është shqetësues, për sa i përket cënueshmërisë nga korrupsioni dhe kapaciteteve për të siguruar integritetin dhe transparencën në praktikën administrative. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm i Policisë ka dhënë rezultate kryesisht, në çështje të vogla korrupsioni. Institucionet e ndryshme të përfshira në luftën kundër korrupsionit, duhet të forcojnë bashkëpunimin ndërinstucional jashtë kuadrit të bashkëpunimit në NjPH. Kapacitetet për luftën kundër korrupsionit mbeten në kufizuara. Këtu përfshihen pagat e ulëta të prokurorëve dhe gjyqtarëve, numrin e stafit të kualifikuar, madje edhe kapacitetet e kufizuara për hetimin dhe praktikën e duhur gjyqësore.



Janë hetuar dhe ndjekur penalisht një numër në rritje i rasteve të korrupsionit, por shkalla e ndëshkimeve mbetet shumë e ulët. Nuk ka rezultate solide që të përfshijnë hetimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e çështjeve të korrupsionit të nivelit të lartë. Imuniteti i gjyqtarëve hiqet vetëm në raste të rralla. Këta faktorë përforcojnë kulturën e përgjithshme mbizotëruese të mosndëshkimit.

Me gjithë përfshirjen ministrore në task-forcën anti-korrupsion dhe grupin e punës, si dhe angazhimin e hapur të nivelit të lartë politik, rezultatet e luftës kundër korrupsionit nuk i përmbushin pritshmëritë.

Jashtë nivelit të institucioneve qendrore, ka mungesë të përgjithshme ndërgjegjësimi për kuadrin ligjor dhe mekanizmat ekzistues për të luftuar korrupsionin. Po ashtu, mungesa e njohurive të publikut për detyrat e institucioneve të caktuara dhe të drejtat e qytetarëve (p.sh sektori i shëndetësisë, sistemi gjyqësor) përkeqëson klimën e pashmangshmërisë së korrupsionit, në veçanti në fusha të caktuara.

*Në tërësi*, Shqipëria ka bërë përpjekje gjatë viteve të fundit për të ngritur një kuadër ligjor dhe institucional për luftën kundër korrupsionit, si dhe ka arritur disa rezultate fillestare. Megjithatë, korrupsioni mbizotëron në shumë fusha dhe është një problem veçanërisht serioz. Shqipëria duhet të plotësojë kuadrin ligjor duke adresuar rekomandimet dhe shqetësimet e GRECO-s lidhur me imunitetin e pakufizuar të zyrtarëve publikë të caktuar. Duhet të demonstron zbatimi i efektshëm i strategjisë anti-korrupsion dhe planit të veprimit, si dhe të arrihet në të gjitha nivelet një vijimësi rezultatesh solide të vërtetuara për ndëshkimin e rasteve të korrupsionit. Sektorët më shqetësues janë sistemi gjyqësor, sektori shëndetësor, të drejtat e pronës dhe financimi i partive politike.

#### *1.1.6. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë*

Kontrolli civil ndaj forcave të armatosura e të sigurisë si dhe ndaj shërbimeve informative, rregullohet nga një kuadër i plotë ligjor dhe të politikave, duke përfshirë kushtetutën dhe ligjet që rregullojnë forcat e ndryshme. Parlamenti është autoriteti më i lartë për kontrollin civil mbi forcat e armatosura dhe të sigurisë, si dhe mbi shërbimet informative. Institucione të tjera të rëndësishme me funksione kontrolli, të parashikuara me ligj, përfshijnë presidentin, kryeministrin, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Prokurorinë e Përgjithshme, Avokatin e Popullit dhe Inspektorin e Përgjithshëm.

Forcat e sigurisë në Shqipëri janë të ndara në tri kategori kryesore: forcat e armatosura, forcat policore dhe shërbimet e sigurisë.

Për sa i përket forcave të armatosura; Shtabi i Përgjithshëm, Komanda e Forcës së Bashkuar, Komanda e Mbështetjes dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes janë të gjitha nën suazën e Ministrisë së Mbrojtjes. Këto të gjitha kanë status ushtarak dhe përfshijnë një numër punonjësish civilë.

Forcat policore përbëhen nga: Policia e Shtetit, e cila është forcë policore kombëtare, me detyrën e ruajtjes së rendit publik dhe luftën ndaj krimit; Policinë bashkiake, të cilat shërbejnë nën autoritetin e njësisë të qeverisë vendore, si dhe Garda e Republikës e cila është forcë xhandarmërie që ka për detyrë mbrojtjen e pronës dhe personaliteteve shtetërore, dhe që ka status ushtarak dhe kompetenca

ndalimi. Ka inspektorate brenda ministrive të linjës, anëtarët e të cilave kanë attribute të oficerëve të Policisë Gjyqësore (kompetentë për të identifikuar dhe ndjekur shkeljet e ligjit dhe që raportojnë tek prokurori).

Shërbimet informative janë të ndara ndërmjet Shërbimit të Sigurisë së Brendshme që ka për detyrë përballjen me kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare dhe Shërbimit Informativ Ushtarak që kryesisht merret me kërcënimet nga jashtë ndaj sigurisë.

Parlamenti mbikëqyr sektorin e sigurisë përmes disa komisioneve brenda parlamentit, ku më relevantet janë Komisioni i Sigurisë dhe Komisioni i Ligjeve. Ata kryejnë seanca dëgjimore periodike të zyrtarëve mbi çështjet e sektorit të sigurisë. Megjithatë, kapaciteti i këtyre komisioneve dhe kompetencat e tyre ligjore për të kryer funksione efektive të mbikëqyrjes në një sistem kontrolli dhe ekuilibri, mbeten të pamjaftueshme. Përveç kësaj, ndërkohë që orientimi politik ose zhvillimi i politikave të sigurisë është brenda sferës së kompetencave të ministrave, ekzistojnë akoma ndërhyrje politike në sektorin e sigurisë që shtrihen deri në shkallët më të ulëta të hierarkisë.

*Në tërësi*, kontrolli civil mbi forcat e armatosura dhe të sigurisë si dhe shërbimet informative rregullohet nga një kuadër i plotë ligjor dhe politikash, në bazë të të cilit parlamenti është institucioni më i lartë mbikëqyrës. Mbikëqyrja parlamentare ndaj sektorit të sigurisë vuan nga dobësitë dhe ndërhyrjet politike.

## 1.2 **Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve** (*Shiko edhe Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore*)

### *Respektimi i të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut*

Respektimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve mishërohen në Kushtetutë dhe në një sërë dispozitash ligjore. Shqipëria ka ratifikuar pjesën më të madhe të **instrumenteve për të drejtat e njeriut**; këto janë pjesë e sistemit të brendshëm gjyqësor dhe janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme pas botimit në Fletoren Zyrtare. Shqipëria iu bashkua Këshillit të Europës në vitin 1995 dhe në vitin 1996 ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Deri më sot, **Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut** ka dhënë 29 vendime që kanë të bëjnë me Shqipërinë. Kryesisht, Gjykata ka gjetur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme, të së drejtës për dëmshpërblim efektiv si dhe të së drejtës për të gëzuar qetësisht të pronës. Në shtator 2010, GjEDNj kishte në shqyrtim 287 çështje që kishin të bënin me Shqipërinë.

Lidhur me **promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut**, Avokati i Popullit është institucioni kryesor kombëtar për të drejtat e njeriut. Ky institucion ka luajtur rol aktiv në monitorimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në vend, si dhe ka kontribuar në rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve shtetërore. Avokati i Popullit zgjidhet nga parlamenti me shumicë të kualifikuar. Për shkak të ngërçit politik në vazhdim, zgjedhja e Avokatit të ri të Popullit ka mbetur pezull prej muajit shkurt 2010. Fushat kryesore në të cilat ka ndërhyrë Avokati i Popullit, kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet për pronën, abuzimin e policisë, zgjatjen e tepruar të procedurave gjyqësore, moszbatimin e vendimeve në çështjet civile, si dhe largimet e padrejta nga puna. Ai ka shprehur po ashtu, në mënyrë të përsëritur shqetësim të veçantë lidhur me kushtet e papërshtatshme në burgje, qendrat e

paraburgimit dhe rajonet e policisë, korrupsionin në sistemin gjyqësor dhe kushte të vështira të jetesës të minoritetit rom. Rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk janë vënë aq sa duhet në praktikë nga institucionet qeveritare. Raporti i tij vjetor në parlament është kritikuar me forcë nga disa deputetë. Puna e këtij institucioni pengohet nga mungesa e kapaciteteve, dhe shkurtimi i ndjeshëm së fundmi, i buxhetit të tij përbën shqetësim. Këto kufizime kanë bërë që Avokati i Popullit t'i ketë shfrytëzuar shumë pak kompetencat e tij *ex officio*. Pavarësia e këtij organi është e nevojshme të sigurohet nëpërmjet akordimit të burimeve të duhura.

Kuadri institucional për të drejtat e njeriut është përforcuar përmes krijimit të një organi të barazisë. Në bazë të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi të miratuar në shkurt 2010, u emërua në muajin prill 2010 Komisioneri për mbrojtjen ndaj diskriminimit. Komisioneri ka kompetenca për të pranuar ankesa në lidhje jo vetëm me sektorin publik, por edhe me sektorin privat dhe individët, si dhe ka kompetencë për të vënë gjopa për shkelje të ligjit. Megjithatë, kjo zyrë nuk është ende plotësisht funksionale. Është i nevojshëm një financim adekuat i kësaj zyre që të krijojë kapacitetet e duhura për shqyrtimin e ankesave dhe për ndërmarrjen e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit në zbatim të parimit të trajtimit të barabartë.

Janë bërë trajnime për çështjet e të drejtave të njeriut, në veçanti për oficerët e policisë, megjithatë duhet të forcohet ndërgjegjësimi dhe ndjeshmëria në radhët e administratës, gjyqësorit dhe organeve të zbatimit të ligjit.

#### *Të drejtat civile dhe politike*

Mbrojtja e **të drejtës së jetës** është e parashikuar me kushtetutë. Në vitin 2007, Shqipëria ka ratifikuar Protokollin Nr. 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke hequr dënimin me vdekje në të gjitha rrethanat. Numri i vrasjeve nga gjakmarrjet është ulur, kryesisht për shkak të punës më të mirë policore. Në këtë fushë janë bërë hapa të rëndësishëm, si parashikimi si vepër e cilësuar e gjakmarrjes dhe vrasjes për gjakmarrje, krijimi i njësisve të specializuara të policisë, si dhe krijimi i Komisionit Koordinues të nivelit të lartë. Megjithatë, shpeshësia e këtyre vrasjeve vazhdon të rezultojë në ngujimin e familjeve nga frika e gjakmarrjes, duke i privuar kështu fëmijët nga të drejtat bazë, të tilla si arsimiti inkluziv. Qeveria ka marrë masa për të përmirësuar aksesin në arsim të fëmijëve të ngujuar, kryesisht nëpërmjet programit të saj "shansi i dytë". Përveç kësaj, disa OJF-ë janë treguar aktive në këtë fushë, duke ofruar mbështetje për familjet e prekura dhe duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës për nevojën e shfarosjes së kësaj dukurie. Duhet të grumbullohen të dhëna të besueshme për vrasjet me motiv gjakmarrjen, me qëllim që të matet shtrirja e problemit dhe të trajtohet ai siç duhet. Nevojiten masa për arsimimin, lehtësimin e jetesës dhe pajtimin e familjeve.

Shqipëria ka bërë përpjekje për të siguruar **aksesin në drejtësi**, me miratimin në dhjetor 2008 të Ligjit për ndihmën ligjore, sipas të cilit, kategorive të ndryshme të personave u ofrohen shërbime ligjore falas në procedime civile, penale dhe administrative. Megjithatë, sfidat në këtë fushë vazhdojnë të jenë të pranishme. Anëtarët e Komisionit Shtetëror për ndihmën ligjore janë emëruar dhe kanë nisur punën, dhe pse me shumë vonesë, duke penguar kështu vënien në zbatimin me efektshmëri të ligjit. Rritja e ndjeshme e tarifave gjyqësore administrative në mars 2010, rrezikon të kufizojë aksesin në drejtësi për shtresat e varfra, veçanërisht sepse personat që përfitojnë nga skema e ndihmës ligjore falas nuk janë të përjashtuar nga pagesa e tarifave gjyqësore.

**Sistemi i burgjeve** dhe paraburgimi në Shqipëri janë përmirësuar ndjeshëm që nga transferimi i përgjegjësisë nga Ministria e Brendshme tek Ministria e Drejtësisë në vitin 2007. Janë bërë investime për të zhvilluar ambientet e vuajtjes së dënimit, si dhe janë marrë masa të reja administrative në përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe shpeshësinë e pushimeve në ambiente të hapura, duke përmirësuar kështu kushtet e jetesës. Formimi profesional është në dispozicion për të ndaluarit në 15 nga 21 institucionet e shlyerjes së dënimit, me 570 persona që ndjekin kurse të tilla, në veçanti të miturit. Është ulur mbipopullimi, kryesisht me futjen e dënimeve alternative si dhe sistemit të provës.

Megjithatë, qendrat e vuajtjes së dënimit vazhdojnë të funksionojnë vazhdimisht mbi kapacitetet e tyre dhe kushtet e përgjithshme mbeten nën standardin e kërkuar, veçanërisht në disa nga burgjet e vjetra, qendrat e paraburgimit dhe rajonet e policisë. Për arritjen e standardeve ndërkombëtare dhe evropiane në trajtimin e personave të privuar nga liria duhen përpjekje të mëtejshme. Në këtë kuptim, duhet të përforcohen më tej inspektimet mbi aktivitetin të institucioneve të vuajtjes së dënimit, dhe të zhvillohet më tej sistemi i përgatitjes profesionale të oficerëve të burgjeve. Gjithashtu, shqetësuese është dhe përdorimi dhe kohëzgjatja e tepruar e paraburgimeve, në veçanti në rastet e shkelësve të mitur. Aksesi në shërbimet mjekësore adekuate, veçanërisht të kujdesit psikologjik dhe psikiatrik, nuk është gjithmonë i mundur. Duhet marrë masa për trajtimin e duhur të të ndaluarve me çrregullime të shëndetit mendor, dhe për akomodimin e tyre në një institucion psikiatrik të përshtatshëm.

Shqipëria ka ndërmarrë masa për të luftuar **torturën dhe keqtrajtimin** nga ana e policisë dhe personelit të burgjeve si dhe të ndjekur penalisht shkelësit. Vendi është palë në Konventën e OKB-së kundër torturës si dhe ndëshkimeve apo trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese dhe protokollit të tij dhe ka ratifikuar në vitin 1996 Konventën Evropiane për parandalimin e torturës dhe ndëshkimit dhe trajtimit çnjerëzor apo poshtëruës. Në vijim të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, përkufizimi ligjor i krimit të torturës është përfshirë në Kodin Penal (neni 86). Në sistemin e burgjeve kryhen kontrole të brendshme për parandalimin dhe zbulimin e rasteve të ushtrimit të forcës së tepruar. Në bashkëpunim me OJF-të, personelit të burgjeve u janë ofruar seanca trajnimesh për forcimin e kapaciteteve të tij. Në qershor 2010, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rinovoi memorandumun e nënshkruar me disa OJF, duke u dhënë atyre akses në institucionet e shlyerjes së dënimit.

Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit i krijuar në 2008, brenda zyrës së Avokatit të Popullit, është përgjegjës për monitorimin e mjediseve të paraburgimit dhe për trajtimin e personave të privuar nga liria. Avokati i Popullit ka kompetenca të monitorojë mjediset e burgimit dhe paraburgimit por gjithashtu, edhe bazat ushtarake, spitalet në karantinë, sallat e transitit në aeroporte si dhe institucionet psikiatrike. Megjithatë, kjo zyrë nuk ka fonde të mjaftueshme dhe nuk ka ekspertizën e nevojshme sociale, mjekoligjore, psikologjike dhe psikiatrike, që shpesh ofrohet nga OJF-të. Çështja e keqtrajtimin vazhdon të jetë shqetësuese, pasi ende raportohen raste të keqtrajtimin fizik dhe psikologjik, në veçanti në vendet e ndalimit të policisë. Pavarësisht se janë bërë shpesh publike, këto raste shpesh përfundojnë me ndëshkime administrative dhe jo penale. Duhet të merren masa të mëtejshme për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës.

Qeveria shqiptare ka miratuar strategji që përfshijnë masa konkrete lidhur me parandalimin e **trafikimit të qenieve njerëzore**, mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave dhe ndjekjen penale të autorëve. Zyra e Koordinatorit Kombëtar të Antitrafikimit zbaton strategjinë dhe punon për rritjen e ndërgjegjësimit publik në parandalimin e trafikimit të njerëzve. Fokusi është vënë në identifikimin e viktimave dhe funksionimin e mekanizmit referues të viktimave në shkallë kombëtare. Qeveria bashkëpunon me OJF-të për dhënin e ndihmës për viktimat e trafikimit dhe dhënieve të fondeve për strehët e administruara nga OJF-të. Megjithatë, pavarësisht rënies së numrit, Shqipëria mbetet një vend origjine për personat e trafikuar për shfrytëzim seksual dhe punë të detyruar. Trafikimi i brendshëm përbën një shqetësim serioz. Për të rritur zbulimin dhe referimin e viktimave, duhet të përmirësohet koordinimi mes autoriteteve përkatëse si edhe të forcohet bashkëpunimi me OJF-të. Ndjekja penale efektive e autorëve duhet të arrihet përmes zhvillimit të metodave të hetimit proaktiv si dhe duke iu garantuar sigurinë viktimave që dëshmojnë në procese gjyqësore.

E drejta për jetë private është e garantuar me Kushtetutë dhe Kod Penal; **mbrojtja e të dhënave personale** sigurohet me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Në zbatim të këtij ligji, është ngritur Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave me qëllim shqyrtimin e ankesave që kanë të bëjnë me të dhënat personale. Zbatimi i këtij ligji ka nevojë për konsolidim.

**Liria e shprehjes (duke përfshirë median)** është e garantuar me Kushtetutë dhe ligjet përkatëse. Shtypi në Shqipëri është pluralist dhe me operatorë të shumëllojshëm. Pjesa më e madhe e gazetave, stacioneve të radiove dhe TV-ve janë të përqendruar në kryeqytet, me disa përpyetje të fundmi, për zhvillimin e medias lokale. Ndikimet politike mbi median dhe përdorimi i tyre si mjete propagande nga ana e partive politike apo biznesmenë me shumë ndikim, krijojnë kushte për raportim të njëanshëm dhe vetë-censurën e gazetarëve. Klima në të cilën media ushtron veprimtarinë, mbetet çështje shqetësuese pasi pengon zhvillimin e pavarësisë editoriale. Presionet politike dhe ekonomike dhe kërcënimet e rastit, së bashku me informalitetin e kontratave të punës dhe mungesën e arsimit dhe formimit të duhur, ndikojnë për keq në standardet profesionale.

Vendosja nga ana e gjykatave e gjobave disproporcionale dhe nganjëherë selektive ndaj operatorëve të medias në raste ku përfshihen politikanë, është çështje shqetësuese. Rritja e transparencës lidhur me pronësinë e medias do të nxirrte në pah përfshirjen e politikës dhe biznesit në këtë sektor. Dispozitat për shpifjen dhe fyerjen në Kodin Penal ende nuk janë shfuqizuar. Megjithatë, po respektohet moratoriumi i kërkuar nga Kryeministri që ndalon zyrtarët qeveritarë të ngrenë padi ndaj gazetarëve për shpifje. Pavarësia e radiotelevizionit shtetëror dhe e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) është e pamjaftueshme.

Kushtetuta shqiptare dhe Kodi Zgjedhor garantojnë **të drejtën e votës** dhe të drejtën për t'u zgjedhur për të gjitha ata persona që kanë mbushur moshën 18-vjeçare. Reformat në Kodin Zgjedhor ndryshuan rregullat e identifikimit të votuesve, duke sanksionuar detyrimin për të paraqitur kartën e identitetit ose pasaportën dhe jo më certifikatën e lindjes. Vonesat në lëshimin e kartave të identitetit penguan një numër qytetarësh në ushtrimin e së drejtës së tyre për të votuar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Mungesa e regjistrimit civil të shumë personave që i përkasin komunitetit rom, i pengon ata që të marrin pjesë në procesin demokratik.

Për sa i përket **lirisë së tubimit dhe grumbullimit**, Kushtetuta dhe legjislacioni garantojnë të drejtën për organizim kolektiv për çdo qëllim të ligjshëm. Aktorët e shoqërisë civile veprojnë në një mjedis pa kufizime dhe regjistrimi i organizatave të reja nuk pengohet nga autoritetet shtetërore. Ka pasur përparim në krijimin e rrjeteve të organizatave që merren sidomos me dhunën në familje, romët, trafikimin e fëmijëve, lesbiket, homoseksualët, biseksualët, transeksualët dhe njerëzit me aftësi të kufizuara. Megjithatë, pavarësisht rritjes së vizibilitetit të disa **organizatave të shoqërisë civile**, ky sektor mbetet relativisht i dobët dhe vuan nga burime të pamjaftueshme teknike dhe financiare si dhe varësia ndaj fondeve të donatorëve të huaj. Shumë pak OJF kanë kapacitete të forta organizative, dhe shumica nuk kanë struktura drejtuese solide.

Me gjithë miratimin e Kartës për Shoqërinë Civile, përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në bërjen e politikave dhe seancat parlamentare e konsultuese është e kufizuar, gjë e cila minon forcën dhe rolin kundërpeshues të tyre në kontrollin demokratik. Përfshirja qytetare e publikut shqiptar mbetet e kufizuar dhe OJF-të ndonjëherë shikohen me mosbesim. Kuadri fiskal rregullator për OJF-të ka nevojë të qartësohet më tej përmes një procesi konsultues me të gjitha palët përkatëse të interesuara. Është themeluar një agjenci për mbështetjen e shoqërisë civile, e cila ka për detyrë shpërndarjen e financimit shtetëror tek organizatat jofitimprurëse, si dhe është bërë thirrja e parë për propozime.

**Liria e besimit fetar** në Shqipëri është e garantuar me Kushtetutë. Marrëdhëniet ndërfaqetare janë të bazuara në respektin e ndërsjellët dhe tolerancën. Edhe pse Shqipëria nuk ka një fe zyrtare shtetërore, bashkësitë më të mëdha fetare (suni, bektashi, ortodokse dhe katolike) gëzojnë një shkallë më të madhe njohjeje zyrtare (përparësi në kthimin e pronës, përjashtime nga taksat) sesa grupet e tjera fetare. Ndërmjet qeverisë dhe bashkësive kryesore fetare janë nënshkruar marrëveshje që rregullojnë marrëdhëniet e tyre, duke u garantuar kështu atyre akses në financimet shtetërore. Duhet përpjekje të konsiderueshme për zgjidhjen e çështjes së kthimit të pronës që i takon bashkësive fetare.

### *Të drejtat ekonomike dhe sociale*

Për sa i përket **politikave anti-diskriminim**, në shkurt 2010, Shqipëria miratoi një ligj për mbrojtjen nga diskriminimi. Ky ligj është hartuar në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare dhe shoqërinë civile; ligji rregullon zbatimin dhe sundimin e parimit të trajtimit të barabartë bazuar në një listë joshteruese arsyesh ku përfshihen gjinia, raca, paaftësia fizike dhe mendore dhe orientimi seksual. Ligji po ashtu, parashikon krijimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*shiko më sipër*). Kodi Penal i Shqipërisë parashikon se urrejtja si motiv i veprës penale përbën një faktor rëndues të veçantë. Personat lesbike, homoseksualë, biseksualë dhe transeksualë (LGBT) mbrohen me legjislacionin e ri anti-diskriminim. Megjithatë, pavarësisht nga ndërgjegjësimi i rritur për çështje të LGBT-ve dhe shfaqjes së një komuniteti të mbrojtur nga OJF-të, diskriminimi dhe intoleranca mbeten të përhapura. Ka pasur raste dhune, në veçanti me shënjestër bashkësinë transeksuale. Autoritetet, në veçanti Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit, duhet të garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve LGBT.

Për sa i përket **të drejtave të grave**, Shqipëria ka ndërmarrë masa domethënëse për forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për barazinë gjinore dhe luftën ndaj dhunës në familje. Shqipëria është palë në Konventën e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave. Për 2007-2010

është miratuar një strategji kombëtare për barazinë gjinore dhe zhdukjen e dhunës në familje. Është krijuar Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore si dhe një rrjet i punonjësve të barazisë gjinore në ministritë e linjës dhe bashki. Një mekanizëm i ri për monitorimin dhe vlerësimin e barazisë gjinore dhe dhunën ndaj grave, i përcaktuar në udhëzimet e miratuara të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, do të sigurojë grumbullimin e të dhënave të pjesshme dhe zbatimin efektiv të Ligjit për barazinë gjinore në shoqëri. Me këtë ligj si dhe me Kodin Zgjedhor, është sanksionuar një kuotë gjinore prej 30%, në mënyrë që të nxitet pjesëmarrja e grave në politikë. Zbatimi i kësaj kuote garantohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor. Në zgjedhjet e fundit, dhe pse palët ndoqën e zbatuan ligjin, në shumë raste fryma e tij nuk u respektua pasi femrat u zbritën në fund të listave në pozicione të pazgjedhshme. Me gjithë këto mangësi, këto ndryshime legjislative kanë sjellë një rritje të numrit të grave në parlament (nga rreth 7% në 16%).

Megjithatë, femrat janë tejet të nën-përfaqësuar në parlament, në postet e larta qeveritare, si dhe në pozicionet vendimmarrëse në administratën publike dhe sipërmarrjet publike. Femrat vazhdojnë të diskriminohen në kuptimin e aksesit në punësim, arsim dhe pronë. Kjo ndodh kryesisht, nga mosakordimi i burimeve njerëzore, teknike dhe financiare të mjaftueshme për të siguruar zbatimin efektiv të ligjeve dhe strategjive. Pabarazia në paga në bazë gjinore duhet të adresohet, kryesisht duke përmirësuar mbikëqyrjen e Inspektoratit të Punës. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për promovimin e sigurisë ekonomike dhe fuqizimit të grave. Integrimi gjinor në të gjitha nivelet e sistemit arsimor është thelbësor për të ndryshuar qëndrimet tradicionale dhe për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e grave.

Dhuna në familje është një dukuri e vazhdueshme që prek mjaft familje në Shqipëri dhe është gjithashtu, një shqetësim serioz. Miratimi i ligjit për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe strategjia që ka të bëjë me të, kanë sjellë një rritje të konsiderueshme në numrin e incidenteve të denoncuar në polici si dhe në lëshimin e urdhrave për mbrojtje. Në policinë e qarqeve janë krijuar njësi speciale për t'u marrë me të tilla raste dhe shumë oficerë policie, funksionarë gjykatash dhe të tjerë janë trajnuar rreth dhunës në familje. Megjithatë, denoncimet e rasteve vazhdojnë të mbeten nën shifrat reale, dhe këto raste nuk hetohen dhe ndiqen penalisht në mënyrë të mjaftueshme, veçanërisht në zonat rurale. Relativisht pak denoncime kanë çuar në ndjekje penale, pasi i takon viktimës për ta nisur procedimin. Kjo përgjegjësi për nisjen e ndjekjes penale, bie mbi prokurorin vetëm në rastet kur dhuna rezulton në vdekje, lëndime të rënda dhe kërcënime për jetën.

Mbrojtja e grave dhe viktimave të tjera ndaj të gjitha formave të dhunës duhet të forcohet të mënyrë të konsiderueshme. Ka nevojë të garantohet akses i viktimave në drejtësi, në veçanti përmes dhënies së ndihmës ligjore falas, siç parashikohet në ndryshimet në ligjin mbi masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare. Është i nevojshëm zbatimi i urdhrave për mbrojtje duke akorduar kapacitete shtesë si dhe duke trajnuar oficerët e policisë për trajtimin e këtyre rasteve. Duhet të rritet shkalla e koordinimit të autoriteteve shtetërore dhe palëve të tjera të interesuara që merren me rastet e dhunës në familje, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, në veçanti përmes dhënies së fondeve publike për strehët/qendrat rajonale të drejtuara nga OJF-të. Akordimi i burimeve të duhura për drejtimin e qendrës së re kombëtare për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje është kyç për sigurimin e mbrojtjes së viktimave. Ri-integrimi shoqëror i viktimave kërkon vëmendje më të madhe, përfshirë përmes akordimit të burimeve publike për trajnime, punësim dhe mundësi për strehim afatgjatë për gratë e abuzuara.

Shqipëria ka ratifikuar konventat ndërkombëtare relevante që kanë të bëjnë me të **drejtat e fëmijëve**. Strategjia kombëtare për fëmijët 2006-2010 ka për synim të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve e miratuar në korrik 2008, plotëson strategjinë kombëtare kundër trafikimit të njerëzve. Njësitë e të Drejtave të Fëmijëve janë duke u krijuar gradualisht në të gjithë 12 Këshillat e Qarkut dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës ekzistojnë në 15 njësi të qeverisjes vendore, për të promovuar dhe mbikëqyrur të drejtat e fëmijëve. Ligji për statusin civil e heq afatin prej 45-ditësh për regjistrimin e lindjeve që ka sjellë një rënie të përkohshme në numrin e fëmijëve të paregjistruar, në veçanti të romëve. Në 2008, Shqipëria ka miratuar një strategji të kujdesit për jetimët me synim deinstitutionalizimin e fëmijëve pa kujdes prindëror. Sistemi i drejtësisë për të miturit është reformuar, me zbatimin e dënimeve alternativave ndaj burgosjes së shkelësve të mitur, duke krijuar seksione të reja gjyqësore si dhe me ndërtimin e një qendre të re paraburgimi për të miturit në Kavajë.

Me gjithë këto arritje, ende mbeten shqetësuese një numër çështjesh. Shqipërisë ende i mungon një sistem funksional në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve. Miratimi i një ligji integral për të drejtat e fëmijëve që krijon një mekanizëm kombëtar referues do të jetë vendimtar për ecurinë e mëtejshme në këtë fushë. Akordimi i burimeve të mjaftueshme në nivel qendror dhe vendor është vendimtar në sigurimin e mbrojtjes së plotë sociale për familjet. Nuk ka asnjë sistem të ngritur për mbështetjen ekonomike të fëmijëve. Strehimi për fëmijët në nevojë, kryesisht ata mbi moshën 15 vjeçare, kryesisht ofrohet nga OJF-të. Fëmijët e rrugëve dhe puna e fëmijëve janë çështje që përbëjnë një shqetësim të veçantë dhe që kërkojnë vëmendje më sistematike nga autoritetet. Mungesa e regjistrimit civil dhe regjistrimi i ulët në shkolla i bëjnë fëmijët rom veçanërisht të cenueshëm ndaj trafikimit njerëzor dhe punës së fëmijëve. Mbështetja për familjet dhe identifikimi i fëmijëve në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror, janë thelbësore për të frenuar numrin e fëmijëve që humbasin kujdesin prindëror. Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri është çështje shqetësuese. Për shkak të vonësive në procesin gjyqësor, shumë shkelës të mitur e kalojnë të gjithë dënimin e tyre në paraburgim; kjo është shkelje e parimit që paraburgimi i fëmijëve në pritje në gjykimin duhet të jetë masë e fundit. Sistemi shqiptar i drejtësisë për të mitur nuk përmban dispozita për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale, të caktuar në 14 vjeç.

Shpenzimet qeveritare për **arsimin** në Shqipëri janë të pamjaftueshme dhe shkurtimet e fundit janë shqetësuese. Legjislacioni shqiptar parashikon 9 vjet arsim të detyrueshëm. Infrastruktura në shkolla mbetet nën standard, me një numër të lartë shkollash ende me pa sisteme sanitare dhe ngrohjeje. Me gjithë përpjekjet për ta frenuar, korrupsioni vazhdon të jetë problem në sistemin arsimor.

Gjendja e **personave pa përkrahje nga ana sociale si dhe e atyre me paaftësi fizike** në Shqipëri është ende problematike. Kushtet e jetesës janë përmirësuar, nivelet e varfërisë janë ulur në mënyrë të qëndrueshme dhe masa të konsiderueshme janë ndërmarrë drejt zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të përfshirjes sociale 2007-2013. Megjithatë, për shkak të burimeve të kufizuara financiare dhe njerëzore, strukturat qeveritare në nivel qendror dhe vendor ende nuk janë plotësisht në gjendje t'i përgjigjen nevojave të grupeve pa përkrahje. Edhe pse në zbatim të ligjit për ndihmën ekonomike u krijua një sistem i ndihmës ekonomike me qëllim mbështetjen e shtresave më të varfra të popullsisë, mekanizmi ka nevojë të rishikohet, në mënyrë që të pikësynojë jo vetëm shtëpiakët, por gjithashtu edhe individët në nevojë, si dhe të zgjerojë kategoritë e grave që kualifikohen si 'kryefamiljare'.



Shqipëria e ka nënshkruar Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në dhjetor 2009. Qeveria ka nisur shqyrtimin e legjislacionit kombëtar në këtë fushë, duke synuar ratifikimin e saj. Kuadri legjislativ ka ende disa boshllëqe që duhen mbushur përmes një procesi të hapur dhe transparent duke u përqendruar në nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Strategjia kombëtare për personat me aftësi të kufizuara, e miratuar për periudhën 2004-2014 dhe që synon përmirësimin e kushteve të jetesës përmes aksesueshmërisë, shërbimeve mbështetëse, punësimit dhe arsimimit, nuk zbatohet në mënyrë të mjaftueshme. Statusi i veçantë ligjor që i jepet të verbërve, paraplegjikëve, tetraplegjikëve dhe invalidëve të punës, në mungesë të një ligji integral që i mbulon të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, sjell shqetësime për rrezikun e diskriminimit dhe trajtimit diferencial. Ekzistojnë masa të kufizuara në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara; instrumentet në dispozicion janë ende të pamjaftueshme. Personat me aftësi të kufizuara vuajnë nga shërbime shëndetësore, arsimore, shoqërore dhe punësimi të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme, që sjellin rrezik të lartë të përjashtimit shoqëror. Fëmijët shpesh arsimohen në institute të veçanta për shkak të mungesës së kapaciteteve të sistemit arsimor për të integruar nxënësit me aftësi të kufizuara, duke u mohuar atyre kështu të drejtën për arsimim inkluziv. Niveli i përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës mbetet shumë i ulët dhe kuotat e prezantuara nga ligji për nxitjen e punësimit, përgjithësisht nuk zbatohen.

Për sa i përket shëndetit mendor, Shqipëria ka nisur një proces deinstitutionalizimi të personave me aftësi të kufizuara mendore dhe ka nisur të ngrejë shtëpi të kujdesit në komunitet. Autoritetet shqiptare duhet të miratojnë norma të përshtatshme për pranimin në institucione psikiatrike dhe për monitorimin e gjendjes së pacientëve. Duhet përmirësuar më tej kushtet në institucionet e kujdesit shëndetësor, përfshi aksesin në mjediset arsimore. Për shkelësit e ligjit me aftësi të kufizuara mendore është i nevojshëm strehimi i duhur në mjediset të përshtatshme psikiatrike mjekoligjore.

Shqipëria ka ratifikuar 8 konventat kyçe **të të drejtave të punës** të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), si dhe Kartën Sociale Evropiane të rishikuar. E drejta për të krijuar **sindikata** të pavarura si dhe shoqata punëtorësh është e garantuar. Megjithatë, shkalla e lartë e ekonomisë informale nënkupton që këto organizata janë ende të dobëta. Dialogu social është ende në fillimet e tij dhe ka nevojë të përforcohet. Kodi i Punës njih të drejtën e negocimit kolektiv në nivel ndërmarrjesh dhe sektori, por ka mjaft vështirësi në aftësitë e negocimit kolektiv dhe në zbatimin e marrëveshjeve. Është i nevojshëm forcimi i mandatit të Këshillit Kombëtar të Punës, si organi kryesor këshillues trepalësh. Ligji për pasuritë e sindikatave që shtetëzoi pronat e trashëguara nga ish-sindikatat komuniste edhe pse u miratua nga parlamenti, u shfuqizua së fundmi nga Gjykata Kushtetuese në prill 2010. Ndalimi i së drejtës për grevë për nëpunësit civilë duhet të ndryshohet që të jetë në pajtim me zotimet ndërkombëtare. Me gjithë ratifikimin e konventave të ILO-s për moshën minimale dhe ndalimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve, punësimi i fëmijëve mbetet shqetësim serioz, pasi mjaft fëmijë lënë shkollën për të punuar, ndonjëherë në kushte të rrezikshme. Inspektimet e punës duhet të shtohen në mënyrë që kjo tendencë të luftohet. *(Shiko edhe Kapitullin 19: Politikat sociale dhe punësimi)*

Që nga rënia e komunizmit në fillim të viteve 90', Shqipëria ka kaluar në një proces reformash të thella për **të drejtat mbi pronën**. Këto përfshijnë ri-krijimin e pronës së paluajtshme private, rivendosjen e parimeve të së drejtës dhe transaksioneve civile, si dhe njohjen e të drejtave të pronësisë atyre që u shpronësuan në mënyrë të padrejtë gjatë komunizmit.

Masat legislative dhe institucionale janë ndërmarrë në tre fusha të ndërlidhura kryesore: në regjistrimin e pronës, rikthimin dhe kompensimin, dhe legalizimin. Janë miratuar disa ligje si Ligji për regjistrimin e pronave të paluajtshme në 1994 (i ndryshuar së fundmi në 2007), Ligji për verifikimin e vlefshmërisë ligjore të certifikatave të pronësisë për tokën e punueshme në 2008, Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës në 2004 (ligji fillestar në 1993) dhe Ligji për legalizimin, planifikimin urban dhe integrimin e ndërtimeve informale në vitin 2006 (ligji fillestar i vitit 2004). Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është krijuar që të kryejë regjistrimin fillestar të pronës në të gjithë vendin. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave është krijuar për të përgatitur kthimin e tokës dhe pronës së shpronësuar, si dhe të ofrojë kompensim në rast se kthimi është i pamundur. ALUIZNI është krijuar si organ koordinues për lëshimin e lejeve të legalizimit.

Megjithatë, legjislacioni shpesh është zhvilluar pjesë-pjesë dhe në mënyrë të pakoordinuar, duke sjellë një kuadër ligjor shumë kompleks, legjitimiteti dhe drejtësia e të cilit është kundërshtuar shpesh nga personat e interesuar. Çështja e pronës mbetet e pazgjidhur. Vështirësitë përfshijnë numrin artificialisht të lartë të agjencive që ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të pakoordinuar, shpesh të paefektshme dhe ndonjëherë me mbivendosje kompetencash, një sistem regjistrimi tokash që nuk funksionon siç duhet, si edhe korrupsioni gjerësisht i përhapur.

Gjykatat e Shqipërisë janë të mbingarkuara me çështje të mbartura mosmarrëveshesh mbi pronën që shpesh i përshkojnë të gjitha instancat e gjykimit, ndonjëherë disa herë. Problemi sistematik i moszbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë si dhe i vendimeve administrative që urdhërojnë kthimin e pronave ose kompensimin e ish-pronarëve, përbën një shqetësim serioz. Rastet e shkeljes së parimit të gjykimit të drejtë të çështjeve të pronësisë përbëjnë pjesën më të madhe të ankimeve në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Shqipërisë. Mosekzekutimi i vendimeve, veçanërisht në rastet e padive kundër shtetit, është veçanërisht shqetësues. Këto, në mes të tjerash, shkaktohen nga ineficenca e përmbaruesve në zbatimin e vendimit gjyqësor, mungesa e fondeve të nevojshme si dhe mungesa e një sistemi efektiv kompensues.

Gjendja në Shqipëri ka arritur një nivel kompleksiteti i cili në disa raste, e vë në pikëpyetje parimin e respektit për të drejtat e njeriut. Mosmarrëveshjet e pazgjidhura kronike dhe pasiguria ligjore për titujt e pronësisë, pengojnë zhvillimin ekonomik dhe të tregut të tokës, frenojnë investimet e huaja, vënë në rrezik besimin e qytetarëve tek demokracia dhe mbingarkojnë rëndë gjykatat.

Shqipëria duhet të zgjidhë në mënyrë urgjente problemet e shumëfishta në sektorin e sëmure të pronës së paluajtshme. Këto probleme kërkojnë përjasje gjithëpërfshirëse dhe mbështetje të fortë politike në mënyrë që të përmirësohet gjendja e tanishme duke përmbushur kërkesat kushtetuese si dhe ato të të drejtës publike ndërkombëtare, si dhe duke baraspeshuar interesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të interesit në shoqëri, duke synuar parandalimin e konflikteve dhe trazirave sociale në planin afatgjatë. Titujt e qartë mbi pronën dhe siguria ligjore janë parakushte thelbësore për zhvillimin e begatë të vendit dhe në tërheqjen e investimeve të huaja.

*Respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve, të drejtat kulturore*

Kushtetuta garanton mbrojtjen e të drejtave civile, ekonomike, sociale dhe politike të minoriteteve. Shqipëria nuk ka një ligj kuadër specifik për minoritetet. Vendi historikisht i përcakton grupet minoritare në territorin e tij, si minoritete “kombëtare” që janë tre (grek, *maqedonas* dhe malazez) që kanë një shtet amë, si dhe dy minoritete “etno-gjuhësore” (arumunë dhe romë). Zyrtarisht, nuk ka diferencim ligjor për gëzimin e të drejtave nga personat e minoriteteve kombëtare dhe etno-gjuhësore, por ka diferencim në praktikë, kryesisht në lidhje me aksesin në arsimin publik në gjuhët minoritare. Sqarimi i dallimit mes minoriteteve të ndryshme kombëtare dhe etno-gjuhësore do të ndihmonte në shmangien e trajtimit të diferencuar për personat e komuniteteve etno-gjuhësore. Komuniteti egjiptian kërkon të njihet si minoritet etno-gjuhësor, ndërsa ai boshnjak si minoritet kombëtar. Marrëdhëniet ndërtnike janë përgjithësisht të mira, pavarësisht një incidenti të dhunshëm kohët e fundit që rezultoi në vdekjen e një shtetasi shqiptar greqishtfolës në Himarë, që po hetohet nga autoritetet.

Mungojnë të dhënat e sakta për minoritetet në Shqipëri. Kjo situatë pritet të zgjidhet nga regjistrimi i popullsisë në 2011, duke respektuar standardet ndërkombëtare që përfshijnë parimin e vet-deklarimit të lirë. Ky regjistrim do të ketë pyetje fakultative për origjinën etnike, besimin fetar dhe gjuhën amtare. Statistikat për minoritetet duhet të përditësohen, për të mundësuar hartimin e politikave të duhura për minoritetet. Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, por nuk ka miratuar Kartën Evropiane për gjuhët rajonale ose minoritare. Legjislacioni shqiptar parashikon që të drejtat e minoriteteve kombëtare të respektohen në të gjithë territorin. Në disa bashki, janë nënshkruar marrëveshje në nivel vendor për të afishuar emrat lokalë në gjuhën minoritare; megjithatë, zbatimi i këtyre marrëveshjeve nuk ka qenë gjithmonë konsistent. Duhet të rritet mundësia e arsimit në gjuhët minoritare dhe duhet të hiqen rregullat strikte për aksesin në arsimin në gjuhën minoritare. Shqipëria duhet t’u garantojnë minoriteteve gëzimin e plotë të të drejtave të tyre, duke pasur parasysh rekomandimet e Komitetit Këshillimor të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve nën varësinë e Kryeministrit, ka për detyrë t’i rekomandojë qeverisë masa në lidhje me grupet minoritare. Komiteti përbëhet nga përfaqësues të të pesë minoriteteve të njohura. Kryetari emërohet nga Kryeministri. Kapacitetet institucionale të Komitetit mbeten të dobëta dhe performanca e tij si organ këshillimor efektiv mund të vihet në pikëpyetje. Autoritetet shqiptare duhet t’i sigurojnë Komitetit burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore që të realizojë me efektivitet detyrat e ngarkuara. Duhet të rritet niveli i përfaqësimit të minoriteteve në administratën publike dhe në politikë.

Për sa u përket Romëve, në vitin 2003 u miratua Strategjia për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve, e cila po zbatohet nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në 2008, Shqipëria u bë pjesë e Dekadës së Përfshirjes Rome 2005-2015 dhe miratoi një plan kombëtar veprimi i fokusuar në arsimimin, punësimin, mbrojtjen sociale, strehimin dhe infrastrukturën,

shëndetësinë, përfshirjen sociale dhe mundësi të barabarta, si dhe në trashëgiminë kulturore. Megjithatë, komuniteti rom është grupi minoritar më vulnerabël në Shqipëri, pasi përballlet me varfëri të përhapur, përjashtim social-ekonomik dhe diskriminim të vazhdueshëm, sidomos në aksesin në arsim, mbrojtje sociale, shëndetësi, punësim dhe strehim të përshtatshëm. Strategjia kombëtare po zbatohet me ngadalësi, për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare, koordinimit të mangët të të gjitha institucioneve të përfshira në nivel vendor dhe qendror, si edhe mangësive të mekanizmave monitorues dhe vlerësues.

Në 2009 u zhvillua një fushatë regjistrimi për pajisjen e qytetarëve me karta identiteti, përfshi edhe romët. Megjithatë, shumë romë akoma janë të paregjistruar në gjendjen civile, gjë që pengon ushtrimin e të drejtave themelore. Aksesin në shëndetësi është problematik për këtë grup minoritar, dhe mjaft romë vuajnë nga sëmundje që lidhen me varfërinë. Shumë romë jetojnë në kushte të këqija, në banesa pa infrastrukturën sanitare bazë. Me gjithë hapat e ndërmarrë për të nxitur përfshirjen e romëve në sistemin shkollor, sidomos me formimin e klasave parashkollore për të rritur njohuritë e tyre për gjuhën shqipe, regjistrimi shkollor i romëve mbetet i pamjaftueshëm dhe braktisja e shkollës mbetet në nivele të larta. Pjesëmarrja e minoritetit rom në jetën politike dhe publike mbetet e ulët, madje edhe në nivel vendor.

*Në tërësi*, kuadri ligjor për të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve është përgjithësisht i plotë dhe korrespondon gjerësisht me standardet evropiane. Megjithatë, zbatimi i tij në mjaft fusha mbetet i pamjaftueshëm. Kuadri institucional është i përshtatshëm, por duhet të sigurohet funksionimi i duhur i tij. Veçanërisht, për sa i përket të drejtave civile dhe politike, duhet të përmirësohet aksesin në drejtësi i grupeve vulnerabël, të parandalohet keqtrajtimi në vendet e ndalimit nga policia dhe të zgjidhet situata e të burgosurve të sëmurë mendorë, dhe të forcohet pavarësia dhe transparenca në sektorin e medias. Në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale, duhet të akordohen burimet e duhura për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen ndaj diskriminimit, duhet të miratohet një ligj kuadër për të drejtat e fëmijëve, duhet të përmirësohet kuadri ligjor për personat me aftësi të kufizuar, dhe duhet të zbatohen me efektivitet strategjitë ekzistuese për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje. Duhet të gjenden zgjidhje urgjente për mbivendosjet e legjislacionit dhe rrjedhimisht mungesën e sigurisë ligjore, vendimet e paekzekutuara të gjykatave dhe rreziqet e korrupsionit në fushën e të drejtave të pronësisë. Respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve duhet të forcohet nëpërmjet përmirësimit të vizibilitetit të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, dhe rritjes së aksesit në arsimimin në gjuhën minoritare. Nevojitet zbatimi i duhur i strategjive dhe planeve të veprimit që i përkasin minoritetit rom, me qëllim që të përmirësohen kushtet e tyre të jetesës dhe t'u lehtësohet integrimi në shoqëri.

### 1.3. Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Asambleja Parlamentare e **Këshillit të Europës** ka monitoruar detyrimet e anëtarësimit të Shqipërisë që në 1995, dhe së fundmi ka ndjekur nga afër, zhvillimet në situatën politike në vend.

**Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë** formojnë një pjesë thelbësore të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Shqipëria merr pjesë aktive në nismat rajonale, përfshi Procesin e Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECP), Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA), Traktatin e Komunitetit të Energjisë (ECT), dhe Marrëveshjen e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Shqipëria aktualisht kryeson Nismën Rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI).

Për sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar gjyqësor në çështjet civile dhe penale, Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe me disa vende fqinje dhe vende të tjera të rajonit. Shqipëria nënshkroi marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim ligjor në çështjet civile dhe penale me Greqinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Italinë. Shqipëria është palë në Konventën Evropiane për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale, dhe bashkëpunon kënaqshëm në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Shqipëria nënshkroi marrëveshje për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve penale të gjykatave, me Greqinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ligji për bashkëpunimin juridiksional me autoritetet e huaja për çështje penale, u miratua në dhjetor 2009. Shqipëria po merr pjesë aktive në bashkëpunimin policor rajonal, goftë në nivel dypalësh ose nëpërmjet Europolit dhe Interpolit. Marrëveshje bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, të trafikut të drogës dhe terrorizmit janë nënshkruar me Bosnje-Hercegovinën, Kroacinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë. Janë realizuar me sukses operacione të përbashkëta ndërkombëtare kundër drogës, sidomos me Italinë.

Për sa i përket ekstradimit, sipas Kushtetutës, qytetarët shqiptarë nuk mund të dëbohen nga territori i shtetit. Ekstradimi lejohet vetëm kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë, si dhe vetëm me vendim gjyqësor. Procedurat e ekstradimit bazohen në Konventën Evropiane të Ekstradimit të vitit 1957, siç u ratifikua, dhe në marrëveshjet dypalëshe që janë në fuqi me Greqinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Marrëveshjet dypalëshe me Kroacinë dhe Bosnje-Hercegovinën nuk zbatohen *de facto* sepse të dy shtetet janë palë në Konventën për procedurat e ekstradimit.

Shqipëria ka **marrëdhënie dypalëshe shumë të mira me vendet e përfshira në procesin e zgjerimit dhe me vendet fqinje të Shteteve Anëtare të BE-së.**

Marrëdhëniet me *Serbinë* janë konstruktive. Pavarësisht mosmarrëveshjeve serioze për statusin e Kosovës, marrëdhëniet dypalëshe janë normalizuar. Në mars 2010, Ministri shqiptar i Punëve të

Jashtme ishte për vizitë në Beograd për herë të parë që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, dhe nënshkroi disa marrëveshje të rëndësishme dypalëshe, përfshi atë për bashkëpunimin policor. Në prill 2010, Shqipëria hoqi në mënyrë të njëanshme vizat për qytetarët serbë.

Shqipëria ka marrëdhënie të mira me *ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë*. Shqipëria mbështet anëtarësimin e këtij vendi në NATO dhe ka qenë mbështetëse e integritetit dhe stabilitetit etnik të saj. Shqipëria ka inkurajuar dialogun ndërmjet komuniteteve etnike gjatë takimeve me udhëheqësit politikë shqiptarë të Shkupit.

Shqipëria ka tradicionalisht marrëdhënie shumë të mira me *Kosovën* dhe ishte ndër të parat shtete që njohën pavarësinë e saj. Shqipëria ka përkrahur aktivisht njohjen e Kosovës nga Organizata e Konferencës Islamike (OIC) dhe së fundmi, inicioi miratimin e një rezolute në mbështetje të përpjekjeve të Kosovës për ngritjen e institucioneve paqësore dhe demokratike. Janë nënshkruar disa marrëveshje për bashkëpunimin dypalësh, përfshi bashkëpunimin kufitar dhe policor, dhe së fundmi, ato për bashkëpunimin në arsim dhe shkencë.

Shqipëria ka vendosur bashkëpunim shumë të ngushtë me *Malin e Zi*. Një pikëkalim i përbashkët kufitar, i pari në rajon, është hapur kohët e fundit në Muriqan, dhe janë nënshkruar një sërë marrëveshjesh për bashkëpunimin kufitar dhe policor.

Marrëdhëniet me *Bosnje-Hercegovinën* janë zhvilluar pozitivisht. Në nëntor 2009 hyri në fuqi regjimi pa viza me Bosnjë-Hercegovinën, dhe në shkurt 2010, parlamenti ratifikoi marrëveshjen për ripranimin e emigrantëve të parregullt.

Shqipëria ka marrëdhënie të mira me *Kroacinë*. Dialogu politik është zhvilluar fuqishëm vitet e fundit dhe ka pasur rritje mjaft cilësore si rezultat i anëtarësimit të të dy vendeve në NATO në prill 2009. Bashkëpunimi përvijohet nga një numër i madh marrëveshjesh dypalëshe në fusha si zhvillimi ekonomik dhe investimet, dhe siguria.

Marrëdhëniet me *Italinë* janë shumë të mira. Një pjesë e madhe e diasporës shqiptare jeton në Itali. Dy qeveritë kanë vendosur marrëdhënie të ngushta dhe Italia mbështet fuqishëm përpjekjet e Shqipërisë për integrimin në BE. Italia është partneri tregtar kryesor dhe një nga investueset kryesore në Shqipëri. Më 12 shkurt 2010, Italia dhe Shqipëria nënshkruan një marrëveshje partneriteti strategjik që parashikon bashkëpunimin mes dy vendeve për zbatimin e projekteve të përbashkëta, përfshi projekte të energjisë bërthamore.

Marrëdhëniet me *Greqinë* janë shumë të mira. Greqia është përkrahëse e fuqishme e përpjekjeve të Shqipërisë për integrim evropian. Dy vendet kanë bashkëpunim të ngushtë në mjaft sektorë. Kuadri institucional kryesor për këtë bashkëpunim është Marrëveshja e vitit 1996 për miqësinë,

bashkëpunimin, fqinjësinë e mirë dhe sigurinë. Marrëdhëniet dypalëshe nuk janë cenuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese shqiptare në janar 2010, që anuloi paktin e kufirit detar mes dy vendeve. Greqia është investuesi kryesor në Shqipëri dhe partneri i dytë tregtar. Një pjesë e madhe e diasporës shqiptare jeton në Greqi.

Që nga viti 2003, Shqipëria ka me SHBA-në një marrëveshje dypalëshe imuniteti, që i garanton përjashtim nga juridiksioni i **Gjykatës Ndërkombëtare Penale**. Kjo nuk është në pajtim me Qëndrimin e Përbashkët të BE-së mbi integritetin e Statutit të Romës, ose me parimet orientuese të BE-së për marrëveshjet dypalëshe të imunitetit. Shqipëria duhet të bashkohet me qëndrimin e BE-së.

*Në tërësi*, Shqipëria përmbush kënaqshëm kushtet e **Procesit të Stabilizim-Asociimit** që kanë të bëjnë me bashkëpunimin rajonal. Shqipëria është e angazhuar fuqimisht në bashkëpunimin rajonal; ajo luan rol konstruktiv rajonal dhe merr pjesë aktive në nismat rajonale.

#### **1.4. Vlerësim i përgjithshëm**

Ky vlerësim është bërë mbi bazën e kriterëve të Kopenhagënit për stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, respektin dhe mbrojtjen e minoriteteve, si edhe kushtëzimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Shqipëria është **demokraci** parlamentare e bazuar në një kuadër kushtetues dhe legjislativ, që është gjerësisht në pajtim me parimet dhe standardet evropiane. Ekziston një konsensus i përgjithshëm për objektivin e anëtarësimit në BE. Sidoqoftë, efektiviteti dhe stabiliteti i institucioneve demokratike nuk është arritur në një masë të kënaqshme. Procedurat dhe institucionet parlamentare nuk funksionojnë siç duhet. Si rezultat, parlamenti nuk ushtron mbikëqyrje dhe kontroll efektiv mbi qeverinë, dhe shqyrtimi nga ana e tij e zhvillimit legjislativ është i dobët. Dialogu politik është konfrontues dhe jokonstruktiv, kryesisht për shkak të ngërçit politik që vazhdon që nga zgjedhjet e qershorit 2009. Kjo pengon punën parlamentare dhe miratimin e reformave të nevojshme të bazuara në konsensus. Qeveria bashkë me opozitën mbajnë përgjegjësinë që, në mënyrë transparente dhe në respekt të plotë me kushtetutën, të gjejnë zgjidhjet që vendi të eci përpara në rrugën e integritimit në BE. Përveç kësaj, vihen re mangësi në zbatimin e legjislationit. Kuadri ligjor për administratën publike dhe sistemi i shërbimit civil janë më së shumti, në përputhje me standardet dhe praktikat evropiane. Megjithatë, përbën shqetësim moszbatimi i duhur i kuadrit ligjor, dhe shërbimi publik është shumë i politizuar, i mungon transparenca në emërimet dhe karakterizohet nga zëvendësime të shpeshta të stafit.

Vlerësimi i OSBE-ODIHR për zgjedhjet parlamentare të qershorit 2009, ishte se ato përmbushën shumicën e standardeve ndërkombëtare dhe se shënuan përmirësim krahasuar me praktikën e mëparshme. Megjithatë, u vunë re mangësi dhe u bënë disa rekomandime për zgjedhjet e ardhshme,

përfshi mos-politizimin e proceseve si për shembull numërimi i votave. Rekomandimet nuk janë përkthyer ende në një reformë zgjedhore të kënaqshme, që nevojitet për zgjedhjet e radhës.

Shqipëria e ka forcuar **shtetin e së drejtës** në vitet e fundit, sidomos me reformat legislative dhe institucionale të sistemit gjyqësor dhe në fushat e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Janë forcuar kapacitetet administrative, veçanërisht ato të organeve të zbatimit të ligjit. Megjithatë, reformat mbeten ende të paplota, ka mangësi të dukshme në pavarësinë, transparencën dhe përgjegjshmërinë e sistemit gjyqësor, dhe mungon një vijimësi rezultatesh solide në luftën efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Reforma në sistemin gjyqësor po vazhdon. Megjithatë, nuk është realizuar një strategji gjithëpërfshirëse dhe e bashkërenduar për reformën në gjyqësor, ashtu si edhe miratimi i ligjeve kyçe si ai për gjykatat administrative dhe ligji për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Shqetësime serioze ngjall funksionimi i përgjithshëm, efica dhe pavarësia e sistemit gjyqësor. Ka mungesë transparence në emërimet, ngritjet në detyrë, transferimet dhe vlerësimet e gjyqtarëve, dhe ekzistojnë dobësi të konsiderueshme në sistemin e inspektimit të gjyqësorit. Janë shqetësuese rastet e mosrespektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga ana e qeverisë në këto vitet e fundit, si edhe politizimi i votimit për kandidatët e emëruar nga Presidenti për në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e lartë, pasi ato cenojnë parimet themelore si pavarësia e sistemit gjyqësor dhe respekti për shtetin e së drejtës. Burimet njerëzore dhe financiare, si edhe kushtet e infrastrukturës, nuk janë adekuate dhe duhet të përmirësohen për të garantuar funksionim eficient të gjykatave.

Shqipëria ka bërë përpjekje vitet e fundit për të krijuar një kuadër ligjor dhe institucional për luftën kundër korrupsionit, i cili është përgjithësisht i miratuar. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, korrupsioni mbizotëron në shumë fusha dhe përbën një problem veçanërisht serioz. Më shqetësues është korrupsioni në gjyqësor dhe në sistemin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si edhe mitmarrjet e përhapura në shëndetësi. Problem i konsiderueshëm është mungesa e transparencës në financimin e partive politike, gjë që lejon influencat e papërshtatshme në politikë. Shqipëria duhet të plotësojë kuadrin ligjor në luftën kundër korrupsionit dhe të heqë pengesat ndaj hetimeve efektive, sidomos të gjyqtarëve, ministrave dhe deputetëve, që lidhen me imunitetin e pakufizuar të këtyre funksionarëve publikë. Duhet të sigurohet zbatimi i plotë i strategjisë anti-korrupsion dhe planit të veprimit, dhe duhet të arrihet një vijimësi rezultatesh solide në hetimet dhe procedimet penale proaktive, ashtu edhe të akuzave dhe ndëshkimeve bindëse për rastet e korrupsionit në të gjitha nivelet.

Në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, Shqipëria ka krijuar një kuadër legjislativ dhe institucional që është përgjithësisht adekuat. Reforma e organeve të zbatimit të ligjit, si dhe pajisja e tyre me burimet dhe pajisjet adekuate, kontribuuan në goditjen e këtij fenomeni. Megjithatë, zbatimi efektiv i legjislacionit të ri dhe profesionalizmi i strukturave dhe sistemeve të reja duhet të vërtetohen më tej në praktikë. Nevojiten hetime proaktive dhe çështjet e hetuara me sukses duhet të pasohen me



ndëshkime. Veprimtaria e grupeve të krimit të organizuar në Shqipëri, që kanë impakt edhe jashtë vendit, mbetet një shqetësim serioz. Kërkohet forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, sidomos me vendet fqinje.

Kuadri ligjor dhe politik që rregullon të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve është përgjithësisht i miratuar dhe korrespondon gjerësisht me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Kuadri institucional është adekuat. Megjithatë, ekzistojnë boshllëqe në legjislacion dhe në zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit ekzistuese. Duhet të forcohet ndërgjegjësimi dhe ndjeshmëria e administratës, gjyqësorit dhe organeve të zbatimit të ligjit për standardet e të drejtave të njeriut.

Të drejtat e njeriut respektohen gjerësisht në Shqipëri. Megjithatë, mbeten disa shqetësime. Kthimi, kompensimi dhe legalizimi i pronës rregullohet nga një legjislacion i fragmentuar dhe nga shumë agjenci me kompetenca të mbivendosura, duke e bërë procesin kaq kompleks sa që vë në rrezik gëzimin efektiv të të drejtave të njeriut në këtë fushë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka dhënë disa vendime kundër Shqipërisë, në lidhje me cenimin e parimit për proces të drejtë në këtë fushë. Një tjetër shqetësim serioz ka të bëjë me kushtet e paraburgimit dhe trajtimin e personave të ndaluar në rajonet e policisë, qendrat e paraburgimit dhe burgjet. Pavarësia e medias është në rrezik nga mbizotërimi i influencave politike dhe interesave të biznesit. Dhuna në familje është një fenomen i vazhdueshëm që prek shumë familje dhe që nuk adresohet sistematikisht. Kuadri ligjor dhe institucional për anti-diskriminimin është përmirësuar dukshëm, sidomos me ngritjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Megjithatë, romët, personat me aftësi të kufizuara, homoseksualët, biseksualët dhe *transgender* vazhdojnë të jenë objekt diskriminimi. Barazia gjinore nuk garantohet plotësisht në praktikë, sidomos në punësim dhe aksesin në ndihmën ekonomike. Legjislacioni për të drejtat e njeriut ka disa boshllëqe, sidomos pasi nuk është miratuar një ligj integral për të drejtat e fëmijëve. Për më tepër, funksionimi i institucioneve kombëtare që merren me të drejtat e njeriut pengohet për shkak të vonësive në emërimin e Avokatit të Popullit, që ka mbetur pezull që në fillim të vitit 2010.

Megjithëse, Shqipëria nuk ka ligj kuadër për minoritetet, respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve është përgjithësisht e garantuar. Në praktikë, njihen të drejtat specifike të tre minoriteteve “kombëtare” dhe të dy minoriteteve “etno-gjuhësore”, siç përcaktohen nga Shqipëria. Sidoqoftë, zbatimi i këtyre të drejtave shfaq mungesë konsistence. Mungesa e statistikave të sakta për minoritet, pengon zhvillimin e politikave të përshtatshme. Kjo pritet të zgjidhet nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 sipas standardeve ndërkombëtare. Duhet të rritet niveli i përfaqësimit të minoritarëve në administratën publike dhe politikë. Kuadri ekzistues i politikave për përmirësimin e jetesës së romëve nuk zbatohet në një masë të mjaftueshme. Minoriteti rom përballet me kushte jetese shumë të vështira dhe me akses të kufizuar në punësim, arsimim dhe shërbime sociale.

Shqipëria ka përmbushur përgjithësisht, kushtet e Procesit të Stabilizim-Asociimit. Shqipëria është fuqimisht e angazhuar në bashkëpunimin rajonal; ajo luan një rol konstruktiv në rajon dhe merr pjesë aktive në nismat rajonale. Marrëdhëniet dypalëshe me fqinjët janë përgjithësisht të mira. Shqipëria është palë në Statutin e Romës. Megjithatë, Shqipëria ratifikoi një marrëveshje dypalëshe imuniteti me Shtetet e Bashkuara në lidhje me Gjykatën Ndërkombëtare Penale, që nuk është në pajtim me Qëndrimet e Përbashkëta dhe me parimet orientuese të BE-së. Shqipëria duhet të bashkohet me qëndrimin e BE-së.

## **2. KRITERI EKONOMIK**

Në vitin 1993, Këshilli Evropian vendosi në Kopenhagën këto kritere ekonomike për anëtarësimin në BE:

- ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale;
- aftësinë për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së.

Kriteret janë të ndërlidhura. Ekonomia funksionale e tregut përballon më mirë presionet e konkurrencës, dhe në kontekstin e anëtarësimit në BE, tregu i brendshëm i tij është tregu që merret si pikë reference.

Në vijim të një përshkrimi të shkurtër të zhvillimeve dhe politikave ekonomike nga një perspektivë historike, raporti analizon shkallën e përmbushjes nga ana e Shqipërisë të dy kritereve ekonomike të përcaktuara nga Këshilli Evropian në Kopenhagën.

### **2.1. Zhvillimet ekonomike**

Shqipëria është një vend i vogël malor me popullsi pak mbi 3 milion banorë dhe me sipërfaqe 28,750 kilometra katrorë. Shqipëria është e pasur me burime natyrore, kryesisht me krom, nikel, bakër dhe sasi të vogla naftë dhe qymyrguri. Klima është e favorshme për bujqësinë dhe turizmin, dhe pothuajse të gjitha nevojat e saj për energji elektrike mund të plotësohen nga hidrocentralet. Shqipëria i është nënshtruar një transformimi të thellë strukturor gjatë dy dekadave të fundit, nga një vend me ekonomi tejet të centralizuar, në një ekonomi të tregut të lirë, gjë që ka rezultuar në norma të larta rritjeje ekonomike. Rritja vjetore mesatare e PBB-së ishte pak mbi 6% nga viti 2000 në 2008, pastaj ngadalësoi në 3% në 2009. Prodhimi i brendshëm bruto arriti pothuaj në 9 miliard Euro (2009), ose 0.07% të PBB-s të BE-27. E shprehur sipas standardeve të fuqisë blerëse, PBB-ja për frymë në 2009 ishte 6,400 Euro, ose 27.1% e mesatares së BE-27. Kontrasti i të ardhurave mes Tiranës dhe zonave malore pak të zhvilluara, është mjaft i theksuar, por po zbutet.

Në vitet e para të tranzicionit që filloi në 1991, pati një kontraktim drastik të prodhimit, një deficit buxhetor galopant dhe inflacion treshifror. Me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar, në 1993 Shqipëria ndërmori një program për të stabilizuar ekonominë, që përfshinte konsolidimin fiskal, objektiva monetarë striktë dhe reforma strukturore. Përparimet në stabilitetin makroekonomik ndaluan në vitin 1997, me rënien e të ashtuquajturave skema piramidale<sup>6</sup>, që solli një efekt tepër negativ në ekonomi dhe shkaktoi trazira civile. Hapja e vendit dhe rënia e skemave piramidale rezultoi po ashtu, në emigracion masiv dhe remitancat e tyre janë bërë një veçori e rëndësishme e ekonomisë shqiptare.

Pas krizës së skemave piramidale, u lançua një program i ri stabilizimi. Programi solli përmirësime të ndjeshme në performancën ekonomike në 1998 dhe në vitet pasardhëse, të mbështetur nga konsolidimi fiskal gradual dhe politika strikte monetare. Deri në vitin 2000, u arrit që inflacioni të zbritet në nivele njëshifrore. Stabiliteti makroekonomik është ruajtur përgjithësisht, që nga viti 2000 dhe janë marrë masa për ta integruar Shqipërinë në sistemin ekonomik ndërkombëtar.

Shqipëria ka bërë shumë reforma të thella me synim rritjen e cilësisë së shpenzimeve publike. Disiplina fiskale u përmirësua gjatë pjesës më të madhe të viteve '90, në përputhje me programe të ndryshme të përshtatjes. Që në vitin 2000, është në zbatim programi buxhetor afatmesëm që është një plan shpenzimesh me bazë 3-vjeçare.

Në vitet e para të tranzicionit, papunësia u rrit duke arritur pikën më të lartë në vitin 1993 me 23%. Pastaj pati ulje të ngadaltë për shkak të emigracionit. Pas rrëzimit të piramidave, papunësia u rrit sërish. Që nga viti 1999, papunësia ka rënë gradualisht. Sidoqoftë, mbetet në vlera të larta në 13.8% në 2009.

Hapja e moderuar e ekonomisë dhe niveli i ulët i integritetit të sistemit financiar në tregun global, së bashku me përqindjen e lartë që zë prodhimi bujqësor, edhe pse në rënie, bënë që ndikimi i krizës globale në Shqipëri të ishte i kufizuar. Politika makroekonomike ka qenë vendimtare në zbutjen e efekteve të krizës.

### *Ndryshimet strukturore*

Që në 1991, ekonomia i është nënshtruar transformimit strukturor që zbuti dominimin e industrisë dhe bujqësisë në favor të shërbimeve dhe ndërtimit. Shërbimet janë tashmë motori kryesor i rritjes ekonomike, dhe përbëjnë 54% të PBB-së. Industria prodhuese karakterizohet nga mungesa e diversifikimit, si për sa i përket produkteve të eksportuara ashtu edhe tregjeve të eksportit.

---

<sup>6</sup> Marrëveshje investimi në të cilat paratë e paguara nga investitorët e mëvonshëm përdoren për të paguar interesa artificialisht të larta për investitorët e mëparshëm

Privatizimi ka qenë kryefjalë e reformave që në etapat e hershme të tranzicionit. Në etapën e parë që filloi në 1991, u shitën dyqanet e vogla të shitjes me pakicë dhe shërbimet e tjera tregtare, toka bujqësore dhe shtëpitë shtetërore, kryesisht tek punonjësit e atëhershëm. Në vitin 1995 filloi një program privatizimi masiv për shitjen e ndërmarrjeve të mëdha shtetërore, dhe që vazhdoi relativisht me shpejtësi. Që nga 1999, rreth 340 ndërmarrje publike janë privatizuar plotësisht ose pjesërisht, përmes tenderëve ndërkombëtarë në sektorët strategjikë. Tashmë sektori privat përbën 82% të PBB-së.

Deri në vitin 1991, çmimet në të gjitha nivelet e prodhimit përcaktoheshin nga planifikues qendrorë. Liberalizimi gjithëpërfshirës i çmimeve që preku praktikisht të gjitha mallrat e konsumit u realizua në 1992, si pjesë e programeve të stabilizimit ekonomik dhe reformave. Gjithashtu, autoritetet ndoqën politikën e liberalizimit gradual ose rritjen e disa çmimeve të kontrolluara ose administruara prej tyre, në nivele që të mbulohej kostoja.

Në 1992, autoritetet filluan një program për krijimin e një sistemi bankar modern. Kjo nismë mori një shtytje më të madhe si kundërpërgjigje e krizës së skemave piramidale. U miratua një ligj i ri për bankat, i cili forcoi më tej pavarësinë e Bankës së Shqipërisë. U morën hapa për të përmirësuar mbikëqyrjen bankare dhe për të miratuar "rregullimin e kujdesshëm". Përveç kësaj, u shpall një strategji privatizimi dhe u nxit hyrja e bankave të reja private. Reformat rezultuan efektive dhe rritën kreditimin formal të sektorit privat, si dhe sollën rritjen e numrit të bankave private. Me privatizimin e plotë dhe hyrjen e bankave ndërkombëtare private, sektori bankar vazhdoi të zhvillohet në vitet e fundit.

Përmirësimet e konsiderueshme, kryesisht në lehtësimin e hyrjes në treg, çuan në rritjen e investimeve të huaja në vitet e fundit. Megjithatë, ato mbeten të ulëta krahasuar me rajonin. Kjo situatë pasqyron klimën e dobët të biznesit që vuan mes të tjerash, nga njohja e paplotë e të drejtave të pronësisë, mangësitë e administratës publike, zbatimin e dobët të ligjit dhe të metat e infrastrukturës bazë, përfshi edhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji.

## **2.2. Vlerësimi në raport me Kriteret e Kopenhagënit**

### *2.2.1. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale*

Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale kërkon liberalizim të çmimeve dhe të tregtisë, si dhe vendosjen e një sistemi ligjor të zbatueshëm, përfshi edhe të drejtat e pronësisë. Stabiliteti makroekonomik dhe konsensusi për politikat ekonomike rrisin performancën e ekonomisë së tregut. Eficenca e ekonomisë përmirësohet nëse ekziston një sektor financiar i mirëzhvilluar dhe nëse hiqen barrierat e mëdha ndaj hyrjes dhe daljes nga tregu.

## *Bazat e politikës ekonomike*

Shqipëria ka zbatuar ndryshime të mëdha të orientuara drejt tregut, ku përfshihet liberalizimi i çmimeve dhe i tregtisë, privatizimi si dhe reformat fiskale dhe monetare. Këto reforma janë mbështetur, mes të tjerash, nga disa marrëveshje financiare dhe teknike me BE-në, FMN-në dhe Bankën Botërore. Gjatë viteve ka ekzistuar konsensusi mes partive politike për integrimin e Shqipërisë në BE. *Në tërësi*, ekziston konsensus i gjerë në Shqipëri, për masat themelore të politikës ekonomike.

## *Stabiliteti makroekonomik*

Rritja reale e PBB-së ka qenë shumë e fuqishme që nga viti 1998, duke pasqyruar vazhdimin e rialokimit të burimeve nga sektorët me prodhueshmëri të ulët, tek ata me prodhueshmëri të lartë. Për rrjedhojë, PBB-ja për frymë u rrit, por mbetet shumë e ulët. Konsumi privat mbetet komponenti kryesor që përbën rreth 80% të PBB-së, gjë e cila tregon rëndësinë e madhe të remitancave të buxhetit familjare. Roli i remitancave në zhvillimin e ekonomisë ka qenë shumë i rëndësishëm përgjatë tranzicionit. Ndryshe nga shumë shtete të tjera, rritja ekonomike ishte pozitive, edhe pse për shkak të ndikimit të krizës globale ra në pak mbi 3% në vitin 2009. *Në tërësi*, Shqipëria ka pasur rritje ekonomike shumë të fuqishme, mbi 5% që nga viti 1998, ndërsa veprimtaria ekonomike u ngadalësua por mbeti pozitiv gjatë vitit 2009, pavarësisht krizës globale.

Që nga viti 2000, deficitin e llogarive rrjedhëse është rritur gradualisht, kryesisht nga rritja e deficitit në tregtinë e mallrave, dhe në vitin 2009 kapi vlerën 15% të PBB-së. Pasi shënoi deficit në periudhën 2002-2006, bilanci i shërbimeve ishte pozitiv, ndërsa eksportet - të mbështetur nga lulëzimi i sektorit të turizmit - u rritën me shpejtësi. Rreth gjysma e deficitit tregtar është financuar tradicionalisht nga transfertat korrente prej jashtë shtetit, që arrinin në rreth 13% të PBB-së në vitin 2009. Një përqindje e madhe e këtyre transfertave janë remitancat e punëtorëve, të cilat, pas një trendi rritës në gjysmën e parë të viteve 2000, pësuan rënie në këto vitet e fundit. Në dekadën e fundit, flukset hyrëse të kapitalit neto kanë mbuluar përgjithësisht, deficitin e llogarisë korrente, duke kontribuar në rezerva më të larta valutore. Investimet e Huaja Direkte (IHD) u rritën nga të ardhurat prej privatizimeve. IHD, që përfaqësonin rreth gjysmën e financimit të jashtëm, u rritën nga 4% e PBB-së në vitin 2000, në 7.6% të PBB-së në vitin 2009. Deficiti i lartë i llogarisë korrente përbën rrezik. Pamjaftueshmëria e flukseve hyrëse të kapitalit, sidomos të IHD-së, mund të imponojnë ndërhyrje të papritura në ekonominë reale nëpërmjet *feedback loop* negativ dhe të shkaktojnë efekte negative në financat publike. *Në tërësi*, bilanci tregtar dhe llogaria korrente shfaqin deficite të konsiderueshme dhe të vazhdueshme.

Kontributi i punësimit në rritjen e PBB-së ka qenë i kufizuar, kryesisht për shkak të zhvendosjeve të pafavorshme demografike, humbjes së krahut të punës të kualifikuar për shkak të emigracionit masiv, si edhe përmasave të konsiderueshme të sektorit informal. Rritja e numrit të vendeve të punës

ishte pozitive në periudhën 2000-2008, por ajo u reduktua në vitin 2009 si pasojë e krizës. Papunësia ka rënë gradualisht gjatë viteve, dhe në vitin 2009 ishte 13.8%. Tregu i punës karakterizohet nga norma e lartë inaktiviteti, që në vitet e fundit ka qëndruar pak nën 40%. Puna informale mbetet e përhapur në shumicën e veprimtarive ekonomike, pavarësisht disa nismave për ta luftuar, përfshi uljen e kontributeve shoqërore. Papunësia afatgjatë e lartë, që prek rreth 65% të punëkërkuarve, është një tjetër karakteristikë e tregut shqiptar të punës. Krahasuar me meshkujt, pjesëmarrja dhe punësimi i grave është shumë më i ulët ndërsa papunësia më e lartë. Statistikat zyrtare për tregun e punës kanë nivel të lartë pasigurie. Papunësia ka mbetur e lartë për shkak të nivelit të ulët arsimor, kualifikimeve të vjetruara të të papunëve dhe punës në të zezë, që ndihmon në zbutjen e varfërisë por zvogëlon stimujt për të kërkuar punë. *Në tërësi*, ekzistenca e përhapur e punës informale vazhdon të shtrembërojë rëndë tregun e punës, ndërkohë që mungesa e statistikave të besueshme pengon kryerjen e analizave. Edhe pse ka pasur rënie, papunësia vazhdon të mbetet e lartë.

Banka e Shqipërisë, një institucion përgjithësisht i pavarur, u mandatua në 1997 që si objektivi primar të kishte arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Kreditimi i drejtpërdrejtë dhe administrimi i normave të interesit, u zëvendësuan në vitin 2000, nga kontrata riblerjeje, që u bënë instrumenti kryesor për të kontrolluar likuiditetin bankar. Në vitin 2004, Banka iu afrua objektivit për frenimin e inflacionit me qëllim arritjen e stabilitetit të çmimeve, duke e mbajtur inflacionin në 3%, brenda objektivit 2-4 pikë përqindje. Ky objektivi i shpallur publikisht ndihmoi në krijimin e pritshmërisë së qartë për inflacionin.

Gjatë dekadës së fundit, inflacioni është ulur gradualisht dhe përveç vitit 2002 ka qëndruar nën 3%. Inflacioni nisi të rritet në tetor 2009, si rezultat i zhvlerësimit të lekur, çka solli rritjen e çmimeve të importeve. Rritja e inflacionit u përshpejtua në janar dhe shkurt 2010, kryesisht nga rritja e çmimeve administrative (tarifat për ujën dhe energjinë elektrike), por më pas ra, duke arritur në 3.4% në shtator. *Në tërësi*, që në vitin 2003, inflacioni vjetor ka qëndruar nën 3%, duke pasqyruar një politikë monetare të prirur drejt nivelit të lartë të stabilitetit të çmimeve.

Penetrimi i Euros (eurozimi) në ekonomi është i lartë. Normat e larta të interesit për huat në lek, edhe pse janë vendimtare për stabilitetin e valutës, kanë rezultuar në rritje të huave në valutë. Në korrik 2010, huat në valutë përbënin 70% të stokut të huave, ndërkohë që depozitat në valutë zinin 48%. Ky zëvendësim monetar vë nën presion efektshmërinë e politikës monetare. Për më tepër, eurozimi i lartë është rrezik potencial për stabilitetin e sistemit financiar, pasi mund t'i ekspozojë bankat ndaj riskut valutësor. Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë masa të kujdesshme që kanë synuar inkurajimin e huamarrjes në lek, duke u kërkuar bankave mes të tjerash, që kur llogarisin raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, të ponderojnë huat në valutë me +50%.

Diferencat ndërmjet normave mesatare të interesit të ponderuara të huave dhe depozitave janë relativisht të mëdha, duke qenë rreth 8.4 pikë përqindje për huat dhe depozitat në lek, por gjithsesi ato kanë rënë ndjeshëm gjatë viteve të fundit (nga 16.5% në tremujorin e fundit të vitit 2000).

Shqipëria ka ndjekur një regjim kursi këmbimi të liberalizuar, ku vlera e valutës përcaktohet në tregun e këmbimit valutor dhe ndërhyrjet janë kufizuar në zbutjen e luhatjeve të forta, ndërkohë që është ruajtur niveli i duhur i rezervave valutore. Përballë krizës globale, leku filloi të zhvlerësohet dhe humbi mesatarisht 7.5% të vlerës kundrejt Euros në 2009. Në fund të vitit 2009, rezervat e Bankës së Shqipërisë ishin sa 4.3 muaj importe mallrash dhe shërbimesh. *Në tërësi*, politika monetare ka mundësuar uljen e pritshmërisë inflacioniste, pavarësisht se eurozimi i lartë ishte faktor i madh frenues për efektivitetin e politikës monetare.

Deficiti qeveritar që kishte ndjekur një trend në rënie deri në vitin 2006, arriti në 7% të PBB në 2009. Deri në vitin 2006, përmirësimet e përgjithshme në imbalancën fiskale janë orientuar drejt kontrollit të shpenzimeve, bazuar fillimisht në shtrëngimin e shpenzimeve korrente jo-për-rroga dhe shpenzimeve kapitale, ndërsa në periudhën 2000-2005, konsolidimi i buxhetit pasqyroi kryesisht interesa maturimi më të ulëta. Të ardhurat totale u rritën lehtë gjatë periudhës 2000-2006, pasi rritjet e rëndësishme në taksat direkte dhe indirekte u kompensuan pjesërisht nga rënia e ndihmës së huaj në formën e projekteve dhe ulja e detyrimeve doganore, për shkak të harmonizimit të tarifave doganore në përputhje me detyrimet ndërkombëtare. Më vonë, pas një rritjeje në vitet 2006-2008, të ardhurat ranë në 26.2% të PBB-së në vitin 2009, pasi përballë rënies së performancës ekonomike, qeveria u la fushë të lirë stabilizatorëve automatikë më së shumti përmes të hyrave më të ulëta nga taksat direkte dhe indirekte. Shpenzimet totale filluan të rriten në 2006, duke kapur 33.2% të PBB-së në 2009, të nxitura kryesisht nga rritja e shpenzimeve kapitale - si rezultat i projekteve të mëdha në infrastrukturën rrugore - si dhe nga rritja e pagave në sektorin publik dhe e pensioneve. Kjo sugjeron se një politikë prociklike filloi që në vitin 2006 - e maskuar nga të ardhurat e larta nga taksat gjatë periudhës së bumit, - dhe kontribuoi në përkeqësimin e deficitit buxhetor dhe të deficitit të jashtëm tregtar, duke çuar në ngushtimin e hapësirave fiskale në periudhën pas krizës. *Në tërësi*, deficiti publik është ulur nga nivelet e larta, por ky trend është kthyer mbrapsht në vitet 2007-2009, i nxitur nga politikat e shpenzimeve prociklike të nisura që në vitin 2006.

Përbërja e të ardhurave publike mbeti praktikisht e pandryshuar gjatë periudhës 2000-2009, ku të ardhurat nga taksa indirekte (TVSH) zënë pjesën më të madhe (36.8% në 2009) të të ardhurave publike. Si rezultat i zgjerimit të bazës së taksimit, pjesa e taksave direkte (15.5% në 2009), veçanërisht e tatimit mbi të ardhurat, u rrit ndjeshëm në këtë periudhë, pjesërisht për shkak të uljes të normës së tatimit të detyrueshëm në 10% dhe nga përcaktimi i pagave referuese dhe numrit referues të të punësuarve në 2008. Edhe pse këto masa ndihmojnë në uljen e evazionit fiskal, mungon ende një sistem gjithëpërfshirës për respektimin e legjislacionit tatimor. Reformat gjatë viteve, kanë sjellë përmirësime në administratën tatimore. Megjithatë, vazhdojnë boshllëqet si për sa i përket realizimit

të të ardhurave dhe ndryshimeve të vazhdueshme administrative. Gjithashtu, korrupsioni në mbledhjen e detyrimeve tatimore dhe doganore, si edhe zbatimi i dobët i ligjit, u mundësojnë bizneseve të operojnë në sektorin informal që rezulton në ngushtim të bazës së taksimit. Menaxhimi i financave të pushtetit vendor vazhdon të jetë i dobët, duke sjellë realizim të ulët të të ardhurave (taksat për bizneset e vogla, për pronën dhe taksat vendore për të cilat është përgjegjës pushteti vendor përbëjnë rreth 4% të të ardhurave totale të shtetit) dhe shpenzime të kufizuara. Struktura e shpenzimeve totale dominohet nga transfertat korrente (30%) dhe investimet kapitale (29%). Pagat e punonjësve ndoqën një trend në rritje gjatë periudhës 2000-2009, dhe tani zënë rreth 1/5 e shpenzimeve totale. Pagesat e interesave kanë rënë gradualisht, nga ulja e normave të interesit dhe rregullat për huamarrjen publike, por gjithsesi zënë rreth 9.5% të shpenzimeve totale dhe rrjedhimisht ushtrojnë presion mbi shpenzimet bazë. Në tërësi, institucionet e dobëta dhe sektori i gjerë informal rezultuan në një bazë të ngushtë tatimpaguesish, gjë që tkurr të ardhurat fiskale pavarësisht masave të ndryshme në vitet e fundit.

Konsolidimi fiskal solli rënie të borxhit publik, nga 61% të PBB-së në vitin 2000, në 54.3% në 2007. Ky trend ndryshoi për keq në periudhën 2008-2009, kur borxhi ishte pothuajse 60% e PBB-së. Edhe pse ky raport i borxhit publik është i lartë, një faktor zbutës i riskut është fakti se 3/5 e borxhit total publik është borxh i brendshëm, i marrë pothuajse plotësisht në lek. Borxhi publik konsiston nga borxhi i qeverisë qendrore, pasi edhe pse pushteti vendor gëzon të drejtën për huamarrje, e ka përdorur shumë pak këtë mundësi deri tani. Sidoqoftë, rreth 60% e borxhit të brendshëm është afatshkurtër, domethënë me maturim 1-vjeçar ose më pak, çka sjell riskun e ri-financimit. Bankat tregtare mbeten mbajtëset kryesore të borxhit të brendshëm publik. Borxhi i jashtëm përbëhet nga hua afatgjata, nga të cilat pak më tepër se gjysma janë marrë në Euro, ndërsa 30% është në të Drejta Speciale të Tërheqjes (SDRs). Kredituesit shumëpalësh përbëjnë afërsisht 53% të borxhit të jashtëm. Në tërësi, niveli i lartë dhe në rritje i borxhit publik mbetet burim vulnerabiliteti makroekonomik.

Politikat fiskale dhe monetare të përshtatshme kanë qenë faktori kryesor i miqsisht të politikave dhe kanë përforcuar stabilitetin relativ makroekonomik të Shqipërisë. Megjithatë, politika prociklike e buxhetit që nga viti 2006, ka ngushtuar hapësirën fiskale për manovrim, dhe ka rritur borxhin publik. Kuadri i politikave monetare ka stabilizuar pritshmërinë për inflacionin, pavarësisht kufizimeve që shkakton eurozimi i theksuar. Normat fleksibël të këmbimit valutor kanë mbështetur përshtatjen ndaj tronditjeve të jashtme. Në tërësi, rikrijimi i hapësirës fiskale që të garantojë qëndrueshmërinë buxhetore afatmesme, si dhe përshpejtimi i fuqishëm i reformave, janë sfidat kryesore të politikës makroekonomike.

#### *Ndërveprimi i forcave të tregut*

Liberalizimi i çmimeve është përfunduar në përgjithësi, por rregullimi i çmimeve mbron një numër sektorësh. Rreth 4.3% e artikujve që përbëjnë indeksin e çmimeve të konsumit, mbeten të



administruar ose të rregulluar. Çmimet e administruara vendosen nga rregullatorë sektorialë (energji elektrike, telefoni, furnizim me ujë) ose nga organet shtetërore.

Pjesëmarrja e shtetit në ekonomi është ulur gradualisht, dhe për rrjedhojë sektori privat sot, zë rreth 3/5 e PBB-së dhe 82% të punësimit total. Kjo është arritur kryesisht përmes procesit të gjerë të privatizimit. Sektorët që janë akoma në pronësi ose nën kontrollin e Shtetit përfshijnë prodhimin e energjisë elektrike, hekurudhat, portet dhe ndërmarrjet e ujësjellësit. Qeveria planifikon të vazhdojë me programin e privatizimeve, duke filluar me shitjen e kuotave dhe aseteve në sektorë strategjikë si hidrokarburet, sigurimet, disa shërbime portuale, disa operacione në transportin hekurudhor dhe në telekomunikacion. *Në tërësi*, procesi i privatizimit ka avancuar, ndërsa kontributi i sektorit privat në ekonomi ka arritur në një nivel të lartë.

### *Hyrja dhe dalja nga tregu*

Përparime të konsiderueshme janë bërë vitet e fundit në lehtësimin e hapjes së bizneseve të reja. Në 2007, u miratua ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) që ofron regjistrim të njëkohshëm *one-stop-shop* për qëllime të administrimit të taksave, sigurimit shoqëror dhe shëndetësor, si dhe inspektiveve në punë. Procedurat më efektive dhe eficiente kanë bërë që hapja e një biznesi të bëhet më shpejt dhe më lirë. Pavarësisht rritjes së numrit të shërbimeve elektronike dhe qendrave të regjistrimit në mbarë vendin, nevojiten përpjekje të mëtejshme për forcimin e kapaciteteve të QKR-së nëpër bashki. Gjithashtu, me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Licencimit në 2009, shumica e licencave u hoqën dhe procedurat në shumë sektorë u lehtësuan dhe u harmonizuan, duke ulur kështu barrierat administrative për bizneset. *Në tërësi*, progresi i dukshëm është arritur në nivel kombëtar në lehtësimin e hyrjes në treg, por nevojiten më tepër përpjekje në nivel vendor.

Ligji i ri për procedurat e falimentit i majit 2009, përfaqëson një kuadër më eficient për daljen nga tregu. Për më tepër, gjykatat do ta shqyrtojnë çështjen brenda 30 ditësh, duke shpejtuar procedurat e falimentit. Megjithatë, zbatimi i ligjit ka qenë i dobët, nuk është ngritur akoma agjencia që duhet merret me rastet e falimentit, e cila është parashikuar në ndryshimet që i janë bërë ligjit, dhe numri i kompanive të deklaruara të falimentuara nga gjykatat, ka qenë minimal, pavarësisht disa procedimeve gjyqësore në proces. *Në tërësi*, pavarësisht disa ndryshimeve legjislative së fundmi, zbatimi i procedurave të falimentit mbetet gjerësisht joefektiv.

### *Sistemi ligjor*

Sistemi ligjor që mbështet ekonominë e tregut ka evoluar që në vitet 1990. Megjithatë, procesi legjislativ nuk është plotësisht transparent, pasi ligjet e propozuara jo gjithmonë i nënshtrohen konsultimit publik. Ligjet dhe aktet normative nuk janë ndonjëherë konsistentë, të plotë ose u mungojnë aktet zbatuese nënligjore, duke çuar kështu në pasiguri për sa i përket interpretimit.

Funksionimi i tregut të pronave mbetet joeficient, gjë që shton pasigurinë e biznesit. Një nga problemet kryesorë është kthimi i pronave dhe formalizimi i ndërtimeve pa leje. Janë regjistruar rreth 80% e të gjitha pronave, por regjistrimi ka avancuar më pak në zonat urbane dhe bregdetare, këto të fundit kanë potencial të lartë për zhvillimin e turizmit. Procesi i regjistrimit të tokës karakterizohet nga mungesa e dokumenteve ligjore, vonesat dhe zbatimi i dobët i vendimeve gjyqësore, pretendime të shumta për të njëjtën pronë, korrupsioni dhe bashkërendimi i dobët ndërmjet agjencive shtetërore. Kjo çon në shkëmbim informal të të drejtave të pronësisë, duke ngjallur mosmarrëveshje të reja që rëndojnë gjykatat dhe shkaktojnë humbje të mëtejshme në të ardhurat tatimore. Në tërësi, edhe pse janë bërë përparime në dy dekadat e fundit, transferimi i pronësisë dhe njohja e të drejtave të pronësisë mbeten të paplotë dhe pengojnë funksionimin e tregut të tokës.

Sistemi gjyqësor vuan nga ndërhyrjet e papërshtatshme politike, korrupsioni, mungesa e kapaciteteve dhe mungesa e transparencës dhe efikasitetit të procedurave gjyqësore. Metodave informale të ekzekutimit të kontratave, duke anashkaluar sistemin ligjor, vazhdojnë të jenë të përhapura. Qeveria ndërmori disa hapa për të forcuar sistemin gjyqësor dhe për të rritur luftën kundër korrupsionit. Janë futur një sërë shërbimesh elektronike publike (përfshi sistemin elektronik të prokurimit publik), me qëllim rritjen e transparencës. Janë shpeshuar inspektimet në gjykata dhe agjenci publike, dhe janë filluar procedime penale ndaj zyrtarëve përgjegjës për shkelje. Megjithatë, ende nuk është miratuar ligji që parashikon ngritjen e gjykatave administrative që do të merren me çështjet tregtare dhe mosmarrëveshjet ndërmjet kompanive dhe institucioneve publike. Roli i gjykatave në ekzekutimin e kontratave mbetet i kufizuar, për shkak të kapaciteteve të dobëta administrative dhe korrupsionit të përhapur. Në tërësi, edhe pse janë shënuar disa përparime, klima e biznesit vazhdon të pengohet nga shteti i dobët i së drejtës.

#### *Zhvillimi i sektorit financiar*

Ndërmjetësimi bankar, edhe pse akoma i ulët, është rritur me shpejtësi në vitet e fundit. Në 2009, raporti hua-PBB u rrit në pak mbi 41%, nga 7.3% në 2003. Të 16 bankat tregtare janë plotësisht private, me një raport aset-PBB prej afërsisht 82%. Sistemi bankar karakterizohet nga një nivel i lartë përqendrimi, sepse 6 bankat më të mëdha kanë 72% të huave dhe 81% të depozitave.

Sektori bankar dominohet nga pronarët e huaj. Kapitalizimi i sistemit bankar është rritur gradualisht, duke arritur në rreth 9.4% të bilancit të bankave. Mjaftueshmëria e kapitalit ishte 16.2% në 2009 - shumë më lart se minimumi ligjor prej 12% i vendosur nga Banka e Shqipërisë dhe kufiri 8% i përcaktuar nga Marrëveshja Kuadër e Bazelit.

Struktura e aseteve bankare ka pësuar ndryshime të konsiderueshme vitet e fundit. Investimet e sektorit bankar në bono thesari kanë rënë nga pothuaj 50% e totalit të aseteve në 2003, në 12% në 2009,

duke sjellë rritjen e portofolit të kredive. Sektori i bizneseve zë rreth 62% të huave, ekonomitë familjare 33%, sektori publik 2.7%, dhe pjesën e mbetur e zënë institucionet financiare. Në shtatë vitet e fundit, strukturave e maturimit të huave po prirret gjithnjë e më shumë drejt huave afatgjata, domethënë huave me maturim 1 vit e lart, që përfaqësojnë rreth 72% të totalit.

Përfitueshmëria e bankave pati rritje në përgjithësi duke shtuar të ardhurat operative neto në periudhën 2004-2007, por ra në dy vitet pasuese për shkak të rritjes së kostove operative dhe rritjes së shpejtë të shpenzimeve për rritjen e rezervave të kapitalit të imponuar nga kriza ekonomike. Kreditë e këqija patën një rritje të lehtë në periudhën 2005-2007, por ritmi i rritjes së tyre u përshpejtua që nga tremujori i fundit i 2008. Në gjysmën e parë të vitit 2010, kreditë e këqija vazhduan të rriten - duke shënuar 12% në tremujorin e dytë të 2010 - edhe pse me ritëm më të ngadaltë rritjeje. Fitimi nga asetet ra nga 1.3% në 2004 në rreth 0.3% në 2009. Megjithatë, sistemi bankar vazhdon të jetë i mirëkapitalizuar.

Nisur nga një bazë e ulët, kreditimi u zgjerua shpejt në gjysmën e parë të viteve 2000, i nxitur kryesisht nga konkurrenca e forcuar në sektorin bankar pas privatizimit të Bankës së Kursimeve. Pjesa më e madhe e rritjes së huadhënieve, është financuar nga burime të brendshme, në formën e depozitave të brendshme dhe rikapitalizimit. Në dy dekadat e fundit, kapacitetet mbikëqyrëse të Bankës janë forcuar ndjeshëm falë zbatimit të një procesi mbikëqyrës të bazuar më tepër në risk. Progres i qenësishëm është arritur në përmirësimin e kuadrit ligjor për procedurat e insolvencës dhe falimentit. *Në tërësi*, sistemi bankar ka shënuar zgjerim të shpejtë në vitet e fundit si rezultat i privatizimit dhe hyrjes së aktorëve të huaj.

Tregu i sigurimeve ka shënuar zgjerim gradual, pavarësisht bazës së ulët. Në 2008, asetet totale ishin rreth 1.4% të PBB-së. Të 10 kompanitë e licencuara aktive në këtë sektor janë shqiptare, por që në 2007 po rritet numri i kompanive të huaja (BE) që vendosen në Shqipëri. Në sektorin e sigurimit vullnetar, sigurimi i jo-jetës përfaqëson rreth 83% të xhiros. Tregu i pensioneve private është akoma i pazhvilluar. Tre kompani janë licencuar për të ofruar pensione private. Në fund të 2009, ligji i ri për planet e pensionit vullnetar ndryshoi kuadrin ligjor për pensionet private. Ligji ofron mundësinë për krijimin e fondeve të pensionit të shtyllës së tretë me kontribute të përcaktuara, por nuk pasqyron të gjitha dispozitat e *acquis*. *Në tërësi*, sektori financiar jo-bankar është akoma i pazhvilluar dhe luan një rol të papërfillshëm si burim i financimit të sektorit privat.

Bursa e Tiranës u hap zyrtarisht në 1996, por nuk ka asnjë kompani të regjistruar në këtë bursë.

### 2.2.2. *Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së*

Aftësia për të përmbushur këtë kriter varet nga ekzistenca e ekonomisë së tregut dhe një kuadër i qëndrueshëm makroekonomik që u mundëson operatorëve ekonomikë të marrin vendime në një

klime parashikueshmërie. Gjithashtu, ai kërkon burime njerëzore dhe fizike të mjaftueshme. Ndërmarrjet duhet të investojnë për të përmirësuar eficientësinë e tyre, dhe duhet të përqafojnë inovacionet që të përshtaten me mjedisin e jashtëm të globalizuar dhe tepër konkurrues. Në tërësi, sa më shumë të jetë e integruar ekonomia me BE-në para anëtarësimit, aq më e aftë do të jetë ajo të përballojë detyrimet e anëtarësimit.

### *Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale*

Shqipëria është një ekonomi e vogël në hapje të vazhdueshme, me një sektor privat të madh që zë 80% të PBB-së. Çmimet dhe tregtia janë në pjesën më të madhe të liberalizuara. Gjatë tranzicionit, Shqipëria ndoqi një miks politikash që synonte stabilitetin makroekonomik. Rritja ekonomike ka qenë e fuqishme, ndërsa inflacioni ka rënë dhe ka mbetur i ulët. Megjithatë, deficitet e llogarisë korrente është përkeqësuar gjatë viteve, ndërsa papunësia edhe pse në rënie, mbetet e lartë. Politika prociklike e shpenzimeve që filloi në vitin 2006, çoi në rritje të deficitit buxhetor në 2007, që u rëndua më tej nga rënia e realizimit të të ardhurave në 2009. Për pasojë, borxhi publik kaloi nga rënia në ngritje, dhe së bashku me rritjen e deficitit të jashtëm, përbëjnë rrezik për stabilitetin makroekonomik. Rifillimi i konsolidimit fiskal, forcimi i stabilitetit të sektorit bankar, heqja e pengesave për hyrjen dhe daljen nga tregu, si dhe përshpejtimi i zbatimit të sistemit ligjor, do ta përmirësonin potencialin e rritjes së ekonomisë. Në tërësi, Shqipëria ka arritur një nivel stabiliteti makroekonomik që përgjithësisht i lejon operatorët ekonomikë të marrin vendime në një klimë parashikueshmërie. Megjithatë, për t'u bërë ekonomi tregu funksionale, Shqipëria duhet të forcojë më tej qeverisjen, të përmirësojë performancën e tregut të punës, të përfundojë njohjen e të drejtave të pronësisë dhe të përshpejtojë zbatimin e ligjit.

### *Kapitali njerëzor dhe fizik*

Edhe pse burimet publike kushtuar arsimit janë të mëdha (3.8% e PBB-së në 2009), Shqipëria përballlet me një sërë sfidash. Ndryshimet demografike të shkaktuara nga largimi i trurit në vitet e kaluara, informaliteti i lartë, dobësitë në arsim dhe në sistemin e aftësive profesionale, pengojnë realizimin e plotë të kapitalit njerëzor. Si rezultat, firmat përballen me një mungesë aftësish profesionale që kufizon rritjen e tyre. Niveli arsimor është i ulët, pavarësisht përmirësimeve të viteve të fundit. Nxënësit shqiptarë kryejnë mesatarisht 8.6 vite shkollë, një shifër shumë e ulët krahasuar me standardet evropiane. Gjithsesi, shkalla e braktisjes së shkollës ka rënë vitet e fundit, veçanërisht në arsimin fillor, dhe pjesëmarrja në atë dytësor dhe të lartë është rritur. Reformat për ta bërë sistemin e formimit profesional më reagues ndaj ndryshimeve të tregut, janë relativisht të reja. Kurrikulat e universitetit që përputheshin fare pak me kërkesat e tregut të punës, po i nënshtrohen një riorganizimi të plotë, si në përmbajtje ashtu edhe në strukturë, në përputhje me standardet e Bolonjës. Në nivel institucional, reformat po rrisin edhe autonominë dhe vetëqeverisjen e universiteteve. Niveli i shpenzimeve për kërkim shkencor dhe zhvillim mbetet i ulët. Shpenzimet për kërkimin shkencor përfaqësonin 0.2% të PBB në vitin 2009. Në përgjithësi, edhe pse ka mungesa të rënda në njohuri, aftësi profesionale dhe

orientim të fuqisë punëtore që nevojiten në një treg pune dinamik, reformat e fundit përbëjnë një hap në drejtimin e duhur.

Në vitin 2007 u miratua Strategjia për punësimin dhe formimin profesional 2007-2013. Shërbimi Kombëtar i Punësimit organizon programe aktive të tregut të punës, duke ofruar këshillim dhe formim profesional, si dhe programe ndërmjetësimi dhe promovimi të punësimit që synojnë kryesisht studentët, femrat dhe shtresat në nevojë. Shtrirja e këtyre programeve mbetet e pamjaftueshme. Mungon një strategji gjithëpërfshirëse për zhvillimin e aftësive profesionale të forcave të punës, ndërkohë që trajnimi në punë është i dobët. Në tërësi, programet aktive të tregut të punës janë të pamjaftueshme krahasuar me shkallën e papunësisë, ndërkohë që formimi profesional lidhur me punën/profesionin mbetet sfidë.

Nën peshën e një stoku të vjetruar *kapitali fizik*, Shqipëria u përball me nevoja të konsiderueshme investimi pas vitit 1992, sepse kishte mangësi të thella në infrastrukturë bazë dhe në kapital prodhues. E shprehur si përqindje e PBB-së, mesatarja e investimeve vjetore totale arriti në rreth 37% gjatë periudhës 2000-2008. Megjithatë, shtëpitë e banimit, që njohën një zgjerim të shpejtë gjatë viteve të fundit të mbështetur nga flukset hyrëse të remitancave, përbëjnë pjesën më të madhe të këtij niveli të lartë investimesh. Investimeve të tilla, së bashku me investimet hyrëse modeste *green-field*, që kanë qenë të përqendruara në aktivitetet prodhuese ku kishte mungesë kapitali, nuk pritet të rrisin kapacitetin prodhues të ekonomisë. Investimet *green-field* janë penguar nga gjendja e infrastrukturës, e cila edhe pse është përmirësuar në dy dekadat e fundit, ende shfaq dobësi në cilësi, besueshmëri dhe kosto. Në tërësi, investimet kanë qenë të mëdha, por ka ende pengesa ndaj kapitalit prodhues.

Pasiguria në furnizimin me energji elektrike është një nga këto pengesa. Mungesa e investimeve në rrjetet e transmetimit dhe interkonjeksionit, si dhe varësia e tepërt tek hidrocentralet, ka çuar në ndërprerje periodike (*load shedding*). Kjo, së bashku me mangësitë në shpërndarje, kanë rezultuar në humbje financiare për KESH-in, furnizuesin e energjisë elektrike, dhe kanë sjellë nevojën për subvencione. Megjithatë, situata është përmirësuar që nga viti 2008 kryesisht për shkak të kushteve të favorshme hidrologjike. Në vitin 2003, një strategji kombëtare e energjisë u prezantua me qëllim transformimin e këtij sektorit në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut. Qeveria është duke u përpjekur të diversifikojë burimet e energjisë, duke ofruar koncesione për investitorët privatë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve hidroelektrike dhe burimeve të tjera alternative të energjisë. Interkonjeksioni me vendet fqinje është i kufizuar, edhe pse investimet në këtë fushë vazhdojnë. Në tërësi, reformat e kohëve të fundit kanë filluar të korrigjojnë mangësitë në infrastrukturën e energjisë elektrike, por nevojiten investime të mëtejshme për të garantuar furnizim të besueshëm me energji.

Infrastruktura e telekomunikacionit është e pamjaftueshme dhe pengon bizneset. Penetrimi i telefonisë fikse është i ulët, 11.3 për 100 banorë. Penetrimi *me brez të gjerë* mbetet tepër i ulët dhe përfshin 2,5% të popullsisë, pasi tarifatat mbeten të larta. Përdorimi i internetit nga biznesi është rritur

vitet e fundit, por mbetet veçanërisht i ulët mes bizneseve shumë të vogla që përbëjnë përqindjen më të madhe të firmave. Nga ana tjetër, rritja e konkurrencës ka çuar në rritje të shpejtë të dendësisë së përdorimit të telefonisë celulare, e cila është e krahasueshme me nivelet e BE-së. Pavarësisht konkurrencës dhe uljes së tarifave në vitin 2008, tarifat e telefonisë celulare mbeten ndër më të lartat në rajon. *Në tërësi*, performanca e telekomunikacionit është e dobët.

Investimet e ndjeshme gjatë viteve të fundit, sollën zgjerimin e rrjetit rrugor, por përqindja e rrugëve të cilësisë së ulët mbetet e lartë, pasi fondet e akorduara për mirëmbajtjen e rrugëve janë të ulëta. Portet kryesore të Shqipërisë në det të thellë, si i Durrësit dhe i Vlorës, janë duke iu nënshtruar përmirësimit të infrastrukturës. Prioriteti i qeverisë për infrastrukturën rrugore ka rezultuar në mungesë të investimeve në rrjetin hekurudhor. *Në tërësi*, vëmendja e kushtuar për ndërtimin e infrastrukturës së transportit në vitet e fundit nuk është pasuar me mirëmbajtje, ndërkohë që transporti hekurudhor mbetet i papërshtatshëm.

#### *Struktura e sektorit dhe e ndërmarrjeve*

Pjesa më e madhe e prodhimit është klasifikuar si industri e lehtë dhe është pothuajse tërësisht në pronësi private. Pavarësisht zgjerimit të dukshëm vitet e fundit, baza prodhuese e Shqipërisë mbetet e ngushtë dhe e varfër në kapital. Tekstilet dhe këpucët mbeten një nënsektor i madh që përfaqëson rreth 15% të vlerës së shtuar të industrisë. Një pjesë e madhe e prodhimit është e destinuar për tregjet e huaja dhe përbën rreth 43% të totalit të eksportit të mallrave. Sektori i nxjerrjes, i përbërë nga prodhimi i energjisë dhe jo-energjisë, përfaqëson rreth 14% të eksportit të mallrave. Sektori i jo-energjisë përbëhet nga nxjerrja e mineraleve dhe ekstraktive të tjera. Duke ditur rezervat e rëndësishme minerare të Shqipërisë, nënsektori i jo-energjisë mbetet nën potencialin real, kryesisht si rezultat i institucioneve të dobëta, mungesa e efektivitetit rregullator dhe kapacitetet e dobëta teknike. Shërbimet përfaqësojnë rreth 54% të PBB-së, ku pjesën më të madhe e zënë tregtia, hoteleria dhe restorantet. Turizmi ka qenë një nga nënsektorët më dinamikë në dekadën e fundit.

Përqindja shumë më e lartë e shërbimeve në *output* nuk pasqyrohet në shifra punësimi. Sektori privat i ekonomisë shqiptare karakterizohet nga dikotomia; një përqindje e lartë e punësimit (rreth 44%) është e angazhuar në sektorët në rënie që kanë kontribut të ulët në *output*, kryesisht bujqësi, ndërsa sektorët në rritje, d.m.th. shërbimet, industria dhe ndërtimi që kanë peshë të madhe në PBB, mbajnë peshë më të vogël punësimi (38%). Sektori publik përthithi rreth 18% të punësimit total në 2008. Sektorit informal mbetet i madh, i nxitur nga dobësitë në politikën tatimore dhe të shpenzimeve, si dhe në zbatimin e ligjit, përfshi luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ai zvogëlon bazën tatimore dhe efikasitetin e politikave ekonomike. *Në tërësi*, pavarësisht ndryshimeve të konsiderueshme strukturore ndër vite, ka akoma mjaft vend për të përmirësuar *input*-et e punës, për të kaluar nga aktivitetet me produktivitet të ulët, në ato me produktivitet të lartë.

Në vitet e fundit, reformat rregullatore udhëhoqën ristrukturimin dhe liberalizimin gradual të tregut të energjisë elektrike, si dhe nxitjen e tregtisë rajonale të energjisë elektrike. Gjithashtu, qeveria vendosi të ndante KESH-in dhe në 2009, privatizoi sistemin e shpërndarjes. Agjencia rregullatore u forcua dhe iu dhanë më tepër kompetenca, duke përfshirë edhe kompetencën për të pajisur me licencë operatorët e ndryshëm të tregut. Tarifat janë rritur gradualisht, por akoma nuk mbulojnë kostot. Mbetet sfidë forcimi i gjendjes teknike, financiare dhe menaxhimit të KESH-it, si edhe realizimi efektiv i privatizimit, ndërmjet të tjerash, duke marrë masa për të ulur humbjet dhe rritur arkëtimet. Kuadri rregullator i telekomunikacionit i ka elementët thelbësorë, d.m.th një ent rregullator i telekomunikimeve dhe një operator i privatizuar i telefonisë fikse, ndërkohë që legjislacioni është pjesërisht në pajtim me praktikën e BE-së. *Në tërësi*, hapat e fundit në sektorin e energjisë elektrike janë në drejtimin e duhur, por duhet forcuar zbatimi i këtyre masave për ta bërë efektiv riorganizimin e sektorit.

Procesi i tranzicionit në Shqipëri ka rezultuar në një sektor biznesi të dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) që zënë mbi 3/5 të PBB-së dhe punësojnë rreth 4/5 e numrit të përgjithshëm të punëtorëve. Ndërmarrjet shumë të vogla dhe të vogla mbizotërojnë në sektorët e shërbimeve dhe të tregtisë, ndërkohë që ndërmarrjet e mesme janë të përqendruara në ndërtim dhe industri. NVM-të përqendrohen në tregun e brendshëm dhe u mungon aftësia konkurruese për të eksportuar. Mbështetja për kompanitë novatore dhe të orientuara nga eksporti është e dobët. Në vitin 2007, qeveria ngriti një fond garancie eksporti prej 1.6 milion Euro, për firmat me orientim nga eksporti, si dhe një skemë granti si pjesë e një fondi për nxitjen e konkurrueshmërisë. Një kuadër strategjik për zhvillimin e NVM-ve u shpall në vitin 2007 përmes Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, e cila është një strategji afatgjatë e plotësuar me një program afatmesëm. *Në tërësi*, NVM-të janë më së shumti të orientuara drejt tregut të brendshëm, pasi promovimi i eksportimit mbetet i pamjaftueshëm.

Edhe pse aksesimi në financim është përmirësuar ndër viteve, për shumicën e firmave burimi kryesor i financimit mbeten burimet e tyre. Kështu ndodh sidomos me bizneset shumë të vogla, të vogla dhe ato të sapohapura, të cilat përballen me kushte të vështira të kreditimit, sidomos në zonat rurale. Që nga viti 2009, kushtet e kreditimit për NVM-të janë shtrënguar, me norma kreditimi për kreditë e reja në lekë nga bankat tregtare, që shkojnë në rreth 15%. Ndërsa kompanitë vazhdojnë të vuajnë nga vonesat në rimbursimin e mbipagimit të TVSH-së apo rimbursimin e eksporteve, situata është përmirësuar disi që prej fillimit të vitit 2010. Një regjistër publik i kredisë, i krijuar nga Banka e Shqipërisë në vitin 2008, mbledh të dhëna nga bankat dhe i bën ato të disponueshme për huadhënësit. Megjithatë, përjashtimi i institucioneve të mikro-kredive nga regjistri i kredisë, konsiderohet si pengesë për NVM-të në aksesin për kredi bankare. *Në tërësi*, pavarësisht përparimeve të ndjeshme, aksesimi në financim mbetet sfidë për ndërmarrjet shumë të vogla dhe ato të vogla.

## *Ndikimi i shtetit në konkurrencë*

Ndihma shtetërore (duke përfshirë atë për bujqësinë dhe peshkimin) ka rënë nga 0.6% e PBB-së në vitin 2006, në 0.4% në vitin 2008. Tri të pestat e ndihmës shtetërore janë dhënë në mbështetje të sektorëve të veçantë që ofrojnë shërbime publike, si furnizimi me ujë dhe hekurudhat. Sektori i energjisë elektrike ka qenë një përfitues i madh i mbështetjes shtetërore në vitin 2007, pjesërisht si rezultat i kushteve të këqija të motit, të cilat shkaktuan krizë në këtë sektor. Pas kësaj, niveli i subvencioneve që i është dhënë këtij sektori ka pësuar rënie. Asnjë ndihmë financiare specifike nuk iu dha firmave për të përballuar krizën ekonomike në vitin 2009 dhe 2010. *Në tërësi*, shumica e ndihmës shtetërore mbetet e kufizuar.

## *Integrimi ekonomik dhe konvergjenca me BE-në*

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria është integruar edhe më tepër në ekonominë globale dhe është bërë gjithnjë e më e hapur, ndërkohë që tregtimi i mallrave dhe shërbimeve arriti në mbi 80% të PBB-së në 2009 - pothuaj sa dyfishi i shifrës në vitin 1996. BE-ja është partneri kryesor tregtar me rreth 70% të mallrave, e ndjekur nga vendet e CEFTA-s (9.4%). Në vitin 2008, pjesa më e madhe e tregtisë me BE-në u orientua drejt Italisë (62% eksportet, 27% importet) dhe Greqisë (eksportet 9%, importet 15%). Megjithatë, volumi i tregtisë si me Italinë ashtu edhe me Greqinë ka ndjekur një kurbë në rënie. Integrimi në rritje dhe hapja tregtare është arritur në një mjedis ekonomik ku fluksi hyrës i IHD ishte mesatarisht 4.7% të PBB-së gjatë periudhës 2003-2008. Gjatë kësaj periudhe, më shumë se tre të katërtat e IHD-së e kanë pasur origjinën nga BE-ja, nga Greqia si burim kryesor me mbi gjysmën e totalit, e ndjekur nga Italia (11%) dhe Austria (8%). Megjithëse kursi real efektiv i këmbimit është zhvlerësuar që nga mesi i vitit 2008, duke kontribuar në përmirësimin e konkurrueshmërisë së çmimeve, konkurrueshmëria e dobët që nuk lidhet me çmimet është shkak për përmirësimin e kufizuar të cilësisë së eksporteve. *Në tërësi*, integrimi në tregti dhe investime me BE-në është i lartë. Zhvlerësimi i fundit i kursit real të këmbimit ka mbështetur konkurrueshmërinë e çmimeve, por faktorë strukturorë dëmtojnë konkurrueshmërinë që nuk lidhet me çmimet.

### **2.3 Vlerësimi i përgjithshëm**

Vlerësimi i aktual është bërë në bazë të kritereve të Kopenhagënit, në lidhje me ekzistencën e një **ekonomie tregu funksionale**, si dhe kapacitetet për të përballuar **presionet e konkurrencës** dhe forcat e tregut brenda Bashkimit.

Ka një konsensus të gjerë në Shqipëri mbi bazat e politikës ekonomike, si edhe një vijimësi rezultatesh në zbatimin e reformave ekonomike. Shqipëria arriti një nivel stabiliteti makroekonomik të mjaftueshëm, sa për të lejuar operatorët ekonomikë të marrin vendime në një klimë parashikueshmërie. Kombinimi i politikave makroekonomike këto vitet e fundit, ka qenë i



përshtatshëm, duke gjeneruar norma rritjeje mbi 5%, dhe aktiviteti ekonomik, edhe pse më i ngadaltë, ka mbetur pozitiv në vitin 2009, pavarësisht krizës. Inflacioni ka mbetur i ulët. Ndërveprimi i lirë i forcave të tregut është arritur përmes privatizimit. Çmimet dhe tregtia janë liberalizuar ndjeshëm. Përparime të dukshme janë arritur në lehtësimin e hyrjes në treg. Sistemi bankar është zgjeruar me shpejtësi si pasojë e privatizimit dhe hyrjes së aktorëve të huaj. Ndihma shtetërore është pakësuar. Përqindja e tregtisë dhe integrimi i investimeve me BE-në mbetet e lartë.

Megjithatë, konsolidimi fiskal ka bërë hapa mbrapa kohët e fundit dhe niveli i lartë i borxhit publik mbetet një rrezik makro-financiar. Baza e ngushtë e eksporteve dhe investimet publike kanë bërë që deficitin e llogarisë korrente të jetë i konsiderueshëm dhe persistent. Ekzistenca e përhapur e punës informale vazhdon të shtrembërojë rëndë tregun e punës, dhe papunësia mbetet e lartë duke qëndruar në nivelin e 13.8% në vitin 2009. Aksesin në financa mbetet një sfidë për ndërmarrjet e vogla. Dobësitë në shtetin e drejtës pengojnë transferimin e pronësisë dhe njohja e të drejtave të pronësisë mbetet ende një problem serioz. Sistemi i arsimit nuk është në gjendje të pajisë fuqinë punëtore me aftësitë profesionale të nevojshme për tregun dinamik të punës. Infrastruktura kërkon investime të mëtejshme dhe nevojiten hapa institucionalë e rregullatorë për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji. Ekonomia informale mbetet një sfidë e madhe.

### **3. Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**

Këshilli Evropian në Kopenhagën në qershor 1993 përfshiu mes kritereve për anëtarësim “aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, duke përfshirë mbështetjen për realizimin e qëllimeve politike, ekonomike dhe monetare të bashkimit”.

Në aplikimin për anëtarësim në bazë të Traktatit, Shqipëria ka pranuar pa rezervë qëllimet themelore të Bashkimit, duke përfshirë politikat dhe instrumentet e tij.

Kjo pjesë e raportit analitik analizon aftësinë e Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet e detajuara të anëtarësimit - domethënë *acquis*, siç shprehet në Traktate, legjislacionin dytësor dhe politikat e Bashkimit. Ky seksion ndjek strukturën e 33 kapitujve negociues në të cilët është ndarë *acquis* për qëllimin e kryerjes së negociatave të anëtarësimit. Çdo kapitull shqyrton situatën e tanishme dhe perspektivën e Shqipërisë.

Me zhvillimin e Bashkimit, *acquis* është bërë progresivisht më e vështirë dhe paraqet një sfidë më të madhe për pranimet e ardhshme sesa në të kaluarën. Aftësia e Shqipërisë për të zbatuar *acquis* do të jetë vendimtare për kapacitetin e saj që ajo të funksionojë me sukses brenda Bashkimit.

Në këtë aspekt, harmonizimi me *acquis* është kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në BE. Shqipëria duhet gjithashtu, të marrë të gjitha masat e nevojshme për të krijuar strukturat e nevojshme zbatuese, për të ngritur kapacitetet administrative në nivelin e kërkuar dhe për të siguruar zbatimin efektiv të *acquis*. Prandaj, çdo kapitull në vijim përmban analizën dhe vlerësimin e kapaciteteve administrative të Shqipërisë.

Për qëllim të këtij raporti analitik, dhe pa paragjykuar ndonjë datë të ardhshme të anëtarësimit, perspektiva afatmesme në vlerësime është përcaktuar si periudhë 5-vjeçare.

### 3.1 Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Parimi i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton se produktet duhet të tregtohen lirisht nga një pjesë e Bashkimit në një tjetër. Në një numër sektorësh, ky parim i përgjithshëm plotësohet nga një kuadër rregullator i harmonizuar, duke ndjekur 'Përqasjen e Vjetër' (përcaktimin e specifikimeve të sakta të produktit) ose 'Përqasjen e Re' (përcaktimin e kërkesave të përgjithshme për produktet). Transpozimi i legjislacionit evropian të harmonizuar për produktet, përbën shumicën e detyrimeve të këtij kapitulli. Zbatimi i duhur dhe i saktë i *acquis* kërkon kapacitete të mjaftueshme administrative që të informojnë për kufizimet ndaj tregtisë, dhe që të zbatojnë masat horizontale dhe procedurale në fusha si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* përcakton një numër detyrimesh në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, të tilla si, krijimi i një zone të tregtisë së lirë. Ajo parashikon gjithashtu, përafrimin gradual të rregullave teknike dhe standardeve të BE-së, dhe të procedurave të metrologjisë, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit.

Lidhur me **parimet e përgjithshme**, Shqipëria duhet të sigurojë që legjislacioni i saj, duke përfshirë dhe masat e zbatueshme të dallueshme apo të padallueshme, të jetë në përputhje me nenet 34 deri 36 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian dhe me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (me theks të veçantë në parimin e njohjes së ndërsjellë).

Në fushën e **masave horizontale**, Shqipëria gjatë vitit 2007 dhe 2008 miratoi legjislacion të ri për akreditimin, standardizimin dhe metrologjinë. Ligji për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore, ka për qëllim harmonizimin gradual me parimet e *Përqasjes së Re dhe Globale*. Legjislacionit i duhet një rishikim i mëtejshëm për ta sjellë plotësisht në pajtim me parimet e përgjithshme të Përqasjes së Re dhe me *acquis* horizontale të miratuar në vitin 2008.

Ligji kuadër për *standardizimin* u miratua në mars 2008. Megjithatë, Shqipëria nuk ka ngritur ende bazën ligjore dhe strukturën administrative për miratimin e standardeve të ETSI (Instituti i Standardeve Evropiane të Telekomunikacionit) si standarde shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), një departament i qeverisë që i raporton Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, është përgjegjëse për standardizimin në të gjitha fushat me përjashtim të telekomunikacionit. DPS është anëtare korrespondente e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO), anëtare e asociuar e Komisionit Ndërkombëtar Elektroteknik (IEC) dhe anëtare shok e Komitetit Evropian për Standardizim (CEN) ashtu dhe e Komitetit Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC). Ajo planifikon të aplikojë për anëtarësimin e plotë në CEN dhe CENELEC në 2012. Deri më tani, janë miratuar rreth 92% e standardeve evropiane (EN) të përgatitur nga CEN dhe CENELEC, si standarde shqiptare, duke plotësuar kështu kriterin standard lidhur me anëtarësimin. DPS ka një staf prej 18 personash. Ka 60 komisione teknike, ku të gjithë

përveç njërit pasqyrojnë komitetet e CEN/CENELEC. Duhet të sigurohen kapacitetet e mjaftueshme përkthyes dhe të teknologjisë së informacionit, të mbështetura me fonde për nxitjen e përdorimit të standardeve. Ende nuk është themeluar bordi mbikëqyrës i parashikuar në ligjin për standardizimin, i vitit 2008, që shërben për të monitoruar punën e DPS-së.

Për sa i përket *vlerësimit të konformitetit*, ligji kuadër për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore duhet të rishikohet për ta harmonizuar me *acquis* horizontale të vitit 2008. Praktikrat aktuale për përdorimin e shënjitimit “CE” nuk janë në pajtim me *acquis*. Deri tani janë akredituar 17 trupa të vlerësimit të konformitetit. Sipas ligjit, akreditimi është parakusht për t’u shpallur trup i vlerësimit të konformitetit.

Politika e *akreditimit* është gjerësisht në përputhje me parimet e BE-së, veçanërisht në lidhje me natyrën publike jofitimprurëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA ) dhe pavarësinë e saj profesionale dhe financiare nga klientët e mundshëm. DPA është përgjegjëse për akreditimin e trupave të vlerësimit të konformitetit. Ajo ka një staf prej 15 personash dhe rregullorja e saj e brendshme e miratuar me vendim të qeverisë në 2008, synon harmonizimin e mëtejshëm me *acquis*. DPA ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi me Bashkëpunimin Evropian për Akreditim (EA) në vitin 2006, dhe në vitin 2008, ajo aplikoi për të qenë palë nënshkruese e Marrëveshjes Shumëpalëshe EA në fushën e laboratorëve të testimit.

Procedurat e ankimit të parashikuara me ligjin e vitit 2008 për *metrologjinë*, u përmirësuan në vitin 2010, duke u dhënë operatorëve ekonomikë të drejtën e ankimit në gjykatë. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, është përgjegjëse për metrologjinë ligjore, shkencore dhe industriale, dhe shërben si Instituti Kombëtar i Metrologjisë. Ligji për metrologjinë lejon delegimin e disa aktiviteteve verifikuese tek operatorët privatë. DPM financohet nga buxheti i shtetit dhe ka 110 punonjës. Vazhdimësia e stafit të tij do të jetë thelbësore për të ndërtuar kujtesën institucionale dhe transferimin e njohurive. DPM është anëtare me të drejta të plota e Shoqatës Evropiane të Instituteve Kombëtare të Metrologjisë (EURAMET) dhe anëtare me status vëzhguesi e WELMEC, organizatës për bashkëpunim evropian në metrologjinë ligjore. Trupi akreditues shqiptar ka akredituar dy laboratorë kalibrimi, në përputhje me EN ISO / IEC 17025. DPM është duke punuar për zbatimin e planit të investimeve për fushat e reja të matjeve, mjediset dhe pajisjet, si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Sistemin e Metrologjisë në Shqipëri 2008-2012. Një Qendër e re Kombëtare e Metrologjisë është në ndërtim e sipër.

Sistemi i *mbikëqyrjes së tregut* bazohet në shumë akte ligjore të ndryshme, në varësi të produktit në fjalë. Për disa produkte ekziston edhe një sistem autorizimi paratregtimi, i bazuar në leje ose licenca. Ligji i vitit 2007 për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore, një nga aktet kryesore ligjore që rregullon mbikëqyrjen e tregut të produkteve industriale, nuk inkorporon plotësisht kërkesat e *acquis*.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës luan rol koordinues në fushën e mbikëqyrjes së tregut. Drejtoria e saj e Mbikëqyrjes së Tregut e zgjeroi fushën e veprimit pasi u bë Drejtoria për Mekanizmat e Tregtisë dhe Ndihmës Shtetërore në qershor 2010. Kapacitetet dhe burimet e saj institucionale dhe administrative duhet të rriten në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrje efektive dhe të koordinuar të tregut. Inspektorate apo agjenci të ndryshme kryejnë aktivitete të mbikëqyrjes së tregut,

por ato kanë pasur probleme në kalimin nga organe shtetërore të kontrollit të paratregtimit në autoritete të mbikëqyrjes së tregut siç kërkon *acquis*. Struktura e plotë e mbikëqyrjes së tregut që kërkon *acquis* nuk është krijuar akoma, dhe mospërputhjet ekzistuese duhet të shfuqizohen. Duhet të rritet koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional, përfshi këtu edhe autoritetet doganore.

Shqipëria nuk ka transpozuar ende pjesën më të madhe të legjislacionit që është specifik për sektorin. Ekzistojnë akoma mospërputhje të mëdha me *acquis* në fushat që mbulohen nga **legjislacioni i Përqasjes së Vjetër të produkteve**. Shqipëria ka harmonizuar pjesërisht me *acquis* legjislacionin e saj për pluhurat larës, para-paketimin dhe njësitë ligjore të matjes. Megjithatë, legjislacioni për mjetet motorike, ndotjen nga motorët e lëvizshëm jorrugorë, produktet kimike, produktet mjekësore për përdorim njerëzor, produktet mjekësore për përdorim veterinar, kozmetikët, aerosolët, tekstilet, veshjet për këmbën dhe xhamin kristal, nuk është ende në pajtim me *acquis*.

Shqipëria ka miratuar tashmë shumë direktiva në fushat që mbulohen nga **legjislacioni i Përqasjes së Re dhe Globale për produktet**. Shqipëria ka miratuar legjislacionin që synon harmonizimin në lidhje me lodrat, enët e thjeshta me presion, pajisjet me presion, pajisjet e gazit, pajisjet e tensionit të ulët, përputhshmërinë elektromagnetike, makineritë, pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes, ashensorët dhe pajisjet e mbrojtjes personale. Megjithatë, mbetet të verifikohet harmonizimi i këtij legjislacioni me *acquis*. Nuk është transpozuar *acquis* në lidhje me pajisjet mjekësore, mjetet lundruese për argëtim, teleferikët, produktet e ndërtimit, eksplozivët për përdorim civil, artikujt piroteknike, pajisjet fundore për radio dhe telekomunikacion, kërkesat e eko-projektimit për produkte të lidhura me energjinë, emetimet e zhurmës nga pajisjet e jashtme, instrumentet peshues dhe matës joautomatikë.

Lidhur me **masat procedurale**, Shqipëria nuk ka transpozuar ende *acquis* lidhur me dhënien e informacionit për standardet dhe rregullat teknike. Ligji i vitit 1992 për armët dhe legjislacioni lidhur me zbatimin e tij, janë duke u ndryshuar me qëllim përputhshmërinë e plotë me *acquis* për armët e zjarrit civile. Ligji për trashëgiminë kulturore nuk është ende në pajtim me *acquis* lidhur me kthimin e objekteve kulturore që janë nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i Shteteve Anëtare të BE-së. Për sa i përket *kontrollit të kufijve të jashtëm*, legjislacioni shqiptar nuk është në pajtim me *acquis* lidhur me kontrollin e produkteve që vijnë nga vendet e treta.

### *Konkluzioni*

Shqipëria ka filluar të harmonizojë legjislacionin e saj kombëtar në lidhje me parimet e lëvizjes së lirë të mallrave. Megjithatë, shumica e dispozitave të *acquis* nuk janë miratuar ende. Duhet të harmonizohen me *acquis* masat procedurale dhe horizontale, duke përfshirë kuadrin legjislativ për rregullat teknike të produkteve dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit, si dhe legjislacionin e Përqasjes së Re dhe të Vjetër për produktet. Është realizuar ndarja bazë e funksioneve të standardizimit, akreditimit dhe metrologjisë, por nevojiten masa të mëtejshme. Duhet të themelohet një strukturë adekuate e mbikëqyrjes së tregut, në përputhje me *acquis*. Kapacitetet e përgjithshme administrative duhet të përforcohen dhe nevojitet koordinimi i duhur në nivel qeveritar i masave për lëvizjen e lirë të mallrave. Do të nevojiten përpjekje të mëdha për transpozimin e direktivave të BE-së.

Në tërësi, në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme për të harmonizuar legjislacionin me *acquis* dhe për të zbatuar në mënyrë efektive në periudhën afatmesme.

### 3.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve

*Acquis* për këtë kapitull parashikon që qytetarët e BE-së të një Shteti Anëtar kanë të drejtë të punojnë në një Shtet tjetër Anëtar, të qëndrojnë atje për këtë qëllim së bashku me familjen, dhe të trajtohen njësoj si punëtorët vendës për sa i përket kushteve të punës dhe përfitimeve sociale dhe tatimore. Për më tepër, *acquis* parashikon edhe instrumentet e BE-së për koordinimin e sistemeve të ndryshme kombëtare të sigurimeve shoqërore.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* parashikon që, në bazë të kushteve dhe modaliteteve në fuqi, Shqipëria dhe Shtetet Anëtare të BE-së sigurojnë se shtetasit e vendit partner që janë ligjërisht të punësuar në territorin e tyre, nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë lloj diskriminimi për shkak të kombësisë në lidhje me kushtet e punës, shpërblimin e punës ose largimin nga puna.

Në lidhje me **aksesin në tregun e punës**, legjislacioni aktual shqiptar nuk është në përputhje me të drejtën e BE-së për lëvizjen e lirë të qytetarëve të BE-së. Ai kërkon që qytetarët e BE-së të aplikojnë për leje pune (në zbatim të Ligjit për të huajt) e cila lëshohet pas një testi të tregut të punës. Nuk bëhet asnjë dallim në këtë drejtim mes shtetasve të BE-së dhe shtetasve të tjerë të huaj. Familjarët e punëtorëve migrantë të BE-së kanë të drejtë të banojnë në Shqipëri, për aq kohë sa punëtorët. Shtetasit e BE-së që banojnë dhe punojnë në Shqipëri, gëzojnë trajtim të barabartë në lidhje me punësimin, pagën dhe kushtet e punës, por punësimi në sektorin publik lejohet vetëm për shtetasit shqiptarë.

Para anëtarësimit në BE, Shqipëria duhet të zbatojë *acquis* për lirinë e lëvizjes së punëtorëve. Legjislacioni shqiptar duhet të heqë skemën e lejeve të punës për shtetasit e BE-së dhe t'u garantojë punëtorëve të BE-së të drejtën të banojnë në Shqipëri duke gëzuar të njëjtat përfitime sociale ashtu si shtetasit shqiptarë. Përveç kësaj, legjislacioni shqiptar duhet t'u japë familjarëve të punëtorëve migrantë të BE-së, të drejtën për t'u punësuar pa nevojën e një leje pune, dhe fëmijëve të tyre të drejtën e pranimit në institucionet arsimore në të njëjtat kushte si shtetasit shqiptarë.

Për sa i përket punësimit në sektorin publik, legjislacioni shqiptar për statusin e nëpunësit civil përcakton si kusht të përgjithshëm që për të hyrë në shërbimin civil, kandidati duhet të jetë shtetas shqiptar. Shqipëria duhet të marrë parasysh *acquis* (sidomos praktikën gjyqësore) në këtë fushë, që i lejon Shtetet Anëtare të BE-së të rezervojnë pozicionet e punës në shërbimin publik vetëm për shtetasit e tyre, vetëm nëse këto janë drejtpërdrejtë të lidhura me veprimtari specifike të shërbimit publik, p.sh. kur pozicioni kërkon ushtrim të autoritetit dhe përgjegjësisë publike për të garantuar interesat e përgjithshme të Shtetit (përfshi organet vendore).

Përgatitja për pjesëmarrjen e ardhshme të Shqipërisë në rrjetin Shërbimet Evropiane të Punësimit (**EURES**) duhet të demonstrohen. Duhet që baza e të dhënave për vendet vakante të jetë edhe në gjuhën angleze, si dhe të verifikohen aftësitë gjuhësore të këshilltarëve potencialë EURES; gjithashtu,

duhet kushtuar vëmendje që zyrat vendore dhe rajonale të kenë mundësi që të dhënat për vendet vakante t'i shkëmbejnë edhe mes tyre, jo vetëm me agjencinë qendrore të punësimit.

Për sa i përket pensioneve suplementare, skema e pensioneve në Shqipëri ka dy komponentë: pensioni i detyrueshëm publik dhe pensioni vullnetar i miratuar së fundmi (shtylla e parë dhe e tretë). Me t'u anëtarësuar në BE, Shqipëria duhet të marrë masa, në përputhje me Direktivën 98/49 KE, për të garantuar trajtim të barabartë të shtetasve të saj dhe migrantëve të BE-së në lidhje me ruajtjen e të drejtave të garantuara të pensionit suplementar (shtylla e dytë) dhe rrjedhimisht pagimin e pensionit në një Shtet tjetër Anëtar. Për më tepër, edhe punëtorët e transferuar përkohësisht duhet të kenë mundësinë që të paguajnë kontribute në skemën e pensionit suplementar në vendin e tyre të origjinës për kohëzgjatjen e transferimit të tyre, dhe në këtë rast ata përjashtohen nga pagesa e kontributit në një skemë të tillë në Shtetin Anëtar ku janë transferuar.

Për sa i përket **koordinimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore**, sistemi shqiptar i sigurimeve shoqërore ka të gjitha aspektet tradicionale - që parashikojnë rregullat e BE-së për koordinimin e sigurimeve shoqërore - si dhe përfitime dhe karakteristika të ngjashme me ato të mjaft sistemeve të Shteteve Anëtare. Sistemi shqiptar i sigurimeve shoqërore bazohet në parimin e sigurimit të detyrueshëm në shtetin ku është i punësuar (*lex loci labori*). Legjislacioni shqiptar për sigurimet shoqërore parashikon trajtim jodiskriminues për shtetasit e vendeve të tjera. Shqipëria ka lidhur marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore me tre shtete të tjera, përfshi këtu dy Shtete Anëtare të BE-së, dhe po vazhdojnë negociatat edhe me 3 vende të tjera. Në Shqipëri, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor do të jenë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të Bashkimit Evropian në lidhje me koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore. Rregulloret 883/2004 dhe 987/2009 bëhen drejtpërdrejt të zbatueshme sapo Shqipëria të anëtarësohet. Për pasojë, nevojiten vetëm rregullime teknike të legjislacionit shqiptar për sigurimet shoqërore. Zbatimi i këtyre rregulloreve mund të ketë disa implikime financiare për Shqipërinë, përfshi eksportimin e pensioneve dhe rimbursimin e shpenzimeve mjekësore për shtetasit shqiptarë që kurohen në një Shtet tjetër Anëtar. Gjithashtu, duhet të bëhen përgatitjet për pjesëmarrjen në sistemin EESSI (për shkëmbimin elektronik të të dhënave për sigurimet shoqërore), gjë që kërkon kosto shtesë për infrastrukturën e nevojshme kompjuterike. Shqipëria do të duhet të zhvillojë kapacitete të mjaftueshme administrative për zbatimin e plotë të *acquis* pas anëtarësimit. Gjithashtu, Shqipëria sapo të anëtarësohet duhet të marrë në përdorim **Kartën Evropiane për Sigurimin Shëndetësor**.

### *Ndikimi*

Pas anëtarësimit në BE, ndikimi i Shqipërisë në tregun e punës të BE-së duhet të llogaritet mbi bazën e disa faktorëve, si përqindja e popullsisë shqiptare të aftë për punë, struktura e moshës dhe lëvizjet e migrimit.

Shqipëria vlerësohet se ka një popullsi prej rreth 3.2 milion banorësh. Rritja vjetore e popullsisë deri në 2020 vlerësohet 0.5%<sup>7</sup>. Për strukturën e moshës, përqindja e grupit më të ri në moshë (15 vjeç e poshtë) është 23%, më e lartë sesa në BE (15.4%).

---

<sup>7</sup> Sipas parashikimeve të OKB-së; shiko <http://esa.un.org/unpp/index.asp?panel=2>

Popullsia e aftë për punë (15-64) në 2009 ishte rreth 2.1 milion, ose 0.6% e popullsisë së aftë për punë të BE-së. Popullsia ekonomikisht aktive është rreth 1.3 milion individë. Në 2009, shkalla e punësimit vlerësohet se ishte 53.4% (krahasuar me 65.9% në BE). Papunësia ka rënë gradualisht, me përjashtim të vitit 2009, kur pësoi rritje të lehtë nga 13% në 13.8%. Një numër i lartë personash punojnë në ekonominë informale.

Pavarësisht rritjes së fuqishme vjetore të PBB-së, në dekadën e fundit (gjithnjë mbi 5% që nga viti 1998, me përjashtim të vitit 2002), mbetet një diferencë e madhe në nivelin e PBB-së për frymë ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së. PBB për frymë e Shqipërisë si fuqi blerëse është sa 27.1% e mesatares së BE-27.

Që nga fillimi i viteve 1990, ka pasur emigracion nga Shqipëria drejt vendeve të treta, përfshi edhe në Shtetet Anëtare të BE-së. Vlerësohet se rreth 1 milion qytetarë shqiptarë jetojnë aktualisht në BE (kryesisht në Itali dhe Greqi), duke përbërë 3.2% të popullsisë së huaj që jeton në BE (dhe 0.2% të popullsisë totale të BE-së). Në vitet e fundit vihet re prirja në rënie e emigracionit.

Pavarësisht kufizimeve për shkak të mungesës së besueshmërisë dhe krahasueshmërisë së statistikave të tregut të punës të Shqipërisë me ato të BE-së, në përgjithësi, anëtarësimi i Shqipërisë në BE pritet të ketë impakt fare të lehtë në tregun e punës së BE-së. Megjithatë, kjo situatë duhet të monitorohet me kujdes, duke marrë parasysh zhvillimet në Shqipëri dhe në BE.

#### *Konkluzioni*

*Në tërësi*, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të përafuar legjislacionin me *acquis* dhe për të zbatuar atë me efektivitet në periudhën afatmesme, në fushën e lirisë së lëvizjes së punëtorëve. Në lidhje me koordinimin e sigurimeve shoqërore, duke parë që Shqipëria ka vetëm tri marrëveshje për sigurimet shoqërore, zhvillimi i kapaciteteve të duhura administrative për të realizuar koordinimin me të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së do të jetë një sfidë madhore.

### **3.3. Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime**

Shtetet Anëtare duhet të garantojnë që e drejta e vendosjes e shtetasve dhe personave juridikë të BE-së në çdo Shtet Anëtar si dhe liria për të ofruar shërbime ndërkuftare, siç përcaktohet nga përjashtimet e parashikuara në nenet 49 dhe 56 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian, të mos cenohen nga legjislacioni i brendshëm. Akti kryesor i *acquis* në këtë fushë, është Direktiva e Shërbimeve. *Acquis* harmonizon gjithashtu, rregullat për profesionet e rregulluara, me qëllim që të garantojë njohje të ndërsjellë të diplomave dhe kualifikimeve ndërmjet Shteteve Anëtare. Për disa profesione të rregulluara, duhet të ndiqet një kurrikulë e përbashkët formimi minimal, me qëllim që kualifikimi të njihet automatikisht në një Shtet Anëtar. Reforma postare e BE-së synon të garantojë ofrimin e një sistemi postar universal, krijimin e tregut të brendshëm për shërbimet postare, si dhe shërbime postare të cilësisë së lartë për përdoruesit përfundimtare.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* parashikon liberalizimin gradual të së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë. Ajo përfshin një klauzolë pezullimi (*standstill*)

në lidhje me kufizimet që vihen në ofrimin e shërbimeve nga ana e ofruesve të vendosur në një shtet tjetër nga ia personit për të cilin do të bëhen shërbimet.

Për sa i përket të **drejtës së vendosjes**, legjislacioni shqiptar nuk diskriminon operatorët e huaj apo filialet apo degët e tyre. Procedurat për regjistrimin në regjistrin tregtar nuk janë diskriminuese.

Legjislacioni shqiptar për **lirinë për të ofruar shërbime ndërkufitare** nuk është në pajtim me *acquis*, sidomos me Direktivën e Shërbimeve. Legjislacioni aktual i Shqipërisë parashikon ofrimin e shërbimeve nga operatorë të vendosur në Shqipëri, por nuk parashikon shërbimet ndërkufitare. Zbatimi i plotë i Direktivës së Shërbimeve kërkon forcim thelbësor të kapaciteteve administrative. Për më tepër, përputhshmëria e plotë me *acquis* kërkon koordinim të duhur në nivel kombëtar mes të gjitha organeve administrative përkatëse, dhe pas anëtarësimit, edhe me Shtetet Anëtare të BE-së.

Legjislacioni parësor shqiptar për **shërbimet postare** ndjek parimet dhe objektivat e mishëruara në *acquis*. Vëmendje të veçantë kërkojnë disa çështje specifike që lidhen me detyrimin për të ofruar shërbime universale, si për shembull gama e produktit dhe kërkesat themelore, përjashtimi nga TVSH, përjashtimet nga detyrimi dhe periudha për caktimin dhe mbikëqyrjen e ofruesit të shërbimit. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të miratuar dispozita në lidhje me zonat e rezervuara, kriteret e licencës për procedurën e autorizimit, ndarjen e tarifë-vënies dhe kontabilitetit të shërbimit universal nga procedurat e ankimit. Strategjia e re për zhvillimin e sektorit postar që merr parasysh ndryshimet e Direktivës së Tretë për Shërbimet Postare, është në fazën fillestare të përgatitjes. Ministria e Inovacionit dhe e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit është përgjegjëse për politikëbërjen, si dhe për rregullat dhe procedurat për përcaktimin e tarifave dhe kushteve për shërbimet postare universale. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është autoriteti kombëtar rregullator. AKEP është organ i pavarur i themeluar jo me buxhet të Shtetit. AKEP ka kapacitete administrative të dobëta, dhe ende nuk është ngritur departamenti rregullator për shërbimet postare. Kjo pengon ndarjen efektive të funksioneve rregullatore nga politikëbërja.

Në fushën e **njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale**, fusha e veprimit dhe kriteret minimale të formimit për profesionet e rregulluara janë gjerësisht në pajtim me *acquis*. Kriteret minimale të formimit duhet të përshtaten për të siguruar harmonizim të plotë me *acquis*. Disa kërkesa për profesionistët e BE-së që duan të ushtrojnë profesionin në shëndetësi, nuk janë në pajtim me *acquis*. Legjislacioni shqiptar parashikon njohjen e ndërsjellë të arsimit të lartë të huaj dhe të kualifikimeve profesionale. Megjithatë, nuk ka një diferencim të qartë mes njohjes së kualifikimeve profesionale dhe njohjes së kualifikimeve akademike, dhe ende mungojnë disa akte ligjore zbatuese për njohjen e kualifikimeve profesionale. Komisioni për Njohjet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës është përgjegjës si për kualifikimet akademike, edhe ato profesionale. Ai përpunon të gjitha aplikimet për njohje të certifikatave të arsimit të lartë të nivelit të parë, të arsimit të lartë të nivelit të dytë, diplomave master të nivelit të dytë dhe certifikatave të formimit profesional të marra jashtë shtetit. Ministrinë e linjës janë përgjegjëse për profesionet e rregulluara në fushën e tyre. Kapacitetet administrative duket se janë të pamjaftueshme për realizimin e detyrave. Komisioni ka 5 anëtarë dhe ndihmohet nga një sekretariat teknik me 2 vetë. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të arritur transpozimin e plotë të *acquis* dhe për të krijuar një kuadër institucional adekuat.

*Konkluzioni*



Nuk ka barriera ligjore diskriminuuese për të drejtën e vendosjes së operatorëve të BE-së në Shqipëri. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëdha për të harmonizuar me *acquis* legjislacionin e lirisë për të ofruar shërbime, si edhe për rritjen e kapaciteteve administrative dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional. Shqipëria nuk duhet të ketë vështirësi të mëdha në harmonizimin e legjislacionit për shërbimet postare me *acquis* në periudhën afatmesme, por duhet të garantohen kapacitetet adekuate dhe pavarësia e plotë e AKEP-it. Legjislacioni për njohjen e kualifikimeve profesionale duhet të harmonizohet më tej me *acquis*. Duhet të krijohen strukturat dhe procedurat përkatëse për zbatimin e këtij legjislacioni

Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me *acquis* dhe të zbatojë atë me efektivitet në periudhën afatmesme. Nevojitet përgatitje paraprake dhe vëmendje e veçantë për sa i takon lirisë për të ofruar shërbime.

### 3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Shtetet Anëtare pritet të heqin të gjitha kufizimet ndaj lëvizjes së kapitalit dhe pagesave, si brenda BE-së, ashtu edhe mes Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. *Acquis* përfshin gjithashtu, edhe rregullat për pagesat ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Direktiva për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kërkon që bankat dhe operatorët e tjerë ekonomikë të identifikojnë klientët dhe të raportojnë disa transaksione, sidomos kur bëhet fjalë për objekte me vlerë të lartë dhe për transaksione me para në dorë me vlera të mëdha. Një kërkesë kyçe në luftën kundër krimit financiar është krijimi i kapaciteteve efektive administrative dhe zbatuese, përfshi edhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve që merren me mbikëqyrjen, zbatimin dhe ndjekjen penale.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)* përcakton kalendarin për liberalizimin e kapitalit. Gjithashtu, parashikon lirinë dhe konvertueshmërinë e pagesave të llogarive korrente dhe të transfertave.

Në fushën e **lëvizjeve të kapitalit**, Rregullorja për veprimtarinë valutore, miratuar në shtator 2009, liberalizoi transaksionet e llogarive korrente ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve. Rregullorja parashikon flukse hyrëse dhe dalëse për kapitalin, pa kufizime. Gjithashtu, ajo shfuqizoi të drejtat ekskluzive të Bankës së Shqipërisë për kontrollin e flukseve dalëse të kapitalit.

Blerja e pronave të paluajtshme nga të huajt është objekt kufizimesh: të huajt nuk lejohen të blejnë tokë bujqësore, pyje, lëndina dhe kullota. MSA parashikon përshtatjen progresive të legjislacionit në këtë fushë, me synimin që deri në 1 prill 2016 të garantohet që trajtimi i shtetasve të BE-së të jetë jo më pak i favorshëm sesa trajtimi që u akordohet shtetasve shqiptarë. Kjo kërkon rritje të kapaciteteve administrative. Gjithashtu, Shqipëria duhet të zgjidhë pasiguritë aktuale për të drejtat e pronësisë mbi pronat e paluajtshme.

Ligji i vitit 1993 për investimet e huaja parashikon investim të lirë si nga jorezidentët që investojnë në Shqipëri, ashtu edhe për rezidentët që investojnë jashtë shtetit. Investimet e huaja direkte (IHD) kanë qenë një nga faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të kohëve të fundit të Shqipërisë. Në 2009, në Shqipëri ishin të vendosura 304 shoqëri të huaja, 74 degë dhe 21 zyra përfaqësuese të shoqërive të

huaja. Vlera totale e IHD-së në 2009, vlerësohet se ishte 695 milion Euro. Privatizimi në sektorë kyçë (bankat, telekomunikacioni dhe energjia) ka qenë burimi kryesor i IHD-ve. Deri tani, qeveria nuk ka mbajtur të drejta të veçanta apo 'aksione të arta' gjatë privatizimit të shoqërive strategjike, por legjislacioni ekzistues e lejon këtë gjë. Legjislacioni që rregullon investimet në tregun financiar jobankar, përmban dispozita që nuk janë në pajtim me *acquis* dhe mund të justifikohen vetëm për arsye madhore të interesit publik.

Kuadri legjislativ shqiptar për **sistemin e pagesave** është i ndryshëm dhe shumë më pak i zhvilluar sesa kuadri aktual i BE-së. Për ta sjellë atë në pajtim me *acquis*, nevojiten ndryshime thelbësore në legjislacion dhe të miratohen akte të reja ligjore. Pagesat ndërkufitare nuk janë të rregulluara, dhe të drejtat e detyrimit në lidhje me ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve të pagesave aplikohen vetëm për transaksionet kombëtare dhe nuk mbulojnë shumë aspekte që rregullohen nga direktiva e BE-së. Për shembull, dispozitat për instrumentet elektronike të pagimit kanë fushë veprimi të kufizuar, dhe nuk parashikojnë mbrojtje të konsumatorit (zgjidhje të mosmarrëveshjeve). Struktura administrative e nevojshme për transpozimin e *acquis* është e krijuar. Megjithatë, ajo duhet të përforcohet që të përballojë rritjen e detyrave mbikëqyrëse dhe zbatuese gjatë transpozimit dhe pas miratimit të legjislacionit të BE-së për pagesat.

Aktet kryesore legjislative që rregullojnë **luftën kundër pastrimit të parave** janë Ligji i vitit 2008 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe aktet në zbatim të tij. Ato mbulojnë shumë kërkesa të *acquis*. Megjithatë, ka mangësi në përkufizime, sidomos të pronarëve përfitues, bankave fantazmë (*shell banks*) dhe personave politikisht të ekspozuar. Disa masa që duhen zbatuar nga institucionet financiare në lidhje me "due diligence" të konsumatorit, mbeten të paqarta, ndërsa dispozitat për personat e ekspozuar politikisht duhet të ndryshohen.

Zbatimi i legjislacionit kundër pastrimit të parave po përparon në mënyrë të qëndrueshme, dhe nismat e fundit janë fokusuar në përkufizimin e transaksioneve të dyshimta, kriteret për "due diligence" të konsumatorit, detyrimin për ruajtjen e të dhënave, dhe çështjet e mbikëqyrjes. Dokumenti strategjik kombëtar i tetorit 2009, për hetimin e krimit financiar hedh bazat për përparimin në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Numri i rasteve të denoncuara nga Njësia e Inteligjencës Financiare (NIF) në prokurori dhe në Policinë e Shtetit është rritur, ashtu si edhe numri dhe cilësia e inspektimeve. Megjithatë, shkalla e zbatimit dhe sundimit efektiv të ligjit, është shqetësuese. Deri tani ka pasur vetëm një ndëshkim për pastrim parash. Pavarësisht prirjes në rritje, numri total i raportimeve të transaksioneve të dyshimta (RTD) tek NIF mbetet i ulët dhe i pakënaqshëm. Raportimi elektronik vazhdon të jetë shumë i kufizuar. Raportimi nuk është i njëtrajtshëm, pasi përveç bankave tregtare, shumica e institucioneve financiare dhe jofinanciare nuk i dërgojnë RTD-të tek NIF. Nevojitet ndërgjegjësimi i sektorit privat në lidhje me detyrimin e tyre për të raportuar. Gjithashtu, përdorimi i gjerë i transaksioneve me para në dorë në ekonomi dhe niveli i lartë i krimit të organizuar dhe korrupsionit, po e pengojnë zbatimin e kuadrit për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP) shërben si NIF. Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet nga ligji për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit i vitit 2008. DPPPP vepron si qendër kombëtare për mbledhjen dhe analizimin e

informacionit për aktivitetet e dyshuara për pastrim parash apo financim terrorizmi, dhe ia shpërndan këtë informacion agjencive të zbatimit të ligjit. DPPP ka përmirësuar kapacitetet, me punonjës të rinj, me trajnime dhe pajisje të reja TI, por kapacitetet e përgjithshme të saj mbeten të kufizuara, sidomos në aspektin e analizës. Bashkëpunimi ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit është përmirësuar, dhe kanë vazhduar trajnimet e specializuara për të gjitha institucionet, por nevojiten përpjekje të mëtejshme.

### *Konkluzioni*

Lëvizjet e kapitalit në Shqipëri janë liberalizuar thellësisht dhe deri tani Shqipëria i ka respektuar afatet për zbatimin e detyrimeve të MSA-së në këtë fushë. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme, dhe duhet të transpozohet *acquis* për pagesat. Duhet të sigurohen burime njerëzore adekuate. Ekziston një kuadër i shëndoshë ligjor për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Legjislacioni duhet të harmonizohet më tej me *acquis*, por duhet të jetë në gjendje të zgjidhë mangësitë ekzistuese në periudhën afatmesme. Zbatimi efektiv i legjislacionit do të kërkojë përpjekje shtesë dhe vendosmëri politike për të zgjidhur problemet e sistemit, siç është numri i lartë i transaksioneve me para në dorë në ekonomi dhe nivelet e larta të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Një sfidë shtesë është t'i afrohet sektorit privat trajnim, orientim dhe mbikëqyrje adekuate.

Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të siguruar harmonizimin me *acquis* dhe për të zbatuar atë në periudhën afatmesme, në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit.

### **3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik**

*Acquis* për prokurimin publik përcakton parimet e përgjithshme për transparencën, trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin. Gjithashtu, BE-ja ka rregulla specifike për të koordinuar dhënien e tenderëve publike për punime, shërbime dhe mallra, për sektorët klasikë, për sektorët utilitarë dhe për fushat e mbrojtës dhe të sigurisë. Fusha e veprimit përcaktohet në varësi të subjekteve kontraktuese, kontratave, pragjeve të aplikimit dhe përjashtimeve specifike. *Acquis* përcakton edhe rregullat e ankimit dhe mundësitë e dëmshpërblimit.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* (MSA) sanksionon se shoqëritë tregtare të BE-së, të vendosura në Shqipëri ose jo, duhet të kenë akses në tenderë publikë në Shqipëri dhe t'u sigurohet trajtim po aq i favorshëm sa edhe shoqërive tregtare shqiptare.

Legjislacioni shqiptar është gjerësisht në pajtim me **parimet e përgjithshme** të prokurimit publik në tregun e brendshëm. Megjithatë, ende nuk janë transpozuar të gjitha dispozitat e parashikuara në direktivat e prokurimit publik.

**Dhënia e tenderëve publikë** rregullohet me Ligjin për Prokurimin Publik të vitit 2006, i ndryshuar së fundmi në vitin 2009. Rregullat e hollësishtme për zbatimin e ligjit janë përcaktuar. Ky ligj është i harmonizuar me parimet bazë të *acquis*. Megjithatë, kërkohet harmonizimi i mëtejshëm në fusha si: disa procedura të posaçme për dhënien e tenderit, rregullat e dëmshpërblimit dhe prokurimi në sektorin e mbrojtjes. Ligji i Koncesioneve (LK) i vitit 2006, përcakton kuadrin legjislativ për

koncesionet. Rregullat e hollësishme për zbatimin e tij janë përcaktuar. Ky ligj nuk është i harmonizuar me *acquis* dhe nuk përmban dispozita për koncesionet e punimeve dhe shërbimeve. Shqipëria nuk ka legjislacion specifik për partneritetet publike-private.

Për sa i përket kapaciteteve administrative, Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është autoriteti shtetëror përgjegjës për politikëbërjen dhe zbatimin e ligjit në fushën e kontratave publike dhe koncesioneve. Gjithashtu, APP u jep subjekteve prokuruese këshillim se si të zbatojnë si duhet legjislacionin. APP nuk është më përgjegjëse për procedurat e ankimimit, që pas krijimit të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) që u ngrit për këtë qëllim, në zbatim të ndryshimeve që iu bënë Ligjit për Prokurimin Publik. Për rrjedhojë, stafi i APP-së është zvogëluar nga 36 në 18 punonjës, dhe duhet pasur kujdes që APP të ruajë kapacitetet e duhura. Ngritja e KPP-së garanton ndarje të politikëbërjes dhe zbatimit të ligjit nga funksioni i **dëmshpërblimit**, gjë që e sjell sistemin më afër rregullave të BE-së. KPP është përgjegjës për **dëmshpërblimin**, si për tenderët publikë ashtu edhe për koncesionet. Anëtarët e tij zgjidhen nga Këshilli i Ministrave. Për momentin, KPP-ja përbëhet nga 18 punonjës. Duhet t'i garantohen kapacitetet e duhura që të realizojë funksionet me efektivitet. Ruajtja e pavarësisë së KPP-së është thelbësore. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar shmangies së konfliktit të interesit dhe parandalimit të korrupsionit. Duhet të përcaktohen qartë përgjegjësitë e KPP-së dhe të APP-së, si edhe rregullat e ndërveprimit mes tyre.

Avokati i Prokurimit Publik u krijua që në 2008, që të kryejë funksione të ngjashme me ato të 'ombudsmanit', që të mbrojnë të drejtat dhe interesat e ofruesve ndaj veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve kontraktuese. Avokati i Prokurimit Publik emërohet nga parlamenti me mandat 5-vjeçar, me propozim të Këshillit të Ministrave. Në fushën e koncesioneve, Sektori i Trajtimit të Koncesioneve në Ministrinë e Ekonomisë ka disa funksione për të promovuar dhe ndihmuar autoritetet kontraktuese në vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve.

#### *Konkluzioni*

Deri tani Shqipëria i ka përmbushur angazhimet e MSA-së në këtë fushë. Kuadri legjislativ dhe institucional shërben si bazë e mirë për zhvillimin e një sistemi prokurimi publik efektiv dhe në përputhje me rregullat e BE-së. Të gjitha organeve të prokurimit publik duhet t'u garantohen burimet e përshtatshme, dhe duhet të ketë përcaktime të qarta për përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkëpunimit. Ruajtja e pavarësisë dhe efektshmërisë së procedurave të ankimimit do të jetë thelbësore. Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të siguruar harmonizimin me *acquis* dhe që ta zbatojë me efektshmëri në periudhën afatmesme, sidomos në fushën e koncesioneve dhe të dëmshpërblimeve.

### **3.6. Kapitulli 6: Legjislacioni për shoqëritë tregtare**

*Acquis* për shoqëritë tregtare përfshin rregulla mbi detyrimin për informim, formimin, ruajtjen dhe ndryshimin e kapitalit, bashkimet dhe ndarjet, ofertat për marrje në kontroll dhe të drejtat e aksionarëve, si dhe parimet e qeverisjes së korporatave. Në fushën e raportimit financiar, *acquis* parashikon rregulla për dorëzimin e llogarive vjetore dhe të konsoliduara, duke përfshirë edhe rregulla të thjeshtuara për sipërmarrjet e vogla e të mesme. Për sektorin bankar dhe atë të sigurimeve zbatohen rregulla të veçanta kontabiliteti. Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

është i detyrueshëm për disa sipërmarrje me interes publik. Për më tepër, *acquis* specifikon rregulla për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e **audituesve ligjorë**.

Legjislacioni shqiptar për **shoqëritë tregtare** është në përgjithësi, në përputhje me *acquis* në lidhje me detyrimin për informim, ofertat për marrje në kontroll, themelimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar dhe ndryshimin e kapitalit të tyre dhe të drejtat e aksionarëve në shoqëritë aksionare të listuara në bursë. Megjithatë, përputhje e mëtejshme kërkohet në lidhje me detyrimin për informim, kapitalin minimal të nënshkruar për shoqëritë me ofertë publike, bashkimet ndër-kufitare dhe në detyrimin për raportim dhe dokumentim të bashkimeve dhe ndarjeve. Shqipëria nuk ka miratuar akoma një kod të qeverisjes së korporatave.

Themelimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) në vitin 2007, shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të thjeshtimit të kuadrit rregullator për regjistrimin e shoqërive tregtare. QKR funksionon si “one-stop shop” dhe ka 32 sportele shërbimi që funksionojnë në të gjithë vendin. Koha mesatare për regjistrim efektiv është një ditë dhe të gjithë hapat e procedurës kryhen me vetëm një numër regjistrimi. Aktualisht, mangësitë në zbatimin e legjislacionit për nënshkrimin elektronik po pengojnë aplikimet elektronike për regjistrim.

QKR mirëmban regjistrin tregtar, i cili mbahet në formë elektronike. Ligji parashikon që çdo person i publikut, edhe kur nuk ka ndonjë të drejtë legjitime, gëzon të drejtën e informimit rreth dosjeve të ruajtura në këtë regjistër. Të dhënat e regjistrit tregtar mund të konsultohen në mënyrë elektronike. Ligji parashikon informimin e detyrueshëm vjetor të dokumenteve të kontabilitetit. Megjithatë, niveli i ulët i respektimit pasqyron dënimet e papërshtatshme që bien ndesh me qëllimet e Direktivës së BE. Nuk ka akoma një mekanizëm koordinimi dhe bashkëpunimi me Shtetet Anëtare të BE-së në lidhje me regjistrat tregtarë.

**Kontabiliteti i korporatave** rregullohet nga Ligji për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ligji hyri në fuqi në vitin 2006 dhe është gjerësisht, në përputhje me *acquis*. Të gjitha shoqëritë tregtare të listuara në bursë dhe shoqëritë bija, së bashku me bankat, institucionet financiare, fondet dhe titujt e sigurimit dhe të risigurimit si dhe të gjitha shoqëritë tregtare të licencuara për të kryer aktivitete investimi, duhet të zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF). Kjo vlen edhe për subjekte të mëdha ekonomike që përmbushin një grup kriteresh në lidhje me numrin e punësuarve dhe të ardhurat 6-mujore. Njësitë e tjera duhet që të zbatojnë standardet kombëtare të kontabilitetit të vitit 2008.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është përgjegjës për rishikimin dhe dhënien e këshillave ligjore për ligjet dhe aktet normative, si dhe për përmirësimin e kualifikimeve dhe metodave të kontabilitetit. Ai gjithashtu harton standardet kombëtare të kontabilitetit dhe përkthen SNRF në shqip.

Legjislacioni shqiptar në lidhje me **auditimin** ligjor, organizimin e auditimeve ligjore si dhe profesionin e ekspertit kontabël të miratuar është gjerësisht në përputhje me *acquis* sidomos për sa i takon mbikëqyrjes publike, regjistrimit të audituesve, miratimin dhe anulimin e miratimit, arsimimit dhe trajnimit. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) për profesionin e audituesit u themelua në vitin 2009. Është e nevojshme që të garantohet pavarësia e tij. Rrogat e anëtarëve të tij paguhen nga Ministria e Financave, dhe aktualisht e siguron mbështetjen administrative nga Instituti i Ekspertëve

Kontabël të Autorizuar. Nuk ekziston akoma një sistem për veprime hetimore dhe disiplinore në përputhje me *acquis*. Duhet marrë masa të mëtejshme që BMP të ushtrojë mbikëqyrje të pavarur të punës që Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar bën për sigurinë e cilësisë. Legjislacioni dhe praktikat aktuale nuk garantojnë pavarësi të mjaftueshme.

#### *Konkluzioni*

Legjislacioni shqiptar për kontabilitetin e korporatave dhe auditimin ligjor është gjerësisht në përputhje me *acquis*. Standardet kombëtare të kontabilitetit janë hartuar në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Megjithatë, kërkohet përputhje e mëtejshme e legjislacionit për shoqëritë tregtare, duke përfshirë miratimin e kodit të qeverisjes së korporatave dhe funksionimin e regjistrimit të bizneseve. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për t'i siguruar BMP-së pavarësinë dhe kapacitete të mjaftueshme, dhe për t'i garantuar kompetencat hetimore e disiplinore dhe mbikëqyrjen e pavarur të sigurisë së cilësisë.

*Në tërësi*, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje shtesë për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektivitet në periudhën afatmesme.

### **3.7. Kapitulli 7: Legjislacioni për Pronësinë Intelektuale**

Objekti kryesor i *acquis* së BE-së në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, është që të sigurojë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, duke vendosur njëkohësisht një balancë ndërmjet të drejtave të zotëruesve dhe interesave të përdoruesve, si dhe përshtatjen e kuadrit ligjor me ndryshimet e vazhdueshme teknologjike. *Acquis* për të drejtën e autorit harmonizon rregullat për mbrojtjen ligjore të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të. Ekzistojnë dispozita të veçanta për të mbrojtur bazat e të dhënave, programet kompjuterike, topografite e qarqeve të integruara, transmetimet satelitore dhe ato kabllore. *Acquis* për të drejtat e pronësisë industriale parashikon rregulla të harmonizuara për mbrojtjen ligjore të markave tregtare dhe dizenjove. Dispozita të veçanta zbatohen për shpikjet bio-teknologjike, produktet farmaceutike dhe produktet për mbrojtjen e bimëve. *Acquis* gjithashtu, përmban rregulla për krijimin e një marke tregtare të BE-së dhe dizenjove të BE-së. Së fundmi, *acquis* përmban gjithashtu, rregulla të harmonizuara për zbatimin e të drejtës së autorit dhe të drejtat të lidhura me të, dhe të drejtave të pronësisë industriale. Në bazë të *acquis*, Shtetet Anëtare duhet të ngrenë mekanizma adekuatë zbatimi, dhe në mënyrë të veçantë kapacitete efektive zbatuese.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* parashikon që Shqipëria duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të garantuar deri më 1 dhjetor 2010, një nivel mbrojtjeje të të drejtave intelektuale, industriale dhe tregtare të ngjashëm me atë që ekziston në BE, duke përfshirë dhe mjetet e efektshme për zbatimin e të drejtave të tilla.

Shqipëria është anëtarësuar në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) në shtator të vitit 2000, dhe rrjedhimisht është palë në Marrëveshjen TRIPS. Ajo është gjithashtu, palë në një numër marrëveshjesh ndërkombëtare, si Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike, Traktati i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale për të drejtën e autorit dhe Traktati i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale për Interpretimet, Ekzekutimet dhe Fonogramet, Konventa

Universale e të Drejtave të Autorit dhe dy Protokollet shtesë të saj, Konventa Ndërkombëtare e Romës për mbrojtjen e interpretuesve të shfaqjeve, producentëve të fonogrameve dhe organizatave transmetuese, Konventa për mbrojtjen e producentëve të fonogrameve kundër publikimeve të pa-autorizuara të fonogrameve të tyre dhe Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve. Si rrjedhim, vendi ka përmbushur angazhimet e MSA-së në këtë drejtim.

Shqipëria ka miratuar një strategji kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale (DPI) me qëllim arritjen e një niveli mbrojtjeje të ngjashëm me atë të vendeve të Bashkimit Evropian. Strategjia parashikon detyrimet dhe funksionet e të gjitha institucioneve të përfshira. Ajo ka si qëllim ndërtimin e kapaciteteve të duhura administrative, përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional, dhe informimin e ndërgjegjësimin e publikut për përfitimet nga të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale.

Ligji aktual për **të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të**, hyri në fuqi në vitin 2005 dhe nuk është në përputhje me një sërë direktivash të BE-së. Ligji i ri për të drejtën e autorit, i hartuar me ndihmën e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI), nuk është miratuar akoma. Ligji për shkeljet administrative u miratua në vitin 2010, për të përmirësuar mbledhjen e gjobave për shkelje të të drejtës së autorit. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) e krijuar në prill 2007, është institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit. Ekzistojnë dy Zyra Rajonale për të Drejtën e Autorit, dhe strategjia DPI parashikon ngritjen edhe të 10 zyrave të tjera. Duhet të forcohen kapacitetet e teknologjisë së informacionit si në zyrat për të drejtën e autorit ashtu edhe në shërbimet *on-line* për të drejtën e autorit.

Në lidhje me **të drejtat e pronësisë industriale**, Ligji për pronësinë industriale i vitit 2008, është gjerësisht në përputhje me *acquis*. Ekzistojnë gjithashtu, një numër aktesh ligjore për zbatimin e tij. Në vitin 2010 Shqipëria u bë palë kontraktore në Traktatin e OBPI-s për të Drejtën e Patentave dhe palë me të drejta të plota në Organizatën Evropiane të Patentave (OEP). Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) është përgjegjëse për dhënien dhe administrimin e patentave, markave tregtare dhe të shërbimit, dizenjove industriale dhe treguesve gjeografikë. Strategjia DPI parashikon ngritjen nën varësinë e DPPM-së të një rrjeti qendrash që do të ofrojnë informacion teknik dhe shkencor. Kapaciteti administrativ i DPPM ka nevojë për forcim dhe siguria e sistemit të teknologjisë së informacionit duhet të përmirësohet.

Në lidhje me **sundimin e ligjit**, kuadri ligjor duhet të rishikohet tërësisht dhe të harmonizohet me *acquis*. Institucionet kryesore që janë aktive në zbatimin e DPI janë ZSHDA, DPPM, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Inspektorati i Tatimeve, Prokuroria, policia dhe gjykatat. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka një drejtori për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe ka kompetenca për të vepruar *ex officio*, por jo ZSHDA ose DPPM. Strategjia DPI parashikon krijimin e Inspektoratit të Tregut për Pronësinë Industriale për të identifikuar dhe monitoruar shkeljet e legjislacionit në fushën e DPI-së. Megjithatë, legjislacioni i nevojshëm ende nuk është miratuar.

Struktura ligjore dhe institucionale aktuale është e dobët dhe zbatimi i DPI-së pengohet nga shumë mangësi. Si ZSHDA ashtu edhe DPPM, kanë mungesë kapacitësh, sidomos për inspektimet në lidhje me të drejtën e autorit. Duhet përmirësuar bashkëpunimi ndërmjet institucioneve zbatuese me qëllim që DPI të zbatohen në terren. Nuk ka gjykata të specializuara për çështjet e DPI-ve dhe

gjqësorit i mungon përvoja dhe kualifikimi i duhur. Numri i padive gjyqësore për kundravajtje dhe numri i dënimeve, është i ulët. Dënimet nuk janë efektive, sepse niveli i gjobave dhe mbledhja e tyre është shume e ulët. Ndërgjegjësimi i publikut rreth DPI-së është i ulët. Shoqëritë për menaxhimin kolektiv të të drejtave nuk po funksionojnë siç duhet. Të ardhurat e tyre janë shumë të ulëta, sepse shumica e përdoruesve nuk paguajnë tarifat.

### *Konkluzioni*

Shqipëria ka hartuar një ligj të ri për të sjellë legjislacionin e saj në përputhje me *acquis* në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të. Ky ligj mendohet të miratohet në fund të vitit 2010. Duhet të vazhdojë harmonizimi me *acquis* për të drejtat e pronësisë industriale. Shqipëria miratoi strategjinë për zbatimin e DPI-së, duke synuar harmonizimin e praktikave të saj me ato të BE-së.

Mangësitë në fushën e burimeve njerëzore, teknike dhe financiare, sidomos të organeve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit, po pengojnë sundimin efikas të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale. Në tërësi, Shqipëria duhet të tregojë vendosmëri dhe të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektivitet në periudhën afatmesme. Aktualisht, vështirë se Shqipëria do të arrijë të përmbushë detyrimet e MSA-së brenda afatit që është 1 dhjetori 2010.

### **3.8. Kapitulli 8: Konkurrenca**

*Acquis* në fushën e konkurrencës mbulon **antitrust-in**, **bashkimin e shoqërive tregtare** dhe politikat e kontrollit të **ndihmës shtetërore**. *Acquis* përfshin rregulla dhe procedura për të luftuar sjelljet anti-konkurrese të shoqërive tregtare (marrëveshjet kufizuese ndërmjet ndërmarrjeve dhe abuzimin me pozitën dominuese), për të shqyrtuar bashkimin e shoqërive tregtare dhe për të parandaluar dhënien e ndihmës shtetërore që shtrembëron konkurrencën e lirë në tregun e brendshëm. Rregullat për konkurrencën janë drejtpërdrejt të zbatueshme në të gjithë BE-në, dhe Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë plotësisht me Komisionin për zbatimin e tyre.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* (MSA) përmban dispozita që janë në përputhje të plotë me një pjesë të madhe të *acquis* në fushën e konkurrencës. Këto dispozita mbulojnë marrëveshjet anti-konkurrese ndërmjet ndërmarrjeve, abuzimin me pozitën dominuese në treg dhe ndihmën shtetërore që shtrembëron konkurrencën në treg. MSA-ja përfshin rregulla që janë të zbatueshme për ndërmarrjet publike dhe për ndërmarrjet që u janë dhënë të drejta të veçanta dhe ekskluzive, dhe parashikon që mbi importet nga BE-ja për në Shqipëri të mos ketë kufizime sasiore. MSA-ja parashikon që zbatimi i rregullave të konkurrencës të mbikëqyret nga autoritete publike që funksionojnë në mënyrë të pavarur. Ajo gjithashtu, ka një protokoll që përcakton rregullat e ndihmës shtetërore në sektorët e hekurit dhe të çelikut.

Në lidhje me **antitrust-et** dhe **bashkimet e shoqërive tregtare**, Ligji aktual për konkurrencën është i zbatueshëm për të gjithë sektorët e ekonomisë dhe si model janë marrë rregullat e BE-së. Ligji u ndryshua në shtator të vitit 2010, dhe tani është në përputhje me elementët thelbësorë të *acquis*. Ligji i ndryshuar ul ndjeshëm pragun e vlerave për njoftimin paraprak të Autoritetit të Konkurrencës (AK)



në lidhje me bashkimet e shoqërive tregtare. Kjo mund të çojë në një rritje të njoftimeve, duke e bërë të rëndësishme sigurimin e kapaciteteve administrative të përshtatshme për AK-në për të përballuar rritjen e ngarkesës së çështjeve.

Në lidhje me kapacitetet administrative, AK është organ publik dhe subjekt i veçantë juridik, i cili kryen funksionet e tij në mënyrë të pavarur dhe i raporton parlamentit. Kryetari dhe katër anëtarë të organit vendimmarrës të Autoritetit - Komisioni i Konkurrencës - emërohen nga parlamenti për një periudhë 5-vjeçare. AK ka kompetencat e duhura për të hetuar, për të kërkuar informacion dhe për të ushtruar kontroll në mjediset e shoqërive tregtare. Ai mund të vendosë gjoba për ndërmarrjet dhe organet publike. Pragu për gjobat është duke u rishikuar me qëllim që të jetë më afër politikave të BE-së. Vendimet e AK-së janë objekt ankimi në gjykata. AK mund të ndërhyjë në sektorë të rregulluar dhe të japë rekomandime për politikën që duhet ndjekur. Numri i personelit prej 35 vetash të AK-së duket i pamjaftueshëm, duke marrë parasysh detyrat e shumta të ngarkuara autoritetit dhe uljen e pragut të njoftimit për rastet e përqendrimit të shoqërive.

Ligji për **Ndihmën Shtetërore** i vitit 2005, u ndryshua në vitin 2009, për ta përafëruar atë akoma më shumë me rregullat e BE-së. Ligji i ndryshuar parashikon rregulla për ndihmën shtetërore në lidhje me kapitalin e investuar në biznese me risk të lartë dhe për mbrojtjen e mjedisit. Ligji lejon ndihmën shtetërore, përfshi kapitalin për bizneset me risk të lartë, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME) në bazë të disa kushteve. Një inventar i ndihmës shtetërore u hartua në janar të vitit 2008. Në vitin 2007, Shqipëria konfirmoi që nuk synon t'i japë ndihmë shtetërore industrisë së saj të hekurit dhe çelikut.

Në lidhje me *kapacitetet administrative*, Sektori i Ndihmës Shtetërore (SNSH) në Drejtorinë e Mekanizmave të Tregut dhe Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është organi administrativ në sistemin prej dy nivelesh të Shqipërisë. SNSH kryen hetime dhe përgatit propozimet për vendimet në lidhje me ndihmën shtetërore. Deri në fillim të vitin 2010, detyrat hetuese dhe operacionale u kryen nga një Drejtor i veçantë e Ndihmës Shtetërore. SNSH ka të njëjtin numër personeli (katër) me ish-Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore dhe raportohet se ka ruajtur të njëjtat përgjegjësi dhe detyra. Megjithatë, është e nevojshme që të tregohet se kjo ulje nga drejtori në sektor nuk do të cenojë kapacitetet funksionale. Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) është organi vendimmarrës për kontrollin e ndihmës shtetërore. Komisioni kryesohet nga Ministri i Ekonomisë. Katër anëtarët e KNSH-së emërohen nga Këshilli i Ministrave dhe mund të përfshijë kandidatura të propozuara nga METE, e cila ka shumë gjasa të jetë një nga ofrueset kryesore të ndihmës shtetërore. KNSH autorizon skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat e veçanta dhe mund të rimarrë ndihmën e dhënë në mënyrë të paligjshme. Ai gjithashtu monitoron përdorimin e ndihmës shtetërore të dhënë. KNSH mund të fillojë hetime *ex officio* dhe palët e treta kanë të drejtë të paraqesin ankesat e tyre për këtë gjë. Deri më tani, asnjë hetim nuk ka filluar *ex officio* dhe nuk është marrë asnjë ankim.

Në lidhje me **liberalizimin**, Ligji për mbrojtjen e konkurrencës përfshin parimet e *acquis* në lidhje me shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik. Një numër ndërmarrjesh në sektorët e transportit, shërbimeve publike, shërbimeve postare dhe sektorin e energjisë gëzojnë të drejta të veçanta ose ekskluzive. Disa sektorë të mbrojtur mbikëqyren nga autoritete rregullatore sektoriale. Analiza të mëtejshme janë të nevojshme për të parë pajtueshmërinë e këtyre praktikave me *acquis* në këtë fushë.

## Konkluzioni

Kuadri ligjor i Shqipërisë për mbrojtjen e konkurrencës është kryesisht, i bazuar në rregullat e BE-së dhe ekzistojnë strukturat e nevojshme ligjore dhe administrative. Megjithatë, është e nevojshme që të krijohet një siguri e mjaftueshme për të garantuar pavarësinë funksionale dhe kapacitetin administrativ të autoriteteve për mbrojtjen e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, në mënyrë që ata të zbatojnë legjislacionin në mënyrë efikase. Duhet të demonstronhet pavarësia reale e enteve rregullatorë sektorialë. Nevojitet monitorim dhe analizim i mëtejshëm i progresit të Shqipërisë në drejtim të liberalizimit të tregut në sektorët e rezervuar në përputhje me *acquis*.

Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje shtesë për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektivitet në periudhën afatmesme.

### 3.9. Kapitulli 9: Shërbimet Financiare

Objektivat kryesorë të *acquis* në lidhje me shërbimet financiare janë sigurimi i stabilitetit financiar, soliditeti financiar i kompanive që operojnë në sektorin financiar dhe mbrojtja e duhur e konsumatorëve, investitorëve dhe zotëruesve të policave të sigurimit. Qëllimi është të krijohet besim mbi tregjet financiare dhe të sigurohet një fushë loje e barabartë. *Acquis* për shërbimet financiare përfshin rregullat për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e aktiviteteve bankare, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimeve të investimit dhe tregjet e letrave me vlerë, si dhe mbi infrastrukturën e tregjeve financiare. Institucionet financiare mund të kryejnë veprimtari në të gjithë BE-në, sipas parimit 'një pasaportë të vetme' dhe 'kontrollit në vendin e origjinës', duke ngritur degë ose duke ofruar shërbime ndërkufitare.

Për sa i përket **bankave dhe konglomerateve financiare**, legjislacioni aktual shqiptar përbën një bazë të fortë për përputhshmërinë e mëtejshme me *acquis* e BE-së për aktivitetet bankare, si p.sh. për llogaritjen dhe mjaftueshmërinë e fondeve të veta, përqendrimin e rreziqeve për humbjet financiare, kërkesat për kapital, garancinë e depozitave dhe mbikëqyrjen e konglomerateve financiare. Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe degëve të bankave të huaja në Shqipëri dhe degëve të bankave të licencuara që operojnë jashtë vendit. Banka e Shqipërisë ka shtuar veprimtarinë e saj rregullatore dhe ka fuqizuar e ristrukturuar Departamentin e saj të Mbikëqyrjes, duke vënë theksin në mënyrë të veçantë tek mbikëqyrja mbi bazën e vlerësimit të riskut. Ajo ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me institucione të tjera për tregun financiar vendas dhe me autoritete të huaja mbikëqyrëse të njëjsteve bankare që veprojnë në Shqipëri. Në Shqipëri operojnë 16 banka, të cilat janë krejtësisht ose pjesërisht me pronësi të huaj. Strategjia e Bankës së Shqipërisë për zbatimin gradual të Marrëveshjes Bazel II, pasqyron zhvillimin e sistemit bankar vendas.

Kapaciteti i BSH-së është në gjendje të përballojë sfidat që dalin nga përafrimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të Shqipërisë me rregullat e BE-së. Përgjegjësitë e Zyrës Rregullatorë të Bankës dhe të Zyrës së Metodologjisë dhe Analizës përfshijnë miratimin e praktikave më të mira dhe përafrimin e kuadrit ligjor me atë të BE-së.

Në fushën e **sigurimeve dhe pensioneve të punës**, Ligji i Sigurimeve dhe Risigurimeve i vitit 2004 nuk përputhet me direktivat e BE-së mbi sigurimin e jetës dhe sigurimeve të tjera. Legjislacioni shqiptar mbi planet e pensionit vullnetar nuk pasqyron të gjitha dispozitat e *acquis* për sa i përket veprimtarive dhe mbikëqyrjes së institucioneve për dhënien e pensionit të punës. Për sa i përket sigurimit të mjeteve motorike, tarifatat për sigurimin e detyruar dhe përgjegjësitë e palës së tretë duhet të liberalizohen në përputhje me rregullat e BE-së.

Në lidhje me **tregjet e titujve dhe shërbimet e investimeve**, tregu shqiptar i rregulluar i titujve përbëhet nga bursa e Tiranës dhe tregu shtetëror i bonove me pakicë. Në Shqipëri nuk ka sisteme shumëpalëshe negociimi (*MTF*) dhe ende nuk janë vënë rregulla as për sistemet shumëpalëshe të negociimit, si edhe as për tregtinë me këto sisteme. Tregu shtetëror i titujve me pakicë në vitin 2008 dominohej nga instrumente afatshkurtër. Ligji për titujt dhe Ligji për investimin kolektiv janë pjesërisht në përputhje me *acquis* dhe janë një bazë e mirë për përputhshmëri të mëtejshme. Ligji për obligacionet e shoqërive aksionare dhe Ligji për obligacionet e qeverive vendore i tetorit 2009, rregullojnë emetimin e bonove nga kompanitë aksionare që veprojnë në Shqipëri dhe pushtetet vendore. Megjithatë, ka mospërputhje me përkufizimet dhe përjashtimet e një sërë direktivave të BE-së (p.sh. Direktiva e Prospektit, MiFID, Direktiva e Abuzimit të Tregut dhe Direktiva UCITS), dhe nuk ka sistem për ankimim gjyqësor ndaj procedurës së autorizimit. Nuk ka legjislacion mbi skemat e kompensimit të investitorit. Kërkohet vëmendja e duhur për të marrë parasysh amendimet e ardhshme të *acquis* për shërbimet në investime.

Autoriteti shqiptar i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoriteti rregullator dhe kontrollues në fushat e sigurimeve, pensioneve të punës dhe titujve. AMF është organ i pavarur që financohet kryesisht nga burimet e veta. Ka kompetenca të mjaftueshme kontrolluese dhe hetimore, por mosvendosja e sanksioneve të mjaftueshme administrative për abuzime në treg, ndër të tjera, po e kufizon kapacitetin e tij për të siguruar mbikëqyrjen e tregut. AMF u bë anëtare me të drejta të plota e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) në 2009, duke i hapur kështu rrugë bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me institucionet analoge në të gjithë botën. Kapaciteti administrativ i AMF-së duhet fuqizuar për t'i bërë ballë sfidës së harmonizimit me kuadrin Solvency II.

### *Konkluzioni*

Legjislacioni i Shqipërisë në fushën e shërbimeve financiare është pjesërisht në përputhje me *acquis* dhe përbën një bazë të fortë për një harmonizim të mëtejshëm. Sektori bankar ka kapacitete të mjaftueshme, por përpjekje të mëtejshme duhen bërë në sektorin financiar jobankar për të zbatuar mbikëqyrjen e tregut dhe për të siguruar kapacitetet e nevojshme për përballimin e sfidave në të ardhmen.

*Në tërësi*, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje shtesë për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektivitet në periudhën afatmesme, veçanërisht në sektorin jo-bankar.

### **3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e Informacionit dhe media**

*Acquis* për shoqërinë e informacionit dhe median synon të eliminojë pengesat për një funksionim efektiv të tregut të brendshëm në shërbimet dhe rrjetet e komunikimit elektronik, të nxisë konkurrencën dhe të mbrojë interesat e konsumatorit në këtë sektor, përfshi disponibilitetin universal të shërbimeve bashkëkohore bazë. Ai përfshin gjithashtu rregullat për shërbimet e shoqërisë së informacionit dhe një kuadër rregullator transparent, të parashikueshëm dhe efektiv për shërbimet e medias audiovizuale në përputhje me standardet evropiane.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)* kërkon nga Shqipëria zbatimin e *acquis* në shërbimet dhe rrjetet e komunikimit elektronik deri në prill 2010.

Në fushën e **teknologjive të informacionit dhe komunikimit elektronik**, Ligji i vitit 2008 për komunikimet elektronike është gjerësisht i përafuar me kuadrin rregullator të BE-së të vitit 2002, duhet të ndryshohet duke inkorporuar në të zhvillimet e fundit të *acquis* (në 2009). Përveç kësaj, një numër aktesh nënligjore zbatuese u miratuan vonë dhe kjo ka rezultuar në mosplotësimin në kohë nga Shqipëria të angazhimeve të MSA-së. Ligji i 1998 për radion dhe televizionin privat rregullon veprimtarinë e radiove dhe televizioneve, përfshirë shërbimet satelitore dhe kablore. Operatorët televizivë kablorë ende duhet të marrin licenca individuale për të ofruar shërbime telefonie dhe interneti, ndërkohë që një sistem i përgjithshëm autorizimi zbatohet për të gjithë ofruesit e tjerë të telefonisë në bazë të Ligjit për komunikimet elektronike.

Legjislacioni ekzistues përcakton kushtet për liberalizimin e tregut të shërbimeve dhe komunikimeve elektronike. Ribalancimi i tarifës zbatohet, por masat kyçe që mbrojnë konkurrencën, duke përfshirë dhe aksesin e hapur në rrjetin lokal (LLU), përzgjedhja dhe para-zgjedhja e operatorëve, dhe orientimi i tarifave me shumicë drejt kostos nga operatorët, nuk janë zbatuar. Mbartshmëria e numrit nuk është aplikuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj. Një rregullore e përditësuar mbi aksesin dhe ndërlihdjen u miratua në qershor 2010. Që nga 1 nëntori 2010 e në vazhdim, operatorët lëvizës me fuqi të ndjeshme në treg (SMP) nuk do të kenë më detyrime për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare. Konkurrenca është shumë e kufizuar në tregun e telefonisë fikse, ku vetëm një operator i licencuar jep shërbime në gjithë vendin. Ka njëfarë konkurrencë në tregun e internetit me brez të gjerë. Depërtimi i telefonisë celulare është i lartë, pjesërisht për shkak të praktikës për të pasur më shumë se një kartë SIM. Në tërësi, rregullimi i pamjaftueshëm dhe moszbatimi i masave mbrojtëse për konkurrencën po pengojnë konkurrencën e efektshme.

Ministria e Inovacionit dhe e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është autoriteti rregullator dhe gjithashtu përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e legjislacionit. Kapaciteti administrativ dhe ekspertiza teknike e ministrisë dhe AKEP-it duhet të forcohen për të marrë përsipër përgjegjësitë e parashtruara në kuadrin rregullator të vitit 2002 të BE-së dhe rishikimit të tij të mëvonshëm. Legjislacioni shqiptar siguron pavarësinë e rregullatorit kombëtar, që është një komponent kryesor i kuadrit rregullator të BE-së. Megjithatë, rrethanat se si u bë shpërndarja e komitetit drejtues të AKEP-it dhe caktimi i anëtarëve të rinj në 2008 dhe 2009 hedhin dyshime mbi pavarësinë efektive të tij.

Legjislacioni për **shërbimet e shoqërisë së informacionit** po përafrohet gradualisht me *acquis*. Në veçanti, legjislacioni që lidhet me nënshkrimin elektronik është një përafrim i mirë me direktivën.

Megjithatë, ka të meta, për shembull, për sa i përket ruajtjes së të dhënave, komunikimeve të pakërkuara, faturimit zë për zë dhe aksesit të kushtëzuar. Ligji i vitit 2009 për tregtinë elektronike ka nevojë të ndryshohet që të hiqen kufizimet e lirisë së ofrimit të shërbimeve të shoqërisë së informimit. Mbi të gjitha, përpjekje të tjera duhen bërë për të siguruar zbatimin efikas të legjislacionit dhe politikave. Prioritetet kryesore të strategjisë së vitit 2009, për shoqërinë e informacionit janë infrastruktura, qeverisja elektronike dhe shërbimet publike, arsimi dhe njohuritë, biznesi elektronik dhe zhvillimi i kuadrit ligjor. Megjithatë, ende nuk është zhvilluar një politikë për shërbimet e internetit me brez të gjerë dhe investimet në infrastrukturën e komunikimit janë akoma të pakta.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është integruar në Ministrinë e Inovacionit dhe e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, e cila është përgjegjëse për reformat që kanë të bëjnë me shoqërinë e informacionit dhe zbatimin e strategjisë së shoqërisë së informacionit. Institucione të tjera që kanë lidhje me këtë fushë janë Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik. Qeveria ka treguar angazhim në zhvillimet e kësaj fushe duke akorduar burime buxhetore dhe njerëzore, por kapaciteti administrativ për të zbatuar politikën dhe legjislacionin mbetet në përgjithësi i dobët. Nevojitet gjithashtu, të caktohet një pikë kontakti kombëtare, siç e kërkon Direktiva për tregtinë elektronike.

Aktet kryesore ligjore në fushën e **politikave audiovizuale** janë Ligji për radion dhe televizionin privat në Republikën e Shqipërisë, Ligji për transmetimet numerike, Ligji për shtypin dhe Ligji për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare. Kuadri ligjor i Shqipërisë është i harmonizuar vetëm pjesërisht me standardet evropiane që sanksionojnë rregullat për median. Në mënyrë të veçantë, kuadri ligjor nuk është i harmonizuar me Direktivën e Shërbimeve të Medias Audiovizuale dhe nuk arrin të sigurojë disa prej standardeve kryesore, siç është garantimi i pavarësisë së autoritetit rregullator të transmetimit dhe të transmetuesit të shërbimit publik. Legjislacionit i mungojnë gjithashtu, dispozita për rregullimin e shërbimeve audiovizuale me porosi dhe *on-line*. Nuk është miratuar akoma strategjia për kalimin nga transmetimi analog në numerik. Vëmendje kërkojnë edhe çështje të tjera. Në mënyrë të veçantë, duhet siguruar liria e shprehjes dhe një klimë më e mirë në media, duke mos e trajtuar më fyerjen dhe shpifjen si vepër penale. (*Shiko Kapitullin 1.2: Të drejtat civile dhe politike*).

Shqipëria është palë e Konventës së Këshillit të Europës për televizionin ndërkufitar dhe e Konventës së UNESCO-s për promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore.

Parlamenti është përgjegjës për hartimin e politikave dhe Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) është autoriteti rregullator që monitoron sundimin e ligjit. Kapaciteti administrativ dhe teknik i KKRT-së është aktualisht i pamjaftueshëm për të plotësuar detyrimet e caktuara nga Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizuale. KKRT është autoritet i pavarur. Megjithatë, kërkohet të merren masa për të garantuar pavarësinë efektive të tij, përfshi ndryshimin e legjislacionit ekzistues.

*Konkluzioni*

Legjislacioni i Shqipërisë është pjesërisht i harmonizuar me *acquis*. Megjithatë, zbatimi efektiv i legjislacionit ka mbetur prapa dhe kërkon ngritjen e kapaciteteve të duhura të autoriteteve kombëtare rregullatore dhe garantimin e pavarësisë së tyre. Vendi nuk arriti të plotësonte në kohë detyrimet e MSA-së për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik. Legjislacioni ekzistues për shërbimet e medias audiovizuale nuk garanton disa nga standardet kryesore të BE-së për rregullimin e medias. Klima e përgjithshme e medias duhet të përmirësohet nëpërmjet miratimit të një projektligji për shërbimet e medias audiovizuale, dekriminalizimit të shpifjes dhe fyerjes, miratimit të strategjisë së digjitalizimit dhe duke rritur transparencën e pronësisë së medias.

Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme për të përafuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar atë me efektivitet në periudhën afatmesme, në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias. Shqipëria duhet të zbatojë angazhimet në kuadrin e MSA-së në fushën e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik.

### **3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural**

*Acquis* për bujqësinë dhe zhvillimin rural përfshin një numër të madh rregullash të detyrueshme, shumë prej të cilave janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Zbatimi i duhur i këtyre rregullave si dhe zbatimi e kontrolli efikas nga një administratë publike eficiente, janë të domosdoshme për funksionimin e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB). Funksionimi i PPB-së kërkon krijimin e një agjencie pagesash dhe ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, si për shembull, një sistem të integruar administrimi dhe kontrolli (SIAK), si edhe kapacitetin për të zbatuar masat për zhvillimin rural. Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të vënë në zbatim legjislacionin e BE-së për skemat e mbështetjes së drejtpërdrejtë, si dhe të kryejnë organizimin e tregut të përbashkët për produkte të ndryshme bujqësore.

Liberalizimi gradual i tregtisë së produkteve bujqësore ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë është sanksionuar që në dhjetor 2006, nga Marrëveshja e Përkohshme për tregtinë dhe çështjet e lidhura me tregtinë, si dhe nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit që në prill 2009. Shqipëria është vend anëtar i Organizatës Botërore të Tregtisë, si dhe i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë për Europën Qendrore dhe zbaton marrëveshjet e tregtisë së lirë për produktet bujqësore dhe ushqimore. Veçoritë kryesore të tyre janë një sistem i thjeshtë tarifor me tatim maksimal prej 15% sipas vlerës (*ad valorem*) dhe mungesa e stimuljeve ose skemave mbështetëse për importin dhe eksportin e produkteve bujqësore. Shqipëria ka një marrëveshje të tregtisë së lirë me Turqinë.

Bujqësia vazhdon të mbetet një nga sektorët kryesorë të ekonomisë, e cila gjeneron rreth 18.5% të prodhimit të brendshëm bruto (në 2008) dhe 48.3% të punësimit të përgjithshëm. Rreth 500000 njerëz punojnë në bujqësi, prej të cilëve 55% me kohë të plotë dhe 45% me kohë të pjesshme. Produktiviteti i punës në bujqësi përbën vetëm 30% të produktivitetit të punës të të gjithë ekonomisë së Shqipërisë dhe 20% të produktivitetit të punës të BE-së në bujqësi. Mbi 50% e popullsisë së përgjithshme jeton në zonat rurale ku bujqësia është veprimtaria kryesore ekonomike.

Norma vjetore e rritjes së prodhimit bujqësor gjatë pesë viteve të fundit, ka qenë rreth 3 deri në 3.5%. Faktorët të cilët pengojnë rritjen e këtij sektori janë fermat e vogla (mesatarisht 1.2 hektarë), copëzimi i tokës (3.8 parcela për fermë), sistemi jo i zhvilluar i vaditjes dhe kullimit, infrastruktura e pazhvilluar,

mungesa e aksesit në tregje, zhvillimi i ulët i industrisë agro-ushqimore, niveli i ulët i teknologjisë, organizatat e dobëta të fermerëve dhe mungesa e aksesit në financim. Tregu i tokës bujqësore ka mungesë dinamizmi dhe funksionon nën potencialin e vet për shkak të problemeve me regjistrimin dhe problemet e pazgjidhura të pronësisë mbi tokën.

Toka bujqësore e kultivuar arrin përafërsisht 1.15 milion hektarë, prej të cilave 697000 hektarë janë tokë e lërueshme. Rreth 43% e tokës së lërueshme ndodhet në zonat fushore me prodhueshmëri të lartë, 34% ndodhet në zonat kodrinore dhe 23% në zonat malore. Prodhimi i blegtorisë zë 46% të prodhimit të përgjithshëm të sektorit, pasuar nga të korrat me 42% dhe frutat me 12%. Shqipëria është një vend importues neto i produkteve ushqimore me bilanc tregtar tejet negativ. Rreth 80% e eksporteve bujqësore shkojnë në BE. Për sa i përket importeve, pjesa e BE-së arrin në 60%.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), përgjegjëse për hartimin e politikave bujqësore, ka një personel prej 2200 punonjësish. Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (*Agjencia e Pagesave*) u themelua në fund të vitit 2008, për të vënë në zbatim masat mbështetëse në sektorin e bujqësisë, ushqimit dhe zhvillimit rural. Kjo agjenci është caktuar si një agjenci e ardhshme IPARD (*Instrumenti për Asistencën e Para-anëtarësimit për Zhvillimin Rural*) përgjegjëse për zbatimin e masave të para-anëtarësimit.

Informacioni i përgjithshëm i regjistrimit të tokave ekziston vetëm në mënyrë manuale dhe nuk është i plotë apo i përditësuar. Regjistri i vreshtave është përfunduar së fundmi. Regjistrimi i përgjithshëm i bujqësisë është parashikuar të zhvillohet në vitin 2012. Rezultatet e këtij regjistrimi duhet të shërbejnë si bazë e fortë për hartimin e politikës për bujqësinë dhe zhvillimin rural. (*Shiko Kapitullin 18-Statistikat*).

Politika e Shqipërisë për bujqësinë është e bazuar në Strategjinë sektoriale të Bujqësisë dhe Ushqimit 2007-2013. Sektorët strategjikë janë (i) prodhimi i frutave, ullinjve dhe rrushit; (ii) prodhimi i perimeve; (iii) prodhimet blegtorale; (iv) përpunimi i frutave dhe perimeve; (v) përpunimi i rrushit; dhe (vi) përpunimi i mishit dhe i qumështit.

Mbështetja për prodhimin bujqësor sigurohet nga një sërë masash të cilat përfshijnë, në veçanti, subvencione për plantacionet e reja, vaditjen me pika, pajisje serash, pagesa për krerë për delet, ndihmë për prodhimin e qumështit dhe vajit të ullirit, subvencione për prodhimet organike si dhe subvencionim të interesave të huave për bujqësinë dhe agro-industrinë. Lista e masave (disa prej të cilave i përkasin zhvillimit rural) dhe niveli i mbështetjes mund të ndryshojë nga njëri vit te tjetri. Shpenzimet buxhetore për mbështetje të tillë arritën shumën prej 10 milion eurosh për vitin 2009.

*Pagesat e drejtpërdrejta* në Shqipëri nuk janë në përputhje me rregullat e BE-së. Ekzistojnë ndryshime thelbësore në mënyrën se si u jepet mbështetja e drejtpërdrejtë fermerëve. Në kundërshtim me përjasjen e ndjekur në PPB-në e reformuar, ndihmat në pagesa të drejtpërdrejta janë dyfishuar dhe për këtë arsye duhet të vihen në përputhje me *acquis* e BE-së. Ndihma e drejtpërdrejtë aktualisht jepet për sektorët kryesorë të prodhimit në Shqipëri: ndihmë për përpunimin e qumështit dhe vajit të ullirit dhe pagesa për krerë për prodhimet e dheneve dhe dhive. Normat e ndihmës vendosen çdo vit. Ende nuk janë vënë detyrime ligjore për respektimin e standardeve mjedisore apo ndonjë standard tjetër të kushtëzimit ndërsektorial (*cross-compliance*). Shqipërisë do t'i duhet gjithashtu, të krijojë një sistem

informacioni për përfituesit e pagesave të PPB-së nën një menaxhim të përbashkët, si dhe të sigurojë publikimin e përvitshëm të emrave të përfituesve.

Nuk ekziston ndonjë strukturë e ngritur që është ekuivalente me sistemin e integruar të administrimit dhe kontrollit (*SIAK*). Futja e një SAIK-u funksional, përfshirë dhe një regjistër fermash, një sistem të teknologjisë së informacionit dhe një sistem identifikimi për parcelat e tokës, është një detyrë e vështirë dhe që kërkon kohë, e cila do të kërkojë investime të mëdha dhe forcim kapacitetesh institucionale shumë kohë përpara aderimit. Shqipëria duhet gjithashtu, të ketë një *rrjet të të dhënave të kontabilitetit të fermave (RrDhKF)* në përputhje me *acquis*.

Në lidhje me *ndihmën shtetërore*, përveç subvencioneve në lidhje me tregun dhe masave për zhvillimin rural, Shqipëria zbaton një sërë masash shtesë. Shqipërisë do t'i duhet që të gjithë masat e ndihmës shtetërore t'i vëre në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e BE-së.

Tregjet bujqësore janë të dobëta dhe akoma në ndërtim. Theksi po vihet në zhvillimin e tregjeve rajonale, kryesisht të furnizuar nga fermerë të vegjël. Nuk ekziston asgjë që të mund të krahasohet me organizimin e tregut unik sipas *acquis* të BE-së.

Për sa i përket të **korrave** që kultivohen në tokë të lërueshme, drithërat kultivohen në 628000 hektarë, ndër të cilat gruri dhe misri janë të korrat kryesore. Patatet kultivohen në 200000 hektarë, duke shfaqur tendencë në rritje gjatë viteve të fundit. Prodhimi i produkteve të tjera në tokat e lërueshme nuk zë vend të rëndësishëm. Normat e mbulimit me prodhim vendas të Shqipërisë janë 56% për grurin, 81% për misrin dhe 91% për patatet.

Mbarështimi i gjedhëve është nën-sektori më i madh në **prodhimet blegtorale**. Prodhimi i *mishit të viçit* është 66000 ton, prodhimi i mishit të *bagëtive të imëta* është 44000 ton, prodhimi i *shpendëve* është 17000 ton dhe prodhimi i *mishit të dërrit* është 16000 ton. Normat e mbulimit me prodhim vendas të Shqipërisë janë 95% për mishin e viçit, 99% për mishin e dhenve dhe dhisë, 48% për shpendët dhe 58% për mishin e dërrit. Prodhimi i përgjithshëm i qumështit ishte 1045000 ton në vitin 2009, prej të cilave 87% ishte qumësht lope. Rreth 10% e *qumështit dhe prodhimeve të qumështit* të konsumuara në vend janë të importuara.

Në lidhje me **të korrurat e specializuara**, në Shqipëri rreth 30000 hektarë janë të mbjella me perime dhe shalqinj të kultivuar në fusha të hapura, plus rreth 750 hektarë në sera. *Drurët frutorë* zënë një sipërfaqe prej 20000 hektarësh, ullinj të zënë 42000 hektarë dhe vreshtat zënë 10000 hektarë. Vlerësimet për vitin 2009, vendosin prodhimin e *perimeve* në 730000 ton, të frutave në 47202 ton dhe *vajit të ullirit* në 5060 ton. Rreth 70% e fermerëve prodhojnë perime, 80% kultivojnë dru frutorë, 33% kultivojnë ullirin dhe 19% rrushin.

Prodhimi dhe rendimenti i frutave dhe perimeve ka qenë në rritje vit pas viti, por sektori ndikohet nga kapacitetet e ulët grumbullues dhe magazinues, si edhe nga niveli i ulët i organizatave të prodhuesve. Pavarësisht përpjekjeve të bëra për të promovuar dhe shpërndarë teknologji të reja prodhimi dhe për të përmirësuar standardet dhe kushtet e tregjeve, sektori i frutave dhe i perimeve akoma nuk përmbush nevojat e tregut të brendshëm përgjatë gjithë vitit.



Krijta e drurëve dhe vreshtaria kanë qenë sektorët me zhvillim më të shpejtë gjatë viteve të fundit. Në Shqipëri jepet subvencion për çdo hektar të mbjellë me pemë ulliri, dru frutorë dhe vreshta. Kjo masë nuk është në përputhje me *acquis*.

Organizatave të fermerëve janë shumë të dobëta dhe buxheti shtetëror nuk jep asnjë mbështetje për të promovuar krijimin e grupeve të prodhuesve, siç bëhet në organizimin e tregut unik të BE-së për frutat dhe perimet. Shqipërisë i duhet të krijojë strukturën administrative dhe dispozitat ligjore të cilat do të lejonin funksionimin e një sistemi të organizatave të prodhuesve, grupeve të prodhuesve, shoqatave të organizatave të prodhuesve dhe organizatave ndërsektoriale në përputhje me *acquis* e BE-së (rregullat për njohjen, programet operacionale, fondet operacionale, kriteret e pranueshmërisë etj).

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përputhshmërisë së standardeve ekzistuese të marketingut me standardet e BE-së dhe kryerjes së kontrolleve të konformitetit në përputhje me *acquis* (baza e të dhënave të tregtarëve, analiza e riskut, etj). Zhvillimi i sistemit të informacionit të tregut do të jetë i domosdoshëm për të përmbushur detyrimin për të njoftuar Komisionin për çmimet e prodhimit për prodhimet e frutave dhe perimeve, bazuar në llojin, varietetin, përmasat dhe/ose futjen në tregjet përfaqësuese.

**Zhvillimi rural** në Shqipëri, bazohet në Strategjinë ndërsektoriale të Zhvillimit Rural 2007-2013. Një sërë programesh të pavarura me financim të huaj, të kombinuara me masat mbështetëse vendase, janë përfunduar ose janë në fazën e zbatimit ose të përgatitjes. Por, fokusi kryesor i politikës së zhvillimit rural mbetet bujqësia. Përveç kësaj, masat e zbatuara aktualisht, kanë shtrirje të kufizuara dhe ka nevojë për harmonizim të mëtejshëm me *acquis* e BE-së.

Përfaqësuesit strategjike për zhvillimin rural nuk merr parasysh në mënyrë të mjaftueshme aspektet agromjedisore, të tranzicionit nga punësimi bujqësor në atë jo-bujqësor dhe të trajnimit dhe arsimimit në zonat rurale. Duhet të sigurohet pjesëmarrja e grupeve të interesit sektorial në praktikën planifikuese strategjike.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është përgjegjëse për zbatimin e politikës së zhvillimit rural. Si kapacitetet programuese (si për shembull, përgatitja dhe përshtatja e programit, monitorimi dhe vlerësimi) edhe ato zbatuese (për shembull, përzgjedhja e projekteve, autorizimi dhe kontrolli i pagesave) duhet të përmirësohen. Duhet forcuar shërbimet e ekstensionit, me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së fermerëve në zbatimin e masave të zhvillimit rural.

Për sa i përket **politikës së cilësisë**, ndryshe nga sistemi i BE-së për treguesit gjeografikë dhe veçoritë tradicionale, Shqipëria mbron treguesit gjeografikë dhe veçoritë tradicionale me anë të markave të fabrikës dhe sidomos markave të certifikuara. Kjo praktikë duhet vënë në përputhje me *acquis* e BE-së.

**Kultivimi organik** përbën një sektor relativisht të vogël, por pritet të zhvillohet në të ardhmen si rezultat i mbështetjes vendase dhe projekteve dhe tendencave të vazhdueshme ndërkombëtare. Sipërfaqja e përgjithshme e fermave të certifikuara organike në Shqipëri është 89000 hektarë, por mbi 99% e kësaj sipërfaqeje është e zënë me prodhime të pakultivuara (si bimë mjekësore dhe aromatike). Mbi 99% e këtyre produkteve eksportohen. Numri i subjekteve të regjistruara në vitin 2009, ishte 61,

shtatë prej të cilëve janë grupe fermerësh. Legjislacioni shqiptar për kultivimin organik duhet të harmonizohet më tej me *acquis*.

#### *Ndikimi*

**Ndikimi i vlerësuar** i anëtarësimit të Shqipërisë në Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së është në përpjesëtim me strukturën dhe përmasat e sektorit bujqësor të Shqipërisë. Shqipëria do t'i shtonte 1.15 milion hektarë tokë bujqësore të kultivuar sektorit bujqësor të BE-së (e barabartë me 0.6% të tokës bujqësore të kultivuar të BE-së). Prodhimi i të korrave, si edhe prodhimi i qumështit, mishit të viçit dhe dhenve, do të ishte i barasvlershëm me një përqindje shumë të vogël të prodhimit të përgjithshëm aktual të BE-27. Në tërësi, një vlerësim paraprak sugjeron se anëtarësimi i Shqipërisë në BE do të kishte ndikim shumë të pakët në PPB.

#### *Konkluzioni*

Në tërësi, në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Shqipëria do të duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme për të sjellë legjislacionin e brendshëm në përputhje me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektivitet në periudhën afatmesme. Politika e saj bujqësore do të kërkojë rregullime, duke lëvizur drejt mbështetjes së kufizuar. Shqipëria duhet të përforcojë kapacitetin e saj administrativ dhe të përqendrohet në krijimin e instrumenteve bazë dhe institucioneve për menaxhimin dhe kontrollin e fondeve të disponueshme në kuadrin e Politikës së Përbashkët Bujqësore. Një masë e rëndësishme është përgatitja në kohë për zbatimin e asistencës për zhvillimin rural të disponueshëm nga IPA. Shqipëria duhet të krijojë baza solide për statistika të sakta bujqësore. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet forcimit të kapaciteteve administrative për të menaxhuar organizimin e tregut të përbashkët dhe aktivitetet e zhvillimit rural.

### **3.12. Kapitulli 12: Politika e sigorisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare**

BE ka një përjasje të integruar që synon të sigurojë një nivel të lartë të shëndetit publik, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve me anë të masave koherente "nga ferma në tryezë" dhe të monitorimit të duhur, ndërkohë që sigurohet funksionimi efikas i tregut të brendshëm. *Acquis* përcakton rregulla higjienike për prodhimin e ushqimit dhe rregulla veterinarie, të cilat janë të rëndësishme për sigurimin e shëndetit të kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë e ushqimit me origjinë shtazore në tregun e brendshëm. Rregullat fitosanitare të BE-së përfshijnë çështje si cilësia e farës, produktet e mbrojtjes së bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqimi i kafshëve. Shtetet Anëtare duhet të kenë struktura administrative të duhura për inspektimin dhe kontrollin e produkteve ushqimore, përfshirë kapacitetin e duhur laboratorik.

Shqipëria ka filluar të përmbushë detyrimet e *Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit* në lidhje me politikën për sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe fitosanitetin, të cilat synojnë të modernizojnë dhe strukturojnë bujqësinë dhe agro-industrinë në Shqipëri dhe të mbështesin përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *acquis*.

Në fushën e **sigurisë së përgjithshme ushqimore**, përgjegjësia e përgjithshme për hartimin e politikave dhe koordinimin e institucioneve të ndryshme dhe autoriteteve rajonale të përfshira, është

e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Struktura administrative deri në fund të vitit 2009 ishte e komplikuar, me një hierarki të paqartë, përgjegjësi të mbivendosura, si dhe mungonin kontrollet efëcente, sundimi i ligjit dhe regjistrimi i bizneseve ushqimore.

Në vitin 2010, u krijua me asistencën e BE-së, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, i cili kur të jetë në funksionim të plotë, do të marrë të gjitha përgjegjësitë për inspektimin, vlerësimin e riskut dhe komunikimin. Meqenëse këto përgjegjësi aktualisht janë të shpërndara në katër ministri të ndryshme dhe në zyra rajonale, kjo do të përmirësojë organizimin e përgjithshëm administrativ për sektorin. Megjithatë, ky institucion nuk do të jetë krejtësisht funksional deri në vitin 2011 dhe funksionimi i tij do të duhet të monitorohet. Burimet njerëzore në nivelin qendror janë tej mase të kufizuara, pa ndonjë të dhënë se ekziston ndonjë plan që tregon se do të ketë rritje të kapacitetit administrativ dhe të burimeve buxhetore.

Përgjegjësia për hartimin e legjislacionit zbatues në këtë sektor, ndahet ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Ka pasur progres të kufizuar drejt harmonizimit me legjislacionin e BE-së. Ende nuk është miratuar legjislacioni për 'paketën higjienike' të BE-së, i cili përcakton kushtet higjienike të përgjithshme dhe specifike për stabilimentet ushqimore dhe operatorët e biznesit ushqimor. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për zbatimin efëcent dhe të përshkallëzuar të rregullave të higjienës dhe kontrolleve zyrtare për produktet me origjinë shtazore.

Sistemi i laboratorëve të veterinarisë mbikëqyret nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Do të jetë e nevojshme të bëhen më shumë përpjekje në lidhje me analizat laboratorike për mbetjet e pesticideve dhe për akreditimin e laboratorëve. Aktualisht nuk ekziston sistemi i shpejtë alarmi për artikujt ushqimorë për konsum njerëzor e shtazor në Shqipëri. Kapaciteti i menaxhimit të krizave do të duhet të zhvillohet dhe të përshtatet me strukturat e reja administrative. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që marrëveshjet dypalëshe ndërkombëtare për ushqimin të Shqipërisë, të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së.

Dispozitat kryesore legjislative për **politikën e veterinarisë** janë Ligji për shërbimin veterinar dhe inspektoratin veterinar dhe Ligji për *identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve* dhe fermat blegtorale. Legjislacioni i cili përcakton *sistemin e kontrollit për tregun e brendshëm dhe për importet* transponon pjesë të *acquis*. Megjithatë, kapaciteti zbatues duhet të përforcohet. Për sa i përket regjistrimit të kafshëve, po bëhen përpjekje për të siguruar përputhshmërinë me standardet e BE-së: identifikimi dhe regjistrimi i gjedhëve është pothuajse i përfunduar, por mbetet për t'u parë natyra praktike e këtij identifikimi, ndërsa regjistrimi i bagëtive të imta ka filluar në disa pjesë të vendit.

Shqipëria ka miratuar legjislacionin për *masat për kontrollin e sëmundjeve të kafshëve* (p.sh. antraksi, tuberkulozi, bruceloza, tërbimi dhe sëmundja e pseudopestit) por, përpjekjet duhet të vazhdojnë për të siguruar harmonizimin me *acquis* dhe zbatimin e duhur, duke përfshirë marrjen e mostrave dhe raportimin. Është e domosdoshme të ngrihet një sistem i harmonizuar me *acquis* dhe efikas për tregtinë e kafshëve të gjalla, spermës, vezëve dhe embrioneve. Nuk ekziston ndonjë legjislacion specifik shqiptar për lëvizjet jo tregtare të kafshëve shtëpiake, i cili të transpozojë legjislacionin përkatës të BE-së. Parimet bazë të mirëqenies së kafshëve ekzistojnë në legjislacionin kombëtar, por duhet të zhvillohen më tej.

Për sa i përket legjislacionit për **nxjerrjen në treg të ushqimit për njerëzit dhe për kafshët**, rregullat e higjienës dhe rregullat specifike për produktet shtazore janë pjesërisht të harmonizuara. Megjithatë, miratimi i dispozitave ligjore për analizat e rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit nuk kanë filluar akoma, dhe zbatimi i masave legjislative është akoma i papërfunduar. Cilësia mikrobiologjike e qumështit të papërpunuar është nën standardet e BE-së. Nuk ekziston ndonjë legjislacion specifik për ushqimin e kafshëve. Shqipëria nuk ka kapacitetet për djegien e materialeve më rrezikshmëri të lartë.

Harmonizimi me *acquis* për **sigurinë ushqimore** është shumë i kufizuar dhe i pjesshëm. Në një sërë fushash, për shembull organizmat e modifikuar gjenetikut (OMGJ), harmonizimi nuk ka filluar akoma. Përpjekje domethënëse do të duhet të bëhen për të vënë në zbatim legjislacionin në këtë sektor, së bashku me investime të mëdha për të përmirësuar stabilimentet agro-ushqimore.

Për sa i përket **rregullave specifike për ushqimin e kafshëve**, dispozitat përkatëse janë të përfshira në Ligjin e ndryshuar për mbarëshkrimin e blegtorisë, Ligjin për ushqimin për kafshët dhe Ligjin për ushqimin. Duhet përpjekje të konsiderueshme për të arritur harmonizimin me legjislacionin e BE-së. Nevojitet monitorimi i kujdesshëm i zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në këtë sektor.

Dispozitat kryesore ligjore të **politikës fitosanitare** janë të përcaktuara në Ligjin për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve. Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, është autoriteti kompetent për organizmat dhe farërat e dëmshme. Kjo ministri bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe me Ministrinë e Shëndetësisë për produktet e mbrojtjes së bimëve.

Harmonizimi me *acquis* përkatëse është shumë i kufizuar. Megjithëse e normuar me legjislacionin të brendshëm, kontrolli i mbetjeve pesticide nuk është realizuar për shkak të mungesës së laboratorëve. Për sa i përket *cilësisë së farërave* dhe *materialit mbjellës të bimëve*, nuk kryhen teste të veçorisë, uniformitetit dhe qëndrueshmërisë për regjistrimin e larmisë së bimëve, përveçse për grurin. Vendi përdor skemat e certifikimit të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD), dhe jo të BE-së.

### *Konkluzioni*

Megjithëse, Shqipëria ka filluar harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së, ekzistojnë shqetësime të mëdha për politikën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë e fitosanitetit. Duhet të bëhen përpjekje të mëdha për miratimin gradual të *acquis*. Duhet të konsolidohen kapacitetet administrative, duke ditur ngarkesën e madhe të punës që shkaktojnë përgatitjet për detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi. Në tërësi, zbatimi i legjislacionit ekzistues është i dobët. Fushat si paketa e higjienës, regjistrimi i kafshëve, kontrollet e sigurisë ushqimore, OMGJ-të, kapaciteti për inspektimet dhe analizat laboratorike dhe djegia e nënprodukteve shtazore do të kërkojnë vëmendje të veçantë nga autoritetet kombëtare, me asistencën teknike të BE-së. Shqipërisë do t'i duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektshmëri në periudhën afatmesme.

### 3.13. Kapitulli 13: Peshkimi

*Acquis* për peshkimin përbëhet nga akte normative drejtpërdrejt të zbatueshme, të cilat nuk kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, *acquis* kërkon miratimin e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për pjesëmarrje në politikën e përbashkët të peshkimit (PPP), e cila përfshin menaxhimin e burimeve natyrore dhe mjeteve lundruese, inspektimin dhe kontrollin, veprimet strukturore, politikën e tregut dhe kontrollin e ndihmës së shtetit. Në disa raste, do të duhet të përshtaten marrëveshjet ekzistuese të peshkimit dhe konventat me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* normon tregtinë preferenciale të peshkut dhe prodhimeve të peshkimit dhe nxit bashkëpunimin për peshkimin.

Aktiviteti ekonomik në këtë sektor përfshin peshkimin detar, peshkimin e brendshëm dhe akuakulturën. Sasia e peshkut arriti në 7132 ton në vitin 2008. Shqipëria ka ndërmarrë hapat e parë për të përmirësuar kapacitetin e saj administrativ duke krijuar një Sektor për Inspektoratin e Peshkimit në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU). Në mënyrë që të rritej monitorimi dhe kontrolli i sektorit të peshimeve, në janar të vitit 2010 u krijua Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare që aktualisht ka një personel prej 6 personash. Inspektorati i Peshkimit ka 23 inspektorë peshkimi vendorë, me kualifikimet dhe eksperiencën përkatëse, të cilët mbikëqyrin respektimin e legjislacionit të peshkimit, por që u ngarkohen edhe detyra në lidhje akuakulturën, veterinarinë dhe çështjet zoo-teknike.

Është e nevojshme që sistemi monitorues i mjeteve lundruese (SMML) të jetë në përputhje me politikën e përbashkët të peshkimit, duke e pajisur flotën e peshkimit me kuti blu dhe duke përmirësuar infrastrukturën e rojës bregdetare dhe të MMPAU-së. Kërkohej përf forcim i konsiderueshëm i kapacitetit administrativ, meqenëse personeli në nivelet qendrore dhe vendore me pajisjet e tyre bazë, është i pamjaftueshëm për të përballuar detyrat e caktuara nga *acquis* e PPP-së.

Për sa i përket menaxhimit të burimeve dhe flotës, nuk ka kufizime për sasinë e kapur, përveçse për kuotën për peshkun ton. Shqipëria ka filluar të zbatojë *acquis* e PPP-së, veçanërisht Rregulloren 1967/2006 për masat e menaxhimit të peshkimit (përmasat minimale, karakteristikat teknike dhe dimensionet maksimale të pajisjeve të peshkimit etj.) dhe Rregulloren 2371/2002 për menaxhimin e flotës. Megjithatë, ekziston nevoja për të siguruar mbledhje të dhënash të besueshme, sistematike dhe të përmirësuara për flotën e peshkimit, sasinë e peshkut të zënë, sasinë e peshkut të dorëzuar, dhe gjendjen biologjike të rezervave të peshkut në ujërat shqiptarë dhe përtej.

Flota e peshkimit përmban 280 mjete lundruese në katër porte peshkimi (Sarandë, Vlorë, Durrës dhe Shëngjin). Shumica e mjeteve lundruese janë të vjetra, të amortizuara dhe kanë nevojë për riparime dhe pjesë këmbimi. Gjithashtu, ekzistojnë 289 mjete të vogla lundruese (më pak se tetë metra të gjata, të cilat përdorin mjete të fiksuara ose mrezha, dhe që peshkojnë jo më shumë se 2 deri në 3 milje larg nga bregu). Shqipërisë i duhet të përfundojë regjistrin e mjeteve lundruese në përputhje me rregullat e PPP-së (Rregullorja e Komisionit 26/2004) dhe në përputhje me regjistrin e mjeteve lundruese të BE-së. Nuk ekzistojnë monitorime ose regjistrime statistikore të sasisë së peshkut të zënë dhe sasisë së

peshkut të dorëzuar, por vetëm mbledhje të kufizuara të dhënash për sasisë e peshkut të zënë, nga ditari i anijeve. Duhet patjetër të trajtohet çështja e përputhshmërisë me këto kërkesa bazë.

Për sa i përket **inspektimit dhe kontrollit**, në vitin 2009 Shqipëria parashikoi në legjislacion që anijet më të gjata se 10 metra duhet të kenë ditar (ndërsa një sistem i thjeshtuar raportimi është planifikuar për mjetet lundruese më të shkurtra se 10 metra), por do të duhet të bëhen më shumë përpjekje për të thjeshtuar kërkesat e ditarit të anijes (formatin e ditarit të anijes, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, futjen e ditarëve elektronikë për mjetet lundruese më të mëdha etj.) dhe për të ngritur një sistem informacioni të peshkimit për me qëllim që të bëhet rakordimi i sasisë së zënë me të dhënat e sasisë së dorëzuar. Shqipëria duhet të krijojë një qendër monitorimi për peshkimin ose të ketë qendër të përbashkët me vendet fqinje.

Për të arritur nivelin e duhur të inspektimit, duhet të trajnohen sistematikisht inspektorët e peshkimit, veçanërisht në lidhje me përgatitjen para-inspektimit, përzgjedhjen e mjeteve lundruese (analiza e riskut), ruajtjen e kontrollit gjatë kryerjes së inspektimit, kontrollin fizik të peshkut, mjeteve të peshkimit, hambarëve të peshkut, dokumenteve, Sistemit të Monitorimit të Mjeteve të Peshkimit, , plotësimit të raporteve të inspektimit dhe rakordimit pas inspektimit.

Mungon ende një sistem elektronik informacioni për peshkimin, i cili të kryejë rakordimin ndërmjet sasisë së deklaruar në ditarët e anijeve dhe sasisë së regjistruar në raportet e dorëzimit dhe/ose faturat e shitjeve. Sistemi duhet të jetë në gjendje të zbulojë mospërputhjet dhe mungesën e dokumentacionit. Është shumë e rëndësishme të kryhen inspektime të rregullta fizike për përbërjen e sasisë së zënë të peshkut dhe të dhënat në ditarin e anijes gjatë procedurës së dorëzimit, dhe të hartohet një raport inspektimi që përmban detaje të plota për çdo inspektim.

Në përgatitjet për menaxhimin e **veprimit strukturor**, kërkohet përforcimi dhe trajnimi i personelit, me mbështetjen e ekspertizës së BE-së. Masat për **politikën e tregut** janë në një fazë të hershme, sidomos sa i takon organizatave të prodhuesve dhe mbledhjes së të dhënave të tregut. Nuk ekzistojnë tregje për shitjen me shumicë të peshkut, megjithëse investimet janë planifikuar.

Për të siguruar përputhshmërinë me *acquis* në luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të padeklaruar dhe të parregulluar, Shqipëria ka përgatitur certifikata të zënies për produktet e peshkimit të cilat eksportohen në vendet e BE-së dhe ka njoftuar autoritetet përkatëse të BE-së për regjistrin e mjeteve lundruese, procedurat e licencimit dhe kontrollet për vërtetësinë e certifikatave të zënies së peshkut.

Shqipëria jep **ndihmë shtetërore** për të mbështetur zhvillimin e infrastrukturës së peshkimit në katër portet e peshkimit dhe naftë pa akcizë për mjetet e peshkimit. Shqipëria duhet të sigurojë përputhshmërinë me rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore për sektorin e peshkimit, para aderimit në BE.

Për sa i përket **marrëveshjeve ndërkombëtare**, Shqipëria bën pjesë në Komisionin Ndërkombëtar të Ruajtjes së Peshkut Ton në Atlantik që prej vitit 2008. Shqipëria është anëtare e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun dhe merr pjesë në projektin AdriaMed të FAO-s (të bashkë-financuar nga BE-ja).

Ndikimi i përgjithshëm i pranimit të Shqipërisë në BE, do të jetë i papërfillshëm për sa i përket bilancit të tregtisë, flotës, prodhimit dhe funksionimit të PPP-së.

### *Konkluzioni*

Sektori i peshkimit i Shqipërisë po zhvillohet gradualisht, me zënien e peshkut në rritje dhe disa investime në infrastrukturë. Progres ka pasur në funksionimin eficient të strukturave administrative dhe në menaxhimin e burimeve, kontrollin dhe inspektimin e flotës. Megjithatë, përafrimi me *acquis* e BE-së është akoma në fazën fillestare; politikëbërja dhe kapaciteti administrativ në nivelin qendror, përfshirë menaxhimin e veprimeve strukturore, janë të pamjaftueshme. Nevojiten investime dhe trajnime të mëtejshme për inspektorët vendas, si edhe përmirësime në mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e mjeteve lundruese, përfshirë monitorimin me satelit. Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektshmëri në periudhën afatmesme.

### **3.14. Kapitulli 14: Politika e Transportit**

Legjislacioni i BE-së për transportin synon përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm duke promovuar shërbime transporti eficient, të lehta për t'u përdorur dhe të padëmshme për mjedisin. *Acquis* për transportin përfshin transportin rrugor, hekurudhor, aviacionin, transportin detar dhe lumenjtë e lundrueshëm brenda vendit. Ai përcakton standardet teknike dhe të sigurisë, standardet sociale dhe liberalizimin e tregut në kuadër të një tregu unik evropian të transportit.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* (MSA) i cakton Shqipërisë detyrimin për t'i ofruar trafikut transit të Bashkimit Evropian të drejtën e pakufizuar për të kaluar në territorin e saj dhe parashikon zbatimin e tarifave rrugore jodiskriminuese, si dhe një kalendar për harmonizimin e legjislacionit të sigurisë rrugore me atë të BE-së.

Për sa i përket *transportit rrugor*, harmonizimi i legjislacionit me *acquis* ka përparuar shumë dhe zbatimi ka filluar në të gjitha fushat, përfshirë edhe zbatimin e takografit digjital. Kapacitete të mjaftueshme administrative janë ngritur për të trajtuar *acquis sociale*. Është rregulluar e drejta për të hyrë në treg për transportin e mallrave dhe të pasagjerëve, si për shërbimet kombëtare ashtu edhe ato ndërkombëtare, por megjithatë, një prej katër kritereve për të punuar në profesionin e operatorit të transportit rrugor, konkretisht kriteri i gjendjes financiare po mbetet shumë mbrapa kërkesave të BE-së. Megjithëse janë marrë disa masa për të harmonizuar legjislacionin kombëtar me kërkesat e BE-së për kontrollet e automjeteve, siguria rrugore mbetet shqetësuese.

Në sektorin e **transportit hekurudhor**, Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet e saj si për harmonizimin ashtu edhe për zbatimin e *acquis* të BE-së. Kompania shtetërore shqiptare e hekurudhave i ka ndarë llogaritë e saj për shërbimet e pasagjerëve nga ato të mallrave, për t'u përgatitur për kompensimin e transportit të pasagjerëve dhe përlllogaritjen e kostove që përfshihen në aktivitetet e saj me pasagjerët. Sidoqoftë, nuk janë ngritur institucionet e pavarura hekurudhore, të cilat përbëjnë kushtin paraprak për të hyrë pa kufizime në rrjetin hekurudhor shqiptar. Menaxheri i infrastrukturës dhe ndërmarrja shtetërore e hekurudhave (HSH) nuk gëzojnë pavarësinë që kërkohet sipas legjislacionit të BE-së për hekurudhat dhe ndarja e tyre mbetet një shqetësim. Marrëveshja për pikëkalimin e vetëm hekurudhor

ndërkombëtar, konkretisht ai me Malin e Zi, është duke u rishikuar për t'u përshtatur me legjislacionin e BE-së.

Në Shqipëri nuk ka **transport në lumenj të lundrueshëm** brenda vendit.

Në lidhje me **transportin e kombinuar**, Shqipëria është në fazat e para të zhvillimit të tij.

Në lidhje me **transportin ajror**, Shqipëria po vazhdon zbatimin e fazës së parë të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA). Në këtë kontekst, *siguria ajrore* mbetet një shqetësim i vazhdueshëm. Shqipëria e ka ndryshuar legjislacionin e saj për ta përshtatur me *acquis* e BE-së në këtë fushë, por nuk ka siguruar ende zbatimin efektiv të legjislacionit. Duhet të përmirësohet kontrolli i kompanive ajrore nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) për standardet e sigurisë. Në pranverën e 2010 Shqipëria ka miratuar një kod të ri ajror dhe ka miratuar legjislacion që synon shtimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e ekspertizës në fushën e sigurisë ajrore në AAC si dhe për ngritjen e një Autoriteti Kombëtar të pavarur për të hetuar aksidentet dhe incidentet në aviacionin civil. Lidhur me *sigurinë e aviacionit*, Shqipëria duhet të sigurojë përputhshmërinë me versionin më të fundit të kërkesave të sigurisë të Konferencës Evropiane të Aviacionit Civil (KEAC). Në lidhje me *acquis* për kontrollin e trafikut ajror, qiellin e vetëm evropian, janë miratuar katër rregulloret kryesore si dhe rregullorja e kërkesave të përbashkëta dhe rregullorja për përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore. Përpjekje të mëtejshme kërkohen për të përfunduar harmonizimin me kuadrin rregullator të qiellit të vetëm evropian brenda programit të Strategjisë së Përmirësimit të Sistemeve të Informacionit, sidomos në lidhje me ngritjen e një autoriteti të besueshëm kombëtar të kontrollit.

Për sa i përket **transportit detar**, Shqipëria është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare (OND) dhe e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP). Legjislacioni i Shqipërisë është përgjithësisht në përputhje me rregullat e tregut të BE-së, megjithëse disa përshtatje janë të domosdoshme. Referencat për skemat e autorizimeve dhe licencave duhet të hiqen nga legjislacioni për aksesin në tregun e transportit ndërkombëtar. Kabotazhi është rezervuar për transportuesit që mbajnë flamurin kombëtar, gjë që është në kundërshtim me rregullat evropiane. Më në fund, ekziston një kërkesë që kapitenët e anijeve duhet të jenë patjetër shtetas shqiptarë, ndërsa përputhshmëria me *acquis* BE-së kërkon që të kenë cilëndo shtetësi të BE-27. Rregullat për regjistrimin e mjeteve të lundrimit dhe pronarëve të anijeve janë në përputhje me të drejtën e BE-së.

Përpjekje të konsiderueshme do të nevojiten për të përmirësuar kontrollin ndaj mjeteve tregtare të lundrimit që mbajnë flamurin shtetëror ashtu edhe kontrollin shtetëror në porte. Përqindja e ndalimit të mjeteve shqiptare të lundrimit në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit të Parisit mbi Kontrollin Shtetëror në Porte ishte 21% në 2009, krahasuar me mesataren e BE-së prej 2.2% dhe flamuri shqiptar është vendosur në listën me rrezik shumë të lartë, duke u përfshirë në Listën e Zezë të Memorandumit të Parisit. Lidhur me *sigurinë detare*, Shqipëria ka ndërmarrë tashmë një sërë masash për të realizuar harmonizimin me kërkesat ndërkombëtare dhe të BE-së. Sidoqoftë, nuk ka të dhëna për harmonizimin e legjislacionit për transportin e brendshëm me *acquis* të BE-së. Administrata detare u krijua në muajin prill 2009; ajo përmban departamentin e Kontrollit Shtetëror Portual dhe Kontrollin Shtetëror të Flamurit të krijuara kohët e fundit, por nuk janë zhvilluar akoma kapacitetet e duhura për plotësimin e detyrave të caktuara.



Në lidhje me **navigimin satelitor**, Shqipëria nuk ka aktualisht ndonjë plan për të marrë pjesë në programin Galileo për navigimin satelitor pasi të vihet në punë.

#### *Konkluzioni*

Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme për të përshtatur legjislacionin e saj me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektshmëri në periudhën afatmesme. Ndërkohë që ka shënuar shumë përparime në fushën e transportit rrugor, përpjekje serioze duhet të bëhen për të intensifikuar punën në sektorët hekurudhor, detar dhe të aviacionit. Me qëllim që të sigurohet një zbatim efektiv i *acquis*, strukturat e administratës në sektorë të ndryshëm të transportit në Shqipëri duhet të forcohen në mënyrë të konsiderueshme.

### **3.15. Kapitulli 15: Energjia**

Objektivat e politikës së BE-së për energjinë synojnë të përmirësojnë konkurrueshmërinë, të garantojnë sigurinë e furnizimit dhe mbrojtjen e ambientit. *Acquis* për energjinë konsiston në rregulla dhe politika që përfshijnë konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, tregun e brendshëm të energjisë (hapjen sidomos të tregjeve të elektricitetit dhe gazit), duke promovuar burimet e energjisë së rinovueshme, eficientë të energjisë, menaxhimin e krizave dhe detyrimet për sigurinë e rezervave të naftës, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore, dhe mbrojtjen nga rrezatimi.

Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë dhe si e tillë ka detyrimin ligjor të zbatojë pjesë të rëndësishme të *acquis* për energjinë. Shqipëria nuk ka ligj të integruar për energjinë. Sektorë të ndryshëm të energjisë rregullohen me ligje specifike. Strategjia kombëtare aktuale e energjisë nuk është në përputhje me *acquis*. Është duke u përgatitur një strategji e re kombëtare për energjinë.

Në vitin 2008, bilanci i përgjithshëm i Shqipërisë për energjinë përbëhej në radhë të parë nga produktet e naftës (64%), të pasuara nga energjia elektrike (23%), drutë e zjarrit (12%) dhe qymyri (1%). Sektori i transportit zuri 42.3% të konsumit, sektori i banimit 23.6%, industria 13%, shërbimet 10.8% dhe sektorët e tjerë 10.3%. Konsumi i përgjithshëm i energjisë në 2008 ishte 10% më i lartë se në 2007, kryesisht për shkak të rritjes së transportit rrugor. 65% e konsumit të energjisë nga burimet natyrore në 2008 u mbulua nga prodhimi i brendshëm. Nafta dhe gazi zunë 49.8% të prodhimit të brendshëm, elektriciteti 28% dhe drutë e zjarrit 18.5%. Importet në pjesën më të madhe përbëheshin nga produktet e naftës.

Në lidhje me **sigurinë e furnizimit**, ligji përcakton një detyrim për rafineritë shqiptare të naftës dhe kompanitë e shitjes me shumicë që të mbajnë rezerva të produkteve të naftës për 60 ditë, e cila do të rritet në 90 ditë në 2011, në përputhje me Direktivën e Rezervave të Naftës të BE-së. Shqipëria duhet të demonstrojë respektimin efektiv të kërkesave aktuale dhe të së ardhmes për rezervat e naftës. Në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji elektrike, deklarata e Shqipërisë për sigurinë e furnizimit për vitin 2009, merr në konsideratë kapacitetet ekzistuese të prodhimit si dhe kufizimet aktuale të interkonjeksionit dhe mungesën e shumëllojshmërisë së energjisë. Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike, modeli i ri i tregut dhe Strategjia Kombëtare e Energjisë përfshijnë dispozitat bazë për sigurinë e furnizimit me energji elektrike. Megjithatë, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme

për të zbatuar *acquis* mbi sigurinë e furnizimit me energji elektrike, siç kërkohet nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Ligji i vitit 2008 për gazin natyror përcakton sigurinë e furnizimit me gaz natyror.

Shqipëria varet pothuajse krejtësisht nga hidrocentralet për prodhimin e *energjisë elektrike* të saj, gjë që e bën vulnerabël përballë kushteve të pafavorshme hidrologjike. Rrjeti i transmetimit ka nevojë për investime të konsiderueshme. Sistemet e interkonjeksionit me vendet fqinje janë të kufizuara, megjithëse kanë filluar projekte prioritare të infrastrukturës të Komunitetit të Energjisë. Shqipëria ka prodhim të brendshëm të *gazit natyror*, i cili përdoret vetëm brenda vendit për qëllime teknologjike. Vendi nuk është i lidhur me ndonjë rrjet gazsjellësi ndërkombëtar. Prodhimi i *qymyrit* (linjit dhe qymyr agregat) nuk është i madh dhe është me cilësi të dobët. Qeveria ka planifikuar që ta ndërpresë prodhimin e qymyrit në të ardhmen e afërt. Importet aktuale të qymyrit janë shumë të kufizuara. Nuk ka asnjë njoftim për ndihmë shtetërore për këtë sektor. Prodhimi i brendshëm i *naftës së papërpunuar* është i konsiderueshëm dhe është në rritje. Kërkimi dhe prodhimi i naftës po kryhen me përfshirjen e investitorëve të huaj. Sektori i rafinimit është privatizuar në masën 85%. Legjislacioni i Shqipërisë për kërkimin e naftës është në përputhje me Direktivën e BE-së për Hidrokarburet.

Në **tregun e brendshëm të energjisë**, sektori i energjisë elektrike është rregulluar nga Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike, i cili në pjesën më të madhe është në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Megjithatë, ka ende një numër pengesash që e pengojnë hapjen e plotë të tregut. Një përqindje e konsiderueshme e kapacitetit të transmetimit dhe shpërndarjes është rezervuar për kompaninë e furnizimit me shumicë. Operatorit i sistemit të transmetimit është ndarë dhe 76% e aksioneve të operatorit të shpërndarjes janë privatizuar. Tarifat e energjisë elektrike nuk janë ende në nivelin e rikuperimit të kostos. Lidhjet e paligjshme dhe humbjet e mëdha të natyrës teknike dhe joteknike po cenojnë rritjen e natyrshme të tregut të energjisë elektrike. Përqindja e arkëtimit të faturave mbetet më e ulët se mesatarja e BE-së. Ligji për gazin i vitit 2008, që bazohet në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, transponon një pjesë të konsiderueshme të *acquis* përkatëse, por nuk parashikon hapjen e tregut. Shqipëria nuk ka filluar të zbatojë ende *acquis* e vitit 2009 për tregun e brendshëm të energjisë për gazin dhe elektricitetin (“paketën e tretë të masave legjislative”). Në vitin 2008 u ngrit një autoritet i përbashkët rregullator dhe i pavarur (ERE) për energjinë elektrike dhe gazin. Kompetencat monitoruese dhe të zbatimit të ligjit të këtij autoriteti duhet të forcohen.

Ligji shqiptar për **energjinë e rinovueshme** nuk është miratuar akoma, por vendi ka transpozuar disa dispozita të *acquis* në legjislacionin e tij për nxitjen e përdorimit të karburanteve bio dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme në transport. Shqipëria ka marrë masa gjithashtu, për të mbështetur prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, sidomos në sektorin hidroenergetik. Kuadri rregullator i Shqipërisë ka nevojë të zhvillohet më tej për të përmbushur kërkesat e Direktivës së Energjisë së Rinovueshme në të gjithë sektorët. Zbatimi i kuadrit ligjor do të kërkojë vëmendje të veçantë. Të gjitha palët kontraktuese në Komunitetin e Energjisë duhet të përcaktojnë një objektiv për pjesën minimale kombëtare të energjisë së rinovueshme për vitin 2020, në bazë të metodës që zbatohet nga Shtetet Anëtare të BE-së. Një nga sfidat kryesore me të cilën po përballlet Shqipëria, është që të përcaktojë një vlerë të besueshme për pjesën e energjisë së rinovueshme në vitin 2005, i cili është viti bazë për llogaritjen.

Kuadri ligjor për **efiçencën e energjisë** është pjesërisht në përputhje me *acquis* për performancën e energjisë në ndërtesa, etiketimin e energjisë të pajisjeve shtëpiake dhe shërbimet e energjisë. Megjithatë, zbatimi i legjislacionit në përgjithësi, është i dobët, përfshirë etiketimin e produkteve të energjisë. Është duke u përgatitur harmonizimi i legjislacionit me Direktivën Eko-dizenjo, e rimodeluar, dhe po hartohet një ligj i ri që harmonizon *acquis* për bashkëgjenerimin. Projekti i planit kombëtar të veprimit për efiçencën e energjisë përcakton një objektiv indikativ për kursimet e energjisë në 2016.

Në lidhje me **energjinë bërthamore, sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi**, Shqipëria nuk ka centrale bërthamore ose instalime kërkimi ose impiante për ciklin e lëndëve djegëse bërthamore. Qeveria është duke marrë në konsideratë mundësinë e përdorimit të teknologjisë bërthamore për prodhimin e energjisë. Agjencia Kombëtare për Energjinë Bërthamore (AKEB) e krijuar në muajin janar 2010, është përgjegjëse për hartimin e programit bërthamor, i cili është në fazë shumë të hershme, përfshirë edhe aspektet e tij financiare. Shqipëria ka bërë përparime në kuadrin rregullator bërthamor, megjithëse duhet të verifikohet akoma përputhshmëria e plotë me *acquis* e BE-së dhe duhet të hartohen një numër i konsiderueshëm rregulloresh dhe procedurash pune. Shqipëria është palë e Konventës për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor. Ajo ka aprovuar një ligj për të ratifikuar Protokollin Shtesë të vitit 2004 të Marrëveshjes së saj për Mbrojtjen e Gjithanshme me IAEA, megjithëse ligji nuk ka hyrë ende në fuqi. Megjithatë, Shqipëria nuk e ka ratifikuar akoma Konventën e Përbashkët për sigurinë e menaxhimit të karburanteve të harxhuara dhe sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive dhe Konventën për sigurinë bërthamore. Autoriteti rregullator është i dobët dhe do të kërkojë burime të konsiderueshme financiare dhe njerëzore për të ngritur kapacitetet e tij për të hartuar, zbatuar dhe garantuar respektimin në mënyrë efektive legjislacionin në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe *acquis* e Euratom-it, përfshirë edhe Direktivën për Sigurinë Bërthamore të vitit 2009. Masat për informimin e publikut nuk janë të plota. Programi për monitorimin e rrezatimeve në natyrë duhet të vihet në zbatim. Përfundimisht, do të kërkojnë të merren masa për të garantuar pavarësinë financiare të autoritetit rregullator nga Ministria e Shëndetësisë.

Vendi ka një impiant të centralizuar për menaxhimin e mbetjeve radioaktive me kapacitet 300 m<sup>3</sup> për të ruajtur mbetjet e përdorura të prodhuara në pajisje të ndryshme të burimeve të rrezatimit. Ky ambient duhet të licencohet siç duhet, sepse aktualisht është i licencuar si burim. Për më tepër, raporti për analizën e sigurisë së këtij ambienti duhet të (ri)shkruhet.

### *Konkluzioni*

Shqipëria e ka përafëruar legjislacionin e saj me një numër aspektesh të *acquis* dhe po përgatiten ndryshime në kuadrin ligjor. Sidoqoftë, fushat e efiçencës së energjisë, energjisë së rinovueshme dhe rezervave të naftës si dhe rritja e natyrshme e tregut të energjisë elektrike dhe zhvillimin e tregut të gazit do të kërkojnë vëmendje të mëtejshme. Duhet të forcohet roli i autoritetit rregullator të energjisë elektrike dhe gazit. Shumëllojshmëria e energjisë është e pamjaftueshme dhe vendi është i cenueshëm nga mungesa e sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Kapaciteti i autoritetit rregullator për sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme. Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektshmëri në periudhën afatmesme.

### 3.16. Kapitulli 16: Tatimet

*Acquis* për tatimet përfshin fushën e tatimit indirekt në lidhje me tatimin e vlerës së shtuar (TVSH) dhe akcizave dhe përcakton përkufizimet dhe parimet e TVSH-së. Akcizat për energjinë, produktet e duhanit dhe pijet alkoolike i nënshtrohen Direktivave të BE-së që përfshijnë strukturën e taksave, nivelet e normave minimale dhe mbajtjen dhe lëvizjen e mallrave mbi të cilat aplikohet akciza. Lidhur me taksat e drejtpërdrejta, *acquis* përfshin disa aspekte të taksave të drejtpërdrejta mbi fitimet e kompanive dhe synon kryesisht të heqë pengesat për aktivitetet ndërkufitare ndërmjet kompanive. Legjislacioni i BE-së në fushën e bashkëpunimit administrativ dhe ndihmës reciproke siguron mjetet për të parandaluar evazionin fiskal dhe shmangien nga pagimi i taksave brenda BE-së.

Në fushën e **tatimit indirekt**, kuadri ligjor i Shqipërisë është në përputhje me Direktivën e Tatimit mbi Kapitalin.

Kuadri ligjor i Shqipërisë për TVSH-në është në përputhje me rregullat e BE-së deri në njëfarë shkalle, por kërkohen disa ndryshime për ta përshtatur legjislacionin aktual me Direktivën për TVSH-në, duke përfshirë përjashtimet dhe skemat e veçanta.

Sistemi i *akcizave* përfshin shumicën e produkteve që i nënshtrohen aplikimit të akcizës në BE. Akcizat aplikohen për produktet e duhanit, pijet alkoolike dhe produktet e naftës. Sidoqoftë, ka dallime me sistemin e BE-së, përfshirë fushën e veprimt, strukturat dhe normat e tatimit.

Në taksat për pijet alkoolike, kategoritë e taksave dhe disa dispozita për trajtimin preferencial të rakisë nuk janë harmonizuar me *acquis*. Struktura dhe normat e taksës mbi duhanin në Shqipëri ndryshojnë nga ato në BE. Për më tepër, taksa mbi cigaret bazohet në përmbajtjen e nikotinës. Kjo nuk është në përputhje me *acquis*. Produktet e energjisë nuk përfshijnë elektricitetin, qymyrin, gazin natyror dhe gazin e lëngshëm (LPG). Sistemi i kuotës së importimit që u lejohet udhëtarëve është ndryshe nga sistemi i BE-së lidhur me sasinë që mund të importohen, kuotën e lejuar të importimit, kufijtë e vlerës dhe moshën minimale të përfituesve.

Në lidhje me **taksat e drejtpërdrejta**, kuadri ligjor i Shqipërisë nuk është në përputhje me aktet kryesore ligjore të BE-së në këtë fushë. Në vija të përgjithshme Shqipëria vepron në përputhje me kodin e sjelljes për taksimin e biznesit, megjithëse duhen vlerësuar kufizimet ekzistuese mbi aksionet që kanë individët e regjistruar në Shqipëri. Lidhur me qeverisjen e mirë në çështjet e taksave, ka disa shqetësime për identifikimin në mënyrë transparente të pronarit përfundimtar ose përfituesit të aseteve, detyrimeve ose transaksioneve, siç kërkohet nga standardet ndërkombëtare dhe të BE-së. Marrëveshjet për taksimin e dyfishtë që do të negociohen në të ardhmen do të bazohen në modelin e Organizatës për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD), i cili siguron shkëmbim të plotë të informacionit për të gjitha çështjet e taksave.

Për sa i përket **bashkëpunimit administrativ dhe ndihmës reciproke**, Shqipëria pas anëtarësimit duhet të zbatojë *acquis* për ndihmën reciproke në çështjet e taksave të drejtpërdrejta, përfshirë Direktivën për Kursimet. Duhet të ngrihen zyra qendrore ndërlidhëse për shkëmbimin e informacionit për TVSH-në dhe taksat indirekte, dhe duhen të kenë personelin dhe procedurat e

duhura për të respektuar afatet e përcaktuara në *acquis* në lidhje me sigurimin e informacionit. Duhet të vendoset lidhja reciproke dhe të zhvillohet aftësia për të operuar së bashku me sistemet e lëvizjes dhe kontrollit të akcizave të BE dhe me sistemet kompjuterike për shkëmbimin e informacionit për TVSH-në dhe akcizat.

Në lidhje me **kapacitetin operacional dhe kompjuterizimin**, është miratuar kuadri ligjor dhe administrativ për të zbatuar legjislacionin tatimor. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) në Ministrinë e Financave është e ngarkuar me zbatimin e taksave kombëtare, tarifave publike dhe mbledhjen e kontributeve. Kapacitetet dhe procedurat e saj administrative janë të mjaftueshme për detyrat e saj aktuale, megjithëse përpjekje të tjera do të nevojiten për trajnim dhe metodat e punës. Sistemi i TVSH-së do të duhet të përmirësohet, kryesisht në lidhje me identifikimin e tregtarëve. Duhet të vendoset një sistem efektiv për kontrollin e akcizave, përfshirë procedurat elektronike të administrimit. Kapacitete shtesë do të nevojiten gjithashtu, për të përmbushur, pas anëtarësimit, kërkesat e bashkëpunimit administrativ me Shtetet Anëtare të BE-së për TVSH-në, akcizat, taksat e drejtpërdrejta dhe taksat mbi kursimet. Perceptimi i korrupsionit në administratën tatimore është i lartë dhe Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të veçanta për të trajtuar këtë çështje.

Administrata tatimore ka bërë përpjekje të mëdha që taksapaguesit të përmbushin detyrimet në mënyrë vullnetare dhe ajo arrin të mbledhë në mënyrë efektive shumicën e detyrimeve të taksave. Legjislacioni aktual kërkon pagesën e plotë të taksës përpara se të bëhet një ankesë kundër një vendimi të administratës tatimore dhe nuk lejon përdorimin e një garancie bankare për këtë qëllim. Analiza e rrezikut, inspektimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve duhet të forcohen më tej për të përmirësuar zbatimin e ligjit dhe për të reduktuar ekonominë e madhe informale.

Një Këshill Tatimor është ngritur si një strukturë këshillimore në Ministrinë e Financave për të përmirësuar bashkëpunimin teknik ndërmjet ministrisë, DPT dhe taksapaguesve. Megjithatë, kjo strukturë nuk është ende funksionale dhe roli i saj duhet të përcaktohet më tej. Avokati i Taksapaguesve filloi të funksionojë në muajin qershor 2010, për të siguruar informacion dhe për të ndihmuar taksapaguesit dhe për të ndihmuar autoritetet në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në radhët e zyrtarëve të tatimeve.

Kompjuterizimi është shumë i përparuar në administratën tatimore dhe sistemi i integruar i taksave funksionon në të gjithë vendin. Po aplikohet deklarimi elektronik i taksave për taksapaguesit e biznesit dhe ky aplikim është duke u zgjeruar. Një sistem regjistrimi i parave kesh që kanë ndërmarrjet për paratë e thata është duke u zbatuar tashmë për taksapaguesit e mëdhenj të TVSH-së si dhe për pages të tjerë të TVSH-së dhe çdo ditë regjistrohen në formë elektronike 18000 bilance. Megjithatë, qendra e kompjuterëve duhet të pajiset me pajisje dhe programe kompjuterike më të mira dhe duhet të forcohen burimet njerëzore dhe zhvillimi i sistemeve në fushën e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë ndihmën me anë të trajnimeve. Pas anëtarësimit, vendit do t'i kërkohej që të zhvillojë dhe shfrytëzojë të gjitha pjesët kombëtare të sistemeve mbarëevropiane të teknologjisë së informacionit për taksat dhe akcizat.

*Konkluzioni*

Legjislacioni tatimor i Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me *acquis* e BE-së. Nevojitet përafrimi i mëtejshëm në taksat indirekte dhe Shqipëria duhet të zbatojë pjesën më të madhe të *acquis* për taksat e drejtpërdrejta. Nuk ka masa tatimore potencialisht të dëmshme, por transparenca e sistemit të taksave duhet të shqyrtohet më tej. Kapacitetet administrative të administratës tatimore duhet të forcohen, sidomos në lidhje me analizën e rrezikut, inspektimin, komunikimin e brendshëm dhe komunikimin me agjencitë ose autoritetet publike. Duhet të bëjë përpjekje të veçanta për të ngritur strukturat administrative që kërkohen nga *acquis* në momentin e anëtarësimit, dhe për të realizuar lidhjen e plotë me sistemet kompjuterike të taksave dhe akcizave të BE-së.

Në tërësi, Shqipëria ende përballet me sfida për harmonizimin e legjislacionit dhe kapacitetet administrative, por parashikohet se në periudhën afatmesme ka kapacitete për të përmbushur kërkesat e *acquis*, në rast se mban këtë ritëm përpjekjesh.

### 3.17. Kapitulli 17: Politika Ekonomike dhe Monetare

*Acquis* në fushën e politikës ekonomike dhe monetare përmban rregulla që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore në Shtetet Anëtare dhe që ndalojnë financimet e drejtpërdrejta të sektorit publik nga ana e bankave qendrore, ashtu edhe aksesin e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet Anëtare duhet të koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe t'i nënshtrohen rregullave të procedurës së deficitit mbi normën e lejuar ashtu edhe të Paktit të Stabilitetit dhe Zhvillimit. Bankat qendrore kombëtare do t'i nënshtrohen Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (ESCB). Shtetet e reja Anëtare janë të angazhuara gjithashtu, për të plotësuar kriteret për futjen e euros. Derisa ato të bashkohen me zonën e euros, ato marrin pjesë në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar si Shtetet Anëtare me derogim dhe duhet ta trajtojnë politikën e tyre të kursit të këmbimit si shqetësim të përbashkët.

Në fushën e **politikës monetare**, Ligji për Bankën Kombëtare është gjerësisht në përputhje me *acquis*. Ai siguron një shkallë të madhe pavarësie për Bankën Qendrore dhe i përcakton asaj si objektiv kryesor ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ligji parashikon që Banka nuk duhet në asnjë mënyrë të kërkojë ose të marrë udhëzime nga autoritetet e tjera dhe se ajo është institucioni i vetëm përgjegjës në vend për politikën monetare dhe politikën e shkëmbimit të valutës. Megjithatë, ligji duhet të harmonizohet më tej me *acquis*, duke përfshirë edhe pavarësinë individuale të anëtarëve të Këshillit dhe llogaridhënien e Bankës Qendrore. Në mënyrë të veçantë, dispozitat për shkarkimin e Guvernatorit duhet të përafrohen më shumë me Statutin e ESCB.

Banka Qendrore është e pavarur nga pikëpamja financiare dhe në tërësi, ka kapacitete administrative të mjaftueshme për të funksionuar në mënyrë efektive.

Lidhur me **politikën ekonomike**, Ligji për Bankën Qendrore e ndalon në mënyrë të qartë dhënien e kredisë drejtpërdrejt tek shteti, megjithëse jo për institucionet e tjera publike. Në lidhje me ndalimin e aksesit të privilegjuar të sektorit publik, legjislacioni ekzistues do të duhet të përshtatet me *acquis*, duke qenë se ka akte që parashikojnë rregulla ose stimuj të veçantë për sektorin financiar për t'i dhënë hua sektorit publik ose për të blerë letrat me vlerë publike. Në mënyrë të veçantë, Ligji për sigurimet dhe Ligji për fondet e pensioneve përmban dispozita të cilat efektivisht i japin sektorit publik akses të privilegjuar në institucionet financiare.

Që prej vitit 2006, Shqipëria ka marrë pjesë në mbikëqyrjen e politikës ekonomike të para-aderimit, e cila synon forcimin e kapaciteteve të planifikimit ekonomik në vend për t'u përgatitur për pjesëmarrjen e mëvonshme në mekanizmat e koordinimit të politikës ekonomike dhe mbikëqyrjes buxhetore të Bashkimit Monetar Evropian (BME). Në këtë kontekst, Shqipëria dërgon programe të rregullta ekonomike dhe financiare (PEF). Programi ekonomik dhe financiar për 2010 përfshin periudhën 2010-2012 dhe bazohet në disa strategji afatmesme të qeverisë. Në vija të përgjithshme plani përputhet me kërkesat në format dhe përmbajtje, megjithëse, të dhënat publike financiare nuk janë në përputhje me sistemin evropian të llogarive ESA95. Të dhënat kanë disa mangësi të mëdha, gjë që thekson nevojën për forcim të mëtejshëm të sistemit statistikor, përfshirë edhe kontrollin e statistikave. Në përgjithësi, programi paraqet një përmbledhje shumë të gjerë, por kryesisht përshtatëse të planit të reformave strukturore. Ai mbetet i paqartë për strategjinë e përgjithshme dhe për lidhjen ndërmjet reformave dhe objektivave financiare dhe nuk ofron një afat të qartë për zbatimin e reformave.

### *Konkluzioni*

Legjislacioni i Shqipërisë nuk është në përputhje me *acquis* në lidhje me pavarësinë e bankës qendrore, financimet monetare dhe aksesin e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare.

*Në tërësi*, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të përshtatur legjislacionin e saj me *acquis* në fushën e politikës ekonomike dhe financiare dhe për ta zbatuar atë me efektshmëri në periudhën afatmesme. Përgatitjet për të marrë pjesë në fazën e tretë të BME si një Shtet Anëtar me derogim nuk paraqesin probleme të mëdha përpara aderimit.

### **3.18. Kapitulli 18: Statistikat**

*Acquis* në fushën e statistikave pothuajse përbëhet vetëm nga legjislacioni që është i zbatueshëm drejtpërdrejt në Shtetet Anëtare, siç janë rregulloret e Parlamentit dhe Këshillit Evropian dhe vendimet ose rregulloret e Komisionit. Ajo gjithashtu, përmban një numër manualesh dhe udhëzuesish metodikë. Edhe marrëveshjet ndërkombëtare përbëjnë një bazë tjetër për përpilimin e statistikave.

Në fushën e **infrastrukturës statistikore**, sistemi statistikor në Shqipëri është shumë i decentralizuar, ku shumë agjenci qeveritare që hartojnë statistika zyrtare. Ligji për statistikat zyrtare u miratua në vitin 2004. Institucioni kombëtar për Statistikat - INSTAT- ka funksionin e koordinuesit. INSTAT-i është në varësi të Kryeministrit dhe emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm janë objekt i miratimit të kryeministrit. Me qëllim që të forcohet pavarësia profesionale e INSTAT-it, ligji për statistikat ka nevojë që të rishikohet me qëllim që të parashikojë një mandat fiks për Drejtorin e Përgjithshëm dhe të përcaktojë më qartë funksionin e INSTAT si koordinator i sistemit të statistikave kombëtare. Përbërja e këshillit statistikor duhet të ndryshojë me qëllim që të përfaqësojë më mirë të gjitha palët e interesuara të statistikave zyrtare. Burimet aktuale njerëzore dhe financiare për statistikat nuk janë të mjaftueshme për të realizuar harmonizimin e plotë me *acquis* në këtë fushë.

Fusha e **klasifikimit** statistikor kanë nevojë për përmirësim thelbësor. Përkthimi dhe futja e klasifikimit të ri për aktivitetet ekonomike (NACE Rev. 2) është veçanërisht i rëndësishëm dhe do të kërkojë koordinim me të gjithë përpiluesit e statistikave zyrtare. Cilësia e **regjistrimit** të biznesit është e papërshtatshme dhe kërkon azhurnim të rregullt. Ende nuk ekziston klasifikimi statistikor rajonal i pajtueshëm me klasifikimin NUTS.

Në fushën e **statistikave sektoriale**, vazhdojnë dobësitë, sidomos për statistikën në fushën e bujqësisë, sociale, biznesit dhe makroekonomike. Statistikat në fushën e bujqësisë kanë nevojë që të përmirësohen; duhet të futen statistikën agronometare si dhe anketimi i strukturave fermere. Statistikat e popullsisë janë të bazuara në regjistrin e gjendjes civile, por kjo kërkon përmirësime të mëtejshme. Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në vitin 2011 do të lejojë përditësimin e statistikave demografike dhe parashikime më të sakta demografike. Statistikat e migracionit nuk janë në përputhje me kërkesat e BE-së. Anketa e Fuqisë Punëtore duhet të kryhet në baza tre-mujore. Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës nuk është në përputhje me *acquis* në këtë fushë. Statistikat e tjera sociale, për shembull, statistikën për arsimin dhe shëndetësinë gjithashtu, nuk janë të zhvilluara mirë. Përmirësime të mëtejshme janë të nevojshme në lidhje me metodologjinë dhe burimet e të dhënave për llogaritë kombëtare. Statistikat për deficitin dhe borxhin qeveritar, investimet e huaja direkte, si dhe statistikën monetare dhe financiare kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. Kjo është e vlefshme sidomos për matjen e remitancave. Indeksi i çmimit të konsumit nuk është në pajtim me indeksin e harmonizuar të çmimit të konsumit në BE. Statistikat e tregtisë së jashtme janë pjesërisht në pajtueshmëri me kërkesat e BE-së, dhe një bashkëpunim më i ngushtë i INSTAT-it, Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve doganore është i domosdoshëm. Statistikat për biznesin kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. Statistika të kufizuara ekzistojnë për transportin dhe energjinë. Statistikat për peshkimin, mjedisin dhe turizmin nuk janë në përputhje me standardet e BE-së.

### *Konkluzioni*

*Në tërësi*, statistikën e hartuara nga Shqipëria ende nuk janë të harmonizuara në mënyrë të kënaqshme me standardet e BE-së, sidomos në lidhje me klasifikimet dhe regjistrat dhe për statistikën në fushën e bujqësisë, biznesit dhe ato makroekonomike. Pavarësia profesionale e INSTAT nuk është e garantuar mjaftueshëm me ligj. Shqipëria duhet të angazhojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, dhe duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektshmëri në periudhën afatmesme.

### **3.19. Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi**

*Acquis* në politikën sociale dhe punësimin përfshin standardet minimale në fushën e së drejtës së punës, mundësive të barabarta, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe anti-diskriminimin. Shtetet Anëtare marrin pjesë në proceset e politikave të BE-së në fushat e politikës së punësimit, përfshirjes sociale dhe mbrojtjes sociale. Partnerët socialë të Shteteve Anëtare marrin pjesë në dialogun social në nivelin evropian. Fondi Social Evropian (FSE) është mjeti kryesor financiar nëpërmjet të cilit BE mbështet zbatimin e strategjisë së saj të punësimit dhe kontribuon në përpjekjet për përfshirje sociale.

Tregu i punës i Shqipërisë karakterizohet nga një aktivitet i ulët (61.9% në 2009) dhe një normë punësimi e ulët (53.4%) krahasuar me mesataren dhe objektivat e BE-së, duke reflektuar punësimin



shumë të ulët të femrave. Papunësia llogaritet në rreth 13.8%, por përqindja zyrtare e papunësisë nuk reflekton saktë papunësinë ekzistuese në vend. Përqindja e të papunëve afatgjatë dhe punëkërkuesve të dekurajuar është e lartë, ndërkohë që tregu shqiptar i punës përjeton probleme të konsiderueshme me mospërputhjen ndërmjet aftësive profesionale. Punësimi informal është gjerësisht i përhapur.

Në lidhje me **legjislacionin e punës**, kuadri legjislativ i Shqipërisë mbulon pjesërisht një sërë parimesh bazë të përcaktuara në *acquis*. Megjithatë, duhet të bëhen disa ndryshime në legjislacionin kombëtar me qëllim transpozimin dhe zbatimin e plotë të *acquis* në fushën e së drejtës së punës. Legjislacioni i ngjashëm me direktivat e BE-së për informacionin dhe konsultimin në nivel kombëtar ose ndërkombëtar mungon. (d.m.th Këshillat Evropiane të Punës, Kompanitë Evropiane, Shoqëritë Tregtare Kooperative Evropiane). Nuk ekziston ndonjë legjislacion i cili t'i korrespondojë Direktivës për falimentimin, ose direktivës për transferimin e punëtorëve. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore kanë seksione specifike të cilat marrin vendime në rastet e mosmarrëveshjeve industriale. Një ligj i veçantë rregullon Inspektoratin Shtetëror të Punës.

Ligji për **Shëndetin dhe Sigurinë në Punë**, i miratuar së fundmi, synon të përafrojë Direktivën Kuadër 89/391/KEE. Ky ligj fut koncepte të reja, si detyrimet e punëdhënësit në lidhje me vlerësimin e riskut, së bashku me masat e parandalimit dhe mbrojtjes, shërbimet e siguruar nga organe të jashtme me qëllim mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë si edhe përfshirjen e punonjësve. Ligji përcakton për herë të parë një klasifikim të aksidenteve në punë, në varësi të pasojave të tyre dhe numrin e personave të përfshirë. Zbatimi i tij me efikasitet mbetet për t'u parë. Përpjekje të konsiderueshme do të duhet të bëhen për të siguruar përafrimin e duhur dhe zbatimin efikas të direktivave të BE-së në sektorë të veçantë dhe për çështje të veçanta, si substancat kancerogjene, atmosferat me rrezik shpërthimi, simbolet për shëndetin dhe sigurinë, radiacionin optik artificial, pajisjet me ekrane, dridhjet, reagjentët kimikë, fizikë dhe biologjikë në punë dhe të tjera.

Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP) është përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit për shëndetin dhe sigurinë në punë. ISHP ka 12 drejtori rajonale, por kapaciteti i tij për të zbatuar legjislacionin në të gjithë vendin pengohet nga mungesa e pajisjeve dhe nga fakti që vetëm një nga 24 zyrat vendore të planifikuara është hapur. Sektorë të caktuar janë të përjashtuar nga autoriteti i ISHP-së (si për shembull, bujqësia dhe çështjet të lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë), të cilat ndikojnë konsiderueshëm në zbatimin e standardizuar të *acquis* për shëndetin dhe sigurinë në punë.

**Dialogu social** në Shqipëri është akoma në zhvillim. Dialogu social zhvillohet pothuajse ekskluzivisht në kuadër të Këshillit Kombëtar të Punës (KKP), organi kryesor këshillimor trepalësh. KKP-ja kryesohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe përfshin përfaqësues nga organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve. Organizatat ndërindustriale si edhe ato sektoriale përfaqësohen në këtë Këshill. Qëllimi i tij bazë është shqyrtimi i projekt propozimeve të paraqitura nga qeveria. Një grup pune është krijuar brenda KKP-së për të ndryshuar rregulloren ekzistuese të funksionimit të tij, po deri tani KKP-ja nuk ka funksione dhe përgjegjësi të qarta dhe ka mungesë të autoritetit politikëbërës. Në praktikë, partnerët socialë kanë influencë shumë të kufizuar në politikëbërje dhe vendimmarrje. Përmirësimi i dialogut social në vend do të kërkojë rritjen e profilit të KKP-së, duke përcaktuar kriteret e përfaqësimit të cilat duhet të përmbushen nga partnerët socialë dhe duke përmirësuar planifikimin dhe rregullsinë e takimeve të tij.

Dialogu social dypalësh nuk është shumë i zhvilluar. Marrëveshjet kolektive në nivelin sektorial pothuajse nuk ekzistojnë akoma, me përjashtim të disa seksioneve të sektorit publik. Nuk ekziston asnjë marrëveshje kombëtare kolektive në Shqipëri.

Shqipëria ka një Strategji Sektoriale të Punësimit 2007-2013 dhe po zhvillon aktualisht një plan veprimi kombëtar për punësimin. Sfidat kryesore janë përcaktimi dhe monitorimi i objektivave të realizueshëm dhe sigurimi i angazhimit të duhur të qeverisë dhe i të gjithë partnerëve socialë. **Politika e punësimit** kryesisht përfshin një sërë masash aktive të tregut të punës. Katër politika aktive të tregut të punës (PATP) janë në zbatim: punësimi i subvencionuar për femrat në nevojë; praktikë pune për të diplomuarit e universiteteve; trajnim i subvencionuar në punë; dhe trajnim për njerëzit në nevojë. Si buxheti ashtu edhe numri i pjesëmarrësve të përfshirë në masa të tilla janë të ulëta krahasuar me nevojat për mbështetje aktive. Në përgjithësi, burimet financiare të përdorura në masat aktive janë shumë të ulëta (0.016% të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto të vendit në 2009) krahasuar me mesataren e BE-së prej 0.46% të PPB në vitin 2008. Nuk është kryer asnjë vlerësim i thelluar i PATP-ve deri tani. Efikasiteti i programeve të trajnimit në lidhje me integrimin e pjesëmarrësve në tregun e punës, perceptohet të jetë i ulët, meqenëse trajnimi shpesh është i shkurtër dhe cilësia e tij mbetet problematike. Përforsimi i bashkëpunimit ndërmjet zyrave të punësimit dhe institucioneve të trajnimit dhe vazhdimësia e shqyrtimit të nevojave të aftësive në tregun e punës janë të rëndësishme.

Masat e tregut të punës zbatohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP). Gjatë gjithë periudhës 2009 dhe 2010 personeli u trajnua dhe u miratuan udhëzimet për shërbimet moderne të këshillimit. Megjithatë, zyrat rajonale dhe lokale janë akoma shumë dobët të plotësuara me personel dhe pajisje dhe rrallë mund të ofrojnë shërbime efikase këshillimore. Krijimi i kapaciteteve është i domosdoshëm në shërbimin e punësimit, veçanërisht në nivelin vendor.

Për sa i përket përgatitjeve për **Fondin Social Evropian** (FSE), aktualisht nuk ekziston as fondi social e as fondi i punësimit në Shqipëri, i cili do të ishte i ngjashëm me FSE. Do të duhet marrja e masave për të krijuar këto struktura dhe për të siguruar njëtrajtësinë e kërkuar ndërmjet legjislacionit kombëtar shqiptar dhe kuadrit të politikës së kohezionit. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse për zhvillimin e politikës sociale në Shqipëri, por ministritë dhe shërbimet e tjera kanë gjithashtu, autoritet specifik sektorial. Ekzistojnë strategjitë sektoriale dhe grupet ndërministrorë të punës sigurojnë koordinimin. Megjithatë, duhet të hartohet një strategji e integruar për periudhën afatmesme, me mekanizma koordinimi dhe kuadër institucional efikas për menaxhimin dhe zbatimin e fondeve, duke përfshirë të gjitha grupet e interesit në procesin e planifikimit dhe programimit. Përgatitjet për programimin dhe zbatimin e Komponentit IV të IPA-s për zhvillimin e burimeve njerëzore, me qëllim zbatimin e ardhshëm të FSE-së janë akoma në një fazë fillestare. Në këtë kontekst, kërkojnë vëmendje cilësia dhe konsistenca me prioritetet kombëtare të punësimit dhe politikat sociale. (*Shiko Kapitullin 22 – Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturorë*)

Strategjia Kombëtare për **Përfshirjen Sociale** për 2007-2013 ka nevojë për përmirësim, veçanërisht në formën e objektivave, buxheteve dhe përgjegjësive më të qarta. Koordinimi i iniciativave të përfshirjes sociale nga qeveria mbetet i dobët, si ndërmjet sektorëve ashtu dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe

vendor. Përpyekje të mëtejshme janë të nevojshme për të vlerësuar më mirë nivelin e varfërisë dhe për të siguruar përputhshmërinë me konceptet dhe përjasjet e reja të zhvilluara në nivelin e BE-së.

Plani i Veprimit 2009 për Dekadën e Përfshirjes së Romëve është i strukturuar rreth gjashtë fushave prioritare (arsimimi, punësimi dhe mbrojtja sociale, strehimi dhe infrastruktura, shëndeti, përfshirja sociale dhe mundësitë e barabarta, dhe trashëgimia kulturore).

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara vuan nga alokimi i fondeve buxhetore të pamjaftueshme në nivel qendror dhe vendor. Mungojnë shërbimet e duhura shëndetësore, arsimore, sociale dhe të punësimit për personat me aftësi të kufizuara. Niveli i tyre i përfshirjes është shumë i ulët. Kuotat e vendosura nga ligji për të promovuar aksesin e tyre në punësim, zakonisht nuk plotësohen (madje as edhe në institucione publike). Legjislacioni për personat me aftësi të kufizuara është i copëzuar, me kategori të ndryshme që përfitojnë nga statuset e veçantë. Qeveria po punon për një projektligj i cili do të përfshijë të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

Në fushën e **mbrojtjes sociale**, pavarësisht strukturës së favorshme të popullsisë (relativisht raport i ulët i varësisë së moshës së thyer), sistemi shqiptar i pensioneve ka shënuar deficite vitet e fundit. Lidhjet e dobëta ndërmjet kontributeve të paguara dhe përfitimeve të marra, krijojnë stimuj për evazion kontributësh, veçanërisht nga personat me të ardhura më të larta. Mbulimi i sistemit të pensionit është relativisht i ulët krahasuar me standardet e BE-së. Shqipëria ka vënë në zbatim një sërë reformash me qëllim përmirësimin e mjaftueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tij. Duhet vëmendje për të evituar përkeqësimin e shkallës së zëvendësimit, në planin afatgjatë. Shpenzimet buxhetore për shëndetësinë janë të ulëta krahasuar me nevojat.

Për sa i përket **legjislacionit të anti-diskriminimit**, Kushtetuta ndalon diskriminimin për një numër arsyesh. Ligji i Anti-diskriminimit i vitit 2010, përmirësoi ndjeshëm harmonizimin e legjislacionit me *acquis*. Mbeten për t'u adresuar saktë disa çështje, siç është fusha e veprimit e ndalimit të diskriminimit dhe përjashtimet nga parimi i trajtimit të barabartë. Marrëdhëniet ndërmjet Ligjit të Anti-diskriminimit dhe akteve të tjera ligjore duhet të sqarohen më mirë. Është ngritur zyra e Komisionerit për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit, që është një organ kombëtar për garantimin e barazisë, por atij i mungojnë mjediset dhe buxheti i duhur. Mbetet sfida e madhe krijimi i kapaciteteve të duhura administrative si për masat anti-diskriminim ashtu edhe për masat për barazinë gjinore.

Në fushën e **mundësive të barabarta**, Kodi i Punës dhe Ligji për barazinë gjinore ndalojnë diskriminimin në punësim për shkak të gjinisë. Ligji për Anti-diskriminimin gjithashtu, parashikon dispozita për diskriminimin gjinor. Shqipëria është pjesë e një sërë konventash ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit ndaj femrave.

Legjislacioni bazë ekziston, duke përfshirë atë për pagë të barabartë, aksesin në punësim, mbrojtjen e nënave shtatzëna dhe lejen e lindjes. Janë të domosdoshme ndryshime të mëtejshme ligjore, p.sh leja për baballarët, heqja e mbrojtjes së tepruar për femrat, dhe përmirësimi i legjislacionit për pagën e

barabartë. Moshat e ndryshme të daljes në pension për meshkujt dhe femrat, duhet të përshtaten, dhe sistemi i pensionit duhet të shqyrtohet më tej.

Ligji për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare synon të parandalojë dhe ulë të gjitha format e dhunës në familje dhe të mbrojë anëtarët e familjes që janë viktimat e dhunës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë femrave dhe fëmijëve. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010 dhe një plan veprimi zbatues u miratua në 2007. Plani i veprimit ka tetë prioritetet strategjike dhe është vënë në zbatim nga institucionet qendrore dhe vendore në partneritet me institucionet akademike, median, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është autoriteti përgjegjës për barazinë gjinore. Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore është një organ këshillimor për politikën dhe programet gjinore. Ekziston një rrjet i punonjësve të cilët merren me barazinë gjinore në ministritë dhe në autoritetet e qeverisjes vendore, si dhe po krijohet një mekanizëm referues kombëtar për të siguruar një reagim të koordinuar ndaj dhunës në familje. Janë organizuar fushata ndërgjegjësimi për publikun për barazinë gjinore dhe dhunën në familje. Përfaqësimi i femrave në vendimmarrjen politike është i ulët, por futja e një kuote në Ligjin për barazinë gjinore dhe në Kodin Zgjedhor shënuan një hap përpara në promovimin e pjesëmarrjes së femrave në organet politikëbërëse.

#### *Konkluzioni*

Shqipëria ka filluar harmonizimin e legjislacionit me *acquis* në fushat e të drejtës së punës, trajtimit të barabartë për femrat dhe meshkujt dhe të anti-diskriminimit. Por, nevojiten përpjekje të mëtejshme, sidomos për sa i përket shëndetit dhe sigurisë në punë. Zbatimi efikas i kuadrin ligjor dhe krijimi i kapacitetit të duhur zbatues mbeten sfida të mëdha, veçanërisht në fushën e anti-diskriminimit dhe shëndetit e sigurisë në punë. Dialogu social është akoma në fazën fillestare. Duhet një strategji për të përmirësuar kuadrin dhe mekanizmat institucionalë për dialogun social, së bashku me masat për të krijuar kapacitetin e partnerëve socialë dhe për të caktuar kritere përfaqësimi të qarta. Kapaciteti për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikës në fushat e tregut të punës, punësimit, përfshirjes sociale dhe mbrojtjes sociale, mbetet një sfidë e madhe, pa përmendur pjesëmarrjen e Shqipërisë në Fondin Evropian Social. Krijimi i të dhënave dhe statistikave të besueshme mbetet akoma një problem në shumë fusha, veçanërisht në analizat e tregut të punës. Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme dhe të konsiderueshme për të harmonizuar legjislacionin e saj me *acquis* dhe për ta zbatuar me efektshmëri në periudhën afatmesme.

### **3.20. Kapitulli 20: Politika për ndërmarrjet dhe industrinë**

*Acquis* në kapitullin për ndërmarrjet dhe politikën industriale përbëhet në pjesën më të madhe nga parime dhe rekomandime të politikave, të cilat janë reflektuar në deklaratat, rekomandime dhe konkluzione të Këshillit. Politika e BE-së për ndërmarrjet dhe industrinë, përfshirë politikën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), synon të promovojë konkurrueshmërinë e ekonomisë. Ajo nxitet fuqimisht nga Strategjia Europë 2020, pasuese e strategjisë së Lisbonës për rritje ekonomike dhe punësim dhe nga Akti i Biznesin e Vogël për Europën 2008. Politika industriale dhe e ndërmarrjeve përbëhet nga instrumentet e politikave, përfshirë mbështetjen financiare dhe masat rregullatore. Ajo

përfshin gjithashtu, politikat sektoriale, si rekomandimin për më tepër analiza të shënjestruara të politikës dhe për iniciativa dhe konsultime të reja në nivel sektorial.

Shqipëria ka një bazë industriale relativisht të vogël dhe jo shumë të përparuar, që përbëhet kryesisht nga sektorë me teknologji të ulët (p.sh. shfrytëzimi i minierave, tekstilet dhe veshjet, këpucët, ushqimet, pijet alkoolike dhe mobilitet). Në vitin 2009 industria kontribuoi me 7.2% në PBB (nga të cilat 6.5% nga industria përpunuese). Tekstilet dhe këpucët zunë 1.6% të PBB dhe 30% të punësimit në industri. Sektorë të tjerë të mëdhenj të prodhimit janë produktet ushqimore, pijet alkoolike dhe duhani (1.3% të PBB dhe 12% të punësimit në industri) dhe metalet bazë dhe artikujt prej metali (1.3% të PBB dhe 8.4% të punësimit në industri). Industria kimike, e gomës dhe plastikës japin një kontribut modest në ekonomi. Bujqësia prodhon 16.2% të PBB dhe shërbimet 54.3%.

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SBZHI) përbën kuadrin strategjik për **politikën industriale dhe të ndërmarrjeve** të Shqipërisë. Ajo synon të inkurajojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe dinamik të sipërmarrjes private, produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, investimeve dhe përdorimit më të mirë të burimeve njerëzore, financiare dhe natyrore. Politika industriale bazohet në analizën e konkurrueshmërisë dhe përfshin konsultime të gjera me grupet e interesit. Gjatë hartimit të politikës, Shqipëria ndoqi parimet e BE-së. Në përgjithësi, masat e marra janë në përputhje me nevojat e industrisë, por vëmendje i duhet kushtuar zbatimit efektiv. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (METE) është institucioni kryesor përgjegjës për politikën industriale dhe të ndërmarrjeve. Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (Albinvest) është zëvendësuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. Ashtu si edhe Albinvest, agjencia e re varet nga METE dhe është përgjegjëse për nxitjen e investimeve, përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse profesionale për NVM-të.

Politika e Shqipërisë për NVM-të mbështetet në Kartën Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe Shqipëria është e përkushtuar për zbatimin e Aktit të Europës për Biznesin e Vogël. Përkufizimi i Shqipërisë për 'NVM' është në përputhje me atë të BE-së lidhur me numrin e punonjësve dhe partnerëve të pavarur dhe konceptin e ndërmarrjeve të lidhura. Përqindja e NVM-ve në ekonomi është e ngjashme me atë në BE. Në vitin 2008, vlera e tyre e shtuar në PBB qëndroi në shifrat 63%, kontributi i tyre për eksportet në 69%, ndërsa kontributi i tyre në punësim ishte 82.7%. Klima e përgjithshme e biznesit është përmirësuar si rezultat i përmirësimeve në kuadrin rregullator. Në mënyrë të veçantë, janë përmirësuar procedurat e regjistrimit dhe licencimit të biznesit dhe zyrat e regjistrimit të biznesit (*one-stop shops*) funksionojnë për këto formalitete. Masa pozitive u morën gjithashtu, në formën e reformës së taksave, sipërmarrjes private, arsimit dhe programeve për të mbështetur NVM-të dhe për të nxitur konkurrueshmërinë e tyre. Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për të hequr disa pengesa që kanë mbetur për investimet. Në këtë kontekst, vëmendje i duhet kushtuar luftës kundër korrupsionit dhe ekonomisë informale, duke siguruar shtetin e së drejtës, në mënyrë të veçantë ekzekutimin e kontratave, rritjes së cilësisë së produkteve të eksportuara dhe përmirësimin të kapitalit njerëzor dhe infrastrukturës.

Aktualisht, Shqipëria nuk ka politikë për klasterat, por klasterat po zhvillohen në disa sektorë me ndihmë nga jashtë. Mbështetja për inkubimin dhe bizneset e reja has në vështirës, kryesisht nga mungesa e infrastrukturës dhe prirja e ulët e bankave për t'u dhënë hua bizneseve të sapoformuara, sidomos në zonat rurale.

Ekzistojnë vetëm pak komponentë të politikës për novacionin dhe të mekanizmave mbështetës për novacionin efektiv. Iniciativat aktuale në lidhje me strategjitë, qeverisjen dhe mbështetjen, si ngritja e Agjencisë për Kërkimin, Teknologjinë dhe Novacionin, dhe planifikimi i ngritjes së Qendrës së ndërmjetësimit dhe novacionit të biznesit (BRIC), janë shenja inkurajuese të zhvillimit të kuadrit institucional për politikën e novacionit në Shqipëri.

Në lidhje me **instrumentet e politikës industriale dhe të ndërmarrjeve**, Shqipëria po merr pjesë në Programin e Sipërmarrjeve dhe Novacionit (EIP), si pjesë e Programit Kuadër të BE-së për Konkurrueshmërinë dhe Novacionin, por nuk është ende pjesë e Rrjetit Evropian të Sipërmarrjeve ose e instrumenteve financiare të EIP-së. Në përgjithësi, aksesit në financime mbetet i kufizuar. Sistemi bankar financon kryesisht kompanitë e mëdha dhe ka tendencën që të jetë konservativ ndaj NVM. Kredia për sektorin privat u rrit në 2009, por kreditë ende jepen kryesisht për blerjen e pajisjeve dhe fabrikave. Bizneset e sapoformuara nuk kanë pothuaj aspak akses në kreditim nga bankat dhe mbështeten në sektorin jobankar dhe subjektet që ofrojnë kredi të vogla. Kërkesat e bankave për kolateralin e kredisë luhaten nga 120% deri në 150% të kredisë, dhe interesat e kredisë janë të larta. Shqipëria nuk e ka transpozuar ende Direktivën për të luftuar pagesat e vonuara në transaksionet tregtare.

Në **politikat sektoriale**, Shqipëria ka filluar iniciativa në sektorët e shfrytëzimit të minierave, turizmit, veshjeve dhe këpucëve. Minierat gjeneruan 0.8% të PBB në 2008 dhe 9% të punësimit në industri. Megjithatë, duhet të merret parasysh se të ardhurat nga minierat janë shumë ciklike. Tekstilet dhe këpucët zunë rreth 43% të totalit të eksporteve. Megjithatë, sektorët e veshjeve dhe këpucëve varen shumë nga trafiku i përpunimit nga jashtë vendit i bazuar në aktiviteti montimi me kosto të ulët të krahut të punës, si dhe duke eksportuar kryesisht, produkte me vlerë të shtuar të ulët.

Turizmi kontribuoi me rreth 4.1% në PBB dhe 3.3% për punësimin në 2008. Ky sektor po rritet me shpejtësi. Shqipëria ka përcaktuar qëndrueshmërinë si parimin e përgjithshëm kryesor në këtë sektor, gjë që është në përputhje me politikën e BE-së.

#### *Konkluzioni*

Politika e Shqipërisë për industrinë dhe NVM është gjerësisht në përputhje me parimet e BE-së. Megjithatë, i duhet kushtuar vëmendje sfidave të mbetura që janë përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe heqja e pengesave të mbetura ndaj investimeve; dhe duhet të transpozohet Direktiva për luftën kundër pagesave të vonuara në transaksionet tregtare. *Në tërësi*, pritjet që në periudhën afatmesme Shqipëria të plotësojë kërkesat e *acquis* nëse vazhdon përpjekjet me këtë ritëm.

### **3.21. Kapitulli 21: Rrjetet Trans-Evropiane**

Ky kapitull trajton politikën e rrjeteve trans-evropiane në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës së energjisë, përfshirë udhëzimet e BE-së për zhvillimin e rrjeteve ndër-evropiane dhe masat mbështetëse për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët. Qëllimi i ngritjes dhe i zhvillimit të rrjeteve trans-evropiane si dhe nxitja e ndërlidhjes dhe ndërveprimit të duhur të rrjeteve

kombëtare është që të shfrytëzohet plotësisht tregu i brendshëm dhe të kontribuohet në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në Bashkimin Evropian.

Në lidhje me **rrjetet e transportit** trans-evropian (TEN-T), Shqipëria ka për të përballuar një sfidë shumë të madhe për shkak të burimeve të kufizuara financiare, terrenit të saj malor dhe përqendrimit të popullsisë e të veprimtarive kryesore ekonomike në pjesën perëndimore të vendit. Ndërkohë që vendi po shënon një rritje të shpejtë ekonomike, shumë i rëndësishëm është zhvillimi paralel i një rrjeti të përshtatshëm transporti. Kjo duhet bërë në kuadrin Rrjetit Bazë të Europës Juglindore dhe të rrjetit të ardhshëm TEN-T. Në rastin e *rrjetit bazë rrugor*, progres shumë i madh është bërë në cilësinë dhe densitetin e tij. Deri tani *rrjeti bazë hekurudhor* është lënë pas dore dhe duhen përmirësime të shpejta të shigjetuara, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Për sa i përket lidhjeve me *portet detare*, duhet të vazhdojë rikonstrukcioni i Portit të Durrësit, porti kryesor tregtar i Shqipërisë. Duhet caktuar burime të mjaftueshme financiare për mirëmbajtjen e *infrastrukturës së transportit*. Së fundmi, duhet të sigurohet aksesin nga zonat e largëta rurale në rrjetin bazë duke vazhduar përmirësimin e rrjetit dytësor.

Në lidhje me **rrjetet trans-evropiane të energjisë** (TEN-E) në Shqipëri, vetëm transmetimi i energjisë elektrike është zhvilluar deri tani, ndërkohë që tregu i gazit mungon. Rrjeti i tubacionit të *gazit* shqiptar konsiston në 400 km linja prodhimi në jug që furnizojnë konsumatorë të mëdhenj kombëtarë; pjesa më e madhe e infrastrukturës nuk përdoret më. Janë studiuar tashmë shumë ndërlidhje të mundshme me gaz; në kuadrin e procesit të Komunitetit të Energjisë janë identifikuar prioritetet e infrastrukturës. Edhe pse një ligj për gazin u miratua në vitin 2008 për zhvillimin e një sektori të plotë të gazit natyror në vend, Shqipëria duhet të zhvillojë më tej kuadrin ligjor për gazin, si një parakusht për shtrirjen e mëtejshme të tregut të gazit dhe për pjesëmarrjen në rrjetin rajonal të gazit. Shqipëria ka shprehur interes në dy projekte: gazsjellësi Jon-Adriatik (përgjatë bregdetit Adriatik deri në Kroaci, që është një element i Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë) dhe gazsjellësi Trans-Adriatik (që synon lidhjen e Greqisë me jugun e Italisë). Në lidhje me sistemin e transmetimit të *energjisë elektrike* në Shqipëri, profili i tensionit në rrjetin kryesor 400kV dhe 220kV është pothuajse në përputhje me kriteret e UCTE. Megjithatë, sistemi ka nevojë për fuqizim të *përgjithshëm* të rrjetit dhe përmirësim të masave operacionale. Ulja e tanishme e tensionit në rrjetin e transmetimit kufizon konsumin e përgjithshëm neto dhe disa linja të transmetimit janë të mbingarkuara. Sistemi i Shqipërisë është i lidhur me Greqinë (400kV) dhe Malin e Zi (220kV), dhe është në ndërtim e sipër ai me Kosovën (220 kV) dhe Malin e Zi (400kV), por disa pika ndërlidhjeje duhet të përmirësohen dhe finalizohen. Aksesin në energjinë elektrike të importuar është i kufizuar për shkak të kapaciteteve ndërlidhëse, si dhe në njëfarë mase edhe nga procedurat ekzistuese të caktimit të kapacitetit, që duhen adresuar. Dy projekte me interes të përbashkët janë identifikuar në udhëzimet e TEN-E: "Lidhja e energjisë elektrike midis Elbasanit/Shqipëri dhe Podgoricës/Mali i Zi" dhe "Lidhja e energjisë elektrike midis Kardias/Greqi dhe Elbasanit/Shqipëri". I pari është pranë përfundimit. Është thelbësore të përmirësohet koordinimi i investimeve për sistemin e transmetimit me vendet fqinje, kryesisht me Greqinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovën, mbi baza dypalëshe e në kuadrin e Komunitetit të Energjisë.

Shqipëria nuk bën pjesë në **rrjetin e telekomunikacionit** trans-evropian. Qeveria ka shprehur interes për hyrjen në Programin e Mbështetjes së Politikave të Komunikimit dhe Informacionit në kuadrin e Programit të Konkurrueshmërisë dhe Novacionit (CIP).

## Konkluzioni

Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme në fushën e transportit trans-evropian dhe të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme në fushën e rrjeteve trans-evropiane të energjisë për të siguruar harmonizimin me *acquis*, si dhe duhet të zbatojë me efektshmëri në periudhën afatmesme. Shqipëria ka nevojë të zhvillojë infrastrukturën e saj të transportit në përputhje me volumin e pritshëm të trafikut. Hekurudhat kërkojnë një vëmendje të posaçme, pasi ato mund të luajnë rol themelor në periudhën afatmesme dhe duhet të lidhen me rrjetin ekzistues të Malit të Zi. Duhet të gjendet balanca midis përmirësimit të nevojshëm të rrjetit bazë dhe lidhjeve të tij nga njëra anë, dhe përfitimeve nga disa projekte që duhen marrë më mirë në konsideratë, nga ana tjetër. Shqipëria po merr pjesë aktive në Observatorin e Transportit të Europës Juglindore (SEETO) dhe duhet të vazhdojë të bashkëpunojë më fqinjët e saj me synim që të përcaktojnë së bashku, projektet me interes rajonal. Shqipëria duhet të rrisë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe të krijojë mundësitë për përdorimin e gazit natyror në ekonominë shqiptare, me qëllim që lejojë krijimin e një infrastrukture eficiente dhe të qëndrueshme.

### 3.22. Kapitulli 22: Politika rajonale dhe bashkërendimi i instrumentëve strukturorë

*Acquis* për politikën rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturorë përbëhet kryesisht nga rregulloret kuadër dhe ato zbatuese, që nuk kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar. Ato përcaktojnë rregullat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të financuara nga Fondet Strukturorë (Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal dhe Fondi Social Evropian) dhe - për disa Shtete Anëtare - Programet e Fondit të Kohezionit që reflektojnë organizimin territorial të secilit vend. Këto programe negociohen dhe miratohen me Komisionin. Zbatimi është një përgjegjësi që ndahet midis Shteteve Anëtare dhe Komisionit. Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë dispozitat e *acquis* kur përzgjedhin dhe zbatojnë projektet, për shembull, në fushat e prokurimit publik, konkurrencës dhe mjedisit, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, si dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në lidhje me **kuadrin ligjor**, çështja e zhvillimit rajonal nuk është rregulluar në mënyrë uniforme. Nuk ka një ligj të veçantë për zhvillimin rajonal, megjithëse nuk është i detyrueshëm ekzistenca e një ligji të tillë për të zbatuar programe të politikave rajonale. Megjithatë, autoritetet shqiptare po përgatisin aktualisht një ligj, i cili do të hedhë themelet për politikën e zhvillimit rajonal në Shqipëri. Aktualisht, operacionet e zhvillimit rajonal të fragmentarizuara planifikohen në mënyrë të koordinuar nëpërmjet Fondit Rajonal për Zhvillimi që është i sapokrijuar.

Shqipëria ka tre nivele qeverisjeje: nivel kombëtar/qendror, qarku dhe vendor (bashkitë). Organet e vetëqeverisjes të zgjedhura drejtpërsëdrejti janë vetëm në nivel qendror dhe vendor. Territori i Shqipërisë është i organizuar në 12 qarqe dhe 373 njësi të qeverisjes vendore. Administrata shtetërore është e ndarë në 36 rrethe me qëllim kryerjen e detyrave publike nën kontrollin shtetëror. Në Shqipëri nuk ka as qarqe administrative e as vetëqeverisëse që mund t'i korrespondojnë nivelit 2 në klasifikimin NUTS; qarqet janë ekuivalente me nivelin 3 të NUTS-it.

Ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore përcakton se bashkitë janë përgjegjëse për hartimin e strategjive të zhvillimit dhe përzgjedhjen dhe zbatimin e projekteve që lidhen me to.



Fondet për financimin e bashkive sigurohen nga vjelja e taksave vendore dhe transferuat nga buxheti i shtetit. Shqipëria është në procesin e decentralizimit.

Ligji për Buxhetin nuk parashikon shprehimisht programimin e buxhetit shumëvjeçar por alokimet e fondeve për politika e projektet shumëvjeçare koordinohen në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe parashikohen në Ligje Buxhetore vjetore, duke siguruar kështu financimin për investimet shumëvjeçare.

Aktualisht Shqipëria po përgatitet për komponentët III (zhvillimi rajonal) dhe IV (zhvillimi i burimeve njerëzore) të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA), që do të jetë gati sapa Shqipërisë t'i jepet statusi i vendit kandidat. Synimi kryesor i komponentëve III dhe IV të IPA-s është të përgatisë vendet candidate për menaxhimin e instrumenteve financiarë të Fondit Strukturor dhe Kohezionit pas pranimit në BE. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, autoritetet shqiptare miratuan një numër vendimesh për krijimin e **kuadrit institucional** për planifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e asistencës së ardhshme sipas komponentëve III dhe IV të IPA-s. Koordinator strategjik është Zëvendësministri i Ministrisë së Integritit, ndërsa strukturat operuese janë ngritur në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (për komponentin III) dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (për komponentin IV). Drejtuesit e këtyre strukturave janë emëruar. Strukturat e tjera, të krijuara për asistencën e mëparshme të BE-së sipas komponentin I të IPA-s, do të mbeten, konkretisht Koordinatori Kombëtar i IPA-s, Zyrtari Kombëtar Autorizues dhe Fondi Kombëtar. Kapacitetet e ngritura në Njësinë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (CFCU) do të shërbejnë si bazë për zbatimin e programeve të ardhshme të komponentëve III dhe IV të IPA-s. Autoriteti i Auditit është një organ i sapokrijuar. Pavarësia e tij funksionale ka nevojë akoma të verifikohet dhe kapaciteti i tij duhet zhvilluar me qëllim që të plotësojë detyrat e tij audituese.

Duhet të zhvillohen **kapacitetet administrative** për përballimin e kërkesave të politikës strukturore të BE-së. Duhet të merret në punë një staf i kualifikuar dhe duhet zhvilluar kapaciteti i fortë menaxhues në të gjitha nivelet e administratës që merret me Fondet Strukturore. Për menaxhimin e këtij procesi, duhen formuluar strategjitë e trajnimit dhe zhvillimit organizativ dhe duhen alokuar burimet e nevojshme financiare. Mekanizmave të menaxhimit, kontrollit dhe monitorimit të shëndoshë financiar duhet të jepen burimet e nevojshme njerëzore, në mënyrë që ato të japin rezultatet e pritshme.

Përvoja me fondet Komponenti I të IPA-s është e kufizuar dhe duhen përpjekje të mëtejshme për të rritur kapacitetin administrativ që mundëson menaxhimin dhe zbatimin pa probleme të projekteve të Komponentëve III dhe IV të IPA-s. Vëmendje i duhet kushtuar në këtë drejtim, krijimit të një vargu projektsh të pranueshme për financim. Po kështu, kapaciteti në nivel vendor dhe nivel qarku dhe në bashki duhet të rritet në mënyrë të konsiderueshme.

Një numër dokumentesh **programimi** janë miratuar nga qeveria për zbatimin dhe promovimin e politikave sektoriale për qëllime të zhvillimit rajonal. Programi Kombëtar për Zhvillim dhe Integritim 2007-2013 është strategjia kryesore kombëtare planifikuese për Shqipërinë. Ajo sintetizon përparësitë strategjike të përcaktuara në strategji të ndryshme sektoriale. Këto dokumente mund të përbëjnë një

bazë të mirë për hartimin e një kuadri të koherencës strategjike për IPA-n. Përgatitja e kuadrit të koherencës strategjike po vazhdon dhe përgatitja e programeve operationale ka filluar kohët e fundit.

Hartimi i strategjive, duke përfshirë strategjitë për zhvillimin rajonal, koordinohet nëpërmjet Sistemit të Planifikimit të Integruar, që angazhon ministrinë e linjës dhe aktorët e tjerë në përcaktimin e politikave. Financimi sigurohet nga Programi Buxhetor Afatmesëm dhe zbatimi koordinohet dhe monitorohet nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj.

Është e nevojshme të krijohen partneritete, pasi procesi i planifikimit dhe programimit duhet të ketë pjesëmarrje të plotë të partnerëve ekonomikë dhe shoqërorë. Instrumentet e ardhshëm politikë mbeten për t'u përcaktuar, në mënyrë që të sigurohet konsultimi i vazhdueshëm i partnerëve shoqërorë dhe ekonomikë dhe pjesëmarrja e gjerë e qytetarëve dhe grupeve të interesit nëpërmjet konsultimeve të hapura dhe takimeve publike.

Puna për komponentët I dhe II të IPA-s u ka mundësuar autoriteteve shqiptare të familjarizohen me kërkesat e **monitorimit dhe vlerësimit** për programet dhe projektet e bashkëfinancuara të BE-së. Kapaciteti vlerësues është shumë i dobët në Shqipëri. Duhet të ketë sisteme dhe mekanizma të përshtatshëm kombëtarë për të vlerësuar dhe monitoruar cilësinë dhe ndikimin e programeve të zhvillimit. Për qëllime të vendimmarrjes dhe raportimit, aktualisht administrata shqiptare po fut një sistem të menaxhimit të informacionit (MIS) për komponentët I dhe II të IPA-s, i cili mund të jetë një bazë e mirë edhe për komponentët III dhe IV.

Është planifikuar një ligj që rregullon metodologjinë, rregullat, procedurat dhe strukturat administrative për veprimtarinë e **menaxhimit dhe kontrollit financiar** në sektorin publik. Në kuadrin e IPA-s, Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO), si kryetar i Fondit Kombëtar (NF), do të jetë përgjegjës për menaxhimin e mirë financiar të fondeve të BE-së sapo vendi të lejohet të menaxhojë fondet e IPA-s në mënyrë të decentralizuar. Kjo përgjegjësi i jepet Zëvendësministrit të Financave. Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA) merr përgjegjësinë e përgjithshme të menaxhimit financiar të fondeve të BE-së dhe është përgjegjës për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare. ZKA është gjithashtu, përgjegjës për funksionimin me efektivitet të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të IPA-s.

Sapo është krijuar Autoriteti i Auditit si agjenci e pavarur që i raporton Ministrinë të Financave. Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk auditon fondet e BE-së në Shqipëri. Njësitë e auditit të brendshëm dhe nëpunësit e parregullsive në organet e IPA-s duhen fuqizuar. *(Shiko po ashtu Kapitullin 32: Kontrolli Financiar)*

### *Ndikimi*

Shqipëria kishte PBB nominale prej 7.8 miliard Euro në 2007. Kjo është e barabartë me rreth 0.06% të PBB së BE-27 si dhe me afër 0.6% të popullsisë së BE-27. Duke marrë parasysh madhësinë e ekonomisë dhe popullsinë së saj, pranimi i Shqipërisë do të ulte fare pak mesataren për frymë të shifrave të PBB të BE-së dhe si rrjedhim do të kishte ndikim të vogël në klasifikimin e rajoneve.

Duke pasur parasysh se PBB për frymë është nën mesataren e BE-së, Shqipëria do të fitonte të drejtën për të marrë kontribute të BE-së nga Fondi i Kohezionit sipas objektivit të konvergjencës. Pas një vlerësimi paraprak të situatës ekonomike të Shqipërisë dhe duke marrë parasysh rregullat aktuale për limitin e fondeve strukturore, ndikimi i parashikuar i anëtarësimit të mundshëm të Shqipërisë në politikën e kohezionit konsiderohet i menaxhueshëm.

### *Konkluzioni*

Në tërësi, instrumentet dhe strukturat e politikës së kohezionit janë në një fazë shumë fillestare të zhvillimit në Shqipëri. Duhet ngritur strukturat institucionale dhe duhet forcuar në mënyrë të konsiderueshme kapaciteti i tyre administrativ për të lejuar pjesëmarrjen e suksesshme në komponentin e zhvillimit rajonal të IPA-s dhe në politikën e kohezionit të BE-së. Një fillim pozitiv është bërë me përgatitjet për komponentët III dhe IV të IPA-s, megjithatë, nevojiten përpjekje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme për krijimin e procedurave të mira dhe strukturave administrative kompetente për ta lejuar kështu Shqipërinë, që brenda një periudhe afatmesme, të zbatojë rregullat e BE-së dhe të kanalizojë fondet nga instrumentet strukturore të BE-së.

### **3.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore**

Politikat e BE në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore të njeriut kanë si qëllim të ruajnë dhe zhvillojnë më tej Bashkimin si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Krijimi i një gjyqësori të pavarur dhe efikas ka rëndësi shumë të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe standardet e larta të gjykimit nga gjykatat janë thelbësore për ruajtjen e shtetit ligjor. Kjo gjë kërkon angazhim të paepur për eliminimin e influencave të jashtme ndaj gjyqësorit, si dhe mbështetjen e tij me trajnime dhe burime financiare të mjaftueshme. Duhet të ekzistojnë garancitë ligjore për një proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, Shtetet Anëtare duhet të luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive, meqenëse ai paraqet kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe shtetin ligjor. Nevojitet kuadër i plotë ligjor dhe institucione të besueshme për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin dhe frenimin e korrupsionit. Shtetet Anëtare duhet të garantojnë respektimin e të drejtave themelore si dhe të drejtat e qytetarëve të BE-së siç garantohen nga *acquis* dhe Karta e të Drejtave Themelore të Njeriut.

Parimi i *pavarësisë* së **gjyqësorit** është i mishëruar në Kushtetutë dhe gjen zbatim në legjislacionin përkatës. Megjithatë, ka pengesa për pavarësinë e plotë të gjyqtarëve.

Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Nevoja për shumicë të thjeshtë në vend të miratimit me shumicë të cilësuar nga Parlamenti ka çuar në politizimin e procesit të emërimit për të dy gjykatat, gjë e cila dëmton neutralitetin dhe pavarësinë e këtyre institucioneve.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), si organi që administron gjyqësorin, është përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin dhe vlerësimin profesional të gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit. KLD nuk ka kompetenca mbi Gjykatën e Lartë, e cila emërohet politikisht dhe ka një pozitë të posaçme në sistemin gjyqësor. Një shkëputje e tillë e gjykatës më të lartë nga gjykatat e shkallëve të tjera dobëson pavarësinë e të gjithë sistemit.

Emërimi i parë si dhe ri-caktimi i gjyqtarëve të gjykatave të rretheve dhe gjykatave të apelit bëhet nga Presidenti me propozimin e KLD bazuar në kriteret e parashikuara në ligj dhe procedurat e konkurrencës për përzgjedhjen e tyre. Megjithatë, KLD nuk jep vendime të arsyetuara, përveç rasteve disiplinore. Gjithashtu, nuk ka procedura ose dispozita për kandidatët që të ankimojnë këto vendime. Mungesa e vendimeve transparente si dhe mungesa e dispozitave ankimuese ose e mekanizmave të tjerë për rishikim gjyqësor sjell rrezikun e ndërhyrjeve politike dhe mundësinë e të qenit i cenueshëm ndaj korrupsionit, duke kufizuar në këtë mënyrë pavarësinë e gjyqtarëve. Me qëllim forcimin e pavarësisë së tyre, gjyqtarët përfitojnë imunitet të plotë me ligj. Imuniteti mund të hiqet vetëm me vendim të KLD-së, duke i bërë hetimet më të vështira. Veç kësaj, kjo përbën një nga faktorët kryesorë të rrezikut të korrupsionit në gjyqësor.

Sistemi gjyqësor ka pavarësi financiare në Republikën e Shqipërisë. Gjykatat kanë buxhet të veçantë të cilin ato e propozojnë në bazë të ligjit dhe e administrojnë vetë. Megjithatë, fondet buxhetore për gjyqësorin në përgjithësi, janë të pamjaftueshme.

*Inspektimet* e gjyqësorit bëhen nga dy institucione, nga Inspektoratet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Në një farë shkalle, ka mbivendosje dhe mungesë koordinimi midis dy inspektorateve. Vlerësimi i gjyqtarëve nga KLD ka mungesë transparence. Procedurat disiplinore fillohen vetëm nga Ministri i Drejtësisë pa mekanizma ose baraspeshë kontrolli; kjo sjell rrezikun e ndërhyrjeve politike.

Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e shumicës së thjeshtë të Parlamentit, duke e bërë këtë emërim të hapur ndaj ndërhyrjeve politike. Prokurorët e tjerë emërohen nga Presidenti me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Sistemi i prokurorisë është shumë i centralizuar dhe në formë piramide. Konsiderohet se nuk i përket as pushtetit gjyqësor dhe as atij ekzekutiv. Pavarësia e prokurorëve garantohet gjatë fazës së gjykimit, por është e kufizuar gjatë fazës së hetimit duke ulur në këtë mënyrë efikasitetin e hetimeve.

Shkolla e Magjistraturës është përgjegjëse për *trajnimin* fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Parimi i barazisë përpara ligjit dhe e drejta e gjykimit nga gjykata të *paanshme* garantohen nga Kushtetuta. Kodi i Etikës Gjyqësore u miratua nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në vitin 2000, dhe mbikëqyret nga ky organ që nga ajo kohë. Funksionon një sistem kompjuterik i menaxhimit të çështjeve dhe në shumicën e gjykatave bëhet caktimi rastësor i çështjeve penale dhe civile. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të krijuar një sistem të integruar të menaxhimit të çështjeve, plotësisht të standardizuar dhe harmonizuar dhe funksional në të gjitha gjykatat.

Gjyqësori vuan nga problemet e *transparencës* dhe *efikasitetit*. Administrimi i gjykatave është i dobët për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare, sidomos në gjykatat e shkallës së parë. Nuk ka organizim dhe trajnim të mirë dhe të mjaftueshëm për administratorët e gjykatave. Numri i çështjeve të papërfunduara është problematik, procedurat gjyqësore janë të ngadalta dhe numri i seancave për çështje është i lartë. Kushtet e punës në gjykata përgjithësisht, janë të këqija dhe seancat shpeshherë zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, duke penguar transparencën dhe efikasitetin. Kushtet e

punës janë shqetësuese edhe për sigurinë e gjyqtarëve. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë është duke përgatitur ndryshime në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin Civil me synimin që të trajtojë këto probleme.

Shqipëria nuk ka *strategji* gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë për sektorin e gjyqësorit për të vazhduar dhe përmbushur reformat në këtë fushë.

*Zbatimi* i vendimeve është i dobët, sidomos në rastet kur të paditurit janë institucione shtetërore. Sistemi i ri i përmbartimit privat nuk ka filluar ende të funksionojë dhe nuk ka ndonjë sistem të mirë të menaxhimit të çështjeve të përmbartimit.

*Aksesi në drejtësi* është përmirësuar me miratimin e Ligjit për ndihmën juridike të vitit 2008, i cili parashikon asistencë juridike falas në procedimet civile, penale dhe administrative për kategori të ndryshme personash. Megjithatë, ligji nuk është zbatuar ende me efikasitet. Veç kësaj, tarifatat e përgjithshme për administrimin gjyqësor u rritën në mënyrë të konsiderueshme në mars të vitit 2010, duke kufizuar aksesin në drejtësi për personat më pak të favorizuar ekonomikisht.

*(Shiko gjithashtu Kriterin Politik - Demokracia dhe shteti ligjor)*

Në lidhje me **politikat dhe masat anti-korrupsion**, Shqipëria po ndërmerr përpjekje të koordinuara.

Shqipëria është palë në Konventën Penale dhe Civile të Këshillit të Europës për Korrupsionin, në Konventën për Pastrimin e Parave, Kontrollin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Produkteve të Krimin. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit dhe është anëtare që nga prilli i vitit 2001 e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO). Nga 13 rekomandimet e GRECO-s në raportin për Shqipërinë, dy rekomandimet në lidhje me rregullat për financimin e partive politike nuk janë adresuar ende.

Shqipëria ka miratuar disa ligje dhe masa anti-korrupsion. Kodi Penal dënon format kryesore të korrupsionit dhe Kodi i Procedurës Penale parashikon mjetet kryesore në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë edhe metodat speciale hetimore. Në vitin 2008 u përgatit një Strategji Ndër-sektoriale kundër Korrupsionit dhe që nga ajo kohë edhe dy plane veprimi për të zbatuar këtë strategji. Shqipëria ka një ligj për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të nëpunësve civilë dhe një ligj për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike. Shqipëria duhet të zbatojë me rigorozitet strategjinë kundër korrupsionit dhe planet e veprimit, si dhe legjislacionin relevant.

Një numër institucionesh dhe agjencish kryesore janë krijuar për luftën kundër korrupsionit. Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Anti-Korrupsionit kryen kontrole të brendshme të administratës dhe është organi administrativ përgjegjës për koordinimin e strategjisë kundër korrupsionit. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë është përgjegjës për marrjen dhe verifikimin e deklaratave të pasurisë së zyrtarëve publikë dhe nëse pozicioni i tyre është në përputhje me ligjin për konfliktin e interesave. Në Ministrinë e Brendshme, është krijuar Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm për të hetuar çështjet e korrupsionit në polici. Janë krijuar Njësitë e Përbashkëta Hetimore për krimin ekonomik dhe korrupsionin, me qëllim përmirësimin e koordinimit

të organeve të zbatimit të ligjit. Këto Njësi po bëhen edhe më shumë efikase në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve të korrupsionit.

Masat shtesë përfshijnë krijimin e sistemeve elektronike të prokurimit për të ulur kontaktet personale ndërmjet autoriteteve kontraktuese dhe ofertë-kërkuesve, si dhe reformat në sektorin e arsimit (p.sh. databaza elektronike për regjistrimet dhe provimet pa emër të pranimit) dhe në sektorin e shëndetësisë (p.sh. rregullore e re për sistemin e referimeve). Efikasiteti i këtyre masave mbetet për t'u parë në praktikë.

Pavarësisht kuadrit ligjor dhe institucional të përmirësuar, korrupsioni mbetet i përhapur në Shqipëri. Fushat me shqetësim të veçantë janë mitmarrja dhe korrupsioni në gjyqësor, në sektorin e shëndetësisë dhe në sistemin e kthimit dhe kompensimit të të drejtave të pronësisë. Mungesa e transparencës në fushën e financimit të partive politike, duke lejuar ndikimin e papërshtatshëm në politikë, është problem i konsiderueshëm. Mangësitë kryesore përfshijnë dobësitë në kuadrin ligjor të luftës kundër korrupsionit, imunitetin e plotë që kanë një numër i madh zyrtarësh publikë (përfshi gjyqtarë, ministra dhe deputetë), duke paraqitur një pengesë serioze në hetimin e korrupsionit, si dhe mangësitë në strukturën institucionale dhe në kapacitetet administrative. Burimet në luftën kundër korrupsionit mbeten të kufizuara.

Është hetuar dhe ndjekur penalisht një numër madhni rritje i çështjeve të korrupsionit, por numri i dënimeve mbetet i ulët për këto raste. Nuk ka prova që korrupsioni në nivelet e larta po hetohet, ndiqet penalisht dhe gjykohet. Mungojnë rezultate konkrete në lidhje me dënimet e dhëna për korrupsion në të gjitha nivelet.

*(Shiko Kriterin Politik – Demokracia dhe shteti ligjor)*

Shqipëria është mjaft e avancuar në ngritjen e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional për mbrojtjen e **të drejtave themelore të njeriut** dhe vazhdon ta përmirësojë atë. Zyra e Avokatit të Popullit funksionon mirë dhe është plotësuar së fundi me emërimin e Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi. Megjithatë, funksionimi i këtyre institucioneve pengohet nga vonesat në caktimin e personelit në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe emërimin e Avokatit të ri të Popullit, të dyja në pritje që nga fillimi i vitit 2010. Vëmendja duhet të përqendrohet në zbatimin e legjislacionit dhe pavarësinë reale të organeve për të drejtat e njeriut, përfshi edhe përmes alokimit të përshtatshëm të burimeve.

Shqipëria garanton *të drejtën e jetës* dhe ka hequr dënimin me vdekje në të gjitha rrethanat. Megjithatë, pavarësisht uljes në numër, rastet e vrasjeve nga gjakmarrja vazhdojnë të kenë pasoja për një pjesë të popullsisë.

Për sa i përket *sistemit të burgjeve*, është e nevojshme të vazhdojë përmirësimi i infrastrukturës për ta përputhur atë me standardet europiane dhe për të garantuar urgjentisht trajtimin adekuat dhe vendosjen në mjedise të përshtatshme të të paraburgosurve me sëmundje mendore. Në Shqipëri funksionon një sistem i përshtatshëm për parandalimin e *torturës* dhe *keqtrajtimit*, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin dhe partneriteteve me OJF-të. Megjithatë, rastet e

keqtrajtimit mbeten një çështje shqetësuese, në veçanti gjatë ndalimit nga policia. Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe prokurorisë ka nevojë të përmirësohet.

Pavarësisht garancive kushtetuese që rregullojnë *lirinë e shprehjes (përfshi median)* dhe ekzistencës së një media pluraliste, presionet politike dhe ato të biznesit vazhdojnë të pengojnë pavarësinë e medias. Klima e përgjithshme e medias duhet të përmirësohet, sidomos duke adresuar problemin e informalitetit të kontratave dhe mungesën e transparencës për pronësinë e mediave. Dispozitat e Kodit Penal në lidhje me shpifjen duhet të shfuqizohen.

*Liria e grumbullimit dhe organizimit* është e garantuar dhe shoqëria civile funksionon në mjedis jo-kufizues. Megjithatë, sektori i OJF-ve mbetet i dobët.

*Liria e besimit* është e garantuar me Kushtetutë dhe respektohet gjerësisht, duke siguruar marrëdhënie të mira ndër-fetare. Duhet të sigurohet kthimi i pronave që i përkasin komuniteteve fetare.

Për sa i përket *politikave anti-diskriminuese*, miratimi i Ligjit për mbrojtjen kundër diskriminimit është një hap i rëndësishëm që garanton trajtim të barabartë për të gjithë. Duhet të sigurohet zbatimi i tij, në veçanti nëpërmjet akordimit të fondeve të duhura për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Të drejtat e lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe personave *transgender* mbrohen nga ky ligj. Megjithatë, ky komunitet vazhdon të përballet me një diskriminim shumë të përhapur dhe janë raportuar disa raste dhune. Kjo çështje ka nevojë të adresohet.

Për sa i përket *të drejtave të grave*, kuadri ligjor funksionon dhe futja e kuotës gjinore për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në politikë është një hap pozitiv. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre efektive mbetet e kufizuar. Shumë gra diskriminohen në fushën e punësimit dhe aksesit në ndihmën ekonomike nuk garantohet plotësisht. Integrimi gjinor ka nevojë të përmirësohet. Pavarësisht rritjes së numrit të çështjeve të raportuara për dhunën në familje pas miratimit të Ligjit kundër dhunës në familje dhe strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe eliminimin e dhunës në familje, ky fenomen vazhdon të ketë ndikim në shumë familje dhe jo të gjitha rastet e dhunës raportohen, në veçanti ato në zonat rurale. Duhet t'i kushtohet vëmendje rritjes së numrit të ndjekjeve penale, aksesit në drejtësi, mbrojtjes së viktimave dhe programeve për ri-integrimin e tyre në shoqëri.

Për sa i përket *të drejtave të fëmijëve*, Shqipëria në mënyrë progresive po ngre njësitet e të drejtave të fëmijëve në të gjithë Këshillat e Qarkut, dhe deri tani ka ngritur njësitet për mbrojtjen e fëmijëve në 15 bashki. Megjithatë, Shqipërisë i mungon sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve, dhe nuk është miratuar ende një ligj i plotë, integral për të drejtat e fëmijëve. Sistemi i drejtësisë për të miturit është reformuar, por atij i mungojnë akoma masat e duhura për mbrojtjen e fëmijëve nën moshën 14 vjeç. Fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë mbeten probleme shqetësuese.

Zbatimi i strategjisë kombëtare *për personat me aftësi të kufizuara* është i ngadaltë dhe këta persona vazhdojnë të vuajnë nga diskriminimi dhe përjashtimi social. Duhet të paraqitet një ligj kuadër që mbulon të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe të zbatohen kuotat ligjore në lidhje me punësimin. Për sa i përket shëndetit mendor, duhet të vazhdojë procesi i de-institucionalizimit dhe të përmirësohen kushtet në institucionet e kujdesit shëndetësor.

Për sa i përket të drejtave të pronësisë, legjislacioni shqiptar ka mbivendosje dhe kjo çon në nivele të ulëta të sigurisë ligjore. Procesi i kthimit ose kompensimit të pronës së konfiskuar nga regjimet e mëparshme është në vazhdim dhe po ecën ngadalë. Shpeshtësia e praktikave korruptive e pengojnë këtë proces. Numri i lartë i çështjeve të mbetura pezull që presin në gjykatë dhe moszbatimi i vendimeve të gjykatave, vë në pikëpyetje funksionimin e sistemit gjyqësor në këtë fushë.

Kushtetuta parashikon mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Mungesa aktuale e të dhënave për minoritetet do të zgjidhet nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011. Duhet të rritet mundësia e arsimimit në gjuhët e minoriteteve dhe kjo mundësi t'u ofrohet të gjithë personave që i përkasin minoriteteve (kombëtare dhe etno-linguistike). Kthimi i pronës që i përket minoriteteve mbetet një problem. Komisioni Shtetëror i Minoriteteve duhet të forcohet thelbësisht me qëllim që të sigurojë rolin e tij përfaqësues dhe këshillues. Gjithashtu, duhet të përshpejtohet zbatimi i Strategjisë për pakicën romë dhe plani i veprimit dhjetëvjeçar për romët. Është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje përmirësimit të kushteve të jetesës për pakicën romë dhe zvogëlimit të qëndrimeve diskriminuese. Regjistrimi i romëve në Regjistrin e Gjendjes Civile ka nevojë të përmirësohet.

*(Shiko gjithashtu Kriterin Politik - Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve)*

Për të garantuar të drejtat e qytetarëve të BE-së për të votuar dhe për të qenë kandidat në zgjedhjet bashkiake dhe Parlamentin Europian, Shqipërisë do t'i duhet të ndryshojë kuadrin ligjor dhe kushtetues. Ekzistojnë struktura administrative që merren me çështjet elektorale. Nuk duhet të ketë ndonjë vështirësi për Shqipërinë për të transpozuar dhe zbatuar ligjin e BE-së në këtë fushë.

Për sa i përket të drejtave për qëndrimin, kuadri ekzistues i Shqipërisë nuk është në përputhje me atë të BE-së për lëvizjen e lirë të qytetarëve të BE-së, kështu që nevojiten ndryshime të mëdha. Megjithatë, kjo do të jetë një kërkesë vetëm në fazat e mëvonshme të procesit të anëtarësimit në BE. Ekzistojnë struktura administrative që trajtojnë çështjet e migracionit, dhe këto struktura ka mundësi të përfshihen në zbatimin e ligjit të BE-së.

Në lidhje me mbrojtjen diplomatike dhe konsullore, kuadri ligjor ekzistues i Shqipërisë nuk është në përputhje me ligjin e BE-së. Ndryshimet ligjore do të jenë të domosdoshme në një fazë të mëvonshme. Megjithatë, transpozimi dhe zbatimi i ligjit të BE-së nuk duhet të jetë problematik.

Lidhur me aksesin në drejtësi, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e votës, shiko Kriterin Politik, për trafikimin e qenieve njerëzore, shiko Kriterin Politik dhe Kapitullin 24, për të drejtat e punës dhe sindikatat, shiko Kriterin Politik dhe Kapitullin 19.

### *Konkluzioni*

Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme për të përputhur këtë kapitull me *acquis* dhe për ta zbatuar atë në mënyrë efektive në periudhë afatmesme. Do të nevojitet gjithashtu, forcimi i kapaciteteve administrative dhe zbatuese.

*(shiko konkluzionin e Pjesës 1- Kriteri Politik)*



### 3.24. Kapitulli 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria

Politikat e BE-së synojnë të ruajnë dhe të zhvillojnë më tej Bashkimin si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Për çështjet e emigracionit, azilit, kontrollit të kufijve, vizat, bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale dhe civile, bashkëpunimit policor, luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, bashkëpunimit në fushën e lëndëve narkotike dhe bashkëpunimit doganor, Shtetet Anëtare duhet të pajisen plotësisht për të zbatuar siç duhet kuadrin në rritje të rregullave të përbashkëta. Mbi të gjitha, kjo kërkon kapacitete të forta dhe të integruara brenda organeve të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera relevante për të arritur standardet e nevojshme. Organizimi i një force policie profesionale, të besueshme dhe efikase është i një rëndësie të madhe.

Pjesa më e detajuar e politikave të BE-së për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë është *acquis* e Shengenit, e cila përfshin heqjen e kontroleve për kufijtë e brendshëm të BE-së. Për Shtetet e reja Anëtare, pjesët e rëndësishme të *acquis* Shengen zbatohen me anë të një vendimi të veçantë të Këshillit që merret pas anëtarësimit në BE.

Shqipëria ka bërë progres në një numër fushash kryesore të këtij kapitulli në kuadër të dialogut me BE-në për liberalizimin e vizave, që vendosi standardet për t'u përmbushur në këtë fushë si siguria e kufijve, migracioni, azili dhe lufta kundër krimit të organizuar. Arritjet e siguruara në këto fusha janë një bazë e mirë mbi të cilën Shqipëria mund të mbështetet më tej për të përballur sfidat e procesit të zgjerimit.

Për sa i përket **migracionit**, ekziston kryesisht legjislacioni për lejet e qëndrimit, bashkimin familjar, studentët dhe rezidentët afatgjatë, megjithëse ky legjislacion nuk është në përputhje të plotë me *acquis* e BE-së. Disa ndryshime mbeten në fushën e veprimit të së drejtës për bashkimin familjar dhe rregullat për statusin në lidhje me qëndrimin afatgjatë. Shqipëria nuk ka rregulla të veçanta për punëtorët me kualifikime të larta. Ajo ka një bazë të dhënash për lejet e qëndrimit të zhvilluar mjaftueshëm, por nevojitet përputhshmëria e mëtejshme e dënimeve për futjen e paligjshme të njerëzve, punësimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm ose për skemën e lejeve të qëndrimit për viktimat e trafikimit. Politika e kthimit në Shqipëri rregullohet nga Ligji për të huajt, i miratuar në vitin 2008, i cili adreson problemet kryesore të Direktivës së BE-së për Kthimin, dhe është në përgjithësi në përputhje me *acquis*. Megjithatë, procesi i ndalimit për personat që janë subjekt i vendimeve të kthimit duhet të mbështetet më shumë mbi një vlerësim individual rast pas rasti, dhe procesi të jetë më pak shtrëngues. Duhet të merren masa alternative ndaj ndalimit.

Marrëveshja e ripranimit ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë është zbatuar pa probleme që nga viti 2005. Migracioni i parregullt nga Shqipëria mbetet një sfidë e rëndësishme, sidomos kalimi i kufirit tokësor me Greqinë. Bashkëpunimi ndërmjet policisë greke dhe asaj shqiptare për këtë çështje është i mirë. Në vitin 2009, u regjistruan 64625 raste kthimi dhe u kthyen 47239 qytetarë shqiptarë. Shqipëria ka hartuar një strategji dhe plan veprimi për periudhën 2010-2015 për riintegrimin e qytetarëve të kthyer dhe ka nevojë për të ndjekur zbatimin e saj. Zyrat vendore të punësimin dhe shërbimet e migracionit që sigurojnë informacione për shërbimet e veçanta për të kthyerit, luajnë një rol të rëndësishëm. Bashkëpunim më i ngushtë me policinë e kufirit dhe migracionit duhet të vazhdojë në këtë fushë. Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS) në pikat e kalimit të kufirit siguron të dhëna për vizat, lejet e qëndrimit dhe lejet e punës të lëshuara, si dhe statistika për

migracionin. Analiza e riskut dhe monitorimi i fluksit të migracionit ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.

Në fushën e **azilit**, është ngritur kuadri institucional dhe ligjor. Ligji për azilin u miratua në vitin 2009, dhe në përgjithësi, është në përputhje me standardet e BE-së. Është e nevojshme që të sigurohet harmonizimi ndërmjet Ligjit për azilin, Ligjit për integrimin dhe Ligjit për të huajt. Garancitë themelore procedurale në proceset e ankimimit duhet të rregullohen në Ligjin për azilin. Shqipëria ka nevojë të vazhdojë përpjekjet që çojnë në proceduara më të shkurtra ankimimi kundër vendimeve të Departamentit për Shtetësinë dhe Refugjatët. Trajnimi i personelit të Drejtorisë si dhe i gjyqtarëve që gjykojnë ankimet për azil duhet të vazhdojë.

Qendra e pritjes për azil-kërkuesit është plotësisht funksionale që nga muaji maj i vitit 2010. Sistemi i azilit ka burime njerëzore dhe kapacitete të mjaftueshme për t'u përballur me numrin e ulët të çështjeve ekzistuese. Në shkurt të 2010, kishte 69 refugjatë të pranuar dhe 29 azilkërkues. Megjithatë, në rast të një fluksi më të lartë të azilkërkuesve, Drejtoria e Shtetësisë dhe Refugjatëve do të ketë nevojë për personel shtesë dhe më të specializuar. Shqipëria është më shumë një vend transit për refugjatët potencialë në rrugën e tyre drejt BE-së. Azilkërkuesit janë më së shumti persona nga Kosova me kombësi shqiptare. Pajisja me dokumente identifikimi e refugjatëve duhet të sigurohet me qëllim që t'u garantohet akses më efektiv në të drejtat e tyre të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, dhe është e nevojshme që të përmirësohet më tej integrimi i tyre. Legjislacioni duhet të përjashtojë azilkërkuesit dhe refugjatët nga detyrimi për të siguruar dokumentet zyrtare të lëshuara në vendin e tyre të origjinës. Legjislacioni duhet të parashikojë një moshë limit për marrjen e gjurmëve të gishtave të azilkërkuesve dhe imigrantëve. Është e nevojshme që në fushën e azilit të grumbullohen të dhëna statistikore më të plota.

Për sa i përket **politikës së vizave**, Shqipëria ka krijuar një kuadër ligjor i cili ka nevojë të përputhet plotësisht me *acquis*. Ligji për të huajt u miratua në vitin 2008, por kërkohet harmonizimi i mëtejshëm me Kodin e Vizave të BE-së. Listat e Vizave të Shqipërisë nuk janë të harmonizuara me listat e BE-së. Legjislacioni shqiptar që lejon Shqipërinë në mënyrë të njëanshme të zbatojë marrëveshje sezonale për heqjen e vizave për qytetarët e disa vendeve jo-anëtare të BE-së, nuk është në përputhje me *acquis* e BE-së. Dhënia e vizave në kufi duhet të mbetet një përjashtim. Shqipëria zbaton një regjim pa viza për të gjithë Shtetet Anëtare të BE-së dhe në mënyrë të njëanshme njeh vizat Shengen dhe lejet e qëndrimit sikur të jenë viza afatshkurtra të lëshuara nga Shqipëria. Marrëveshja për lehtësimin e vizave ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë është duke u zbatuar. Një sistem informacioni për vizat elektronike është duke u ngritur. Në këtë kontekst, elementet e rëndësishëm që duhen garantuar përfshijnë pronësinë, përdorimin e mirë dhe mirëmbajtjen menaxheriale, elementet e sigurisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Sistemi duhet të jetë në përputhje me kërkesat për sistemin e informacionit për vizat (SIV).

Në fushën e **kufijve të jashtëm dhe Shengenit**, sistemi i menaxhimit të kufijve në përgjithësi, është në përputhje me standardet e BE-së. Ligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror u miratua në vitin 2008 dhe është ndjekur nga një numër aktesh ligjore në lidhje me policinë e kufirit dhe migracionit (PKM). Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të kufirit u miratua në vitin 2007 dhe plani i veprimit që e shoqëronte u përditësua në vitin 2009. PKM është një departament me struktura të qarta brenda Policisë së Shtetit dhe ka burime të mjaftueshme njerëzore (1539 vetë në

organikë), kapacitete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si dhe pajisje teknike për të kryer kontrole kufitare. Kurrikulat për trajnimin e PKM-së janë hartuar në bashkëpunim me Misionin e Asistencës Policore të KE-së për Shqipërinë (PAMECA) dhe Frontex. Kapaciteti për analizën e riskut është forcuar dhe funksionon. Përmirësimi i infrastrukturës në pikat e kalimit të kufirit është duke vazhduar. Të 24 pikat e kalimit të kufirit janë të lidhura me TIMS, duke siguruar akses në të dhënat kombëtare për dokumentet e udhëtimit dhe personat e kërkuar dhe në databazën e Interpolit. PKM ka akses të kufizuar në sistemin e zbulimit të informacionit kriminal MEMEX. Është e nevojshme shtrirja ose përhapja e mëtejshme e tij, sidomos në pikat e kalimit të kufirit.

Përmirësimi i mbikëqyrjes së plotë civile të kufirit detar është duke vazhduar. Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) filloi punë në janar të vitit 2010, nën administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes, duke siguruar bashkëpunim të ngushtë ndërmjet PKM-së, Rojës Bregdetare, autoriteteve doganore dhe Inspektoratit të Peshkimit. Sistemi i trajnimit është duke u ngritur dhe procedurat standarde operative janë duke u përfunduar. Shqipëria duhet të jetë në gjendje të patrollojë bregdetin e saj me efikasitet në një periudhë afatmesme. Momentalisht, për të ndihmuar luftën kundër trafikimit është në fuqi moratoriumi i skafeve për një afat trevjeçar.

Bashkëpunimi ndërkufitar në përgjithësi, funksionon mirë në format e patrullimit të përbashkët, si dhe një pikë e përbashkët e kalimit të kufirit (me Malin e Zi). Një marrëveshje pune me Frontex ekziston që nga shkurti i vitit 2009 dhe bashkëpunimi është i mirë. Shqipëria merr pjesë në mënyrë aktive në rrjetin e Ballkanit Perëndimor për analizën e riskut dhe përfiton nga ekspertiza dhe këshillat e Frontex në lidhje me trajnimin. Bashkëpunimi ndërinstitucional me autoritetet doganore është forcuar. Megjithatë, nevojiten përpjekje të përbashkëta të mëtejshme për të luftuar të gjitha llojet e krimeve ndërkufitare, përfshi trafikimin e mjeteve motorike. Është e nevojshme që autoritetet doganore të kryejnë kontrole sistematike dhe t'i shfrytëzojnë pajisjet në mënyrë efektive.

Për sa i përket **bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile**, njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të huaja është përfshirë në Kodin e Procedurës Civile. Sistemi i përgjithshëm për çështjet civile dhe tregtare është i ngjashëm me atë që përcakton legjislacioni i BE-së. Kërkohen përpjekje për të siguruar zbatimin efikas të tij. Legjislacioni shqiptar nuk parashikon procedura të thjeshtuara për rikuperimin e borxhit. Shqipëria është palë e disa instrumenteve relevante ndërkombëtare, për shembull, Konventa e Hagës e vitit 1970, për marrjen e provës jashtë vendit. Pranimi në konventa të tjera si për shembull, Konventa e 2007-ës për rikuperimin ndërkombëtar të pensionit ushqimor të fëmijës është ende pezull.

Në fushën e **bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale**, Shqipëria ka ratifikuar konventat më të rëndësishme të Këshillit të Europës dhe instrumentet e OKB. Ajo duhet të ndërmarrë hapa për t'u bërë palë në Protokollin Shtesë të Konventës për transferimin e personave të dënuar. Ligji i ri për ndihmën e ndërsjellë juridike hyri në fuqi në shkurt të vitit 2010. Dispozitat në përgjithësi përputhen me standardet e BE-së, por është i domosdoshëm zbatimi me efektivitet i ligjit nga një personel i trajnuar në mënyrë të mjaftueshme. Gjyqtarët dhe prokurorët gjithashtu, kanë nevojë të trajnohen në këtë fushë. Në vitin 2009 u rrit numri i të dënuarve të transferuar brenda dhe jashtë Shqipërisë. Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa sidomos në fushën e mbrojtjes së të dhënave që të jetë në gjendje të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi me Eurojust. Për të marrë anëtarësimin e plotë në Eurojust në të ardhmen, duhen bërë përpjekje të mëtejshme për forcimin e kapaciteteve në fushën e

bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale. Marrëveshje dypalëshe ekzistojnë me një numër vendesh fqinje për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale dhe civile.

Në fushën e **bashkëpunimit policor dhe luftën kundër krimit të organizuar**, janë marrë masa të rëndësishme vitet e fundit. Kuadri ligjor është përmirësuar me një ligj të ri që mundëson sekuestrimin dhe konfiskimin efikas të të ardhurave të paligjshme nga krimi. I ashtuquajtur Ligji "Anti-Mafia" hyri në fuqi në janar të vitit 2010, së bashku me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Zbatimi i tyre me efikasitet, sidomos menaxhimi me efikasitet i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, duhet të sigurohet dhe të demonstron nëpërmjet performancës së treguesve të konfiskimeve përfundimtare.

Struktura e re e policisë që pasqyron edhe prioritetin e caktuar për hetimin e krimit të organizuar funksionon që nga korriku i vitit 2010. Burimet njerëzore janë rialokuar me qëllim që të rritet numri i personelit që merret me hetimin e krimit të organizuar si dhe janë parashikuar fonde buxhetore për investime të tjera. Ngritja e njësisë të përbashkëta hetimore për të luftuar krimin ekonomik dhe korrupsionin rezultoi efektive. Janë bërë përpjekje për të rritur kapacitetet e hetimit dhe është promovuar qasja proaktive dhe e bazuar në informata sekrete. Trajnimet e përbashkëta me prokurorinë dhe organet e tjera të zbatimit të ligjit duhet të vazhdojnë me qëllim që të forcohet më tej bashkëpunimi operacional ndërmjet policisë dhe prokurorisë. Trajnimi i specializuar duhet të zhvillohet më tej, sidomos mbi aspektet ndërkombëtare të krimit të organizuar.

Përdorimi i sistemit të informacionit kriminal MEMEX ka përmirësuar shkëmbimin e të dhënave brenda policisë së shtetit shqiptar. Është planifikuar përditësimi dhe blerja e më shumë licencave. Momentalisht, sistemi nuk përdoret nga organe të tjera të zbatimit të ligjit. Transferimi i të dhënave nga arkivi nuk ka përfunduar ende. Sistemi përmban të dhëna policore por jo informacione për hetimet e drejtuara nga prokuroria. Me rritjen e përdorimit të bazave të reja të të dhënave, duhet të përmirësohet mbrojtja e të dhënave personale në polici. Përdorimi i metodave të veçanta të hetimit sa vjen dhe rritet, megjithëse përgjimi i telefonave dhe përdorimi i agentëve të fshehtë është kufizuar në nivelin qendror. Ndarja e detyrave ndërmjet Policisë së Shtetit dhe SHISH (Shërbimi Informativ Shtetëror), sidomos i detyrave të tilla si përgjimi i telekomunikacionit, duhet të qartësohet dhe organizohet në përputhje me praktikat më të mira europiane dhe instrumentet relevante të Këshillit të Europës. Kapacitetet e policisë shkencore, përfshi dhe menaxhimin e ADN-së në çështjet penale, duhet të përmirësohen. Është i domosdoshëm një sistem i besueshëm për raportimin e statistikave.

Veprime të përbashkëta të gjithanshme, të vazhdueshme dhe të efektshme, nga të gjitha palët e interesuara, janë të nevojshme për të çmontuar lidhjen e përgjithshme që ka Shqipëria me trafikimin e qenieve njerëzore, lëndëve narkotike, armëve, makinat e vjedhura dhe pastrimin e parave. Operacionet e suksesshme të policisë duhet të mbështeten nga dënime penale. Në tetor të vitit 2010, u firmos një marrëveshje që krijonte një zyrë rajonale në Beograd, për përmirësimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar ndërmjet Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Është i nevojshëm forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, përfshi edhe me Interpolin. Shqipëria duhet të përmbushë kërkesat për nënshkrimin e një marrëveshjeje operationale me Europolin.

Në **luftën kundër terrorizmit**, Shqipëria ka rishikuar dhe përshtatur kuadrin e saj të brendshëm ligjor me kuadrin rregullator ndërkombëtar, por ende ka nevojë për përputhje të plotë me *acquis*. Nuk është miratuar ende një strategji kundër terrorizmit. Sistemet e informacionit dhe databazat, që do të lehtësonin bashkëpunimin dhe koordinimin e autoriteteve kompetente, mbeten për t'u ngritur.

Lufta **kundër lëndëve narkotike** mbetet një fushë shqetësuese, megjithëse kohët e fundit është përdorur një qasje më aktive nga organet e zbatimit të ligjit që ka rezultuar në konfiskimin e lëndëve narkotike. Shqipëria vazhdon të mbetet një nga rrugët kryesore të trafikimit të lëndëve narkotike në Ballkan. Kanabisi prodhohet ende në Shqipëri, por kultivimi i tij ka lëvizur kryesisht në zona më të largëta malore. Po zbatohet një plan veprimi për luftën kundër kultivimit të lëndëve narkotike. Duhet të zhvillohen programe për kultivimin e bimëve alternative. Strategjia Kombëtare Anti-Drogë përfundon në fund të vitit 2010. Duhet të hartohet një strategji e re bazuar në mësimet e nxjerra. Janë bërë disa përpjekje për hetime dhe ndjekje penale më efikase të çështjeve të trafikimit të lëndëve narkotike. Bashkëpunimi me agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit duhet të vazhdojë. Kërkohe zhvillimi i mëtejshëm i metodave hetimore për të kryer hetime komplekse.

Kapacitetet e Shqipërisë për t'u përballur me kërkesën për trajtim dhe rehabilitim të personave të droguar nuk janë ende të mjaftueshme. Bashkëpunimi me Qendrën Europiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Drogat (EMCDDA) dha disa rezultate të dukshme në vitin 2009; u publikua për herë të parë një përmbledhje për vendin dhe një hartë informuese, si dhe u organizuan aktivitete shkencore. Në tërësi, kuadri institucional për bashkëpunimin me EMCDDA është ende në fazën fillestare.

Me gjithë progresin e mirë, **trafikimi i qenieve njerëzore**, vazhdon të jetë fushë shqetësuese. Shqipëria mbetet një vend origjine për trafikimin për qëllime shfrytëzimi seksual dhe punë të detyruar. Duhet të vlerësohet impakti i strategjive që janë në përfundim të zbatimit dhe duhet të hartohen strategji të reja. Shqipëria po përmirëson kapacitetet e saj për të identifikuar, mbrojtur dhe riintegruar viktimat.

Megjithatë, në përputhje me tendencat rajonale, ka pasur një ulje në identifikimin e rasteve. Në vitin 2009, shumë pak çështje të trafikimit u dërguan për gjykim në gjykata. Trajnime në lidhje me identifikimin dhe intervistimin e viktimave, si dhe për metodat speciale të hetimit duhet të sigurohen më tej për oficerët e zbatimit të ligjit. Rekrutimi i punonjëseve femra të policisë të trajnuara në mënyrë të specializuar, në pikat më të ndjeshme të kalimit të kufirit duhet të vazhdojë. Bashkëpunimi policor ndërkombëtar duhet të rritet.

Ligji i ri për shërbimet sociale u miratua në mars të vitit 2010, duke parashikuar mbështetje financiare për viktimat. Burimet financiare dhe njerëzore duhet të përmirësohen më tej dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve vendore të përfshira (shkollave, shërbimeve sociale, bashkive) duhet të përmirësohet për të parandaluar më mirë trafikimin dhe për të riintegruar viktimat, sidomos fëmijët. Në vitin 2009, u krijuan qendrat e përkujdesjes ditore dhe njësitë e mbrojtjes për fëmijët. Nevojitet mbrojtje e efektshme e viktimave që bashkëpunojnë me organet e zbatimit të ligjit.

Në fushën e **pastrimit të parave**, Shqipëria ka ndërtuar një kuadër ligjor, i cili megjithatë ka nevojë të përputhet në mënyrë të plotë me normat ndërkombëtare, rekomandimet e Task Forcës së Veprimit

Financiar (FATF) dhe dispozitat e *acquis* (shiko gjithashtu Kapitullin 4 - Lëvizja e lirë e kapitalit). Dënimet penale minimale për pastrimin e parave duhet të rriten në përputhje me *acquis*. Përmirësime praktike janë arritur vitet e fundit duke ulur pragun e raportimit, futjen e masave parandaluese dhe uljen e transaksioneve financiare me para në dorë. Identifikimi i klientit është kontradiktor dhe lypset të vazhdojë paralel me konsolidimin e sistemit të Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe Regjistrimit të Adresave. Njësia e Inteligjencës Financiare (FIU) ekziston dhe ka përmirësuar kapacitetet e saj operacionale dhe analitike nëpërmjet rritjes së trajnimit. Numri i rasteve të raportuara në prokurori është në rritje. Bashkëpunimi me institucionet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare është i kënaqshëm. Strategjia Kombëtare dhe plani i veprimit po zbatohen, por përpjekje plotësuese nevojiten për të përballuar këtë fenomen me efikasitet. Cilësia dhe numri i ulët i raporteve me transaksione të dyshuara që i dërgohen FIU-t mbeten një sfidë. Raportimi elektronik, sidomos nga sektori jo-bankar duhet të ndihmohet. Nuk ekziston një regjistër kombëtar me llogaritë bankare. FIU duhet të kryejë më shumë kontrole të ndërthurura me informacionin e marrë nga institucionet e tjera. Personeli analitik dhe mjetet e teknologjisë së informacionit duhet të forcohen. Banka e Shqipërisë duhet të luajë një rol më aktiv në këtë fushë si mbikëqyrëse kryesore e sistemit bankar. Shqipëria duhet të përdorë kompetencat për konfiskimin e pasurive kriminale më me efektivitet. Zyra qendrore për sekuestrimin e pasurive kriminale siç kërkohet nga *acquis* e BE-së nuk është ngritur ende në Shqipëri. Numri i ulët i ndjekjeve penale dhe i dënimeve të formës së prerë mbetet shqetësues.

Shqipëria ka një numër marrëveshesh bilaterale në fushën e **bashkëpunimit doganor** dhe duhet t'i zbatojë këto me efektivitet. Ajo duhet të fillojë përgatitjet për ratifikimin dhe zbatimin e Konventës për asistencë dhe bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet Shteteve Anëtare (Napoli II) dhe të Konventës për përdorimin e teknologjisë së informacionit për qëllime doganore (CIS). Kapacitetet teknike dhe administrative të shërbimeve doganore duhet të përmirësohen më tej, dhe kompetencat e tyre të hetimit të përdoren në mënyrë aktive për të kryer operacione efektive kundër krimit të organizuar.

Për mbrojtjen e Euros nga falsifikimi, shiko kapitullin 32 Kontrolli financiar.

### *Konkluzioni*

Shqipëria ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të përputhur legjislacionin e saj me *acquis* në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Janë arritur rezultate pozitive në reformën e organeve të zbatimit të ligjit dhe në sigurimin e burimeve dhe mjeteve të përshtatshme për t'u përballur me sfidat e krimit të organizuar. Megjithatë, duhen bërë hapa të mëtejshëm për të përputhur plotësisht legjislacionin me *acquis* dhe normat ndërkombëtare. Një qasje pro-aktive e organeve të zbatimit të ligjit është çelësi për përballimin e krimit të organizuar, i cili mbetet çështje shqetësuese. Duhet të krijohet një vijimësi rezultatesh solide për dënimet. Në tërësi, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme për të përputhur këto fusha me *acquis* dhe ta zbatojë atë me efektivitet në periudhën afatmesme.

### **3.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi shkencor**

Në parim, *acquis* në fushën e shkencës dhe kërkimit nuk kërkon transpozimin e rregullave të BE-së në legjislacionin kombëtar. Zbatimi me sukses i *acquis* në këtë fushë përfshin kryesisht, plotësimin e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen efektive në Programet Kuadër të Kërkimit Shkencor dhe

kontributin për krijimin e Hapësirës së Kërkimit European. Kjo kërkon kapacitete të mira administrative (personel të mjaftueshëm dhe njohuri në bashkëpunimin kërkimor), njohuri të shkëlqyera shkencore për të kryer me sukses kërkimin dhe projektet novatore së bashku me partnerët shkencorë nga Shtetet Anëtare të BE-së, si dhe krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin në mënyrë të qëndrueshme nga aspekti ekonomik.

Shqipëria, si vend kandidat potencial, i është bashkuar Programit Kuadër Kërkimor 7 të BE-së (FP7) që nga janari i vitit 2008.

**Politikat kombëtare të kërkimit shkencor** janë nën kompetencën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, që mbikëqyr planifikimin strategjik dhe aspektet ligjore, dhe bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar. Prioritetet themelore të kërkimit shkencor përcaktohen nga qeveria dhe miratohen nga parlamenti, pas konsultimit me Akademinë e Shkencave, Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe Konferencën e Rektorëve të Universiteteve. Në 2010-ën, Shqipëria krijoi një Agjenci të Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, e cila është përgjegjëse për vlerësimin e fondeve të kërkimit shkencor si në nivel kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar. Shqipëria ka përcaktuar shtatë fusha prioritare për kërkimin, të cilat duhet të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrencën në vend.

Shqipëria filloi të reformojë sistemin e saj të kërkimit shkencor në vitin 2006, me integrimin e ish-instituteve të Akademisë së Shkencave në universitetet kryesore publike. Roli i Akademisë tani konsiston, si në shumicën e vendeve europiane, në përfaqësim dhe këshillim. Institutet kërkimore në vartësi të ministrive të linjës u ristrukturuan gjithashtu, dhe u shkrinë në 12 qendra dhe agjenci të reja të transferimit të teknologjisë.

Niveli aktual i investimit është shumë i ulët (rreth 0.2% e PBB-së në 2009). Për shkak të mungesës së statistikave dhe sistemeve për grumbullimin e të dhënave nga sektori privat, nuk ka mjete për monitorimin e objektivave të caktuara. Shqipëria po punon në mënyrë aktive për një reformë në statistikat kërkimore dhe shkencore për të plotësuar kriteret e BE-së.

Në vitin 2009 u miratua një Strategji e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (STI) për periudhën 2009-2015, e cila përcakton reformat që nevojiten për krijimin e një ekonomie të bazuar në njohuri. Strategjia STI, midis të tjerash, synon të rrisë shpenzimet publike për kërkimet në 0.6% të PBB-së në vitin 2015, krijimin e qendrave të ekselencës, rritjen e numrit të studiuësve dhe rritjen e kapaciteteve novatore të bizneseve me ndihmën e partneriteteve midis akademikëve dhe industrisë.

Pjesëmarrja efektive në **programet kuadër** kërkimore të BE-së, kërkon kapacitete të mira administrative (personel të mjaftueshëm dhe ekspertizë në bashkëpunimin kërkimor sipas *programeve kuadër të BE-së*) dhe përsosmëri shkencore me qëllim aftësimin për të paraqitur propozime për projekte të suksesshme së bashku me institutet kërkimore të BE-së dhe jo të BE-së. Që kur Shqipëria iu bashkua FP7, ajo është familjarizuar më shumë me bashkëpunimin sipas programit kuadër kërkimor të BE-së, por niveli i saj i pjesëmarrjes së suksesshme është ende shumë i ulët. Shqipëria ka filluar të marrë masat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve duke caktuar delegatë vëzhgues në komitetet menaxhuese të FP7 dhe duke ristrukturuar rrjetin e saj të pikave kombëtare të kontaktit. Vendi nuk është angazhuar në kërkimin bërthamor dhe nuk ka kërkuar t'i bashkohet *programit kuadër Euratom*.

Për sa u përket iniciativave për politikat që ndihmojnë në krijimin e Zonës së Kërkimit European (ERA), strategjia STI për periudhën 2010-2015 është plotësisht në përputhje me objektivat e Programit të ERA-s, por duhen përpjekje serioze për arritjen e objektivave të caktuara. Veç kësaj, mungojnë të dhëna të sakta për investimet në kërkime dhe numrin e studiuesve në vend apo në diasporë. Shqipëria ka filluar të veprojë për të kthyer trurin duke tërhequr mbrapsht në vend shkencëtarët. Ajo ka deklaruar një plan veprimi për lëvizjen e lirë të kërkuesve shkencorë, duke përfshirë masat për tërheqjen e të rinjve drejt shkencës dhe forcimin e ngritjes së kapaciteteve njerëzore. Shqipëria po vuan nga mungesa e infrastrukturës kërkimore bashkëkohore dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë, por po bëhen përpjekje për përmirësimin e infrastrukturës, duke filluar me mbështetjen për zhvillimin e rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Shqipëria merr pjesë në punën e Komitetit European për Zonën Europiane të Kërkimit (ERAC, ish-CREST) dhe ka caktuar një delegat vëzhgues në Komitetin e Përhershëm për Kërkimin në Bujqësi (SCAR). Ajo është ftuar të caktojë delegatë vëzhgues në organe të ndryshme drejtuese të ERA-s.

Në agjendën kombëtare i jepet rëndësi bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht me partnerët e BE-së. Shqipëria po merr pjesë aktive në disa projekte rajonale me vende të tjera të Ballkanit dhe kohët e fundit ka nënshkruar marrëveshje për shkencën e teknologjinë me disa vende fqinje dhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

#### *Konkluzioni*

*Në tërësi*, në rast se vazhdon përpjekjet e saj, Shqipëria në periudhën afatmesme pritet të ketë kapacitetet për të plotësuar kërkesat e *acquis*. Plani Kombëtar për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin është krejtësisht në përputhje me synimet e përcaktuara në nivelin e BE-së, në kuadrin e Zonës Europiane të Kërkimit. Megjithatë, rëndësi të madhe ka zbatimi i vazhdueshëm dhe monitorimi nga afër i synimeve të miratuara në nivel kombëtar. Shqipëria do të duhet të bëjë përpjekje të tjera për pjesëmarrjen e saj efektive në programet kuadër dhe integrimin e mëtejshëm në zonën europiane të kërkimit. Kjo kërkon gjithashtu, forcimin e kapaciteteve administrative dhe rritjen e nivelit, aktualisht të ulët, të investimeve.

### **3.26. Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura**

*Acquis* për arsimin dhe kulturën konsiston kryesisht në kuadrin e bashkëpunimit të përbërë nga programe dhe metoda e hapur e koordinimit (OMC), që synojnë konvergencën e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave të përbashkëta. Në fushën e arsimit dhe rinisë, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë menaxhimin e mirë të programeve të decentralizuara të BE-së. *Acquis* kërkon gjithashtu, nga Shtetet Anëtare të lehtësojnë arsimin për fëmijët e punëtorëve emigrantë të BE-së dhe të ndalojnë diskriminimin kundrejt shtetasve të BE-së. Në fushën e kulturës, Konventa e UNESCO-s e vitit 2005, mbi mbrojtjen dhe nxitjen e diversitetit të shprehjeve kulturore, e ratifikuar nga BE-ja, është një komponent kryesor i *acquis*. BE kontribuon gjithashtu, në promovimin e çështjeve sportive europiane.

Në fushën e **arsimit dhe trajnimit**, Shqipëria është në procesin e reformimit të sistemit të saj arsimor në përputhje me zhvillimet e BE-së. Po bëhen përpjekje për të përmirësuar sistemin e arsimit dhe



trajnimin dhe janë caktuar objektiva shumë ambiciozë në nivel kombëtar dhe rajonal. Kurrikulat shkollore janë rishikuar dhe kanë njëfarë fleksibiliteti për plotësimin e nevojave të grupeve të minoriteteve dhe atyre vulnerabël. Duhet të zbatohet legjislacioni për sigurimin e arsimit përfshirës të grupeve vulnerabël dhe fëmijëve me nevoja të veçanta. Disa masa për sigurimin e cilësisë janë ndërmarrë apo forcuar, siç janë librat e rinj shkollorë dhe inspektimet në shkolla. Megjithatë, cilësia e arsimit ndikohet nga nevoja për rehabilitimin e vazhdueshëm të shkollave, përmirësimin e pajisjeve dhe trajnimin e mësuesve. Shqipëria ende nuk merr pjesë në testimin ndërkombëtar (testi OECD PISA) ose në burimet e të dhënave, të tilla si databaza e UNESCO-s. Legjislacioni i rishikuar kohët e fundit dhe kurrikula e re e shkollës e zbatuar në 2009-2010 synon përmirësimin e nivelit të arsimit. Zbatimi i reformave duhet ndjekur nga afër dhe progresi duhet të monitorohet. Sigurimi i burimeve njerëzore dhe kapaciteteve materiale të mjaftueshme dhe reformimi i drejtimit të shkollës janë sfida të mëdha. Për sa i përket shpenzimeve publike për arsimin, financimi në vitin 2009 ishte 3.8% e PBB-së.

Sistemi i arsimit dhe formimit profesional (VET) është duke u rishikuar. Me qëllim që të merren parasysh nevojat e tregut të punës dhe kërkesat shoqërore, struktura e studimeve VET është në përputhje me Kornizën e Kualifikimeve Europiane (EQF). Agjencia Kombëtare për Arsimin dhe Formimin Profesional, e krijuar kohët e fundit, ka marrë mandatin për të monitoruar sigurimin e cilësisë në VET.

Si palë e procesit të Bolonjës, Shqipëria po vazhdon përpjekjet e saj në reformën e arsimit të lartë. Megjithatë, është i nevojshëm vlerësimi i reformave të kohëve të fundit. Po aplikohen si gradat e nivelit të tretë (PhD) ashtu dhe Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (NQF), por ato kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Sistemet e brendshme të sigurisë së cilësisë kanë ende nevojë të plotësohen. Autonomia institucionale dhe qeverisja e mirë kërkojnë ende vëmendje. Duhet përpjekje të mëtejshme për integrimin e mësimdhënies e kërkimit, vazhdimin e reformës në programet shkollore, njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe shtimin e lëvizjes së lirë së pedagogëve dhe studentëve.

Në Shqipëri, përgjegjësinë për formulimin dhe zbatimin e **politikave rinore** e ka Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në vitin 2006, u miratua Strategjia Kombëtare e Rinisë, që u pasua nga Plan Kombëtar i Veprimit për Rininë për periudhën 2007-2013. Aktualisht, po krijohet një qendër kombëtare e rinisë, si organi kryesor drejtues me përgjegjësinë për të zbatuar politikatat që lidhen me rininë. Megjithatë, shumë gjëra varen nga vizioni dhe angazhimi i organizatave jo-qeveritare të rinisë të cilat, vetë, po përpiqen të krijojnë një pozicion të qëndrueshëm në shoqëri. Shqipëria duhet të rishikojë strategjinë e saj në përputhje me Strategjinë e BE-së për Rininë (2010-2018).

Në lidhje me Direktivën për arsimimin e fëmijëve të punëtorëve emigrantë të BE-së, legjislacioni shqiptar tashmë i mbulon të gjitha kërkesat e saj.

Me qëllim që të plotësojnë parakushtet për pjesëmarrjen në programet e decentralizuara të BE-së në fushat e arsimit, trajnimin dhe rinisë, autoritetet përkatëse do të duhet të zhvillojnë kapacitetet për menaxhimin e shëndoshë financiar dhe kontrollin financiar.

Në fushën e **kulturës**, nëpërmjet fondeve publike kombëtare dhe vendore, Shqipëria po mbështet institucionet kulturore dhe punën artistike dhe krijuese, si dhe nxitjen e forcimit të kapaciteteve, përfshi trajnimin ndërkombëtar. Shqipëria ratifikoi Konventën e UNESCO-s të vitit 2005 për mbrojtjen

dhe nxitjen e diversitetit të shprehjeve kulturore në 2006-ën dhe ka shprehur pëlqimin për objektivat e Agjendës Europiane për Kulturën. Një strategji e re kombëtare për kulturën pritet të miratohet në 2010-ën. Bisedimet për pjesëmarrjen e plotë të Shqipërisë në Programin e Kulturës kanë nisur.

### *Konkluzioni*

Reformat në këtë sektor duhen ndjekur dhe zbatimi i tyre të monitorohet. Prioritetet kombëtare kryesore janë përputhshmëria me politikat e BE-së, promovimi i cilësisë dhe qeverisjes së mirë në arsim dhe trajnim. Duhet të sigurohet mosdiskriminimi kundrejt shtetasve të BE-së në sistemin arsimor shqiptar. Shqipëria do të duhet të forcojë shumë kapacitetet e saj administrative për të siguruar një menaxhim të shëndoshë financiar të programeve të decentralizuara të arsimit. *Në tërësi*, pritet që në periudhën afatmesme, Shqipëria të plotësojë kërkesat e *acquis* nëse vazhdon përpjekjet me këtë ritëm.

### **3.27. Kapitulli 27: Mjedisi**

Politika e BE-së për mjedisin synon nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Kjo politikë bazohet në integrimin e mbrojtjes mjedisore në politikat e tjera të BE-së, veprimet parandaluese, parimin “ndotësi paguan”, luftën kundër dëmit mjedisor që në burim dhe në përgjegjësinë e ndarë. *Acquis* përfshin mbi 200 akte ligjore kryesore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet dhe zhurmën. Sigurimi i përputhshmërisë me *acquis* kërkon investime domethënëse, por gjithashtu, sjell përfitime domethënëse. Për zbatimin e *acquis* është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e pajisur mirë, në nivel kombëtar dhe vendor.

Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen mjedisore si një nga objektivat kryesorë të shtetit. Ligji Kuadër i vitit 2002 për mbrojtjen mjedisore shërben si bazë juridike për akte ligjore specifike që rregullojnë komponentët e ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Ligje specifike ekzistojnë për të rregulluar cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, kimikatet, biodiversitetin, etj. Megjithatë, përpjekje të konsiderueshme nevojiten për të rishikuar kuadrin legjislativ kombëtar ekzistues për ta sjellë atë në përputhje të plotë me *acquis* mjedisor të BE-së.

Për sa i përket kuadrin institucional dhe administrativ, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave së bashku me 12 agjencitë rajonale mjedisore dhe Inspektoratin Mjedisor mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të politikës mjedisore. Megjithatë, institucionet ekzistuese nuk janë plotësisht funksionale dhe ekzistojnë boshllëqe dhe copëzime përgjegjësish, veçanërisht në sektorët e mbetjeve dhe ujit. Kërkohet thjeshtëzim i mëtejshëm dhe konsolidim i marrëveshjeve ekzistuese institucionale si edhe krijimi i institucioneve të reja, si për shembull, agjenci e njësi inspektimi për mjedisin dhe pyjet. Gjithashtu, është e rëndësishme të krijohet një ndarje e qartë e përgjegjësi ndërmjet organeve të ndryshme administrative. Koordinimi ndër-institucional mbetet i varfër.

Sistemi i inspektimit mjedisor është vetëm pjesërisht në përputhje me *acquis*. Ka mungesë të kapaciteteve administrative, në veçanti të personelit të mjaftueshëm të trajnuar dhe të pajisjeve të përshtatshme për zbatimin e duhur të të gjithë ciklit të inspektimit mjedisor. Nevojiten përpjekje të veçanta për planifikimin e inspektimit, bashkëpunimin efikas ndërmjet inspektorëve të mjedisit dhe

autoriteteve të tjera mbikëqyrëse si edhe për përmirësimin e sistemit të raportimit dhe të vlerësimit të punës së inspektorëve. Duhet të ketë një sistem më efikas për procedimin e shkeljeve të legjislacionit mjedisor, duke përfshirë legjislacionin e ri që ka si objektive vepra penale specifike, sanksionet proporcionale dhe dekurajuese, një sistem zbatimi efikas dhe ndjekje penale të duhura. Në përgjithësi, nivelet e zbatimit dhe shtrëngimit të zbatimit janë të ulëta për arsye të legjislacionit të dobët, mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare, mungesës së ndërgjegjësimit të qeverisë, biznesit dhe shoqërisë në përgjithësi, përgjegjësive të copëzuara dhe të një sistemi gjyqësor të dobët.

Monitorimi mjedisor në të gjithë sektorët është i dobët dhe jo koherent, dhe nuk siguron të dhëna të besueshme. Përpjekje urgjente duhet të bëhen për të zhvilluar një sistem monitorimi dhe informacioni të konsoliduar dhe të pajisur si duhet.

Nuk ekziston një strategji e përgjithshme për investimet mjedisore. Duhet t'i jepet prioritet shpenzimeve mjedisore nga burimet kombëtare, për të plotësuar financimet ndërkombëtare. Në këtë kontekst, angazhimi për të krijuar një fond mjedisor është i mirëpritur dhe duhet të plotësohet. Një strategji kombëtare për investimin mjedisor duhet të përgatitet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ndërgjegjësimi i publikut dhe pjesëmarrja në vendimmarrjen mjedisore si dhe aksesin e publikut në informacionin mjedisor mbetet i dobët. Përpjekje të mëtijshme nevojiten për të krijuar partneritet solid ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile.

**Legjislacioni horizontal**, ka përputhje të dobët me *acquis*. Nevojiten përpjekje të mëtijshme për të përfunduar përputhshmërinë në fushën e vlerësimit të ndikimit mjedisor, përfshi korigjimin e të metave në përafrim. Transpozimi i legjislacionit për vlerësimin strategjik mjedisor dhe përgjegjësinë mjedisore është në fazën fillestare dhe duhet të përshpejtohet. Përpjekje të mëtijshme nevojiten për të përmirësuar aksesin në sistemin e drejtësisë dhe për të lehtësuar përfshirjen e publikut, përfshi gjithashtu, informacion më të mirë, asistencë financiare, ndihmë ligjore dhe sigurinë që procedurat nuk janë pa arsye të gjata dhe të shtrenjta. Zbatimi i legjislacionit në këtë fushë kërkon përforsim të konsiderueshëm. Në veçanti, duhet të kryhen siç duhet vlerësimet e ndikimit mjedisor, duhet të shqyrtohen alternativa të mundshme, si dhe të sigurohet koordinimi ndërmjet autoriteteve dhe palëve të interesuara.

Ndotja e ajrit përbën një nga shqetësimet kryesore mjedisore për Shqipërinë. Për trajtimin e **cilësisë së ajrit**, nuk ka as strategji të veçantë kombëtare dhe as plane rajonale (me përjashtim të Tiranës) për të trajtuar **cilësinë e ajrit**. Strategjia ndërsektoriale e vitit 2008 për mjedisin, përcakton një sërë objektivash për përafrimin me standardet e BE-së dhe OBSH-së, por këto nuk janë ende në funksionim. Cilësia e ajrit tashmë monitorohet në të gjitha qytetet kryesore, por monitorimi pengohet nga pajisjet dhe metodat e dobëta dhe nuk ekzistojnë të dhëna konsistente. Transpozimi dhe zbatimi i *acquis* në këtë sektor mbetet në fazën fillestare. Boshllëqet kryesore për t'u plotësuar përfshijnë përzgjedhjen e autoriteteve kompetente, miratimin e një sërë ligjesh, përfshi Ligjin e ri për mbrojtjen e ajrit, krijimin e një programi dhe databaze monitorimi gjithëpërfshirës, si dhe vënia e të dhënave në dispozicion të publikut.

Përputhshmëria në fushën e **menaxhimit të mbetjeve** është e kufizuar dhe ka nevojë të përshpejtohet në mënyrë të konsiderueshme. Në veçanti, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duhet të hartohet

shpejt një strategji gjithëpërfshirëse si dhe plane në nivel kombëtar dhe bashkiak. Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve duhet të jetë në përputhje me Direktivën Kuadër të BE-së për Mbetjet. Duhet të miratohen një numër aktesh legislative që përafrojnë një pjesë të madhe të legjislacionit të BE-së për mbetjet. Zbatimi është në fazën më fillestare dhe investimet duhet të rriten në mënyrë të konsiderueshme. Nuk kryhen monitorime të përhershme dhe nuk ekziston asnjë databazë zyrtare. Aktualisht, sistemi i mbledhjes së mbetjeve të ngurta ekziston vetëm në qytetet e mëdha. Nuk ekziston ndonjë landfill i sigurt që të jetë në përputhje me standardet e BE-së. Pjesa më e madhe e mbetjeve, veçanërisht në zonat rurale, grumbullohet në pirgje plehrash të pakontrolluara ose digjen. Kërkohen përpjekje domethënëse për të ulur gjenerimin e mbetjeve dhe për të promovuar riciklimin. Rehabilitimi i pikave të nxehta toksike po përparon, por pika të reja po identifikohen.

Për sa i përket përputhshmërisë së **cilësisë së ujit** me standardet e BE-së është në një fazë fillestare. Strategjia kombëtare për furnizimin me ujë dhe ujërat e zeza, ligji i ri për ujin dhe pjesa më e madhe e legjislacionit për përafrimin me Direktivën Kuadër të Ujit dhe direktivat e tjera në këtë sektor, nuk janë miratuar ende. Shqipëria po bën progres të qëndrueshëm në përmirësimin e mbledhjes dhe përpunimit të ujërave të zeza dhe në infrastrukturën e furnizimit me ujë të pijshëm, por ende nevojiten investime domethënëse. Për sa i përket mjedisit detar, Shqipëria është e përfshirë në aktivitetin që kryhet në kuadër të Konventës së Barcelonës për mbrojtjen e mjedisit në detin Mesdhe. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme, për përputhshmërinë me Direktivën Kuadër për Detin. Zbatimi i legjislacionit për ujin gjithashtu, ka nevojë të përforcohet në mënyrë të konsiderueshme. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përcaktimit të qartë të përgjegjësisive, aktualisht të copëzuara, dhe sigurimit të koordinimit të mirë ndërmjet autoriteteve kompetente.

Shqipëria po përparon në përafrimin e legjislacionit për **mbrojtjen e natyrës**. Përgatitjet fillestare po bëhen për krijimin e rrejtit Natyra 2000 dhe anëtarësimin në marrëveshjet kyçe shumëpalëshe në fushën e mbrojtjes së natyrës. Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit po zbatohen. Megjithatë, monitorimi i mëtejshëm është i nevojshëm, duke synuar përshtatjet e strategjisë në përputhje me objektivin e ri të biodiversitetit të BE-së. Shqipëria po përparon mirë në krijimin e rrejtit Emerald. Megjithatë, zbatimi, dhe në veçanti menaxhimi i zonave të mbrojtura, ka nevojë për përmirësim të konsiderueshëm. Prerja e drurëve në mënyrë të paligjshme, gjuetia e paligjshme dhe ndërtimet pa leje në rezervatet natyrore mbeten shqetësime të mëdha. Inspektimet dhe sanksionet duhet të zbatohen. Sistemi efikas i monitorimit dhe informacionit duhet të zhvillohet më tej.

Për sa i përket **ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut**, niveli i përputhshmërisë është shumë i ulët dhe duhet të përshejtohet. Në veçanti, duhet të trajtohet sa më shpejt që të jetë e mundur transpozimi i Direktivës së Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes dhe zhvillimi i sistemit të lejeve bazuar në teknikat më të mira të disponueshme, përfshi pajisjen e inspektorateve mjedisore me kapacitetin e duhur për të kryer funksione kontrolli, verifikimi dhe asistencë. Përafrimi i Direktivave të Impianteve të Mëdha Djegëse, Seveso II, Furrave për djegien e Mbetjeve dhe Tretësit është gjithashtu në fazën më fillestare. Nevojiten përpjekje serioze për ngritjen e kapaciteteve institucionale.

Shqipëria ka legjislacion kombëtar që rregullon menaxhimin e **kimikateve** dhe substancave të rrezikshme. Megjithatë, ky legjislacion është vetëm pjesërisht, në përputhje me legjislacionin kryesor të BE-së në fushën e kimikateve (REACH - regjistrimi, vlerësimi dhe autorizimi i kimikateve dhe

rregulloret për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierësve). Në veçanti, nuk ekziston një autoritet i vetëm kompetent. Përgjegjësia në fushën e kimikateve është e shpërndarë në një numër ministrish me përgjegjësi të paqarta dhe të mbivendosura si dhe me kapacitete të dobëta administrative. Regjistri i substancave dhe përzierësve kimikë si edhe sistemi i klasifikimit dhe etiketimit duhet të përshtaten me kërkesat e BE-së. Mekanizmi për vlerësimin e kimikateve duhet të zhvillohet. Për sa i përket kontrollit të materialeve të rrezikshme, Shqipëria zbaton konventat përkatëse ndërkombëtare, por përputhshmëria me legjislacionin e BE-së është ende e domosdoshme. Duhet të miratohen direktivat për biocidet dhe mirëqenien e kafshëve laboratorike.

Për sa i përket kontrolleve mjedisore dhe eko-etiketimit, nuk ekziston një sistem i veçantë në Shqipëri dhe përpjekje domethënëse janë të nevojshme për të krijuar kushtet për zbatimin e duhur të këtyre sistemeve.

Shqipëria është palë e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për **ndryshimin e klimës** që prej vitit 1994 si vend jo i Aneksit I dhe gjithashtu, ka ratifikuar Protokollin e Kiotos në vitin 2004. Megjithatë, si palë që nuk i përket Aneksit I, Shqipëria nuk ka ndonjë pikësynim për kufizimin /reduktimin e emetimit të gazrave serë (GS). Shqipëria ka paraqitur dy Deklarata Kombëtare. Deklarata e dytë e dorëzuar në nëntor të vitit 2009, përfshin vlerësime për emetimin e HFC-ve, PFC-ve dhe SF<sub>6</sub>-ës. Aktualisht, Shqipëria nuk është gati të marrë mbi vete një zotim ligjor të detyrueshëm ligjor për kufizimin/reduktimin e emetimit të gazrave serë siç parashikojnë aktet normative për klimën pas vitit 2012. Shqipëria po lufton për të përmirësuar monitorimin dhe raportimin e GS-ve, për të cilin mbetet shumë për t'u bërë. Ekziston një inventar për GS-të për periudhën 1990-2000, por të dhënat për vitet e fundit nuk janë të disponueshme. Shqipëria planifikon të përfshijë një inventar të GS-ve për periudhën 2001-2010 në Deklaratën e saj të tretë Kombëtare. Nuk janë marrë masa për transpozimin dhe zbatimin e sistemit të tregtimit të emetimeve të BE-së (STE BE). Shqipëria ka bërë përpjekje për të trajtuar sektorët kryesorë jashtë STE të BE-së (p.sh transport dhe mbetjet), por masa të mëtejshme duhet të parashikohen për përafrimin me *acquis*.

Shqipëria është palë në Protokollin e Montrealit për substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit dhe ka ratifikuar të gjitha ndryshimet e këtij Protokollit. Krahasuar me BE-në dhe Shtetet Anëtare të saj, Shqipëria duhet të hartojë një kalendar më realist për heqjen nga përdorimi të substancave që dëmtojnë ozonin dhe të arrijë një nivel të kënaqshëm të respektimit të Protokollit. Shqipëria së fundmi ka dërguar njoftim për rishikimin e legjislacionit të saj për ozonin, i cili duket sikur po shkon përtej asaj që kërkohet në kuadër të Protokollit, dhe e përputh legjislacionin shqiptar me *acquis* e BE-së.

Kapacitetet administrative dhe burimet teknike dhe financiare duhet të përforcohen në mënyrë të konsiderueshme që Shqipëria të jetë në gjendje të përputhë legjislacionin e saj dhe zbatojë të gjitha kërkesat e *acquis* të BE-së për ndryshimin e klimës.

Për sa i përket **zhurmës**, transpozimi i pjesëve të *acquis* është në proces e sipër, por zbatimi është në fazë fillestare.

Këshilli i Ministrave është përgjegjës për planifikimin dhe masat reaguese në lidhje me **mbrojtjen civile**. Është krijuar një Komitet Ndërministror për Emergjencat Civile për të trajtuar çdo emergjencë

civile. Ministria e Brendshme është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile. Shqipëria gjithashtu, ka disa ligje përkatëse në zbatim. Është krijuar bashkëpunimi ndërkombëtar. Në fillim të vitit 2010, Shqipëria përdori Qendrën e Monitorimit dhe Informacionit (QMI) të vënë në funksionim nga Komisioni Europian për të reaguar ndaj përmbajtjeve të rënda. Gjithashtu, Shqipëria po mbështet bashkëpunimin rajonal për reagimin ndaj zjarreve në pyje dhe ka përmirësuar kapacitetet e saj kombëtare për shuarjen e zjarrit.

### *Konkluzioni*

Përpyetje të konsiderueshme nevojiten për të rishikuar kuadrin legjislativ kombëtar ekzistues me qëllimin për ta përputhur atë plotësisht me *acquis* mjedisor të BE-së. Procesi i planifikimit strategjik në të gjithë sektorët duhet të përshpejtohet dhe duhet të sigurohet një financim i qëndrueshëm për zbatimin, përfshi krijimin e një fondi mjedisor të posaçëm. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet cilësisë së transpozimit të legjislacionit të BE-së dhe sigurimit të zbatimit të duhur. Mjedisi duhet të integrohet në sektorë të tjerë, si në nivelin e zbatimit strategjik ashtu edhe në atë të zbatimit të politikave. Zhvillimi i një sistemi gjithëpërfshirës monitorimi dhe informacioni mjedisor në të gjithë sektorët duhet të trajtohet urgjentisht.

Kapaciteti administrativ duhet të përforcohet në mënyrë domethënëse, përfshi plotësimin e mangësive ekzistuese, harmonizimin e përgjegjësive aktualisht të copëzuara, dhe të sigurohet koordinimi horizontal dhe vertikal i duhur. Veçanërisht në nivelin vendor, duhet të kushtohet kujdes për të siguruar që autoritetet vendore kanë burimet e nevojshme për të kryer detyrën me efikasitet. Kapacitetet zbatuese të inspektorateve duhet të përforcohen në mënyrë të konsiderueshme, duke bërë përshtatjet legjislative të domosdoshme, duke ngritur kapacitetet e përgjithshme dhe duke siguruar një bashkëpunim efikas me sistemin gjyqësor.

*Në tërësi*, Shqipëria do të duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme për të përputhur legjislacionin e saj me *acquis* mjedisore dhe ta zbatuar atë me efikasitet për një periudhë afatmesme. Do të jetë veçanërisht e rëndësishme, të krijohen kushtet për ngritjen e kapaciteteve dhe burimeve të nevojshme teknike dhe njerëzore në këtë fushë brenda viteve të ardhshme. Përputhshmëria efikase me legjislacionin e BE-së që kërkon një nivel të lartë e të qëndrueshëm investimi dhe përpjekje të konsiderueshme administrative, mund të arrihet vetëm në një periudhë afatgjatë.

### **3.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e Konsumatorit dhe e Shëndetit**

*Acquis* për mbrojtjen e konsumatorit mbulon sigurinë e mallrave të konsumit, si edhe mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorit në një numër specifik sektorësh. Shtetet Anëtare duhet të përafrojnë legjislacionin e brendshëm me *acquis*, të krijojnë struktura të pavarura administrative dhe autoritete me kompetenca zbatuese, për të mundësuar mbikëqyrje efikase të tregut dhe zbatim të ligjit. Duhet të sigurohen gjithashtu, mekanizma të përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve si në gjykatë ashtu edhe jashtë gjykatës, informacioni dhe edukimi i konsumatorit, si edhe një rol funksional për organizatat e konsumatorit. Ky kapitull gjithashtu mbulon rregulla në fushën e shëndetit publik.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* parashikon rritjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së konsumatorit duke synuar përafrimin e standardeve përkatëse me ato të Bashkimit Europian, përfshi mbrojtjen aktive të konsumatorit dhe zbatimin me efikasitet të ligjit.

Kuadri i përgjithshëm për **mbrojtjen e konsumatorit** në Shqipëri është mishëruar në strategjinë kombëtare ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut, të miratuar në vitin 2007, dhe përfshin produktet industriale, ushqimore dhe farmaceutike. Politikat janë të hartuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE). Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndihmës Shtetërore, që funksionon nën Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore në METE, është përgjegjëse për përgatitjen e legjislacionit dhe hartimin e politikave në këtë sektor. Inspektorati Qendror Teknik (IQT) nën METE, me 67 inspektorë në Tiranë dhe zyrat rajonale kryen disa aktivitete të mbikëqyrjes së tregut. Megjithatë, zbatimi i planit strategjik dhe metodologjisë së përshtatshme është ende pezull. Qeveria nuk ka caktuar ende personelin shtesë për vënien në zbatim të Direktivës së Përgjithshme të Sigurisë së Produktit. Kapacitetet institucionale dhe administrative duhet të rriten për të siguruar mbikëqyrjen eficiente të tregut.

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit kryesohet aktualisht nga METE dhe anëtarët e tij emërohen nga Kryeministri. Pavarësia dhe paanësia e tij si organ përgjegjës për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorit do të duhet të përforcohet. Këshilli i Mbrojtjes së Konsumatorit, i krijuar me ligj si forum këshillimor, për të mbledhur së bashku përfaqësuesit e qeverisë, organizatat e konsumatorit dhe bizneset nuk ka zhvilluar akoma mbledhjen e parë. Aktualisht në Shqipëri, ekzistojnë dhe funksionojnë dy organizata të mbrojtjes së konsumatorit.

Për sa i përket *masave të sigurisë së produktit*, niveli i përafrimit të legjislacionit shqiptar me Direktivën e Përgjithshme të Sigurisë së Produktit, mund të konsiderohet i kënaqshëm për momentin. Megjithatë, për të arritur përputhshmëri të plotë me legjislacionin dytësor të BE-së në këtë sektor, Shqipërisë do t'i duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme, veçanërisht duke ndryshuar legjislacionin e sigurisë së përgjithshme të produktit.

Në rastin e *masave jo të lidhura me sigurinë*, Shqipëria ka miratuar tashmë legjislacionin për përafrimin me pjesën më të madhe të *acquis* për konsumatorin, por kuadri institucional i domosdoshëm, për të zbatuar të drejtat e konsumatorit nuk është krijuar ende plotësisht. Në disa fusha, autoriteti përgjegjës mbetet ende për t'u caktuar (p.sh. për paketat e udhëtimit, paketat për turnetë ose ekskursionet e organizuara për pushime, etj.), ndërsa për të tjerat, kompetencat e disa autoriteteve zbatuese duhet të përcaktohen më qartë.

Gjithashtu, mjetet e zbatimit dhe hetimit, së bashku me burimet e disa autoriteteve (p.sh. Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit), duhet të përmirësohen më tej në mënyrë që të trajtojnë me efektshmëri shkeljet e ligjeve të konsumatorit.

Për sa i përket **shërbimit shëndetësor publik**, qëllimi i përgjithshëm i politikës së BE-së është përmirësimi i shëndetit dhe parandalimi i sëmundjeve njerëzore. *Acquis* e BE-së në këtë fushë përbëhet nga pak instrumente detyruese ligjore dhe shumë masash e dokumentesh politikë jodetyrues, si edhe nga dy angazhime ndërkombëtare për shëndetin.

Ministria e Shëndetësisë (MSH) është përgjegjëse për përcaktimin, koordinimin dhe drejtimin e politikës së shërbimit të përgjithshëm shëndetësor (shëndetit publik). Instituti i Shëndetit Publik asiston ministrinë me monitorime, analiza, informimin publik dhe rritjen e ndërgjegjësimit. Prioritetet aktuale të shëndetit përfshijnë përmirësimin e shërbimeve të ndihmës së shpejtë, përmirësimin e aksesit në kujdesin për shëndetin publik në të gjithë vendin, zhvillimin e kapaciteteve për të trajtuar epidemitë dhe informatizimin e mëtejshëm të shërbimeve shëndetësore.

Shpenzimet qeveritare për shëndetin janë të ulëta (2.8% e PPB-së). Ekzistojnë ndryshimet në lidhje me mbulimin nga shërbimet bazë shëndetësore për shkak të shpërndarjes gjeografike të ofruesve të shërbimit, aksesit të kufizuar në zonat e largëta dhe kërkesave që kufizojnë regjistrimin në skemat e sigurimeve. Ekziston një problem i madh për pacientët që u duhet të kryejnë pagesa informale për të marrë kujdesin shëndetësor.

Ligji për Shërbimet Shëndetësore u miratua në mars të vitit 2009, si ligj kuadër që përcakton parimet bazë dhe kuadrin rregullator për organizimin dhe funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Në maj të vitit 2009, Ligji për Kujdesin Shëndetësor Publik u miratua për të përcaktuar aktivitetet dhe shërbimet e sistemit të shërbimit publik, rolin e shtetit në sigurimin e financimit për shërbimet e shëndetit publik dhe shpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet institucioneve përkatëse. Qeveria aktualisht po punon për aktet nënligjore specifike për të zbatuar Ligjin për Kujdesin e Shëndetit Publik, disa prej të cilave janë të lidhura me sëmundjet infektive.

Në fushën e kontrollit të duhanit, përafrimi me *acquis* është jo i plotë, veçanërisht në lidhje me burnotin, rregullat e detajuara për paralajmërimet dhe garancitë shëndetësore. Një program i qartë për përafrimin dhe zbatimin e plotë të masave të kontrollit të duhanit mungon. Një angazhim i qartë për kufizimet e reklamimit të duhanit dhe produkteve të duhanit mbetet i domosdoshëm. Për sa i përket mbrojtjes nga tymi i duhanit në mjedis, masat e paqarta po krijojnë vështirësi në zbatimin e dispozitave ligjore.

Për sa i përket *sëmundjeve infektive*, ekziston baza e nevojshme ligjore, por ajo duhet të zhvillohet më tej për t'u përputhur plotësisht me legjislacionin e BE-së. Sëmundjet infektive nuk janë shkak kryesor i vdekshmërisë, por rëndojnë ndjeshën në patologji të ndryshme. Sëmundjet që parandalohen me vakcina duken se janë në përgjithësi, nën kontroll dhe shkalla e imunizimit është shumë e lartë (mbi 95%). Shqipëria u shpall si vend pa sëmundjen e poliomielitit në vitin 2002. Me gjithë pakësimin, sëmundjet që transmetohen përmes ujit përbëjnë ende një problem shëndetësor publik të madh. Po shfaqen kërcënime të reja, si HIV/SIDA dhe infeksione seksualisht të transmetueshme, megjithatë përhapja e HIV/SIDA është e ulët. Ekziston një sistem për paralajmërimin fillestar të sëmundjeve infektive, por duhet të përputhet me *acquis*.

Në lidhje me rregullat e sigurisë dhe cilësinë për gjakun, indet dhe qelizat njerëzore, përafrimi i legjislacionit për gjakun me *acquis* e BE-së ka përparuar mirë. Riorganizimi i shërbimit të transfuzionit të gjakut është në proces, siç është planifikuar në strategjinë kombëtare, e cila parashikon pesë banka gjaku rajonale, përfshi Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, 15 banka gjaku në rrethe dhe 11 banka gjaku në spitale. Deri më sot, analizat e gjakut janë të centralizuara në nivel kombëtar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, ndërsa përpunimi i gjakut është përqendruar në dy banka rajonale (Tiranë dhe Vlorë) nga pesë të përfshira në plan. Strategjia Kombëtare synon të kalojë



nga sistemi ekzistues me dhurues me pagesë dhe me zëvendësim gjaku në një përjasje krejtësisht vullnetare me dhurim pa pagesë. Në rastet e indeve dhe qelizave, përafrimi me *acquis* është në një fazë shumë fillestare.

Kushtet dominuese në fushën e *shëndetit mendor* përbëjnë shqetësim, veçanërisht në lidhje me deinstitutionalizimin e pacientëve afatgjatë në spitalet psikiatrike. Angazhimet e politikës do të duhet të mbështeten nga ofrimi i kujdesit shëndetësor mendor adekuat të bazuar në komunitet, në të gjithë vendin.

Për sa i përket parandalimit të abuzimit *me pijet alkoolike dhe drogën*, Shqipëria ka ngritur struktura për zhvillimin e politikave të shëndetit publik, duke siguruar një drejtim në nivel kombëtar në mbështetje të shëndetit dhe mbledhjen e informacionit mbi shëndetin publik. Hapat e para janë hedhur për të zhvilluar shërbime për trajtimin e çrregullimeve të shkaktuara nga abuzimi me pijet alkoolike. Një strategji kombëtare për drogat është vënë në zbatim që në vitin 2004, por strategjia kombëtare për alkoolin është ende në fazën e planifikimit. Meqenëse alkooli njihet si një nga përcaktuesit kryesorë të shëndetit, që llogaritet se shkakton 6% të barrës së sëmundjeve në Shqipëri, atëherë miratimi, dhe zbatimi dhe monitorimi i kujdesshëm i një strategjie të tillë janë shumë të rëndësishme, pa përmendur këtu rregullimin e shitjes së pijeve alkoolike.

Nuk ekziston aktualisht një dokument i veçantë për politikën e e-shëndetit, megjithëse plani dhe objektivat për të promovuar përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në sektorin shëndetësor janë të përcaktuara në një kapitull të veçantë të Strategjisë Kombëtare të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

Një strategji kombëtare për *kancerin* po përgatitet. Megjithatë, programet e kontrollit për kancerin e gjirit, të qafës së mitrës dhe të zorrës së trashë e rektumit nuk janë krijuar ende. Aktualisht, nuk ekziston asnjë kuadër legjislativ për mbrojtjen ndaj fushave elektromagnetike në Shqipëri.

### *Konkluzioni*

Masat për mbrojtjen e konsumatorëve duhet të zbatohen në një kuadër që garanton autoritete publike efikente dhe me përfshirjen aktive të OJF-ve që mbrojnë konsumatorin. Plotësimi i kuadrit legjislativ të përshtatshëm dhe të përditësuar duhet të kombinohet me një sistem efikas për zbatimin dhe monitorimin. Masa të mëtejshme do të duhet të merren për të përmirësuar efikasitetin e sistemeve shëndetësore për të trajtuar çështjet e shëndetit publik dhe uljen e kontrasteve sociale dhe rajonale në lidhje me aksesin në shërbimet shëndetësore. Në *tërësi*, Shqipëria do të duhet të bëjë përpjekje shtesë për të përafruar *acquis* dhe për ta vënë atë në zbatim në mënyrë efikase për një periudhë afatmesme.

### **3.29. Kapitulli 29: Bashkimi Doganor**

*Acquis* në këtë sektor përbëhet nga Kodi Doganor i BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, Nomenklatura e Kombinuar, Tarifa e Përbashkët Doganore duke përfshirë preferencat tregtare, kuotat tarifore dhe përjashtimet nga tarifatat doganore dhe legjislacioni tjetër në lidhje me doganat jashtë fushës së veprimit të Kodit Doganor. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë krijimin e kapaciteteve zbatuese dhe

ekzekutuese, përfshirë lidhjet me sistemet doganore të informatizuara të BE-së (p.sh sistemet në lidhje me tarifën, NCTS- sistemi i ri i informatizuar i transitimit), ECS- Sistemi i Kontrollit të Eksporteve, ICS- Sistemi i Transportit të Integruar dhe EOS- Sistemet e Operatorit Ekonomik). Administrata doganore duhet të sigurojë gjithashtu, kapacitetin e duhur për zbatimin dhe respektimin e rregullave të veçanta të parashtruara në fushat e *acquis* që kanë lidhje me doganat, siç janë dispozitat për tregtinë e jashtme, shëndetin dhe sigurinë.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)* parashikon krijimin e një zone të tregtisë së lirë me BE-në dhe heqjen e menjëhershme ose progresive të detyrimeve doganore për një gamë të gjerë produktesh. MSA-ja përcakton detyrimin e Shqipërisë për të zbatuar Nomenklaturën e Kombinuar. Gjithashtu, MSA-ja parashikon bashkëpunimin administrativ për çështjet doganore, dhe rregullat e origjinës, të cilat duhet të respektohen me qëllim që të përfitohet nga preferencat tregtare.

Për sa i përket **legjislacionit doganor**, Shqipëria zbaton tashmë Nomenklaturën e Kombinuar dhe rregullat e saj të klasifikimit janë gjerësisht në përputhje me *acquis*, megjithëse zbatimi i tyre në praktikë nuk është gjithmonë konsistent. Sistemet ekzistuese të informimit tarifor doganor të detyrueshëm, pezullimet e tarifave, kuotat e tarifave dhe lehtësimi i detyrimeve janë të ngjashme me ato të BE-së, por akoma nuk janë të harmonizuara plotësisht. Në momentin e anëtarësimit në BE, Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin e të gjithë legjislacionit të BE-së që ka lidhje me doganat. Legjislacioni doganor shqiptar nuk përfshin akoma masat e sigurisë ose konceptin e operatorit ekonomik të autorizuar (OEA). Sistemi i tarifave administrative për mbikëqyrjen dhe kontrollin doganor do të duhet të analizohet hollësisht, meqenëse disa nga tarifën e aplikuar mund të mos jenë në përputhje me *acquis*. Shqipëria do të duhet të përafrojë procedurat e saj të transitit në përgatitje për anëtarësimin në Konventën e Përbashkët të Transportit. Është bërë pranimi i përkohshëm në *ATA carnet*, por nuk po zbatohet akoma në praktikë sepse nuk ka garantues kombëtar.

Sistemi i Shqipërisë për rregullat preferenciale të origjinës dhe metodat e bashkëpunimit administrativ janë gjerësisht si ato që përdor BE-ja në marrëveshjet e saj të tregtisë së lirë. Shqipëria zbaton akumulimin diagonal me BE-në dhe vendet e tjera pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit. Për shkak të shqetësimeve për faturat nën kosto, çmimet e referencës përdoren shpesh si metoda vlerësimi alternative. Aktualisht, vlera e transaksionit njihet vetëm për rreth 80% të importeve, një nivel ky më i ulët se standardet e BE-së.

Legjislacioni dhe procedurat doganore sigurojnë një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale i cili është gjerësisht i ngjashëm me nivelin e BE-së, megjithëse kërkohen më shumë përpjekje për të siguruar zbatim efikas, përfshirë përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Për sa i përket **kapacitetit administrativ dhe operacional**, janë krijuar strukturat ligjore dhe administrative për të zbatuar dhe garantuar zbatimin e rregullave doganore. Njësia e Auditit të Brendshëm luan një rol të rëndësishëm në zbatimin e njëtrajtshëm të rregullave në të gjithë vendin. Burimet në përgjithësi janë të mjaftueshme, por infrastruktura dhe pajisjet do të kenë nevojë të përmirësohen për t'iu përgjigjur sfidave të së ardhmes dhe do të jetë i nevojshëm shtimi i kapaciteteve për të zbatuar dhe siguruar respektimin e *acquis* së BE-së, duke përfshirë fushën e teknologjisë së informacionit. Stabiliteti dhe pavarësia e administratës doganore duhet të përforcohet, veçanërisht në lidhje me statusin e punonjësve të saj. Perceptimi i korrupsionit në administratën doganore është i

lartë dhe Shqipëria duhet të vazhdojë me vendosmëri përpjekjet e saj për ta zgjidhur këtë problem. Nevojitet përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstucional dhe i shkëmbimeve të informacionit, si brenda vendit ashtu edhe me vendet fqinje, për të përmirësuar sigurinë në kufi dhe luftën kundër trafikeve të paligjshme.

Sistemi i menaxhimit të riskut është adekuat nga pikëpamja e arkitekturës së sistemit, funksioneve dhe strukturës së drejtimit, megjithëse nevojiten përmirësime në zbulimin e parregullsive. Kontrollat pas zhdoganimit do të duhet të kryhen sistematikisht për të kompensuar për përqindjen e ulët të kontrolleve fizike dhe të dokumentacionit dhe për të vendosur një ekuilibër ndërmjet lehtësimit të tregtisë dhe kontrolleve efikente.

Duhet të krijohet baza ligjore për lehtësimin e tregtisë (procedura të thjeshtuara dhe OEA) dhe nevojitet përdorim më i gjerë i procedurave të thjeshtuara për të zgjeruar praktikën e kryerjes së formaliteteve doganore në lokalet e bizneseve. Në tërësi, vëmendje e duhur duhet t'i kushtohet zhvendosjes së fokusit të administratës doganore nga mbledhja e taksave te lehtësimi i tregtisë dhe mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së qytetarëve.

Sistemi ekzistues i informatizuar i deklarimit dhe përpunimit (ASYCUDA) mundëson analizat e riskut të të gjithë dokumentacioneve të regjistruara dhe gjithashtu, përfshin disa masa bazë për të filluar menaxhimin e bazuar në performancë. Sistemi përfshin regjistrime të deklarimit dhe informacion të para-mbërritjes *on-line*. Megjithatë, sistemi shqiptar i teknologjisë së informacionit nuk është në përputhje me sistemin e ri të informatizuar të transitimit (NCTS), sistemin e menaxhimit të integruar të transitimit (ITMS) dhe specifikime të tjera të BE-së që kanë të bëjnë me doganat elektronike. Nevojitet përmirësimi i infrastrukturës për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të Qendrës Kompjuterike të Doganave, duke përfshirë krijimin e një qendre për rikuperimin e të dhënave në rastin e shkatërrimit të sistemit të kompjuterizuar të doganave. Kërkohe përpjekje shtesë për informatizimin, për të mundësuar plotësimin elektronik të të gjitha formaliteteve dhe shkëmbimeve doganore ndërmjet operatorëve dhe doganave, në përputhje me Kodin Doganor të modernizuar të BE-së. Në periudhën afatmesme duhet të miratohen strategjitë e biznesit dhe të teknologjisë së informacionit dhe duhet të forcohen metodat e zhvillimit të sistemeve.

### *Konkluzioni*

Legjislacioni doganor shqiptar është pjesërisht në përputhje me *acquis*. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në disa fusha, së bashku me harmonizimin e përgjithshëm me legjislacionin doganor të BE-së. Kapaciteti administrativ dhe operacional i administratës doganore do të duhet të përforcohet për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit ekzistues dhe për t'iu përgjigjur sfidave të së ardhmes. Duhet të forcohet kapaciteti i Teknologjisë së Informacionit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndërlidhjes dhe ndërfunksionimit me sistemet e informatizuara të BE-së.

*Në tërësi*, Shqipëria akoma përballlet me sfida në fushat e harmonizimit të legjislacionit dhe të kapacitetit administrativ, por pritet që në periudhën afatmesme, Shqipëria të plotësojë kërkesat e *acquis* nëse vazhdon përpjekjet me këtë ritëm.

### 3.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me Jashtë

*Acquis* në fushën e marrëdhënieve të jashtme përbëhet kryesisht nga legjislacion drejtpërdrejt i detyrueshëm i cili nuk kërkon transpozim në legjislacionin e brendshëm. Në fushën e ndihmës humanitare dhe politikës së zhvillimit, vendet aplikuese duhet të sigurojnë përputhjen me legjislacionin e BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare të tij dhe të sigurojnë kapacitetin për të marrë pjesë në politikat e të BE-së.

*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit* (MSA) përfshin një pjesë thelbësore që përqendrohet mbi tregtinë, dhe që krijon një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së. MSA-ja përfshin dispozita në disa fusha ku i kërkohet palëve të vepronë në përputhje me rregullat e OBT-së ose me detyrimet ndërkombëtare përkatëse. Shqipëria duhet të zgjerojë bashkëpunimin, përfshirë liberalizimin e tregtisë, me vendet e rajonit dhe me vendet e tjera të përfshira në procesin e zgjerimit.

Në momentin e anëtarësimit në BE, Shqipëria ka për detyrë të respektojë **politikën e përbashkët tregtare**. Shqipërisë do t'i duhet të zbatojë të gjitha marrëveshjet autonome tregtare (preferenciale dhe jo-preferenciale) që BE-ja u akordon vendeve të caktuara jo-anëtare të BE-së, përfshirë edhe Sistemin e Përgjithësuar të Preferencave (GSP). Aktualisht Shqipëria nuk zbaton asnjë program të GSP-së. Shqipërisë do t'i duhet gjithashtu, që t'u japë fund të gjitha marrëveshjeve ekzistuese të tregtisë preferenciale me vendet jo-anëtare të BE-së dhe t'i ndryshojë të gjitha marrëveshjet e tjera, përfshirë edhe marrëveshjet tregtare jo-preferenciale, për të qenë në përputhje me detyrimet e anëtarësisë së BE-së. Shqipëria gjithashtu, do të bëhet pjesë e Zonës Ekonomike Europiane (ZEE) dhe me pranimin në BE, do t'i duhet të zbatojë të gjithë marrëveshjet tregtare ndërkombëtare të BE-së.

Shqipëria është anëtare e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë për Europën Qendrore (CEFTA). Shqipëria ka marrëveshje të tregtisë së lirë me Turqinë. Marrëveshja e tregtisë së lirë me Shoqatën Europiane të Tregtisë së Lirë (EFTA) pritet të ratifikohet. Normat tarifore *ad valorem* mesatare shqiptare të kombit më të favorizuar (KMF) janë 7.6% për prodhimet e bujqësisë, 0.0% për peshkun dhe produktet e peshkimit dhe 4.44% për mallrat industriale, me një mesatare të përgjithshme prej 5.2%.

Mesatarja e BE-së për normat tarifore *ad valorem* të kombit më të favorizuar janë 9.74% për produktet bujqësore, 10.02% për peshkun dhe produktet e peshkimit dhe 3.75% për mallrat industriale, me një mesatare të përgjithshme prej 4.83%. Në momentin e anëtarësimit në BE, Shqipëria do të duhet të vërë në zbatim Tarifat e Përbashkëta Doganore të BE-së.

Shqipëria është anëtare e OBT-së që nga viti 2000. Për sa i përket marrëveshjeve shumëpalëshe, Shqipëria është palë në Marrëveshjen për tregtinë e avionëve civilë. Kalendarin e Shqipërisë për plotësimin e angazhimeve në kuadër të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë dhe Shërbimet (GATS), dhe si kufizimet horizontale ashtu edhe angazhimet për sektorët e veçantë, ndryshojnë në përgjithësi, nga angazhimet e ndërmarra nga BE-ja. Në përgjithësi, Shqipëria ka më pak angazhime horizontale se sa BE-ja për sa i përket numrit të sektorëve apo nënsektorëve për të cilët janë marrë angazhime. Angazhimet sektoriale apo nënsektoriale nga Shqipëria dhe BE-ja nuk kanë të njëjtin nivel kufizimesh si për aksesin në treg ashtu edhe për trajtimin kombëtar. Shqipëria ka thelbësisht më pak angazhime për sektorë e veçantë se sa BE-ja dhe sistemi shqiptar është më i liberalizuar. Shqipëria gjithashtu, ka më pak përjashtime të KMF-së se sa BE-ja. Me qëllim që të shmangë kompensimin sipas

nenit XXI të GATS, me pranimin në BE, Shqipëria do të duhet të vlerësojë nëse do të ndryshojë ose do të tërhiqet nga angazhimet e saj në disa sektorë delikatë për BE-në. Asnjë nga angazhimet e Shqipërisë në kuadër të GATS-it, nuk cenon aftësinë e saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE.

Shqipëria ka në fuqi traktate dypalëshe investimi (TDI) me 37 vende dhe 8 marrëveshje të tjera mbeten për t'u nënshkruar. Për më tepër, Shqipëria po negocion aktualisht për 13 TDI të tjera. Disa nga dispozitat e TDI-ve të Shqipërisë do të duhet të harmonizohen me *acquis* për të përmbushur detyrimet e Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian dhe vendimet relevante të gjykatave të Bashkimit Europian. Disa TDI nuk parashikojnë përjashtime nga transfertat pa pagesë të fondeve që kanë lidhje me investimet ndërmjet palëve nënshkruese dhe parashikojnë rregulla për trajtimin kombëtar përpara regjistrimit të shoqërisë tregtare, për investitorët e vendeve të treta në lidhje me shërbimet e ofruara.

Shqipëria ka ligje në fuqi për masat e "antidumping" dhe balancuese për të kompensuar dëmin e shkaktuar nga importet e subvencionuara. Me pranimin në BE, Shqipëria duhet të shfuqizojë legjislacionin kombëtar të lidhur me instrumentet e mbrojtjes së tregtisë dhe masat e bazuara në këtë legjislacion.

Për sa i përket kapacitetit administrativ, pjesëmarrja në mekanizmat e vendimmarrjes së BE-së për tregtinë dhe zbatimin dhe sigurimin e respektimit të *acquis* do të kërkojnë forcimin e Drejtorisë së Politikave Tregtare në METE. Mekanizmi ekzistues për koordinimin ndërmjet ministrive duhet të përforcohet më tej.

Shqipëria nuk ka sistem *kreditimi për eksportin*. *Acquis* për kreditimin e eksportit do të duhet të vihet në zbatim me anëtarësimin në BE.

Shqipëria ka legjislacion në fuqi për kontrollet e *eksporteve me përdorim të dyfishtë*, por ky legjislacion nuk është akoma në përputhje të plotë me *acquis*. Disa pjesë të këtij legjislacioni janë të ndryshme nga legjislacioni aktual i BE-së, veçanërisht nga Rregullorja e fundit e BE-së (Rregullorja 428/2009), dhe lista e artikujve të kontrolluar përpara eksportimit nuk bazohet në këtë Rregullore.

Në lidhje me **politikën e zhvillimit dhe ndihmën humanitare**, Shqipëria është palë nënshkruese e Deklaratës së Mijëvjeçarit dhe mbështet Konsensusin e Montereit për financimin e zhvillimit. Shqipëria është përfituese e ndihmës dhe nuk ka as kuadër politikash dhe as struktura administrative për politikat e zhvillimit dhe të ndihmës humanitare. Ajo ka dhënë ndihmë të kufizuar *ad hoc* për vendet jo-anëtare të BE-së në përgjigje të fatkeqësive natyrore. Shqipëria do të duhet të miratojë kuadrin ligjor dhe material për ndihmën humanitare për vendet jo-anëtare të BE-së dhe ndihmën për mbrojtjen civile për Shtetet Anëtare dhe vendet jo-anëtare të BE-së, në përputhje me parimet e miratuara tashmë nga Bashkimi Europian, veçanërisht Rregullorja 1257/96. Shqipëria do të duhet të përforcojë strukturën administrative brenda ekzekutivit dhe aftësinë e saj për të marrë pjesë në procesin vendimmarrës të BE-së për politikat e zhvillimit dhe të ndihmës humanitare. Ndryshimi nga përfitues në donator të asistencës së jashtme do të kërkojë mbështetjen aktive të një shoqërie civile të mirinformuar.

*Konkluzioni*

Në tërësi, në lidhje me marrëdhëniet e jashtme, Shqipëria duhet të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e BE-së brenda periudhës afatmesme, nëse vazhdon harmonizimin me *acquis* dhe nëse forcohet kapaciteti institucional për zbatimin dhe sundimin e ligjit. Gjatë përgatitjes për anëtarësim, veprimet dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadrin e organizatave ndërkombëtare, duhet të jenë të harmonizuara dhe të koordinuara me ato të BE-së.

### 3.31. Kapitulli 31: Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes

Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë (PPJS) dhe politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes (PPSM) janë të bazuara në akte ligjore, duke përfshirë marrëveshje ndërkombëtare të detyrueshme ligjorisht si edhe dokumentet e politikave. *Acquis* përmban deklarata politike, veprime të përbashkëta, marrëveshje dhe qëndrime të përbashkëta. Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë dialogun e përbashkët brenda kuadrit të PPJS-së, të sigurojnë përputhjen e qëndrimeve të tyre me deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimet e BE-së, dhe të zbatojnë masat kufizuese të miratuara. Vendeve aplikante u kërkohet të bëjnë gradualisht harmonizimin me deklaratat e BE-së dhe të zbatojnë masat kufizuese si dhe kur të kërkohet.

Shqipëria mbështet plotësisht përpjekjet e Bashkimit Europian për të përforcuar rolin e vet si një forcë e vetme në marrëdhëniet e jashtme dhe aftësinë e saj për të promovuar interesat dhe vlerat europiane në skenën ndërkombëtare. Shqipëria është e angazhuar seriozisht për të qenë gati dhe e aftë për të marrë pjesë plotësisht dhe në mënyrë aktive në PPJS-në dhe PPSM-në e BE-së, siç përcaktohet në Traktatin për Bashkimin Europian, që nga data e anëtarësimit.

Strukturat administrative të Shqipërisë janë në përgjithësi adekuate, megjithëse pjesë të saj janë akoma në zhvillim ose në ristrukturim. Shqipëria ka 40 ambasada (gjashtë të tjera po hapen), gjashtë përfaqësi të përhershme dhe gjashtë konsullata të përgjithshme. Shërbimi diplomatik përbëhet nga 615 punonjës, prej të cilëve 187 në Tiranë. Zhvillimi dhe ristrukturimi i administratës duhet të vazhdojë me qëllim që Shqipëria të jetë në gjendje të marrë pjesë plotësisht në PPJS-ë dhe PPSM-ë.

Për sa i përket **dialogut politik**, Shqipëria ka vendosur konsultime të ngushta politike me Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ky konsultim kryhet brenda strukturave të MSA-së. Që nga janari i vitit 2004, Shqipëria në shumicën e rasteve, kur është ftuar, ka mbajtur qëndrim të njëjtë me vendimet e Këshillit, demarshet dhe deklaratat e BE-së. Megjithatë, në qershor 2003, Shqipëria nënshkroi me SHBA-në Marrëveshjen për nenin 98 të Statutit të Romës me SHBA, e cila nuk është në përputhje me qëndrimin e BE-së. Shqipëria do të duhet të ndryshojë legjislacionin në këtë fushë përpara anëtarësimit.

Politika e jashtme e Shqipërisë synon në krijimin e marrëdhënieve konstruktive dypalëshe dhe shumëpalëshe. Në këtë kontekst, Shqipëria ka për qëllim të rrisë rolin e saj në promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon. Ajo është aktive në të gjitha organizatat dhe iniciativat shumëpalëshe me fokus në Europën Juglindore dhe luan një rol pozitiv. Ajo mban presidencën e MARRI-t (Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët) për periudhën 2010-2011.

Në tërësi, marrëdhëniet dypalëshe të Shqipërisë nuk paraqesin ndonjë problem të madh.

Për sa i përket *masave kufizuese*, Shqipëria ka zbatuar të gjitha masat kufizuese të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe ka miratuar aktet ligjore të domosdoshme për këtë qëllim.

Në lidhje me *mospërhapjen dhe strategjinë e armëve të dëmtimit në masë/armëve të vogla dhe armëve të lehta (ADM/AVAL)*, Shqipëria merr pjesë në marrëveshjet ndërkombëtare të kontrollit të eksporteve dhe instrumentet në lidhje me mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë. Ajo ka aplikuar të bëhet palë e Marrëveshjes Wassenaar për kontrollet e eksporteve për armët konvencionale dhe mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë. Ligjet dhe sistemi i kontrollit i Shqipërisë përputhen me angazhimet ndërkombëtare të AVAL-it, duke përfshirë strategjinë e BE-së. Megjithatë, deri tani, Shqipëria nuk ka strategji kombëtare për AVAL. Shqipëria ka deklaruar qëllimin e saj për të përfunduar dhe miratuar një strategji kombëtare për AVAL deri nga fundi i vitit 2010. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të zhvilluar regjistrin elektronik të armëve dhe municionit, nën administrimin e Policisë së Shtetit. Shkatërrimi i armëve dhe municioneve të tepërta kryhet në përputhje me një plan veprimi i cili do të përfundohet në vitin 2013, por kjo kërkon fonde të konsiderueshme.

Në lidhje me *bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare*, Shqipëria është anëtare e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës, OSBE-së, NATO-s dhe shumë organizatave e marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare.

Shqipëria ka miratuar bazat ligjore dhe planet praktike të domosdoshme për të siguruar përputhshmërinë me vendimet e Këshillit për sigurinë e informacionit, duke përfshirë administrimin e informacionit të klasifikuar. Megjithatë, ajo nuk ka lidhur akoma një marrëveshje sigurie me BE-në për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.

Shqipëria është gati të marrë pjesë aktive në misione të ndryshme *civile dhe ushtarake për menaxhimin e krizave*. Vendi tashmë ka një grup prej 12 personash që marrin pjesë në operacionet e ALTHEA-s për asgjësimin e municioneve dhe eksplozivëve si dhe një oficer në Shtabin e Përgjithshëm. Në Çad, një grup prej 63 ushtarakësh nga Shqipëria mori pjesë në EUFOR Çad/RAQ (tani nën MINURCAT). Shqipëria ka marrë pjesë në misionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara në Irak dhe Afganistan dhe ka kontribuar në KFOR. Bashkëpunimi me misionin e shtetit të së drejtës të BE-së (EULEX) në Kosovë duket se është përmirësuar dhe nuk përbën shqetësim aktualisht. Disa marrëveshje në vitet 2008 dhe 2009 vendosën bazën ligjore për këtë bashkëpunim.

Duhet të përmirësohen më tej shërbimet e emergjencave civile dhe gatishmëria ndaj fatkeqësive.

### *Konkluzioni*

*Në tërësi*, Shqipëria duhet të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kuadrin e PPJS-ë dhe PPSM-ë në periudhën afatmesme, nëse merr masat e nevojshme ligjore dhe administrative dhe nëse bën përshtatjet e duhura.

### 3.32. Kapitulli 32: Kontrolli Financiar

*Acquis* për kontrollin financiar ka lidhje me fushat e mëposhtme të politikave: *kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP)*, i cili përfshin standarde të miratuara në nivel ndërkombëtar dhe praktikën më të mirë të BE-së për t'u zbatuar në mbarë sektorin publik, si dhe *auditin e jashtëm* që përfshin pavarësinë operacionale dhe financiare të funksionit të auditit të jashtëm (zyra kombëtare e auditit). Menaxhimi dhe kontrolli i fondeve të BE-së është trajtuar në kapitujt e tjerë përkatës (p.sh. për bujqësinë dhe zhvillimin rural, politikën rajonale, koordinimin e instrumenteve strukturore ose peshkimin). Ky kapitull përfshin aspekte më të përgjithshme të kontrollit të brendshëm dhe auditit të jashtëm të fondeve kombëtare. Ai përfshin gjithashtu, mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, përfshirë bashkëpunimin administrativ dhe mbrojtjen penale (Konventa për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Europiane [Konventa PIF] dhe protokollat e saj). Së fundi, seksioni për mbrojtjen e euros kundër falsifikimeve trajton aspektet e shtyllës së parë të kësaj çështjeje.

Në Shqipëri, sistemi i **kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP)** po zhvillohet më tej. Dokumenti i parë i politikës për KBFP-në, i miratuar në qershor të vitit 2005, është rishikuar për periudhën 2009–2014 dhe thekson rëndësinë e parimit të llogaridhënies administrative, e cila i kalon kufijtë e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Kjo strategji përcakton prioritetet e zhvillimit dhe masat e nevojshme për t'u ndërmarrë në të ardhmen. *Ligji për Buxhetin* (i ndryshuar për herë të fundit në vitin 2008), *Ligji për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar*, i korrikut 2010 dhe *Ligji për Auditimin e brendshëm* i vitit 2007 (i ndryshuar për herë të fundit në shtator 2010) sigurojnë bazën ligjore për zhvillimin e KBFP-së. Ligji për Inspektimin i korrikut 2010 siguron bazën ligjore për një *inspektim të centralizuar të buxhetit* në përputhje me kërkesat e KBFP-së. Kërkohen akte nënligjore të përditësuara, si edhe përpjekjeve të konsiderueshme shtesë për zbatimin e kuadrit ligjor.

*Menaxhimi dhe kontrolli financiar (MKF)* në Shqipëri aktualisht, kuptohet kryesisht në termat e kontrollit, por është konstatuar nevoja për të forcuar llogaridhënien administrative. Një manual për MKF-në është hartuar dhe është miratuar nga Ministri i Financave. Nuk ka linjë sistematike gjurmësh auditimi. Menaxhimi i riskut nuk është zhvilluar ende në mënyrë sistematike. Do të kërkohen përpjekje të konsiderueshme për trajnime dhe rritjen e ndërgjegjësimit për të zbatuar dispozitat ligjore për llogaridhënien administrative dhe parimet e MKF-së. Në lidhje me funksionin e *auditit të brendshëm*, nga pikëpamja organizative auditit i brendshëm është zhvilluar, por strukturat ekzistuese të auditit të brendshëm realizojnë kryesisht, audite lidhur me zbatimin e standardeve. Janë bërë vetëm pak përpjekje për të realizuar auditim e sistemeve ose performancën. Rolet e auditit dhe inspektimit të brendshëm janë të ndara qartë nga pikëpamja ligjore, por duhet të rritet ndërgjegjësimi dhe të krijohet funksioni i inspektimit financiar. Në Ministrinë e Financave janë ngritur dy struktura qendrore për harmonizimin (një për MFK-në dhe tjetra për auditin e brendshëm) për të zhvilluar dhe koordinuar KBFP-në në të gjithë sektorin publik.

Lidhur me **mbrojtjen e interesave financiare të BE-së** (Konventa MIF), vendi është në një fazë të hershme të përgatitjeve legislative dhe administrative. Legjislacioni kombëtar penal i Shqipërisë përmban tashmë shumë elemente të legjislacionit të "MIF" (Konventa për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe protokollat e saj). Në një periudhë afatmesme, Shqipëria do të duhet të sigurojë që dispozitat e mishëruara në Kodin Penal Shqiptar dhe në Kodin e Procedurës Penale shqiptare të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.



Shqipëria duhet të ngrejë një shërbim koordinimi efektiv dhe efikas (AFCOS – Struktura Koordinuese kundër Mashtrimit) për të garantuar respektimin e detyrimeve që lidhen me kontrollet dhe inspektimet e befashme nga Komisioni Europian, sidomos detyrimin për të ndihmuar inspektorët e Komisionit; kjo duhet të arrihet para anëtarësimit. Është hartuar baza ligjore për këtë dhe kanë filluar tashmë përgatitjet për ta vënë atë në funksionim.

Lidhur me *mbrojtjen e euros nga falsifikimet*, ka legjislacion që përfshin lloje të ndryshme falsifikimesh (kartëmonedha, karta krediti dhe letra me vlerë). Shqipëria po punon për ndryshimin e Kodit Penal për të përfshirë dispozita për veprat penale të parave të falsifikuara, si dhe për importin, eksportin dhe transportin e parave të falsifikuara. Legjislacioni ekzistues kombëtar nuk e rregullon faktin se cilat autoritete janë caktuar për centralizimin, analizën teknike dhe përpunimin e informacionit për kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara, si ato euro ashtu edhe monedhat e tjera. Në një periudhë afatmesme, Shqipëria duhet të sigurojë që Kodi i saj Penal dhe ligjet dhe aktet e tjera ligjore për falsifikimin e parave të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së për mbrojtjen e euros nga falsifikimet.

#### *Konkluzioni*

*Në tërësi*, lidhur me kontrollin financiar, Shqipëria i ka filluar përgatitjet, por duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme që legjislacioni i saj të jetë në përputhje me *acquis*, sidomos në fushat e *mbrojtjes së interesave financiare të BE-së* dhe *të mbrojtjes së euros nga falsifikimet* dhe për të zbatuar *acquis* në këtë kapitull me efektshmëri në periudhën afatmesme. Ndërkohë që kuadri ligjor dhe masat institucionale për *kontrollin e brendshëm financiar publik* në pjesën më të madhe ekzistojnë, zbatimi aktual si i parimeve të menaxhimit dhe kontrollit financiar, ashtu edhe i parimeve të auditit të brendshëm duhet të zhvillohen më tej. Kërkohen përpjekje të mëtejshme të konsiderueshme për trajnimet dhe rritjen e ndërgjegjësimit me qëllim që të ngulitet kultura e re e menaxhimit dhe e mjedisit të kontrollit. Lidhur me *auditin e jashtëm*, pavarësia e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) duhet të garantohet dhe Ligji për KLSH duhet të ndryshohet dhe të sillet në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit). Kapacitetet e KLSH-së duhet të forcohen më tej për të garantuar auditim të jashtëm efikas të aktivitetit të qeverisë.

### **3.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore**

Kapitulli 33 përfshin rregullat lidhur me burimet financiare të nevojshme për financimin e buxhetit të BE-së ('burimet e veta'). Këto burime të veta përbëhen kryesisht nga kontributet e Shteteve Anëtare në bazë të (1) burimeve të veta tradicionale që rrjedhin kryesisht nga taksat doganore dhe taksat e sheqerit, (2) burimeve me bazë TVSH-në, dhe (3) burimet me bazë nivelin e AKB-së (të ardhurave kombëtare bruto - GNI).

*Acquis* në këtë kapitull, përbëhet nga legjislacioni i BE-së që është drejtpërdrejt detyrues për Shtetet Anëtare dhe nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar. Sidoqoftë, duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar, që nga momenti i anëtarësimit, zbatimin e plotë dhe korrekt të rregullave për burimet e veta.

Në Shqipëri ekzistojnë parimet institucionet bazë për fushat kryesore të politikave që ndikojnë në sistemin e burimeve të veta. Është në funksionim një sistem kombëtar i TVSH-së, taksat doganore janë vendosur për importet dhe llogaritë kombëtare dhe vlerësimet e PBB-së bazohen në standardet ESA95. Instituti i Statistikave nuk ka krijuar ende një version zyrtar të AKB-së. Kërkohen përpjekje të tjera për të arritur përmbushjen e plotë të standardeve të ESA 95, me qëllim që burimet e AKB-së të llogariten siç duhet.

Lidhur me menaxhimin operacional të sistemit të burimeve të veta, Shqipëria duhet të ketë zhvilluar në momentin e duhur burimet e nevojshme njerëzore dhe **burimet administrative** për zbatimin e rregullave të BE-së lidhur me pagesat në buxhetin e BE-së. Shqipëria duhet të zhvillojë kapacitetet e duhura administrative për të koordinuar siç duhet dhe siguruar parashikimin, llogaritjen, kontabilitetin, mbledhjen, pagimin dhe kontrollin korrekt të burimeve të veta.

#### *Ndikimi*

Duke parë nivelin e PBB-së së saj, pritet që anëtarësimi i Shqipërisë të ketë një ndikim të kufizuar në buxhetin e BE-së. Kjo vlen si për të hyrat e saj të mundshme në kuadër të programeve të ndryshme të shpenzimeve të BE-së, ashtu edhe për kontributin e saj të pritshëm në buxhetin e BE-së në bazë të zbatimit të rregullave mbi burimet e veta.

#### *Konkluzioni*

Nuk ka ndryshime të mëdha ndërmjet sistemeve të Shqipërisë dhe të BE-së për sa i përket parimeve dhe institucioneve bazë që duhen për zbatimin e rregullave me burimet e veta. Në tërësi, nëse do t'i vazhdojë përpjekjet e saj, Shqipëria pritet t'i zhvillojë në periudhën afatmesme kapacitetet për të përmbushur kërkesat e *acquis* në fushën e dispozitave financiare dhe buxhetore.

### **3.34. Vlerësimi i Përgjithshëm**

Aftësia e Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësisë është vlerësuar sipas treguesve të mëposhtëm:

detyrimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit;  
progresit për miratimin, zbatimin dhe sigurimin e respektimit të *acquis* së BE-së.

Shqipëria në tërësi, ka zbatuar mirë detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, megjithëse vëmendje e duhur duhet t'i kushtohet respektimit të afateve të angazhimeve. Deri së fundmi ka pasur edhe disa boshllëqe në zbatimin e disa dispozitave tregtare (pikërisht klauzola e pezullimit në lidhje me taksimin e importeve).

Shqipëria ka miratuar një Strategji Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007-2013) e cila është një plan gjithëpërfshirës dhe ambicioz që parashikon përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së. Vitet e fundit, Shqipëria ka bërë përpjekje të mëdha për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* e BE-së, veçanërisht në disa fusha të tregut të brendshëm, dispozitat që lidhen me tregtinë, doganat dhe tatimet. Megjithatë, vendi përballë me sfida të mëdha në zbatimin dhe sigurimin e

respektimit të legjislacionit. Kapacitetet administrative dhe gjyqësore mbeten në tërësi të kufizuara dhe vendi do të ketë nevojë për përpjekje të qëndrueshme për t'i përforcuar këto kapacitete me qëllim që të jetë në gjendje për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësisë për një periudhë afatmesme..

Nëse vazhdon përpjekjet e saj, Shqipëria pritet të zhvillojë kapacitetet e duhura në periudhën afatmesme për të përmbushur kërkesat e *acquis* në fushat e mëposhtme:

- Taksat
- Politika e ndërmarrjeve dhe industriale
- Shkenca dhe kërkimi shkencor
- Arsimi dhe kultura
- Bashkimi Doganor
- Marrëdhëniet me jashtë
- Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes
- Dispozitat financiare dhe buxhetore

Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar atë me efektshmëri në periudhën afatmesme në fushat e mëposhtme:

- Liria e lëvizjes së punëtorëve
- E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime
- Lëvizja e lirë e kapitalit
- Prokurimet publike
- Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare
- Politika e Konkurrencës
- Shërbimet Financiare
- Energjia
- Politika ekonomike dhe monetare
- Statistikat

- Rrjetet Ndër-Evropiane
- Mbrojtja e Konsumatori dhe e Shëndetit

Në fushat e mësipërme nevojitet përshtatje e mëtejshme e kuadrit ligjor dhe institucional dhe në veçanti përforsimi i kapaciteteve administrative dhe zbatuese.

Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* dhe për ta zbatuar atë me efektshmëri në periudhën afatmesme në fushat e mëposhtme:

- Lëvizja e lirë e mallrave
- Legjislacioni për pronësinë intelektuale
- Shoqëria e informacionit dhe media
- Bujqësia dhe zhvillimi rural
- Politika e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare
- Peshkimi
- Politika e transportit
- Politika sociale dhe punësimit
- Politika rajonale dhe bashkërendimi i instrumenteve strukturorë
- Gjyqësori dhe të drejtat themelore
- Drejtësia, liria dhe siguria
- Kontrolli financiar

Në këto fusha nevojitet përshtatje e konsiderueshme e kuadrit ligjor dhe institucional dhe përforsim domethënës i kapaciteteve administrative dhe zbatuese.

Për sa i përket mjedisit, nevojiten përpjekje shumë të mëdha për ta harmonizuar legjislacionin e brendshëm me *acquis* të BE-së dhe për ta zbatuar atë me efektshmëri. Kjo duhet të përfshijë edhe investime të mëdha dhe forcim të kapaciteteve administrative, me qëllim që të arrihet përputhshmëria për pjesën më të madhe të çështjeve, përfshirë ndryshimet klimatike, në periudhën afatmesme. Përputhshmëria e plotë me *acquis* mund të arrihet vetëm në periudhën afatgjatë dhe kërkon patjetër nivele të larta investimesh.

## Shtojca Statistike

### TË DHËNA STATISTIKORE (më 18 tetor 2010)

#### Shqipëria

<b>Të dhëna bazë</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Popullsia (në mijë)		3 058	3 063	3 084	3 103	3 120	3 135	3 149	3 153	3 170	3 185
Sipërfaqja totale (km <sup>2</sup> )		28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750
<b>Llogaritë Kombëtare</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) (milion ALL)	1)	523 043	583 369	622 711	694 098	751 022	814 797	882 209	967 670	1 088 132e	1 122 566e
PBB ( milion euro)	1)	3 945	4 541	4 705	5 048	5 883	6 561	7 168	7 828	8 861e	8 500e
PBB (euro për frymë)	1)	1 289	1 477	1 521	1 622	1 881	2 088	2 275	2 476	2 785e	2 661e
PBB (sipas Fuqisë Blerëse për frymë (FBS)		:	:	:	:	:	5 000.0	5 500.0	5 800.0	6 500.0	6 400.0
PBB në Fuqi Blerëse për Frymë (BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	22.2	23.2	23.3	25.9	27.1
Norma e rritjes e PBB-së (volumi, leku, ndryshim nga viti i kaluar %)		6.7	7.9	4.2	5.8	5.7	5.7	5.4	5.9	7.7e	3.3
Rritja e Punësimit (llogaritë kombëtare, % ndryshim nga viti i kaluar)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Rritja e Prodhueshmërisë së Punës: rritja e PBB për person të punësuar (ndryshim në % nga viti i kaluar)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Rritja e kostos për njësi punë (llogaritë kombëtare, ndryshim në % nga viti i kaluar)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Prodhueshmëria e Punës (PBB në Fuqi Blerëse për person të punësuar, BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlera bruto e shtuar nga sektorët kryesorë (%)											
Bujqësia dhe peshkimi		25.5	23.6	23.4	23.5	22.3	20.6	19.4	19	18.5e	:
Industria		7.8	7.3	6.9	8.7	10	10.6	11.1	9.4	9.8e	:
Ndërtimi		8.3	10.4	12	13.7	13.9	13.8	14.3	14.8	14.9e	:

Shërbimet		58.5	58.6	57.6	54	53.8	55	55.2	56.8	56.7e	:
Shpenzimet e Konsumit Final, si përqindje e PBB-së (%)		86	80.9	86	86.1	89	88.9	87.4	90.4	89.6	:
Formacioni i kapitalit fiks bruto, si përqindje e PBB-së (%)		31.7	38.4	37.9	40.5	37.2	37	39	38.7	38.1	:
Ndryshime në inventarë, si përqindje e PBB-së (%)		2.4	1.3	0.8	-1.8	-3.8	-1.2	-2.8	-2.4	-1.1	:
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, kundrejt PBB (%)		17.9	18.4	19.6	20.4	22	22.8	24.9	28.1	29.4	:
Importet e mallrave dhe shërbimeve, kundrejt PBB (%)		38.1	39	44.3	45.1	44.4	47.5	48.5	54.8	56.1	:
<b>Industria</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2000=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
<b>Norma e Inflacionit</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Indeksi i Çmimit të Konsumit (CPI), % ndryshim nga viti paraardhës		4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	2	2.5	3.1	2.2	3.5
<b>Bilanci i pagesave</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Bilanci i pagesave: totali i llogarive rrjedhëse (milion euro)		-185	-316	-444	-350	-340	-589	-471	-831	-1 370	-1 346
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: bilanci tregtar (milion euro)		-897	-1 149	-1 218	-1 177	-1 277	-1 477	-1 659	-2 104	-2 431	-2 304
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: shërbimet neto (milion euro)		12	100	-8	-72	-41	-140	-32	13	69	121
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: të ardhura neto (milion euro)		115	150	116	132	138	131	209	217	55	-101
Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave: transfertat rrjedhëse neto (milion euro)		586	583	667	767	839	897	1 011	1 043	937	938
prej tyre transfertat qeveritare (milion euro)		105	31	41	53	61	61	43	60	31	27
Investimet të Huaja Direkte neto (IHD) (milion euro)		157	231	141	157	267	209	250	470	620	680
Investimet të Huaja Direkte (IHD) jashtë shtetit (milion euro)	2)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
nga këto IHD nga ekonomia raportuese e BE-27 (milion euro)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Investimet të Huaja Direkte (IHD) në ekonominë raportuese (milion euro)	2)	157	231	141	157	267	209	250	470	620	680
nga këto IHD të BE-27 në ekonominë raportuese (milion euro)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
<b>Financat Publike</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Deficiti qeveritar/teprica, kundrejt PBB (%)		-7.6	-6.9	-6.1	-4.9	-5.1	-3.5	-3.3	-3.5	-5.5	:
Borxhi qeveritar, kundrejt PBB (%)		60.2	58.5	63.9	61.5	58.3	56.8	56.8	54.8	53.9	:

<b>Treguesit Financiarë</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Borxhi i huaj bruto i ekonomisë, kundrejt PBB (%)		17	17.2	22.1	21.1	19	16.7	17.2	16.6	17.1	:
Borxhi I huaj bruto i ekonomisë, kundrejt eksportit total (%)	3)	94.9	93.1	112.5	103.5	86.5	73	69	59	:	:
Oferta e parasë: M1 (kartëmonedha, monedhat, depozitat ditore, (milion euro)		936	1 113	1 102	1 033	1 332	1 801	1 969	1 963	2 303	2 154
Oferta e parasë: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri në dy vjet, milion euro)		1 995	2 376	2 430	2 555	3 080	3 434	3 879	4 094	4 520	4 378
Oferta e parasë: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme , milion euro)		2 475	3 069	3 083	3 225	3 942	4 614	5 415	6 129	6 643	6 599
Kreditimi total i institucioneve financiare monetare për banorët rezidentë (konsoliduar) (milion euro)		175	217	302	381	566	1 007	1 590	2 377	3 227	3 335
Normat e interesit: norma ditore e parasë, bazë vjetore (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Normat e interesit e huadhënies (një vit), bazë vjetore (%)	4)	24	11.9	15	12.2	15.5	12.4	12.9	11.7	11.8	12.5
Normat e interesit të depozitave (një vit), bazë vjetore (%)	5)	8	7.8	8.5	8.3	6.6	5.1	5.2	5.7	6.9	6.8
Kursi i këmbimit mesatar vjetor - 1 euro = ... lek		132.5 8	128.4 7	132.3 6	137.5 1	127.6 7	124.1 9	123.0 8	123.6 2	122.8	132.06
Indeksi efektiv i kursit të shkëmbimit (2000=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlerat e aktiveve në rezerva (përfshi arin) (milion euro)		697	853	1 704	1 486	1 650	1 885	2 145	2 203	2 658	2 723
<b>Tregtia me jashtë</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Vlera e importeve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)		:	:	1 586.5	1 648.5	1 859.9	2 096.1	2 430.9	3 045.7	3 699.4	:
Vlera e eksporteve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)		:	:	348.3	396.2	485	530.1	628.1	786.1	784.3	:
Bilanci tregtar: të gjithë mallrat, tërë partnerët (milion euro)		:	:	-1 238.2	-1 252.3	-1 374.9	-1 566.0	-1 802.8	-2 259.6	-2 915.1	:
Termet tregtarë (indeksi i çmimit të eksporteve / importeve),		100.2	101.5	99.9	98.2	99	80.3	100.6	98.1	96	97.6
Përqindja e eksportit me BE-27 si përqindje e eksporteve totale (%)		:	:	92.8	93.8	90.7	92	88.6	83.1	76.6	:
Përqindja e importit nga BE-27 si përqindje e importeve totale (%)		:	:	77	74.6	70.4	70.6	65.5	59.8	62.2	:

		2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
<b>Demografia</b>	Shënim										
Rritja natyrale: ndryshimi natyral (lindje minus vdekje) (për 1000 banorë)		11.4	12.5	9.5	9.3	8.1	7.2	5.5	5.9	6.3	:
Vdekshmëria foshnjore: vdekjet e fëmijëve nën një vjeç në 1000 lindje gjallë		13.8	10.8	10.2	8.4	7.8	7.6	7.4	5.6	6	:
Jetëgjatësia: meshkuj (vite)		72.1	72.1	72.1	72.1	72.1	72.1	73.9	72.9	72.9	72.9
Jetëgjatësia: femra (vite)		78.6	77.5	77.9	78.6	78.6	78.6	78	77.8	77.8	77.8
<b>Tregu i Punës</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Popullsia (15-64): popullsia në moshë 15-64 (mijë)	6)	1 939.0	1 773.1	1 767.0	1 825.7	1 850.6	1 876.8	2 022.6	2 106.0 b	2 052.5	2150.6
Aktiviteti ekonomik (15-64): pjesa e pop. 15-64 vjeç ekonomikisht aktive (mije)	6)	1283. 3	1101. 1	1092. 5	1089. 3	1088. 2	1085. 4	1084. 5	1373. 1b	1271.4	1331.9
Punësimi (15-64): pjesa e popullsisë në moshë 15-64 e punësuar (mijë)	6)	1 068.2	920.6	920.1	926.2	931.2	932.1	935.1	1 188.3 b	1 103.5	1147.8
Norma e aktivitetit ekonomik (15-64): % e popullsisë 15-64 vjeç ekonomikisht aktive	6)	66.2	62.1	61.8	59.7	58.8	57.8	53.6	65.2b	61.9	61.9
Norma e punësimit (15-64): pjesa e popullsisë 15-64 vjeç të punësuar (%)	6)	55.1	51.9	52.1	50.7	50.3	49.7	46.2	56.4b	53.8	53.4
Meshkuj të moshës (15-64) vjeç të punësuar (%)	6)	66	64	63.9	62.6	61.2	60	58.8	63.6b	63	64.3
Femra të moshës (15-64) vjeç të punësuar (%)	6)	44.1	39.6	39.7	39.1	38.9	38.8	38.1	49.3b	45.6	43.6
Përqindja e popullsisë në moshë më të madhe (55-64): pjesa e popullsisë e moshës 55-64 e punësuar %		:	:	:	:	:	:	:	46.6	44.0	48.9
Punësimi sipas sektorëve kryesorë (%)											
Bujqësia	6)	71.8	57.7b	57.7	58.2	58.5	58.5	58	47.9b	44.6	44.1
Industria	6)	5.4	7.7b	7.6	7.2	8.1	7.9	8	10.4b	9.3	10
Ndërtimi	6)	1.2	6.1b	6.1	6	5.5	5.5	5.7	8.2b	8.5	9.9
Shërbimet	6)	21.5	28.5b	28.6	28.5	27.9	28.1	28.3	33.5b	37.6	36
Papunësia: krahu i punës i papunë (%)	7)	16.8	16.4	15.8	15	14.4	14.1	13.8	13.5b	13	13.8



Meshkuj të papunë të krahut të punës (%)	7)	14.9	14.2	13.6	12.9	12.4	12.1	11.8	14.4b	12.5	12.2
Femra të papuna të krahut të punës (%)	7)	19.3	19.9	19.1	18.2	17.5	17.2	16.8	12.2b	13.5	15.9
Papunësia e personave < 25 vjeç: krahut të punës <25 i papunë (%)	7)	:	:	26.8	:	:	:	:	20.1b	27.2	27.2
Papunësia afat-gjatë: % e krahut të punës në papunësi për 12 muaj a më shumë (%)	7)	:	:	:	:	:	:	:	9.3b	8.5	9.1
<b>Kohezioni Social</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Rrogat mesatare mujore nominale (lek)		14 963.0	17 218.0	19 659.0	21 325.0	24 393.0	26 808.0	28 822.0	33 750.0	36 537.0	40 874.0
Indeksi i rrogave reale (indeksi i rrogave nominale pjesëtuar me CPI) (2000=100)		:	11.6	21.1	27.8	42.8	53.3	60.9	83.1	91.7	109.8
Braktisja e hershme e shkollës - pjesa e popullatës e moshës 18-24 vjeç që nuk ka përfunduar arsimin e mesëm dhe që aktualisht nuk merr arsimim ose formim profesional (%)		:	:	:	:	:	:	:	42.0	39.0	:
<b>Standardi i jetesës</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Numri i automjeteve për 1000 banorë		37.4	43.6	48.2	56.4	60.9	62.2	71.4	89.1	91.4	:
Numri i abonimeve në shërbimin celular për 1000 banorë		:	120.8	259.4	370.6	403.6	488	561.7	:	:	:
<b>Infrastruktura</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksionim, për 1000 km <sup>2</sup> )		13.9	14.3	15	15	15.1	15	13.9	13.9	13.9	13.9
Gjatësia e autostradave (mijëra km)		:	:	:	0	0	0	0	0	0	:
<b>Novacioni dhe kërkimi shkencor</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Shpenzimet për burime njerëzore (shpenzimet publike për arsimin, në raport me PBB (%))		3.1	3.3	3	3.1	3.2	3.2	3.1	3.2	3.5	3.4
Shpenzimet e brendshme bruto për kërkimin shkencor dhe zhvillimin, në raport me PBB (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Përqindja e familjeve që kanë akses në internet në shtëpi (%)		:	:	:	:	:	1.5	:	:	3.4	:
<b>Mjedisi</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009

Totali i shkarkimeve të gazrave serë, CO2 ekuivalent ( tonë, 1990=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg i ekuivalentit naftë për 1000 euro Pbb0)		400.5	386.5	356.3	370.6	384	366.5	328.9	306.6	259.2e	:
Përqindja e energjisë së rinovueshme në konsumimin e energjisë elektrike (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Transport rrugor mallrash si përqindje e transportit total tokësor të mallrave (%) (% tonë-km)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
<b>Energjia</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Prodhimi parësor i të gjithë produkteve të energjisë (mijë TOE (ekuivalenti i një Ton Naftë))		987	933	896	1 012	1 178	1 149	1 237	1 080	1 159	:
Prodhimi parësor i naftës së papërpunuar (mijë TOE)		314	335	308	359	443	418	500	564	578	:
Prodhimi parësor i antracitit dhe linjitit (mijë TOE)		20	15	5	19	19	15	15	15	20	:
Prodhimi parësor i gazit natyror (mijë TOE)		12	8	8	12	9	10	10	16	8	:
Importet neto të të gjitha produkteve të energjisë (mijë TOE)		858	1 001	965	1 043	1 080	1 130	826	1 020	1 033	:
Konsumimi i brendshëm bruto i energjisë (mijë TOE)		1 845	1 934	1 861	2 055	2 258	2 279	2 156	2 130	2 119	:
Prodhimi/gjenerimi i energjisë(mijë GWh)		4.7	3.7	3.2	4.9	5.5	5.5	5.6	3	3.9	5.2
<b>Bujqësia</b>	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor për mallrat dhe shërbimet (çmimet e prodhuesit, viti pararendës =100)		:	:	:	102.9	105.1	101.2	102.5	100.4	107.4	:
Sipërfaqja totale bujqësore e përdorur (mijëra hektarë)		1 144	1 139	1 140	1 121	1 122	1 077	1 120	1 121	1 146	1 164
Blegtori: gjedh (mijëra kokë, fundi i periudhës)		728	708	690	684	654	655	634e	577	541	494
Blegtori: derra (mijëra kokë, fundi i periudhës)		103	106	114	132	143	147	152e	147	161	160
Blegtori: bagëti të imta (mijëra kokë, fundi i periudhës)		3 045	2 933	2 773	2 919	2 739	2 701	2 770e	2 729	2 620	2 540
Prodhimi dhe përdorimi i qumështit në fermë (qumështi total, mijëra tonë)		948	984	1 010	1 060	1 064	1 076	1 102e	1 016	1 040	1 045
Prodhimi i të mbjellave: drithëra (përfshi orizin) (mijëra tonë, prodhimi i korrur)		566	503	519	489	499	511	508	494	609	:
Prodhim i të mbjellave: panxhar sheqeri (mijëra tonë, prodhim i korrur)		42	39	39	50	40	40	:	:	:	:
Prodhim i të mbjellave: perimet (mijëra tonë, prodhim i korrur)		620	677	669	675	678	685	688	672	715	730

: nuk ka

e = vlerë e llogaritur

b = thyerje ose ndërprerje në seri

- 1) Vlerat e 2009 janë bazuar në shumën e të dhënave tre-mujore, të kthyera në çmimet aktuale për 2009.
- 2) Janë përdorur shenjat konvencionale për bilancin e pagesave. Për IHD jashtë vendit, shenja minus do të thotë se investimi dalës sipas ekonomisë raportuese e tejkaloj investimin hyrës në këtë periudhë, kurse një shifër pa shenjë do të thotë se tërheqja e investimeve tejkaloj investimet. Për IHD në ekonominë raportuese një shifër pa shenjë do të thotë që investimet në ekonominë që raportohet tejkalojnë tërheqjen e investimeve kapitale, ndërsa, një shenjë minus tregon që tërheqja e investimeve kapitale tejkalon investimet..
- 3) Disbursimi i Borxhit të Vonuar/pa paguar (DOD) rezervat kumulative përfshin borxhin publik të jashtëm dhe borxhin me garanci publike, por që nuk përfshin kreditë nga FMN. Eksportet totale janë llogaritur sipas koncepteve të llogarive kombëtare.
- 4) Normat mesatare e ponderuar për huat e reja 12-mujore në muajin përkatës, me maturim 12-mujor.
- 5) Normat e interesit të depozitave përfaqësojnë normën e ponderuar mesatare të depozitave të sapopranuara në muajin përkatës, me maturim 12-mujor.
- 6) Për 2001-2006 të dhënat administrative (informacion vetëm për popullsinë meshkuj të moshës 15-59 dhe të popullsisë femra të moshës 15-54); nga 2007 e më pas të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore.
- 7) Nga 2000 deri me 2006 treguesit e papunësisë i referohen të dhënave administrative; nga 2007 treguesit e papunësisë i referohen të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore.